International Partnerships Austria

Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

ME ÇFARË ÇMIMI?

Vlerësimi i kostove të shërbimeve të specializuara për adresimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë



© Rrjeti i Grave të Kosovës, 2026

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Autore: Era Kadriu, Nicole Farnsworth dhe Donika Elshani

Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të International Partnerships Austria. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autoreve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e International Partnerships Austria.

FALËNDERIME

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) falënderon të gjithë përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave që ndanë kohën e tyre dhe kontribuuan në këtë hulumtim. Dr. Elisabeth Klatzer dha këshilla për metodologjinë. Ekipi hulumtues i RrGK-së përbëhej nga Nicole Farnsworth, Era Kadriu, Donika Elshani, Besarta Breznica dhe Adelina Berisha, të cilat realizuan intervistat, i transkriptuan dhe i analizuan ato, si dhe hartuan këtë raport. Ekipi menaxhues i RrGK-së ofroi mbështetje të vazhdueshme gjatë gjithë procesit të hulumtimit dhe hartimit të raportit, duke përfshirë Igballe Rogovën, Zana Rudin dhe Besa Shehun. Arbenita Kllokoqi ndihmoi në sigurimin e cilësisë së llogaritjeve financiare, ndërsa Erkenda Kabashi, Elirjeta Beka, Mirjeta Ademi, Melisë Mustafaj dhe Melisa Kadolli ndihmuan me shqyrtimin e dokumenteve. Liridona Shkodra, Blerona Sojeva, Liza Qafleshi, Puhiza Shemsedini, Driana Mustafa dhe Mrika Rrustemi kontribuuan vullnetarisht në transkriptimin e intervistave. Ebba Hellman koordinoi vullnetarët. Loreta Suka ndihmoi me përkthimin, ndërsa Laurie Engelhardt në mënyrë vullnetare kreu lekturimin e versionit anglisht të raportit. Ekipi hulumtues falënderon recensentët që në mënyrë vullnetare dhanë komentet e tyre të vlefshme mbi draft-raportin: Ministria e Drejtësisë, Koordinatorja kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore; Valentina Bejtullahu, zyrtare kombëtare e programit, dhe Yulia Safranova, zyrtare e lartë ligjore në Misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë; Adile Shaqiri, udhëheqëse e Divizionit për Shërbime Sociale dhe Familjare në Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ); Bind Skeja, drejtor ekzekutiv i Qendrës për Informim dhe Përmirësim Social; Arber Nuhiu, drejtor ekzekutiv i Qendrës për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD); Donjeta Morina, eksperte e barazisë gjinore; Dr. Bergita Curri, eksperte e mjekësisë ligjore në Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML); dhe Ardita Ramizi Bala, drejtoreshë e Qendrës për Mirëqenien e Gruas (strehimore). Ky raport nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e International Partnerships Austria.

Përmbajtja

FALËNDERIME 3
SHKURTESAT 5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 7
HYRJE 9
Rreth këtij hulumtimi: Metodologjia e përmbledhur 9
Çfarë përmban ky raport? 11
KAPITULLI 1. ANALIZA LIGJORE 12
Detyrimet ligjore për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor 12
Korniza ligjore lidhur me dhunën me bazë gjinore 16
Zotimet buxhetore për adresimin e dhunës me bazë gjinore 42
KAPITULLI 2. NË PËRMBLEDHJE: KOSTOT E SHËRBIMEVE TË SPECIALIZUARA PËR ADRESIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE 49
Linja telefonike SOS 49
Qendra e Krizave për Rastet e Përdhunimit dhe Qendra e Referimit për Dhunën Seksuale 58
Strehimoret 76
Banimi social 98
Menaxhimi i rasteve, koordinimi dhe shërbimet sociale të specializuara 103
Përfundim: Kostot e përgjithshme 108
REKOMANDIME 111
PUNIMET E CITUARA 120
SHTOJCAT 123
Shtojca 1. Proceset buxhetore dhe mundësitë për të ndikuar në buxhete 123
Shtojca 2. Buxhetet komunale për stafin që ofron shërbime sociale 126
Shtojca 3. Programet Komunale për Banim Social 129

SHKURTESAT

ABGj	Agjencia për Barazi Gjinore
AR	Agjenda e reformave
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BP	Ballkani Perëndimor
BPGj	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor
BPV	Bruto Produkti Vendor
CEDAW	Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave
CEL	Qendra për Barazi dhe Liri
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
CSGD	Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GREVIO	Grupi i ekspertëve për veprim kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
IST	Infeksionet seksualisht të transmetueshme
KAB	Korniza afatmesme buxhetore
KASh	Korniza afatmesme e shpenzimeve
KDF	Konventa për të drejtat e fëmijës
KDPAK	Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KS	Konventa e Stambollit
LBGj	Ligji për barazi gjinore
LDhBGj	Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore
LGBTQI+	Persona lezbike, gej, biseksualë, transgjinorë, kuir, interseks, aseksualë dhe persona me identitete të tjera
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MKL	Mekanizmi Koordinues Lokal kundër dhunës në familje
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPFVLÇ	Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare
MVPT	Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPS	Objekt i përkohshëm i sigurisë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OShC	Organizata e shoqërisë civile
OShCG	Organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e grave
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PEFA	Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënia Financiare
PKBGj	Programi i Kosovës për barazi gjinore 2020–2024
PKIE	Programi Kombëtar për Integrim Evropian
PSV	Procedurat standarde të veprimit
QPS	Qendra për Punë Sociale
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës

SART	Ekipet e reagimit ndaj sulmeve seksuale (*Sexual Assault Response Teams*)
SANE	Infermierët Ekzaminues të Sulmit Seksual
SKDhG	Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022–2026
VNGj	Vlerësimi i ndikimit gjinor
UNMIK	Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZBGj	Zyrtar/e për barazi gjinore
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) e realizoi këtë hulumtim me qëllim të shqyrtimit të financimit të shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore. Hulumtimi vlerëson nëse Qeveria e Kosovës ka ndarë dhe ka shpenzuar fonde të mjaftueshme për këto shërbime, në përputhje me Konventën e Stambollit (KS), gjatë periudhës 2022-2025, si dhe nëse është planifikuar buxhet i mjaftueshëm për periudhën 2026-2029. Gjithashtu, aty përllogariten kostot e shërbimeve të specializuara sipas standardeve të KS-së dhe legjislacionit të Kosovës.

Kosova ka një kornizë ligjore mjaft gjithëpërfshirëse që rregullon shërbimet e specializuara për trajtimin e dhunës me bazë gjinore. Në vitin 2020, Kushtetuta u ndryshua me qëllim të përfshirjes së KS-së, ndërsa disa ligje janë rishikuar në mënyrë që të harmonizohen me standardet e saj. Që nga viti 2015, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGj) është detyrim ligjor për të gjitha institucionet sipas Ligjit për Barazi Gjinore (LBGj), i cili kërkon që ligjet, politikat dhe buxhetet të hartohen në bazë të analizës gjinore. BPGj-ja ende nuk është integruar plotësisht në sistemet e menaxhimit financiar, gjë që e pengon zbatimin e saj. Strategjitë dhe planet e veprimit përmbajnë masa për trajtimin e dhunës me bazë gjinore, por jo gjithmonë i përcaktojnë qartë institucionet përgjegjëse për buxhetimin apo shumat që duhet të ndahen. Disa masa varen nga donatorët ose shoqëria civile, prandaj buxhetet mund të jenë të pamjaftueshme. Buxhetet afatmesme dhe vjetore nuk i ndërlidhin qartë ndarjet buxhetore me ligjet, strategjitë dhe planet e veprimit. Shtojcat e kërkuara të BPGj-së nuk e kanë përfshirë një informacion të tillë dhe as nuk janë publikuar në mënyrë të qëndrueshme. Linja buxhetore e Ministrisë së Drejtësisë për subvencionimin e shërbimeve të specializuara është rritur, mirëpo fondet nga kjo linjë nuk ndahen vetëm për strehimoret. Edhe ndarjet buxhetore të komunave për trajtimin e dhunës me bazë gjinore kanë qenë të paqëndrueshme.

Kosova nuk ka një linjë telefonike të dedikuar, me mbulim në të gjithë vendin, që funksionon 24 orë në ditë, që është pa pagesë dhe konfidenciale, si dhe që mbulon të gjitha format e dhunës ndaj grave në përputhje me kërkesat e nenit 24 të KS-së. Ministria e Drejtësisë mund të ndajë fonde në formë subvencioni dhe të kontraktojë një organizatë joqeveritare (OJQ) të konsoliduar dhe me përvojë për ta menaxhuar Linjën Telefonike, me një kosto të përllogaritur prej 150.727 € në vitin 2027. Nëse duhet të krijohet dhe të pajiset një hapësirë e re, kostoja do të jetë më e lartë. Nëse Ministria e Drejtësisë vendos që Linja Telefonike të menaxhohet nga Qeveria, do të duhet të krijohen linja më të qarta buxhetore dhe të merren parasysh edhe kostot fillestare. Në këtë rast, duhet të buxhetohen rreth 154.043 € për vitin 2028 dhe 157.124 € për vitin 2029.

Kosova nuk ka një Qendër të Krizave për Rastet e Përdhunimit ose një Qendër Referimi për Dhunën Seksuale, në përputhje me standardet e nenit 25 të KS-së. Ky raport propozon themelimin e të dyja këtyre shërbimeve të specializuara. **Një Qendër e Referimit për Dhunën Seksuale** duhet të themelohet urgjentisht, duke siguruar lidhje të ngushta me shërbimet e mjekësisë ligjore, shëndetësore, psikosociale, ligjore dhe shërbime të tjera përkatëse, pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML) dhe të financohet nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë. Themelimi i Qendrës në vitin 2027 do të kushtojë deri në 302.831 €, pa përfshirë koston e infrastrukturës. Për vitin 2028 parashihet një buxhet prej rreth 218.289 €, ndërsa për vitin 2029 prej 222.655 €. Një **Qendër e Krizave për Rastet e Përdhunimit** duhet të themelohet pranë saj, në Prishtinë, në vitin 2028 dhe të fillojë punën në vitin 2029. Kostot e funksionimit të saj në vitin 2029 do të jenë rreth 158.539 €, pa llogaritur qiranë. Edhe pse ende nuk ekziston korniza e politikave që rregullon funksionimin e kësaj Qendre, për të siguruar menaxhim gjithëpërfshirës të shërbimeve të specializuara, Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ) duket të jetë institucioni më i përshtatshëm për ta financuar funksionimin e tyre drejtpërdrejt ose përmes subvencioneve.

Strehimoret për të mbijetuarat/it e dhunës në familje që u shërbejnë disa komunave nuk kanë financim të mjaftueshëm për të funksionuar në përputhje me standardet zyrtare. Financimi i strehimoreve ekzistuese do të kushtojë 2.339.632 € në vitin 2027, 2.605.110 € në vitin 2028 dhe 2.654.152 € në vitin 2029. Për të siguruar efikasitet, ministria përgjegjëse, aktualisht MPFVLÇ-ja, duhet t'i financojë plotësisht strehimoret. Ndërkohë, komunat mund të ndajnë hapësira dhe toka për zgjerimin e strehimoreve ekzistuese dhe ndërtimin e strehimoreve të tjera, në përputhje me kërkesat e KS-së. Komunat mund të ndajnë buxhet për infrastrukturën mbështetëse, ndërsa kostot e saj mund të përllogariten në vitin 2027 dhe të shërbejnë si bazë për përcaktimin e kostove të ardhshme të ndërtimit.

Komunat duhet të sigurojnë që të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore të përfshihen shprehimisht në kriteret e pranueshmërisë, mekanizmat e përcaktimit të përparësisë dhe procedurat e ndarjes së **banimit social**, duke përfshirë rregullimin e kësaj çështjeje edhe përmes rregulloreve komunale. Ministria e Financave (MF) dhe komunat duhet ta përmirësojnë buxhetimin për **shërbimet sociale**, duke përfshirë 18.130 € shtesë për punësimin e dy punonjësve socialë shtesë në secilën komunë dhe 36.260 € për katër punonjës socialë shtesë në Prishtinë. Kostoja e përgjithshme do të ishte 707.078 € në vitin 2027, 722.634 € në vitin 2028 dhe 737.086 € në vitin 2029. Nevojiten sisteme më të mira për monitorimin e numrit të rasteve dhe të orarit të punës, në mënyrë që të përllogaritet më saktë koha e nevojshme për menaxhimin cilësor të rasteve dhe për organizimin e punës me ndërrime të punonjësve socialë, duke përfshirë kompensimin për punën jashtë orarit, gjatë natës dhe fundjavave. Komunat duhet të ndajnë gjithashtu buxhet për mekanizmat koordinues lokalë kundër dhunës në familje (MKL-të), banimin social dhe fondet emergjente. Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave mund të mundësojë buxhetim më të mirë për të gjitha shërbimet sociale.

HYRJE

Të gjitha qeveritë e Ballkanit Perëndimor (BP) janë zotuar për zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e njohur si "Konventa e Stambollit" (KS). Kjo i obligon shtetet të ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse dhe të përqendruara te të mbijetuarat/it për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.[1] Ndonëse Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës dhe për rrjedhojë nuk është palë në Konventë në kuptimin e zakonshëm të një traktati ndërkombëtar, KS-ja është përfshirë në kornizën kushtetuese të Kosovës. Që nga 25 shtatori 2020, ajo është pjesë e instrumenteve të renditura në nenin 22 të Kushtetutës dhe është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë.

Pavarësisht zotimeve për zbatimin e KS-së, qeveritë e BP-së, përfshirë Kosovën, rrallë kanë ndarë buxhete të mjaftueshme për këto shërbime. Ndonëse Kosova ka rritur ndarjet buxhetore për strehimoret, të dhënat tregojnë se disa shërbime mbeten të nënfinancuara.[2] Përdorimi i BPGj-së për të vlerësuar me saktësi kostot e shërbimeve të specializuara është thelbësor për të siguruar ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme dhe cilësore, në përputhje me KS-në. Megjithëse Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj) ka hartuar udhëzime për buxhetimin e funksionimit të strehimoreve në vitin 2019,[3] ato nuk janë përdorur çdo vit nga institucionet përgjegjëse për planifikimin e saktë të buxheteve vjetore për shërbimet e strehimit. Po ashtu, nuk është bërë vlerësimi i kostove për shërbimet e tjera të specializuara. Ky raport synon t'i ofrojë Qeverisë së Kosovës një metodologji të përditësuar për vlerësimin e kostove, në përputhje me standardet e KS-së, për të gjitha shërbimet e specializuara. Gjithashtu, raporti përmbledh të dhëna mbi trendet e buxheteve dhe shpenzimeve të mëparshme, të cilat Qeveria mund t'i përdorë për vlerësimin vjetor të kostove të këtyre shërbimeve, në përputhje me KS-në.

Rreth këtij hulumtimi: Metodologjia e përmbledhur

Si pjesë e një studimi rajonal, metodologjia është mbështetur në praktikat më të mira në fushën e BPGj-së, duke u bazuar në udhëzimet ekzistuese për vlerësimin e kostove të shërbimeve të ngjashme, udhëzimet e ABGj-së [4] dhe metodologjinë e njohur ndërkombëtarisht të RrGK-së për vlerësimin e kostove. [5] Hulumtimi ka përdorur qasjen e vlerësimit të kostos për njësi, duke u fokusuar në vlerësimin e kostove reale të ofrimit të shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore. Në këtë raport, termi "të mbijetuarat/it" përdoret përgjithësisht kur bëhet fjalë për mbrojtjen, mbështetjen dhe shërbimet sociale, ndërsa termi "viktimat" përdoret në kontekstin ligjor, procedural dhe të drejtësisë penale, në përputhje me terminologjinë e përdorur në legjislacionin përkatës.

[1] Këshilli i Evropës, *Convention on Preventing and Combating Violence Against Women and Domestic Violence* [Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje], 2011.
[2] RrGK, Zero tolerancë? Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë, 2025.
[3] ABGj, Buxhetimi operacional i strehimoreve në Kosovë dhe udhëzuesi i projektimit2019.
[4] Po aty.
[5] RrGK, *Me çfarë çmimi? Alokimet buxhetore për zbatimin e kornizës ligjore kundër dhunës në familje në Kosovë* 2012. Fillimisht i hartuar në konsultim me eksperten ndërkombëtare të BPGj-së, Dr. Elizabeth Villagomez, ai është përdorur më pas si referencë për ushtrime të ngjashme të përllogaritjes së kostove në disa vende.

Pyetjet e hulumtimit

Pyetjet kryesore të hulumtimit që kanë udhëhequr këtë hulumtim janë: (1) në çfarë mase Qeveria e Kosovës ka ndarë dhe shpenzuar fonde të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve të specializuara për trajtimin e dhunës me bazë gjinore, në përputhje me KS-në, gjatë viteve 2022–2025, si dhe ka planifikuar fonde të mjaftueshme në buxhet për periudhën 2025–2029; dhe (2) cilat janë kostot e vlerësuara për ofrimin e këtyre shërbimeve në përputhje me kërkesat e KS-së për periudhën 2026–2029, përfshirë mbështetjen për organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e grave (OShCG) që i ofrojnë ato?

Metodat e hulumtimit dhe burimet e të dhënave

Për t'iu përgjigjur pyetjeve të hulumtimit, metodologjia ka zbatuar një qasje me metoda të përziera, duke kombinuar metoda dhe analiza cilësore e sasiore, si në vijim:

- **Analizën juridike** të ligjeve dhe politikave ekzistuese që lidhen me shërbimet e specializuara për adresimin e dhunës me bazë gjinore, në përputhje me KS-në. Me këtë rast, janë analizuar ligjet, strategjitë dhe raportet për të identifikuar mangësitë në kornizën ligjore, si dhe për të përcaktuar shkallën në të cilën dokumentet dhe proceset buxhetore kanë përfshirë BPGj-në. Gjithashtu, është analizuar nëse është parashikuar buxhet i mjaftueshëm për këto shërbime të specializuara për adresimin e dhunës me bazë gjinore, sipas KS-së.
- **Analizën institucionale** të institucioneve kryesore përgjegjëse për buxhetimin dhe ofrimin e shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore. Të dhënat janë mbledhur nga uebfaqet e institucioneve, raportet dhe literatura ekzistuese.
- **Analizën buxhetore** për të vlerësuar deri në çfarë mase Qeveria e Kosovës ka ndarë dhe shpenzuar fonde të mjaftueshme për shërbimet e specializuara për trajtimin e dhunës me bazë gjinore gjatë viteve 2022–2024, si dhe ka planifikuar buxhete adekuate për periudhën 2025–2027. Analiza ka përfshirë shqyrtimin e linjave specifike buxhetore për këto shërbime, shpenzimeve faktike, joefikasiteteve, përfituesve dhe ndikimit të shpenzimeve. Burimet e të dhënave kanë përfshirë buxhetet e qeverisë, raportet e shpenzimeve, raportet e auditimit, të dhënat institucionale dhe literaturën tjetër përkatëse.
- **Analizën e kostove**, e cila ka zbatuar praktikat më të mira në BPGj për të vlerësuar kostot e shërbimeve të specializuara për mbështetjen e të mbijetuarave/ve të dhunës me bazë gjinore, bazuar në KS. Kjo ka përfshirë shqyrtimin e kostove, të shpenzimeve të mëparshme dhe të çmimeve të tregut, si dhe zhvillimin e intervistave me palët kryesore të interesit. Gjetjet kanë shërbyer si bazë për hartimin e parashikimeve buxhetore.
- **Anketën me komunat** për të mbledhur të dhëna lidhur me financimin e shërbimeve sociale të specializuara për trajtimin e dhunës me bazë gjinore, përfshirë burimet e financimit, boshllëqet dhe sfidat në financim, si dhe mbështetjen financiare të planifikuar nga komunat. Nga gjithsej 38 komuna, vetëm nëntë janë përgjigjur.

Vlefshmëria

Hulumtimi ka përdorur triangulimin e metodave, të burimeve të të dhënave dhe të anëtarëve të ekipit me ekspertizë nga disiplina të ndryshme, si dhe verifikimin nga pjesëmarrësit, me qëllim rritjen e vlefshmërisë së hulumtimit.

Kufizimet

Ky hulumtim është fokusuar në shërbimet e specializuara. Nuk janë shqyrtuar kostot e parandalimit (p.sh., ndërgjegjësimit), mbrojtjes dhe/ose drejtësisë (p.sh., veprimtarisë policore, ndjekjes penale dhe gjykatave), pasi kanë qenë jashtë fushëveprimit të këtij hulumtimi. Megjithatë, ka pasur disa përjashtime, ku shërbimet e rehabilitimit dhe riintegrimit kanë përfshirë edhe kosto të parandalimit, siç janë materialet informuese të shpërndara për shërbimet në dispozicion. Hulumtimi nuk ka përfshirë studime të fizibilitetit për zhvillimin e infrastrukturës. Po ashtu, ai nuk ka shqyrtuar kostot që dhuna i shkakton shoqërisë, përfshirë të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore dhe familjet e tyre. Këto çështje duhet të jenë objekt i hulumtimeve të veçanta.

Çfarë përmban ky raport?

Ky raport është i ndarë në tre kapituj. Kapitulli i parë shqyrton deri në çfarë mase korniza ligjore kërkon zbatimin e BPGj-së në adresimin e dhunës me bazë gjinore. Ky kapitull analizon kornizën ligjore që rregullon ofrimin e shërbimeve në përputhje me kërkesat e KS-së, duke shqyrtuar gjithashtu deri në çfarë mase strategjitë dhe planet e veprimit për adresimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë kanë parashikuar burime të mjaftueshme për këto shërbime.

Kapitulli i dytë shqyrton kërkesën për shërbime dhe kostot e shërbimeve të specializuara, në përputhje me kërkesat e KS-së. Në këtë kapitull analizohen ndarjet e përgjithshme buxhetore dhe shpenzimet që lidhen me dhunën me bazë gjinore, si dhe përfshin vlerësimet e shpenzimeve të nevojshme. Gjithashtu, përfshin përgjegjësitë dhe kapacitetet institucionale për mbledhjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave mbi përfituesit dhe për buxhetimin e shërbimeve të specializuara.

Kapitulli i fundit ofron rekomandime për institucionet përgjegjëse.

Duhet të theksohet se të gjitha shifrat janë rrumbullakuar në numrin e plotë më të afërt për ta lehtësuar leximin.

KAPITULLI 1. ANALIZA LIGJORE

Ky kapitull fillimisht shqyrton deri në çfarë mase korniza ligjore përcakton detyrimin për zbatimin e BPGj-së, veçanërisht në lidhje me adresimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Së dyti, analizon kornizën ligjore që rregullon ofrimin e shërbimeve të specializuara në përputhje me kërkesat e KS-së, duke vlerësuar nëse strategjitë dhe planet ekzistuese të veprimit kanë siguruar burime të mjaftueshme për ofrimin e këtyre shërbimeve. Së treti, shqyrton zotimet buxhetore për financimin e shërbimeve të specializuara.

Detyrimet ligjore për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor

Ky seksion shqyrton deri në çfarë mase korniza ligjore kërkon zbatimin e BPGj-së, veçanërisht në lidhje me adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Ligji për barazi gjinore

Në vitin 2015, Kuvendi i Kosovës miratoi LBGj-në e re.[6] Ky ligj përcakton masat e përgjithshme dhe të veçanta për garantimin e të drejtave të barabarta për gratë dhe burrat, si dhe përcakton institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre. Ligji e përcakton BPGj-në si një detyrim kyç ligjor për institucionet publike. Ai kërkon që të gjitha institucionet publike, përfshirë institucionet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor dhe strukturat e tjera shtetërore të zbatojnë BPGj-në.[7] Ligji e përkufizon BPGj-në si një mjet thelbësor për të siguruar që barazia gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe ndarjen e burimeve publike. Ligji gjithashtu kërkon që perspektiva gjinore të integrohet në të gjitha politikat, programet dhe proceset publike,[8] përfshirë ato që lidhen me buxhetimin dhe shërbimet e specializuara. Prandaj, nga këndvështrimi i integrimit gjinor, BPGj-ja duhet të jetë pjesë përbërëse e hartimit të politikave, planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të të gjitha programeve, përfshirë shërbimet e specializuara për trajtimin e dhunës me bazë gjinore. LBGJ-ja kërkon që parimet e barazisë gjinore dhe integrimi i perspektivës gjinore të zbatohen në të gjitha fazat e analizës, planifikimit, buxhetimit dhe zbatimit të politikave dhe legjislacionit nga subjektet publike dhe private, përfshirë mbledhjen dhe analizën e rregullt të të dhënave të ndara sipas gjinisë, si dhe ndarjen e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të mbështetur arritjen e barazisë gjinore.

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Ky ligj përcakton mënyrën se si fondet publike ndahen nga qeveria qendrore ndërmjet ministrive, komunave dhe agjencive shtetërore.[9] Ai duhet të zbatohet së bashku me LBGj-në. Megjithatë, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nuk kërkon shprehimisht zbatimin e BPGj-së dhe as nuk përcakton mënyrën e zbatimit të saj si pjesë e procesit buxhetor. Kjo ka dobësuar përpjekjet e qeverisë për të siguruar zbatimin e BPGj-së në të gjitha ministritë dhe komunat, përfshirë në lidhje me shërbimet e specializuara.[10] Në vitin 2025, Qeveria kishte planifikuar ta ndryshonte këtë ligj si pjesë e reformave të

[6] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-020 për barazi gjinore, 2015.
[7] Po aty. Neni 5.1.5.
[8] Po aty, neni 4 dhe 6.
[9] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë 2008.
[10] Zyra e Kryeministrit, Programi i Kosovës për barazi gjinore 2020–2024, 2020.

vazhdueshme të financave publike në kuadër të procesit të anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian (BE). Kjo u shty për shkak të paqëndrueshmërisë politike dhe ishte planifikuar të realizohej në qershor 2026,[11] megjithëse mund të ketë vonesa si rrjedhojë e zgjedhjeve parlamentare të 7 qershorit 2026.

Ligji për financat e pushtetit lokal

Ligji për financat e pushtetit lokal, i miratuar në vitin 2008 dhe i ndryshuar në vitin 2016, rregullon financimin e komunave në Kosovë.[12] Ky ligj përcakton Grantin e Përgjithshëm për komunat në masën 10% të të hyrave totale të qeverisë qendrore, me disa përjashtime, si dhe formulën për shpërndarjen e këtij granti ndërmjet komunave. Granti i Përgjithshëm ndahet sipas madhësisë së popullsisë (89%), popullsisë së komuniteteve pakicë (3%), komunave ku shumica e popullsisë përbëhet nga pakicat kombëtare (2%) dhe madhësisë gjeografike (6%).[13] Komunat marrin gjithashtu grante të veçanta për kujdesin shëndetësor parësor dhe arsimin. [14]

Ligji u lejon komunave të krijojnë të hyra vetanake përmes tatimit në pronë, licencave dhe tarifave. Megjithatë, ato vazhdojnë të jenë shumë të varura nga transferet e qeverisë qendrore. Historikisht, më shumë se 80% e buxheteve komunale kanë ardhur nga grantet qeveritare.[15] Grantet përbënin rreth 81% të të hyrave komunale në vitin 2012 dhe ky model ka vazhduar edhe në vitet pasuese. Sipas kornizës buxhetore komunale për vitet 2024–2026, grantet e qeverisë qendrore ishin planifikuar të siguronin pjesën më të madhe të financimit komunal, duke përbërë 85.4% të financimit total komunal në vitin 2024, 85.7% në vitin 2025 dhe 85.3% në vitin 2026.[16]

Komunat janë përgjegjëse për financimin e shërbimeve sociale, përfshirë shërbimet për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, kryesisht përmes fondeve nga Granti i Përgjithshëm. Ndryshe nga sektori i arsimit dhe ai i shëndetësisë, shërbimet sociale nuk kanë një kod të veçantë buxhetor. Shërbimet sociale financohen nga e njëjta kategori e buxhetit komunal si infrastruktura dhe shpenzimet administrative. Prandaj, financimi i shërbimeve sociale është në "konkurrencë" me shpenzimet tjera komunale.[17] Ndarjet buxhetore nuk përcaktohen në bazë të vlerësimit të nevojave për shërbime sociale. Disa akterë kanë kërkuar një grant specifik për shërbime sociale ngjashëm me grantet specifike për shëndetësi dhe arsim për të siguruar fonde për shërbime sociale, të dizajnuara në bazë të nevojave. [18]

Ligji nuk përfshin perspektivën gjinore në llogaritjen ose shpërndarjen e Grantit të Përgjithshëm. Formula e ndarjes nuk përfshin analizën gjinore, BPGj-në apo vlerësimin e nevojave të ndryshme të grave dhe burrave. Për pasojë, komunat kanë mundësi të kufizuara për t'i përshtatur ndarjet buxhetore me nevojat specifike të grupeve të ndryshme të grave dhe burrave, përfshirë ofrimin dhe zgjerimin e shërbimeve sociale të specializuara. Varësia e madhe nga transferet e bazuara në formulë kufizon më tej hapësirën fiskale të komunave, pasi ato nuk mund t'i rrisin në mënyrë të ndjeshme kërkesat për financim përtej tavaneve të përcaktuara në sistemin e granteve, edhe kur rritet kërkesa për punonjës socialë ose për shërbime të specializuara. Nga perspektiva e BPGj-së, kjo kufizon masën në të cilën buxhetet

[11] Republika e Kosovës, Programi i projektligjeve të Qeverisë për periudhën 2026–2028, 2025.
[12] Republika e Kosovës, Ligji për financat e pushtetit lokal, 2008.
[13] Neni 24.
[14] Ibid.
[15] European Committee of the regions, Kosovo * - Fiscal Powers, [Komiteti Evropian i rajoneve, Kosova* - Kompetencat fiskale] 2020.
[16] Llogaritje të RrGK-së bazuar në Buxhetin Komunal për periudhën 2024-2026.
[17] Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF), Analizë e qendrave për punë sociale: Sfidat në aspektin ligjor, institucional dhe funksional, 2023.
[18] Ibid.

komunale mund të planifikohen dhe përshtaten në bazë të nevojave të identifikuara dhe objektivave për barazi gjinore.

Sipas Programit Legjislativ të Qeverisë në fuqi në maj 2026, rishikimi i këtij ligji ishte planifikuar për vitin 2028.[19]

Ligji për prokurimin publik

Ky ligj synon të sigurojë që fondet publike të përdoren në mënyrë efikase, të drejtë dhe transparente,[20] si dhe përcakton rregullat, procedurat, të drejtat dhe detyrimet për të gjithë personat e përfshirë në prokurimin publik, përfshirë autoritetet kontraktuese, operatorët ekonomikë dhe organizatat. Ligji parasheh që "autoriteti kontraktues mund të përcaktojë, ndër të tjera, kushte specifike në kontratë që mundësojnë marrjen parasysh të objektivave sociale", përfshirë "2.4. detyrimin për të zbatuar, gjatë ekzekutimit të kontratës, masa të cilat janë të dizajnuara për të promovuar barazinë gjinore ose diversitetin në baza të tjera". Në përputhje me BPGj-në, kjo mundëson përfshirjen e kërkesave për avancimin e barazisë gjinore si pjesë e shërbimeve të prokuruara.

Ligji i njeh OSHC-të si operatorë ekonomikë dhe përcakton bazën ligjore për miratimin e një akti nënligjor që do të rregullonte kriteret dhe procedurat për kontraktimin e shërbimeve të ofruara nga OSHC-të. Edhe pse Ligji lejon rregulla specifike të prokurimit për OSHC-të e angazhuara në ofrimin e shërbimeve, nuk duket se është miratuar asnjë akt i tillë nënligjor. Pra, nuk ka asnjë kornizë rregullatore të posaçme që rregullon kontraktimin e shërbimeve të OSHC-ve. Procesi i hartimit të Udhëzimit Administrativ për Procedurat e Kontraktimit të Shërbimeve me OSHC mbetet i papërfunduar. Ai mund të lehtësojë kontraktimin e shërbimeve të tilla përmes prokurimit publik.

Qarkoret buxhetore

Çdo vit, Ministria e Financave (MF) përgatit qarkore buxhetore për t'i udhëzuar organizatat buxhetore, përfshirë komunat dhe ministritë, gjatë përgatitjes së buxheteve të tyre afatmesme dhe vjetore.[21] Duke u bazuar në rekomandimet e RrGK-së, Ministria e Financave ka integruar BPGj-në si një parim të planifikimit buxhetor në Kosovë.[22] Pas miratimit të LBGj-së në vitin 2015, Ministria ka nxjerrë një qarkore buxhetore që u kërkon organizatave buxhetore të dorëzojnë tabela për BPGj-në me objektiva, aktivitete dhe tregues për promovimin e barazisë gjinore. Qarkorja ka theksuar se BPGj-ja nuk kërkon rritje të shpenzimeve, por një shpërndarje më të barabartë të burimeve ekzistuese. Që nga viti 2015, qarkoret vjetore buxhetore u kanë kërkuar të gjitha organizatave buxhetore të raportojnë për përfituesit aktualë dhe të planifikuar të shpenzimeve, të ndarë sipas gjinisë.[23] Ato kërkojnë

[19] Republika e Kosovës, Programi i projektligjeve të Qeverisë për periudhën 2026–2028, 2025.

[20] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092, 2016. Veçanërisht, neni 4(5) përcakton se "përemri 'ai' dhe mbiemri pronor 'i tij' zbatohen në mënyrë të barabartë për të dy gjinitë", duke e trajtuar gjininë mashkullore si formën e parazgjedhur, në vend që të përdoret gjuhë neutrale nga aspekti gjinor. Kjo dispozitë duhet të ndryshohet për të shmangur përforcimin e stereotipeve gjinore.

[21] Emri i ministrisë ka ndryshuar me kalimin e kohës, përfshirë edhe gjatë periudhës së shqyrtuar në këtë raport. Ministria e Financave u bë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) në mars 2021, pas riorganizimit të ministrive nga Qeveria e re. Në shkurt 2026, MFPT-ja u ristrukturua dhe u bë Ministria e Financave (MF). Në këtë raport përdoret emërtimi përkatës i ministrisë, varësisht nga periudha që trajtohet.

[22] RrGK, Udhërrëfyes praktik: Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në nivel lokal, 2014, qasur më 17 prill 2025. Shih po ashtu, Instituti GAP, *Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në komuna*, 2023, qasur më 17 prill 2025.

[23] Republika e Kosovës, Qarkoret Buxhetore 2015/01, 2014.

që të gjitha organizatat buxhetore të marrin parasysh ndikimin e shpenzimeve publike në barazinë gjinore.[24]

Megjithëse qarkoret buxhetore kanë inkurajuar analizën gjinore si pjesë të përgatitjes së shtojcave të BPGj-së që shoqërojnë buxhetet çdo vit, shqyrtimi nga RrGK i shtojcave të dorëzuara nga institucionet tregon se analiza e pamjaftueshme gjinore ka ndikuar në përgatitjen e buxheteve. Organizatat buxhetore kryesisht plotësojnë tabelat standarde për punësimin, shpërndarjen e pagave, subvencionet dhe transferet, pa analizuar ndikimin real të shpenzimeve në barazinë gjinore. Sa i përket përcjelljes së shpenzimeve buxhetore në funksion të arritjes së barazisë gjinore, Kosovës i mungon një proces sistematik për monitorimin e këtyre shpenzimeve gjatë përgatitjes, zbatimit dhe raportimit buxhetor.[25] Kjo nënkupton se, megjithëse ndikimet gjinore dokumentohen, nuk ekziston një mekanizëm i qëndrueshëm për të siguruar që shpenzimet publike të planifikohen dhe të ndahen në mënyrë që të adresojnë nevojat specifike të gjinive të ndryshme.

Koncept-dokumenti për BPGj-në

Në vitin 2022, ABGj-ja dhe MF-ja miratuan koncept-dokumentin për BPGJ-në.[26] Ky dokument përcakton hapat për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm rregullator për integrimin e mjeteve dhe qasjeve të BPGj-së në kornizën e politikave publike, proceset e planifikimit dhe menaxhimit të financave publike, strukturat institucionale, si dhe proceset e prokurimit dhe auditimit në të gjitha nivelet. Qëllimi i deklaruar i Qeverisë është eliminimi i pabarazive gjinore, rritja e transparencës dhe llogaridhënies, avancimi i qeverisjes së mirë dhe funksionimit demokratik, si dhe arritja e barazisë gjinore. Qeveria propozon miratimin e një akti nënligjor për BPGj-në dhe institucionalizimin gradual të saj. Ky opsion mbështet planifikimin, ndarjen e burimeve dhe monitorimin e ndikimit të BPGj-së, të bazuara në dëshmi. Aktivitetet kryesore përfshijnë hartimin e një plani veprimi dhe të një kornize rregullatore për BPGj-në, vlerësimin e sistemeve financiare dhe kapaciteteve të stafit, krijimin e mekanizmave për planifikim dhe mbikëqyrje, pilotimin e BPGj-së në ministri dhe komuna, themelimin dhe trajnimin e strukturave planifikuese, zhvillimin e ekspertizës për BPGj-në dhe të një platforme elektronike, ofrimin e udhëzimeve për prokurimin e përgjegjshëm gjinor, si dhe ofrimin e asistencës teknike dhe ngritjen e kapaciteteve. Pjesërisht si pasojë e mungesës së një qeverie funksionale, rekomandimet e koncept-dokumentit ende nuk janë zbatuar.

Përfundim: BPGj-ja në Kosovë në lidhje me shërbimet e specializuara

Tabela 1. BPGj-ja në Kosovë në lidhje me shërbimet e specializuara

Kriteret	Gjetje
BPGj-ja është e detyrueshme për të gjitha institucionet	Po
Përgjegjësitë e institucioneve në lidhje me BPGj-në janë të qarta	Pjesërisht
Analiza gjinore kërkohet për planifikimin e buxheteve	Po
Monitorimi i përfituesve sipas gjinisë kërkohet me ligj	Po
Analiza e ndikimit gjinor (vlerësimi) kërkohet me ligj	Po
Të dhënat e ndara sipas gjinisë janë të disponueshme nga ofruesit e shërbimeve	Pjesërisht

[24] Republika e Kosovës, Qarkoret Buxhetore 2025, 2014.
[25] Llogaridhënia financiare dhe shpenzimet publike, GRPFM e Kosovës 2022, Aneksi gjinor, 2022.
[26] Republika e Kosovës, *Koncept-dokumenti për BPGj-në*, 2022.

Edhe pse BPGj-ja është e detyrueshme për të gjitha institucionet sipas LBGj-së, ajo nuk është integruar në sistemin e menaxhimit të financave publike dhe, rrjedhimisht, nuk është institucionalizuar si pjesë e proceseve të menaxhimit të financave publike. Megjithëse të gjitha institucionet janë përgjegjëse për zbatimin e BPGj-së, përgjegjësitë specifike nuk janë përcaktuar në përshkrimet e vendeve të punës ose në proceset e sigurimit të cilësisë, siç është rasti, për shembull, me zyrtarët buxhetorë të MFPT-së. Ngjashëm, megjithëse LBGj-ja kërkon që analiza gjinore të shërbejë si bazë për integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha ligjet dhe politikat, përfshirë buxhetet, kjo nuk kërkohet shprehimisht si pjesë e procesit buxhetor në legjislacionin për menaxhimin financiar dhe për rrjedhojë nuk zbatohet në praktikë. LBGj-ja gjithashtu kërkon mbledhjen e të dhënave për përfituesit të ndara sipas gjinisë dhe realizimin e analizës së ndikimit gjinor. Megjithatë, në praktikë, mbledhja, mirëmbajtja dhe publikimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë për përfituesit e shërbimeve sociale në përgjithësi mbetet i dobët.[27] Kjo pengon kryerjen e analizave të ndikimit gjinor të bazuara në dëshmi, si dhe planifikimin buxhetor të bazuar në nevojat reale për shërbime.

Korniza ligjore lidhur me dhunën me bazë gjinore

Ky seksion shqyrton se deri në çfarë mase korniza ligjore përcakton shërbimet e specializuara dhe financimin e tyre në përputhje me kërkesat e KS-së. Më pas, vlerësohet nëse strategjitë dhe planet ekzistuese të veprimit për adresimin e dhunës me bazë gjinore kanë parashikuar burime të mjaftueshme për këto shërbime.

Korniza ligjore ndërkombëtare

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton se instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe kanë përparësi ndaj ligjeve kombëtare që bien në kundërshtim me to. [28] Këto përfshijnë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të OKB-së, Konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe protokollet e saj, Konventën ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial, Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW), Konventën për të drejtat e fëmijës (KDF), Konventën kundër torturës dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, si dhe KS-në. Megjithëse Kosova nuk mund t'i ratifikojë zyrtarisht këto konventa për shkak të statusit të saj politik (përkatësisht, mosnjohjes së saj si shtet i pavarur), ajo është zotuar për zbatimin e tyre duke i përfshirë në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, zbatimi i instrumenteve ndërkombëtare pa ratifikim paraqet ende disa sfida, përfshirë faktin se Kosova nuk ka qasje në mekanizmat përkatës të monitorimit ose në mekanizmat e ankesave.[29]

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)

KS-ja ka hyrë në fuqi më 1 gusht 2014. Ajo synon mbrojtjen e grave nga të gjitha format e dhunës dhe eliminimin e dhunës në familje; promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave; krijimin e një kornize gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave; nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar; si dhe mbështetjen e përpjekjeve të koordinuara nga institucionet dhe shoqëria civile.[30] KS-ja e përkufizon dhunën me bazë gjinore

[27] Për informata të mëtejshme, shih seksionet për të dhënat në Kapitullin 2.
[28] Republika e Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.
[29] Për një diskutim më të hollësishëm, shih RrGK, *Diskriminimi me bazë gjinore dhe punësimi në Kosovë*, 2019.
[30] Këshilli i Evropës, Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence [Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje], 2021.

ndaj grave si dhunë që drejtohet ndaj një gruaje për shkak se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë joproporcionale. Konventa kërkon kriminalizimin e formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore. KS-ja i obligon shtetet të krijojnë shërbime të specializuara, të qasshme dhe me burime të mjaftueshme për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore. Këto përfshijnë linja kombëtare falas dhe konfidenciale të ndihmës SOS, që funksionojnë 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë; qendra të krizave për rastet e përdhunimit dhe qendra referimi për dhunën seksuale që ofrojnë asistencë mjekësore, psikologjike, ligjore dhe forenzike; strehimore të specializuara që ofrojnë akomodim të sigurt dhe mbrojtje për gratë dhe fëmijët në rrezik; shërbime këshillimi dhe psikologjike që ofrojnë terapi të bazuar në qasjen e informuar nga trauma dhe përfaqësim të interesave të viktimave; si dhe ndihmë juridike falas për t'i ndihmuar të mbijetuarat/it të sigurojnë mbrojtje dhe qasje në drejtësi. Për të garantuar mbështetje efektive për viktimat, shtetet duhet të sigurojnë qasje në një sërë shërbimesh për rimëkëmbje, përfshirë këshillim ligjor dhe psikologjik, strehim, arsimim, trajnim dhe asistencë për punësim. Njëkohësisht, shtetet duhet të sigurojnë numër të mjaftueshëm strehimoresh të sigurta dhe shërbime të specializuara për viktimat e dhunës seksuale, përfshirë kujdesin mjekësor, ekzaminimet forenzike, mbështetjen për tejkalimin e traumës dhe këshillimin.

Përtej ofrimit të shërbimeve, KS-ja kërkon që palët të përmbahen nga kryerja ose tolerimi i çdo akti të dhunës ndaj grave dhe u përcakton shteteve një detyrim të qartë për të siguruar që të gjitha autoritetet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me këtë detyrim. Shtetet duhet të integrojnë perspektivën gjinore si në zbatimin ashtu edhe në vlerësimin e masave, duke njohur ndikimin joproporcional të dhunës ndaj grave dhe duke promovuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. KS kërkon nga palët që të "pranojnë, nxisin dhe mbështesin, në të gjitha nivelet, punën e organizatave përkatëse joqeveritare dhe të shoqërisë civile, aktive në luftën e dhunës kundër grave dhe krijimin e bashkëpunimit efektiv me këto organizata". [31] Nga to gjithashtu kërkohet të ndajnë burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për zbatimin e politikave dhe programeve gjithëpërfshirëse për adresimin e dhunës, "duke përfshirë ato që janë kryer nga organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile".[32]

Më 25 shtator 2020, Kuvendi i Kosovës miratoi një amendament kushtetues për të siguruar zbatimin e drejtpërdrejtë të KS-së.[33] Kosova ka ndërmarrë disa masa legjislative dhe politike për zbatimin e KS-së, të cilat diskutohen më tej në këtë seksion.

Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

Në vitin 2020, Kosova zgjeroi zotimet e saj ndaj CEDAW-së, një traktat ndërkombëtar i miratuar në vitin 1979, i cili synon eliminimin e diskriminimit ndaj grave.[34] CEDAW-ja kërkon që shtetet të sigurojnë barazinë gjinore në ligj, arsim, punësim dhe jetën publike, si dhe t'i mbrojnë gratë nga diskriminimi nga individët, organizatat dhe institucionet. Me ratifikimin e Konventës, shtetet zotohen të shfuqizojnë ligjet diskriminuese, të përfshijnë parimin e barazisë në sistemet e tyre ligjore, të krijojnë mekanizma për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të parandalojnë diskriminimin në sferën publike dhe private. CEDAW-ja e përkufizon diskriminimin ndaj grave në mënyrë që të përfshijë edhe dhunën me bazë gjinore, e cila drejtohet ndaj grave për shkak se janë gra ose që i prek ato në mënyrë joproporcionale.[35] Kjo përfshin dëmtimin fizik, mendor dhe seksual, kërcënimet, detyrimin dhe kufizimet e lirisë.

[31] Ibid., Neni 9.
[32] Neni 8.
[33] Këshilli i Evropës, The National Assembly of Kosovo* decides to apply the Istanbul Convention [Kuvendi i Republikës së Kosovës* vendos për zbatimin e Konventës së Stambollit], 2020.
[34] OKB, Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women [Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave], rezoluta 34/180, miratuar më 18 dhjetor 1979, hyrë në fuqi më 3 shtator 1981.
[35] Shih nenin 1.

Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 19 thekson rëndësinë e krijimit, forcimit dhe mbështetjes së shërbimeve të përshtatshme për mbrojtjen dhe përkrahjen e grave që kanë përjetuar ose janë në rrezik të dhunës, përdhunimit, sulmit seksual ose formave të tjera të dhunës me bazë gjinore.[36]

Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës

KDF-ja kërkon që autoritetet të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'i mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës dhe abuzimit, përfshirë abuzimin seksual.[37] Ato duhet të reagojnë me shpejtësi ndaj çdo pretendimi për abuzim ose dhunë, të kryejnë hetime të plota dhe të sigurojnë që personat përgjegjës të japin llogari. Shtetet obligohen të zbatojnë masa legjislative, administrative dhe sociale për të mbështetur fëmijët viktima.[38] Sa i përket shërbimeve dhe buxhetimit, kjo nënkupton krijimin e njësive për mbrojtjen e fëmijëve dhe ekipeve të reagimit, ofrimin e kujdesit të ndjeshëm ndaj fëmijëve për tejkalimin e traumës dhe mbështetjes psikologjike, si dhe ndarjen e fondeve për programe të parandalimit në shkolla dhe komunitete. Gjatë menaxhimit të rasteve të tilla, institucionet përkatëse duhet të garantojnë mbrojtjen e plotë të të drejtave të fëmijëve, përfshirë të drejtën e tyre për privatësi, siguri dhe shërbime të përshtatshme mbështetëse.[39]

Konventa e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Kosova ende nuk e ka përfshirë shprehimisht Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (KDPAK) në kornizën e saj kushtetuese. Në vitin 2023, Gjykata Kushtetuese konstatoi se amendamenti i propozuar kushtetues për përfshirjen e KDPAK-së është në përputhje me Kushtetutën, ndërsa ky amendament është ende në pritje të miratimit nga Kuvendi. [40]

KDPAK-ja i obligon shtetet që t'i mbrojnë personat me aftësi të kufizuara nga dhuna dhe keqtrajtimi, përfshirë dhunën me bazë gjinore, si dhe të sigurojnë qasje në shërbime për ndihmë, rimëkëmbje dhe riintegrim.[41] Konventa e vë theksin te të drejtat e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për qasje në kujdes shëndetësor, përfshirë shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues, si dhe në masat e mbrojtjes sociale.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së

Edhe pse Kosova nuk mund të jetë nënshkruese e Agjendës 2030 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), për shkak të statusit të saj si shtet joanëtar i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ajo është zotuar t'i mbështesë këto përpjekje. Në janar 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë parlamentare përmes së cilës shprehu mbështetjen për OZHQ-të.[42] OZHQ 5, synimi 5.2, synon trajtimin e dhunës me bazë gjinore. OZHQ 5, synimi

[36] Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, General recommendation No. 35 on gender-based violence against women, updating general recommendation No.19 [Rekomandimi i përgjithshëm nr. 35 për dhunën me bazë gjinore ndaj grave, që përditëson Rekomandimin e përgjithshëm nr. 19], 2017.
[37] UN, Convention on the Rights of the Child [Konventa për të drejtat e fëmijës], Rezoluta 44/25, miratuar më 20 nëntor 1989, hyrë në fuqi më 2 shtator 1990.
[38] Neni 19.
[39] Ligjet relevante për shërbimet sociale përfshijnë: Ligjin Për Mbrojtjen Nga Diskriminimi, 2015; Ligjin Për Familjen, 2006; Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna Ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, 2023; Ligjin Për Shërbimet Sociale Dhe Familjare, 2023; Dhe Ligjin Për Skemën E Ndihmës Sociale, 2023.
[40] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi KO207/22, 2023.
[41] UN, Convention on the Rights of Persons with Disabilities [Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], miratuar më 13 dhjetor 2006, hyrë në fuqi më 3 maj 2008.
[42] Republika e Kosovës, Kuvendi, Rezoluta për miratimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, 2018.

5.c, synon avancimin e BPGj-së. Treguesi 5.c.1 dhe metodologjia e zhvilluar nga UN Women ofrojnë udhëzime për vlerësimin e zbatimit të BPGj-së në vende të ndryshme dhe mund të përdoren për të udhëhequr përmirësimin e institucionalizimit të BPGj-së në Kosovë. Ky tregues vlerëson tri aspekte kryesore: i) zotimin e qeverisë ndaj barazisë gjinore, bazuar në ekzistencën e politikave, programeve dhe buxheteve përkatëse; ii) shkallën në të cilën sistemi i menaxhimit të financave publike mbështet objektivat e barazisë gjinore; dhe iii) ekzistencën e mekanizmave në procesin e ndarjes së burimeve publike që forcojnë llogaridhënien.[43]

Direktiva e BE-së 2024/1385 për dhunën ndaj grave

Kjo direktivë synon të krijojë një kornizë ligjore në nivel të BE-së për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ajo synon të sigurojë një nivel minimal të mbrojtjes për viktimat në të gjitha shtetet anëtare, në mënyrë që masat mbrojtëse dhe përgjigjet ligjore të jenë të harmonizuara në të gjithë BE-në.[44] Direktiva parashikon kriminalizimin e disa formave të dhunës, përfshirë dhunën me bazë gjinore të lehtësuar nga teknologjia, shpërndarjen pa pëlqim të imazheve intime, përndjekjen kibernetike, ngacmimin kibernetik dhe nxitjen kibernetike të urrejtjes ose dhunës. Ajo zbatohet për të gjitha viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, pavarësisht gjinisë së tyre.

Në Kosovë, Kodi Penal përmban dispozita për ngacmimin, ngacmimin seksual dhe nxitjen e urrejtjes; megjithatë, ai nuk i përkufizon ose rregullon në mënyrë të posaçme format e reja të dhunës në internet. Kodi nuk trajton drejtpërdrejt veprime të tilla si përndjekja kibernetike, publikimi i paautorizuar i të dhënave personale (doksingu), shpërndarja pa pëlqim e imazheve intime, përdorimi i teknologjisë deepfake ose ekspozimi seksual i paautorizuar përmes internetit (cyberflashing). Kjo direktivë e BE-së i njeh shprehimisht këto forma të abuzimit digjital dhe përcakton standardet minimale për kriminalizimin e tyre në të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Prandaj, Kosova do të duhet t'i adresojë këto forma të dhunës në Kodin Penal dhe në shërbimet e mbështetjes sociale. Disa rregullore në Kosovë janë në përputhje me këtë direktivë, siç është Rregullorja (QRK) Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore.

Ligjet lidhur me adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe BPGj-në

Ky nënseksion përmbledh ligjet që lidhen me adresimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë, veçanërisht ato që rregullojnë shërbimet e specializuara të kërkuara nga KS dhe identifikon institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre ligjeve, përfshirë sigurimin e burimeve të mjaftueshme buxhetore.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Në vitin 2019, KPRK u ndryshua për të përfshirë vepra të tjera penale në përputhje me KS-në, duke përfshirë dhunën në familje, ngacmimin seksual dhe gjymtimin e organeve gjenitale femërore. KPRK-ja e përkufizon dhunën në familje si dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik brenda një marrëdhënieje familjare.[45] Ndryshimet gjithashtu parashikuan ndjekjen penale sipas detyrës zyrtare (ex officio) për vepra të tilla si

[43] Treguesi 5.c.1 i OZHQ.
[44] Direktiva, EUR-Lex, qasur më 18. maj 2026.
[45] Neni 248 i KPRK-së përcakton se "kushdo që kryen dhunë ose keqpërdorim fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të një personi tjetër brenda një marrëdhënieje familjare" dënohet, por përjashton disa forma të dhunës nga partnerët intimë që nuk bashkëjetojnë me viktimën, megjithëse këto veprime përfshihen në nenin 3(b) të KS-së.

lëndimi i lehtë trupor, lëndimi i rëndë trupor, përdhunimi, sulmi seksual, martesa e detyruar, aborti i detyruar dhe sterilizimi i detyruar, duke e harmonizuar KPRK-në me nenin 55(1) të KS-së. KPRK-ja u ndryshua më tej në vitin 2023, duke përfshirë dispozitat që ashpërsojnë sanksionet për përdhunimin dhe dhunën në familje, si dhe vendosin kufizime lidhur me ushtrimin e funksioneve publike.[46]

KPK-ja kërkon që të gjithë personat të raportojnë veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare. Personat që nuk raportojnë një vepër penale i nënshtrohen ndëshkimit. [47] Kjo dispozitë mund t'i dekurajojë viktimat e dhunës që të kërkojnë ndihmën e nevojshme ose të strehohen, veçanërisht në rastet kur ato nuk dëshirojnë që krimet të raportohen. Kjo mund të ndikojë gjithashtu në aftësinë e ofruesve të shërbimeve të specializuara, si strehimoret dhe profesionistët shëndetësorë, për të siguruar një qasje të përqendruar te viktima gjatë ofrimit të kujdesit të menjëhershëm për gratë që kanë përjetuar dhunë. Ofrimi i ndihmës në raste të tilla mund t'i ekspozojë profesionistët ndaj sanksioneve penale nëse ata nuk i raportojnë krimet përkatëse. Për më tepër, Qeveria nuk financon shërbimet e strehimit për klientet që nuk i kanë raportuar krimet në polici. Kjo mund të krijojë kosto shtesë për strehimoret, të cilat nuk mund të rimbursohen nga shteti. Për të siguruar përputhshmëri me kërkesat e KS-së për qasje të përqendruar te viktima, e cila i jep përparësi sigurisë, dinjitetit dhe nevojave të menjëhershme të viktimave, KPK-ja do të duhej të ndryshohej për të parashikuar rrethana në të cilat profesionistë të caktuar nuk do të ishin të detyruar të raportojnë krimet, kur një raportim i tillë nuk është në interesin më të mirë të mbrojtjes dhe kujdesit të menjëhershëm për viktimat. Këto ndryshime do të duhej të merrnin parasysh edhe sigurinë dhe mbrojtjen e viktimave në rastet kur krimet nuk raportohen.

Kodi i Procedurës Penale

Kodi i Procedurës Penale i Kosovës (KPP) përcakton rregullat e detyrueshme të procedurës penale që rregullojnë punën e gjykatave, prokurorisë së shtetit dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurat penale që mbulohen nga ky Kod.[48] Ai kërkon që t'u kushtohet "vëmendje e duhur" palëve të dëmtuara ose viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, dhunës me bazë gjinore, dhunës në marrëdhënie familjare, dhunës seksuale, shfrytëzimit ose diskriminimit, si dhe viktimave që kanë pësuar dëme të konsiderueshme për shkak të peshës së veprës penale. Ai e përkufizon "viktimën e cenueshme" si person, rrethanat e të cilit, përfshirë shtatzëninë ose marrëdhënien me kryerësin dhe varësinë prej tij, e bëjnë atë veçanërisht të cenueshëm ndaj viktimizimit të përsëritur, frikësimit ose hakmarrjes. Viktimat e cenueshme njihen shprehimisht në lidhje me disa vepra penale që lidhen me dhunën me bazë gjinore, ndërsa kryerja e çfarëdo vepre penale ndaj një viktime që konsiderohet "veçanërisht e cenueshme" trajtohet si rrethanë rënduese gjatë caktimit të dënimit.

KPP-ja gjithashtu përmban dispozita të hollësishme për të drejtat e viktimave dhe e zgjeron konceptin e palës së dëmtuar ose viktimës duke përfshirë personat që kanë pësuar dëme fizike, mendore ose emocionale, ose humbje ekonomike. Ndonëse këto dispozita vlejnë për viktimat në përgjithësi, KPP-ja kërkon shprehimisht t'u kushtohet vëmendje e duhur viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, dhunës me bazë gjinore, dhunës në marrëdhënie familjare, dhunës seksuale, shfrytëzimit ose diskriminimit, si dhe viktimave që kanë pësuar dëme të konsiderueshme për shkak të peshës së veprës penale, viktimave me aftësi të kufizuara dhe personave që janë veçanërisht të cenueshëm. Neni 124 i KPP-së ka të bëjë me lirimin nga detyrimi për të dëshmuar. Kjo duhet të shqyrtohet në kuadër të kornizës më të

[46] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-188 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, 2023.
[47] Neni 81.
[48] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-002 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-091.

gjerë të provave, duke siguruar që rastet e dhunës me bazë gjinore të mbështeten në të gjitha format e ligjshme dhe të disponueshme të provave dhe të mos varen pa nevojë nga dëshmia e viktimave. Së fundi, dhuna në familje duhet të identifikohet në mënyrë të qëndrueshme gjatë regjistrimit të akuzave penale dhe statistikave, përfshirë rastet kur veprat ndiqen sipas dispozitave të përgjithshme penale. Regjistrimi i qartë i dhunës në familje do ta rriste pasqyrimin e saj në statistikat penale dhe do të mundësonte parashikim më të saktë të numrit të rasteve, kërkesës për shërbime dhe buxhetimit përkatës.

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore

Në vitin 2023, Kuvendi i Kosovës miratoi LDhBGj-në, i cili e përkufizon dhunën me bazë gjinore në përputhje me KS-në.[49] Ky ligj synon të parandalojë dhe të trajtojë dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore; të mbrojë gratë dhe të kontribuojë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj tyre; të promovojë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave; si dhe të krijojë mekanizmat e nevojshëm për ofrimin e mbështetjes për viktimat e të gjitha formave të dhunës. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji përfshijnë të gjitha organet shtetërore, gjykatat, prokurorinë, policinë, qendrat për punë sociale (QPS), mbrojtësit e viktimave, njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe personat juridikë që ushtrojnë funksione publike të përcaktuara me ligj.[50]

Ligji përcakton se shërbimet mbështetëse për viktimat duhet të ofrohen pa pagesë, pa diskriminim dhe të financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.[51] Ai parasheh mbështetje financiare për ofruesit e shërbimeve, pa përcaktuar qartë se për cilat forma të dhunës janë të destinuara këto shërbime, duke lënë të kuptohet se shteti do të mbështesë shërbimet për të gjitha format e dhunës. Ligji kërkon që strehimoret dhe qendrat e licencuara të shërbimeve të financohen përmes ndarjeve buxhetore nga Buxheti i Kosovës, duke lejuar gjithashtu mbështetje shtesë përmes granteve ose subvencioneve. Ky financim synon zbatimin e programeve afatmesme dhe masave prioritare për ofrimin e asistencës për viktimat e dhunës në familje.

Për të garantuar qëndrueshmërinë e këtyre shërbimeve, Qeveria e Kosovës duhet të ndajë fonde të mjaftueshme buxhetore për financimin e qëndrueshëm të strehimoreve të licencuara për një periudhë jo më të shkurtër se tre vjet, si dhe të krijojë një linjë buxhetore ose nënprogram me kod të veçantë brenda ministrisë përgjegjëse për menaxhimin e këtij financimi.[52] Deri më tani, nuk është krijuar ende as financimi shumëvjeçar dhe as një linjë specifike buxhetore.

Ligji për shërbime sociale dhe familjare

Ky ligj i vitit 2024 rregullon shërbimet sociale dhe familjare për individët dhe familjet në nevojë.[53] Ai përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike që hartojnë politika dhe ofrojnë këto shërbime, si dhe të institucioneve private të përfshira në ofrimin e tyre. Ligji i përkufizon shërbimet sociale si shërbime të ofruara përmes metodave të punës sociale dhe qasjeve të tjera profesionale, me synim përmirësimin e mirëqenies së individëve, familjeve në situata të cenueshme dhe komuniteteve. Këto shërbime synojnë reduktimin e rreziqeve dhe varfërisë, promovimin e përfshirjes dhe integrimit, si dhe mbështetjen e

[49] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore, 2023.
[50] Neni 9.
[51] Neni 22.
[52] Neni 24.
[53] Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare, 2024.

individëve për të realizuar potencialin e tyre të plotë në jetë. Përfitues të shërbimeve sociale janë qytetarët dhe çdo individ që banon ose ndodhet përkohësisht në Kosovë dhe që ka nevojë për këto shërbime, duke përfshirë fëmijët dhe të rriturit që janë viktima të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore ose formave të tjera të dhunës.[54] Neni 4 thekson se shërbimet sociale duhet të ofrohen pa diskriminim për shkak të racës, gjinisë, moshës, kombësisë, fesë, përkatësisë politike ose sindikale, gjendjes ekonomike, kulturës, gjuhës, aftësisë së kufizuar ose çdo karakteristike tjetër personale. Po ashtu, ato duhet të jenë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

Ligji i ndan shërbimet sociale dhe familjare në shërbime primare dhe sekondare. Të dyja kategoritë kanë rëndësi në trajtimin e dhunës me bazë gjinore. Shërbimet primare përfshijnë informimin, udhëzimin dhe këshillimin profesional, me qëllim parandalimin dhe ndërhyrjen e hershme për zvogëlimin e cenueshmërisë. Shërbimet sekondare përfshijnë trajtimin e specializuar, rehabilitimin dhe mbrojtjen e individëve që kanë përjetuar dhunë, duke përfshirë këshillimin terapeutik për tejkalimin e traumës, programet e riintegrimit dhe mbështetjes, si dhe shërbimet e mentorimit për zvogëlimin e rrezikut dhe mbështetjen e rimëkëmbjes. Këto shërbime duhet të ofrohen sa më afër vendbanimit të përfituesit dhe në ambiente që garantojnë konfidencialitetin.

Shërbimet terciare janë shërbime intensive të kujdesit social, të ofruara 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, për individët në rrezik ose viktimat, duke ofruar trajtim dhe rehabilitim afatshkurtër ose afatgjatë.[55] Këto shërbime përfshijnë: kujdesin në baza familjare, brenda ose jashtë familjes biologjike, i cili ofron strehim, ushqim, higjienë, kujdes shëndetësor, arsimim, aktivitete pune, rehabilitim psikosocial dhe aktivitete të kohës së lirë; qendrat e kujdesit në grupe të vogla si alternativë e kujdesit, me shërbime të ngjashme; qendrat pranuese, të cilat ofrojnë strehim të përkohshëm dhe mbështetje për individët ose familjet në situata emergjente, deri në transferimin e tyre në shërbime profesionale; banimin e mbështetur në grup, ku deri në pesë banorë marrin mbështetje profesionale të organizuar 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, për plotësimin e nevojave të tyre themelore të jetesës në afat të shkurtër.

Shërbimet duhet të financohen kryesisht nga buxheti i Republikës së Kosovës, me mundësi për mbështetje shtesë nga partnerët zhvillimorë, partneritetet publiko-private dhe përfituesit e shërbimeve.[56] Ministria përgjegjëse për çështjet sociale duhet të planifikojë buxhetin dhe të sigurojë pagesa ose kompensime materiale për shërbimet, duke përfshirë strehimin rezidencial, kujdesin ditor, asistencën në shtëpi, pushimin dhe rekreacionin, banimin e mbështetur, shërbimet e strehimit dhe të qendrave pranuese, strehimin për personat në nevojë dhe shërbime të tjera, sipas mundësive buxhetore. Komunat gjithashtu planifikojnë dhe financojnë shërbimet sociale, duke përfshirë QPS-të, kujdesin ditor, strehimin rezidencial dhe qendrat në baza në komunitet për fëmijët. Siç u përmend më lart, financimi i shërbimeve sociale në nivel komunal nga qeveria qendrore rregullohet përmes një formule të përcaktuar në Ligjin për financat e pushtetit lokal.

Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit

Ky ligj ofron mbrojtje gjithëpërfshirëse për të gjitha viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, duke garantuar qasje në ndihmë ligjore, mjekësore, psikologjike dhe sociale, si dhe të drejtën për kompensim dhe të drejta të tjera.[57] Mbrojtja zbatohet për të gjithë individët e identifikuar ose të dyshuar si viktima të trafikimit, pavarësisht gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, shtetësisë, bindjeve politike, fesë, përkatësisë etnike, racës, gjendjes pasurore, lindjes ose çdo statusi tjetër. Kjo mbrojtje

[54] Neni 29.
[55] Neni 19.
[56] Neni 74.
[57] Kuvendi i Kosovës, Ligji nr. 04/l-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, 2013.

bazohet në qasjen e të drejtave të njeriut dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Luftimi i trafikimit me njerëz bëhet në bazë të këtyre parimeve, nder te tjera, sigurohet që të gjitha aktivitetet kundër trafikimit me njerëz të kenë parasysh aspektin gjinor, promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e viktimave gra dhe vajza.

Qeveria mbështet strehimoret e specializuara dhe qendrat e përkohshme që ofrojnë akomodim, higjienë, ushqim, kujdes urgjent, ndihmë ligjore dhe psikologjike, siguri dhe mundësi për mbajtjen e kontakteve me familjen. Qëndrimi në strehimore zakonisht zgjat nga 30 deri në 90 ditë dhe mund të zgjatet për arsye mjekësore, ligjore ose personale, duke përfshirë deri në një vit për viktimat shtatzëna.[58] Autoritetet gjithashtu sigurojnë identifikimin e shpejtë, referimin dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore falas për viktimat, si dhe trajnimin profesional dhe mbështetjen për punësim për personat mbi moshën 16 vjeç.[59] Mbrojtje e veçantë ofrohet për fëmijët viktima. Të gjitha rastet e dyshuara duhet të raportohen menjëherë te organet e zbatimit të ligjit. Viktimat, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë në kompensim për të mbështetur rimëkëmbjen dhe riintegrimin e tyre të plotë. Kompensimi mund të sigurohet përmes dëmshpërblimit të urdhëruar nga gjykata, kërkesave civile ose mjeteve të tjera juridike të parashikuara me ligj.[60]

Autoritetet kompetente përgjegjëse për parandalimin e trafikimit dhe ofrimin e asistencës për viktimat përfshijnë ministritë përkatëse, policinë, gjykatat, organet komunale, Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, ABGj-në, OJQ-të dhe ofruesit e tjerë të autorizuar të shërbimeve.[61]

Ligji për mbrojtjen e fëmijës

Ky ligj përcakton një kornizë të plotë ligjore dhe institucionale, në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, KDF-në dhe legjislacionin tjetër përkatës, për parandalimin dhe trajtimin e të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit. Ligji mbron fëmijët nga dhuna fizike dhe psikologjike, trafikimi, abuzimi seksual dhe format e tjera të dëmtimit. Mbrojtja e fëmijëve pa përkujdesje prindërore sigurohet përmes kujdestarisë, strehimit familjar, strehimit rezidencial ose qendrave në baza në komunitet, birësimit dhe jetesës së pavarur nën mbikëqyrje. Ligji përcakton se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (ose ministria përgjegjëse) dhe komunat duhet të mbështesin familjet që ofrojnë kujdes familjar ose strehim për fëmijët. Qendrat për Mbrojtjen e Fëmijëve ofrojnë shërbime emergjente deri në tri ditë; shërbejnë si qendra për menaxhimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës, veçanërisht të veprave penale seksuale që përfshijnë fëmijë viktima ose dëshmitarë; ofrojnë këshillim dhe terapi; si dhe sigurojnë strehim të përkohshëm për fëmijët që nuk mund të qëndrojnë në mënyrë të sigurt në shtëpitë e tyre ose në strehime familjare. Këto qendra financohen nga Buxheti i Kosovës dhe kontributet e donatorëve. Çdo fëmijë i referuar në një QPS pajiset me menaxher rasti, ndërsa kujdestarët ligjorë emërohen për të mbrojtur interesat e fëmijëve viktima të dhunës në familje dhe për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e tyre.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi

Ky ligj i vitit 2015 synon parandalimin dhe trajtimin e diskriminimit mbi të gjitha bazat, duke garantuar zbatimin e qëndrueshëm të parimit të trajtimit të barabartë.[62] Zbatimi i tij sigurohet nga tri institucione kryesore: Institucioni i Avokatit të Popullit, një organ i pavarur kushtetues që shqyrton rastet e diskriminimit; Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës

[58] Neni 23.
[59] Neni 24.
[60] Neni 39.
[61] Neni 6.
[62] Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi, 2015.

së Kryeministrit, e cila koordinon përpjekjet e Qeverisë për trajtimin e formave të ndryshme të diskriminimit; si dhe njësitë ose zyrtarët përgjegjës brenda ministrive dhe komunave, të cilët merren me zbatimin e masave kundër diskriminimit. Ligji ka rëndësi për shërbimet e specializuara që synojnë trajtimin e dhunës me bazë gjinore, pasi të mbijetuarat/it duhet të kenë qasje në mbështetje dhe mbrojtje pa u përballur me diskriminim për shkak të gjinisë, statusit shoqëror ose faktorëve të tjerë.

Grupi i ekspertëve për veprim kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO) ka shprehur shqetësim se gratë që përballen me forma të shumëfishta të diskriminimit ose cenueshmërisë hasin pengesa të theksuara në shfrytëzimin e shërbimeve të specializuara, veçanërisht për shkak të barrierave gjuhësore dhe mungesës së qasshmërisë.[63] Këtu përfshihen gratë me aftësi të kufizuara, gratë rome, ashkali, egjiptiane, serbe, gratë migrante dhe gratë e moshuara. Mungesa e shërbimeve të specializuara për viktimat e dhunës seksuale, gjymtimit të organeve gjenitale femërore, martesës së detyruar, përndjekjes, ngacmimit seksual, dhunës në internet, sterilizimit të detyruar dhe abortit të detyruar i lë këto gra pa qasje të mjaftueshme në këshillim ligjor dhe social, mbështetje psikologjike ose trajtim të traumës të përshtatur me nevojat e tyre. Kjo thekson nevojën për ndarje të fondeve buxhetore për adresimin e këtyre nevojave dhe për të siguruar që shërbimet e specializuara të ofrohen pa diskriminim.

Ligji për Avokatin e Popullit

Kuvendi e miratoi këtë ligj në vitin 2015.[64] Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë që promovon, monitoron dhe mbështet trajtimin e barabartë pa diskriminim mbi bazat e mbrojtura me ligjin për barazi gjinore dhe ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi. Ligji për barazi gjinore e përcakton Avokatin e Popullit si institucion të barazisë përgjegjës për trajtimin e rasteve të diskriminimit me bazë gjinore. Ai ka kompetencë të monitorojë nëse autoritetet publike i përmbushin detyrimet e tyre për parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, dhunën seksuale dhe diskriminimin. Po ashtu, ai mund të identifikojë mangësi në legjislacion ose në zbatimin e tij dhe të rekomandojë përmirësime.

Ligji për banim social dhe të përballueshëm

Në maj të vitit 2026, Kuvendi e miratoi këtë ligj.[65] Ky ligj synon të krijojë programe për banim social dhe të përballueshëm, duke përcaktuar rregullat dhe procedurat për planifikimin, menaxhimin, zbatimin dhe ofrimin e këtyre programeve. Gjithashtu, përcakton kriteret e përfitimit dhe mundësitë e qasjes për familjet dhe individët që kanë nevojë për mbështetje në fushën e banimit. Grupet që synohen të përfitojnë nga banimi social dhe i përballueshëm përfshijnë, ndër të tjera, të mbijetuarit e dhunës në familje, viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, si dhe gratë dhe burrat viktima të luftës. Dispozitat e tij zbatohen për të gjitha institucionet e përfshira në planifikimin, menaxhimin, mbikëqyrjen, zbatimin dhe shpërndarjen e programeve të banimit në nivel qendror dhe komunal, si dhe për përfituesit dhe palët e tjera relevante. Komunat janë përgjegjëse për sigurimin e burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe për krijimin e strukturave të përshtatshme lokale për ofrimin e shërbimeve për banorët. Krijimi dhe zgjerimi i njësive të banimit social financohen përmes fondeve komunale, granteve të përgjithshme, fondeve nga ministria përgjegjëse për banimin, kontributeve të donatorëve dhe mbështetjes nga institucionet financiare vendore dhe ndërkombëtare. Njësitë në kuadër të programit të banimit të përballueshëm mund të financohen përmes buxhetit të ministrisë

[63] Këshilli i Evropës, Assessment of the alignment of Kosovo*'s laws, policies and other measures with the standards of the Istanbul Convention [Vlerësimi i përputhshmërisë së ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës* me standardet e Konventës së Stambollit], 2022.
[64] Kuvendi i Kosovës, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, 2015.
[65] Kuvendi i Kosovës, Ligji nr. 10/L-022 për banim social dhe të përballueshëm, 2026.

përgjegjëse, buxhetit komunal, buxheteve të institucioneve të tjera publike, partneriteteve publiko-private, donacioneve dhe huave.

Politikat, strategjitë dhe planet e veprimit lidhur me BPGj-në për adresimin e dhunës me bazë gjinore

Ky nënseksion shqyrton përgjegjshmërinë gjinore dhe zbatimin e BPGj-së në politikat, strategjitë dhe planet e veprimit që parashohin shërbime të specializuara për adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave (2022-2026)

Në vitin 2022, Qeveria miratoi SKDhG-në.[66] Strategjia trajton të gjitha llojet e veprave penale që duhet të kriminalizohen sipas Kapitullit V të KS-së. Ajo gjithashtu përcakton qëllimet duke u bazuar në masat e kërkuara nga KS-ja, duke përfshirë dhunën fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike. Strategjia parasheh krijimin e një linje telefonike kombëtare të ndihmës për të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në dispozicion 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës.

Strategjia përcakton përgjegjësitë institucionale për zbatimin e politikave që synojnë parandalimin, mbrojtjen, koordinimin, ndjekjen penale, risocializimin dhe riintegrimin. Ministria e Drejtësisë, përmes Zyrës së Koordinatores Nacionale kundër Dhunës në Familje, është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të SKDhG-së dhe Planit të saj të Veprimit. Ndërkohë, disa institucione janë të obliguara t'i përmbushin përgjegjësitë e përcaktuara në Planin e Veprimit të Strategjisë. Strategjia gjithashtu parasheh fuqizimin e kapaciteteve institucionale reaguese të Policisë së Kosovës, përmes themelimit të një drejtorie të veçantë policore në nivel qendror dhe njësive të posaçme në nivel rajonal dhe lokal për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Përveç kësaj, parashihet mbështetje logjistike për njësitë e dhunës në familje, për të mundësuar transportimin e viktimave për qasje në shërbime mjekësore emergjente, paraqitje në gjykatë apo shërbime të tjera mbështetëse. Strategjia më tej parasheh krijimin e fondeve emergjente (para të imëta) në Policinë e Kosovës dhe në QPS, për t'i adresuar nevojat e menjëhershme të viktimave gjatë qëndrimit të tyre në stacionet policore dhe në QPS.

Plani i Veprimit për zbatimin e SKDhG-së 2022-2026 ka një kosto totale të zbatimit prej 5.745.570 € për tri vjet (2022-2024). Ky plan përcakton buxhetet, afatet, burimet e financimit, institucionet përgjegjëse, rezultatet dhe referencat. Megjithatë, për disa aktivitete mungon buxheti për vite të caktuara. Ndonjëherë, për një veprim është përgjegjës më shumë se një institucion, gjë që mund të krijojë vështirësi për t'u kërkuar llogari institucioneve të caktuara për buxhetimin e shpenzimeve. Buxheti nuk siguron burime të mjaftueshme për zbatim. Plani i Veprimit parasheh financim nga buxheti qendror dhe donatorët ndërkombëtarë, duke u mbështetur në mbështetjen e jashtme të donatorëve për zbatimin e tij. Kjo mund ta rrezikojë zbatimin nëse këto fonde nuk sigurohen ose zvogëlohen.

Plani i Veprimit parasheh mbështetje të vazhdueshme financiare për strehimoret, me një buxhet vjetor prej 320.000 € për periudhën 2022-2024. Ky veprim parasheh fuqizimin e shërbimeve mbështetëse përmes punësimit të psikologëve dhe punëtorëve socialë në institucionet publike dhe OJQ-të e specializuara, në proporcion me popullsinë e secilës komunë. Ai kërkon së paku një punëtor social për çdo 20 viktima në secilën QPS dhe kërkon këshillim të specializuar psikosocial, të përshtatur sipas nevojave të grupeve të veçanta. Përveç kësaj, ai i jep përparësi themelimit dhe fuqizimit të mekanizmave koordinues në nivel lokal për

[66] Republika e Kosovës, Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026, 2022.

menaxhimin e rasteve të dhunës. Kjo përfshin themelimin e mekanizmave koordinues në komunat ku mungojnë, hartimin e udhëzuesve dhe protokolleve për funksionimin e tyre, sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare për funksionimin e tyre, ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve përmes trajnimeve periodike për trajtimin e rasteve dhe mbështetjen e komunave për zbërthimin e kësaj Strategjie në strategji lokale dhe plane pune. Buxheti i përgjithshëm për këto veprime është 11.730 €.[67]

Vlen të theksohet se afati i Planit të Veprimit ka skaduar në fund të vitit 2024 dhe nuk është miratuar asnjë Plan i ri Veprimi për ta zëvendësuar. Pritet të hartohet një Plan i ri Veprimi në përputhje me Strategjinë e re për periudhën 2027–2031. Plani i mëparshëm i Veprimit nuk parashihte shpenzime për shërbimet e Qendrës së Krizave për Rastet e Përdhunimit ose të Qendrës së Referimit për Dhunën Seksuale. Ende nuk ekziston ndonjë raport vlerësimi i disponueshëm publikisht për zbatimin e Planit të Veprimit. Prandaj, nuk është e mundur të vlerësohet nëse buxheti i ndarë është shpenzuar sipas planifikimit. Raportet vjetore të shpenzimeve mund të ofronin më shumë qartësi lidhur me shpenzimet.

Raporti Vjetor për vitin 2023 vinte në pah se zbatimi lidhur me Objektivin Strategjik IV, i cili mbulon shërbimet mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara, vazhdonte të ishte i pabarabartë.[68] Nga 28 aktivitetet e planifikuara, 7 (25%) u zbatuan plotësisht, 14 (49%) ishin në zbatim e sipër dhe shtatë (25%) mbetën të pazbatuara, duke treguar një përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2022.[69] Sfidat kryesore të identifikuara në Raport përfshijnë planifikimin e papërshtatshëm të aktiviteteve, angazhimin e pamjaftueshëm të grupeve të caktuara (p.sh., djemve, burrave dhe personave LGBTI+), bashkëpunimin e dobët ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, si dhe buxhetet e pamjaftueshme për fëmijët viktima, të mbijetuarat/it e sulmit seksual dhe shërbimet e OJQ-ve. Raporti gjithashtu vëren mungesën e një fondi emergjent për viktimat dhe programet e pamjaftueshme mbështetëse për riintegrimin ekonomik dhe strehimin. Këto çështje tregojnë se buxheti nuk është ndarë ose siguruar plotësisht për t'i mbuluar të gjitha aktivitetet e planifikuara. Rreziqet e identifikuara përfshijnë rolet e paqarta institucionale, mbështetjen e kufizuar për riintegrimin ekonomik, strehimin e pamjaftueshëm dhe mungesën e ndihmës financiare për arsimimin e fëmijëve. Progresi kufizohet më tej nga raportimi i pamjaftueshëm për rezultatet e arritura për viktimat. Për t'i adresuar këto çështje, institucionet duhet t'i qartësojnë rolet, të ndajnë buxhet të mjaftueshëm dhe ta përmirësojnë monitorimin për ta përcjellë qasjen e viktimave në mbështetje dhe mbrojtje, si dhe realizimin e të drejtave të tyre, që nga procedurat fillestare deri në zgjidhjen e plotë të rasteve. Mungesa e llogaridhënies dhe e mekanizmave të duhur të monitorimit tregon se ekzekutimi i buxhetit është vetëm i pjesshëm dhe nuk është plotësisht në përputhje me ndarjet e planifikuara.

Raporti vjetor i vitit 2024 tregonte se zbatimi i Objektivit Strategjik IV vazhdon të jetë i pabarabartë. Nga 28 aktivitetet e planifikuara, 7 (25%) u zbatuan plotësisht, 14 (49%) ishin në zbatim e sipër dhe 7 (25%) mbetën të pazbatuara. Sfidat kryesore të identifikuara përfshijnë planifikimin dhe koordinimin e dobët, angazhimin e kufizuar të grupeve të caktuara (si burrat, djemtë dhe personat lezbike, gej, biseksualë, transgjinorë dhe interseksualë - LGBTI+), bashkëpunimin e pamjaftueshëm me sektorin privat dhe buxhetimin e papërshtatshëm për shërbimet që mbështesin fëmijët viktima dhe të mbijetuarat/it e dhunës seksuale, si dhe për shërbimet e udhëhequra nga OJQ-të. Raporti thekson vonesat dhe mangësitë në përzgjedhjen dhe financimin e OJQ-ve, mbështetjen e kufizuar komunale për strehimoret dhe subvencionet për pagesat e kopshteve, si dhe hartimin jo të njëtrajtshëm të planeve të banimit social. Përveç kësaj, programet e riintegrimit dhe mbështetja për të drejtat pronësore të grave mbeten të pazhvilluara sa duhet. Në përgjithësi, progresi është kufizuar nga financimi i pamjaftueshëm, përgjegjësitë e paqarta për zbatim dhe sistemet e dobëta të

[67] Më konkretisht, 5.620 € në 2022, 3.055 € në 2023, dhe 3.055 € në 2024.
[68] Republika e Kosovës, Raporti Vjetor i Zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026, 2024.
[69] Ibid.

monitorimit, të cilat së bashku pengojnë përputhjen e plotë ndërmjet aktiviteteve të planifikuara dhe zbatimit në praktikë. Raporti nuk përmban asnjë informacion lidhur me shpenzimet.

Tabela 2. BPGj-ja në SKDhG dhe Plani i Veprimit 2022-2024

Kriteret	Gjetja
Strategjia dhe Plani i Veprimit përcaktojnë qartë buxhetin për të gjitha aktivitetet	Pjesërisht
Shumat e buxhetuara janë të mjaftueshme për realizimin e aktiviteteve	Pjesërisht
Institucioni përgjegjës për buxhetin është i përcaktuar qartë	Pjesërisht
Janë ndarë burime të mjaftueshme shtetërore (pa varësi nga donatorët)	Jo
Buxheti është ndarë (siguruar) plotësisht	Jo
Buxheti i ndarë shpenzohet sipas planifikimit	Pjesërisht

Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë 2022-2026

Objektivat e kësaj Strategjie përfshijnë forcimin e mekanizmave institucionalë, parandalimin e trafikimit me njerëz, përmirësimin e identifikimit, mbrojtjes dhe riintegrimit të viktimave, hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të trafikimit, si dhe fuqizimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.[70] Aktivitetet në Planin e saj të Veprimit 2022-2024 përfshijnë profilizimin e stafit profesional në institucionet ku ofrohen shërbime për viktimat e trafikimit, rritjen e burimeve njerëzore në QPS për trajtimin e rasteve të trafikimit dhe fuqizimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të linjës ndihmëse. Ai gjithashtu përfshin ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve sociale dhe mbrojtësve të viktimave për ta përmirësuar identifikimin e hershëm të viktimave. Plani i Veprimit përfshinte ndarje buxhetore për aktivitete të caktuara; megjithatë, për disa aktivitete nuk ishin specifikuar buxhete. Shumë aktivitete mbështeteshin në financimin nga donatorët. Nuk ka të dhëna nëse buxheti i ndarë është shpenzuar sipas planifikimit.

Tabela 3. BPGj-ja në Strategjinë kombëtare kundër trafikimit me njerëz

Kriteret	Gjetja
Strategjia dhe Plani i Veprimit përcaktojnë qartë buxhetin për të gjitha aktivitetet	Pjesërisht
Shumat e buxhetuara janë të mjaftueshme për realizimin e aktiviteteve	Pjesërisht
Institucioni përgjegjës për buxhetin është i përcaktuar qartë	Pjesërisht
Janë ndarë burime të mjaftueshme shtetërore (pa varësi nga donatorët)	Jo
Buxheti është ndarë (siguruar) plotësisht	Jo
Buxheti i ndarë shpenzohet sipas planifikimit	NA

Protokolli shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale

Në vitin 2022, Qeveria miratoi këtë Protokoll me synim sigurimin e një reagimi të koordinuar për t'i identifikuar, mbrojtur, trajtuar dhe riintegruar të mbijetuarat/it e dhunës seksuale. Protokolli kërkon krijimin e një qasjeje të përqendruar te viktima; kërkon ndarjen e burimeve njerëzore shtesë për menaxhimin adekuat të rasteve (p.sh., së paku dy punëtorë socialë të specializuar dhe të angazhuar posaçërisht në secilën komunë dhe katër në Prishtinë) deri në vitin 2022; kërkon krijimin e një linje telefonike SOS për ofrimin e ndihmës në rastet e dhunës seksuale; dhe kërkon organizimin e Ekipeve të reagimit ndaj sulmeve seksuale (SART). Këto ekipe mbajnë përgjegjësi ligjore për ofrimin e kujdesit profesional dhe gjithëpërfshirës, të koordinuar dhe që përfshin një qasje ekipore shumëdisiplinore për t'iu

[70] Republika e Kosovës, Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë 2022-2026, 2022.

përgjigjur dhunës seksuale në mënyrë të menjëhershme dhe me përgjegjësi. Ekipet duhet të përfshijnë të gjitha institucionet përkatëse: policinë, prokurorinë, mbrojtësit e viktimave, mjekët ligjorë, profesionistët shëndetësorë, QPS-të, strehimoret dhe qendrat e specializuara, siç janë qendrat e referimit për dhunën seksuale ose qendrat e krizave për rastet e përdhunimit.[71] Shërbimet duhet të jenë gjithëpërfshirëse, në dispozicion 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, pa pagesë, të qasshme, të përshtatura sipas nevojave të ndryshme, të financuara në mënyrë adekuate dhe me staf të përbërë nga profesionistë të trajnuar. Shërbimet duhet të sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë personat, pa marrë parasysh moshën, gjininë, aftësitë dhe prejardhjen, si dhe të përfshijnë referime të koordinuara për mbështetje shtesë.

Aktualisht, Kosova nuk ka qendra të krizave për rastet e përdhunimit ose qendra të referimit për dhunën seksuale në numër të mjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve të kërkuara sipas nenit 25 të KS-së. Sfidë kryesore është rregullimi ligjor i këtyre qendrave dhe sigurimi i financimit të mjaftueshëm për themelimin e tyre në përputhje me KS-në. Megjithëse Qeveria ka miratuar Udhëzimin Administrativ (QRK) nr. 01/2025 për Linjën Telefonike Emergjente për Viktimat e Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës me bazë gjinore, Ministria e Drejtësisë si institucion përgjegjës nuk ka ndarë fonde për ta mbështetur funksionimin e saj dhe nuk është e qartë nëse kjo linjë do t'i trajtojë edhe rastet e dhunës seksuale. Krahasimi i buxheteve vjetore komunale për periudhën 2023-2026 nuk tregon ndonjë rritje të numrit të stafit në linjën buxhetore të Departamentit të Mirëqenies Sociale, gjë që sugjeron se komunat nuk i kanë punësuar dhe trajnuar dy punëtorët socialë shtesë të specializuar, siç ishte paraparë.

Tabela 4. BPGj-ja në Protokollin shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale

Kriteret	Gjetja
Protokolli përcakton qartë buxhetin për të gjitha aktivitetet	Jo
Shumat e buxhetuara janë të mjaftueshme për realizimin e aktiviteteve	Jo
Institucioni përgjegjës për buxhetin është i përcaktuar qartë	Jo
Janë ndarë burime të mjaftueshme shtetërore (pa varësi nga donatorët)	Jo
Buxheti është ndarë (siguruar) plotësisht	Jo
Buxheti i ndarë shpenzohet sipas planifikimit	NA

Programi i Kosovës për barazi gjinore 2020-2024

PKBGj-ja synonte ta vendoste barazinë gjinore në qendër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve. Programi kishte tri shtylla: Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale; Zhvillimi njerëzor, rolet dhe marrëdhëniet gjinore; dhe Të drejtat e grave, qasja në drejtësi dhe siguria.[72] Ai ofronte një bazë strategjike dhe institucionale për integrimin e BPGj-së në të gjitha fazat e menaxhimit të financave publike. Ai kërkonte që ABGj-ja dhe zyrtarët komunalë për barazi gjinore (ZBGj) të ofronin mbikëqyrje, mbështetje teknike dhe koordinim lidhur me BPGj-në. Kjo përfshinte hartimin e një kornize gjithëpërfshirëse ligjore dhe të politikave, së bashku me përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve që synonin sigurimin e zbatimit efektiv të LBGj-së.

Ndër veprimet e tij, PKBGj-ja parashihte rishikimin dhe plotësim-ndryshimin e kornizës ligjore për shërbime sociale dhe familjare; ky veprim nuk parashihte ndonjë kosto shtesë. Ai gjithashtu planifikonte trajnimin e punëtorëve socialë për zbatimin e standardeve minimale të shërbimeve sociale, pa asnjë kosto. Një veprim tjetër ishte trajnimi i vazhdueshëm i policisë, prokurorëve, gjyqtarëve, mbrojtësve të viktimave, punëtorëve socialë dhe ofruesve të licencuar të shërbimeve nga OShC-të lidhur me dhunën me bazë gjinore, me theks të veçantë

[71] Republika e Kosovës, Vendimi nr. 11/109, Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, 2022. Protokolli është në përputhje me Nenin 25 të KS-së.
[72] Qeveria e Kosovës, Programi i Kosovës për barazi gjinore 2020-2024, 2020.

në përkufizimet e KPRK-së. As ky aktivitet nuk parashihte ndonjë kosto shtesë, duke pasur parasysh se SKDhG-ja do t'i mbulonte shpenzimet.

Plani i Veprimit parashihte disa ndarje buxhetore për aktivitetet e tij. Megjithatë, për disa masa thuhej se nuk përfshinin kosto shtesë ose se mbuloheshin në kuadër të strategjive ekzistuese. Jo të gjitha aktivitetet kishin ndarje buxhetore të qarta dhe të hollësishme. Institucionet përgjegjëse për zbatimin ishin identifikuar qartë, me detyrimin për të dhënë llogari për veprimet e planifikuara. PKBGj-ja nuk përmbante përllogaritje të hollësishme të kostove dhe shumë aktivitete mbështeteshin në fondet ekzistuese dhe jo në financim shtesë, gjë që e vështirësonte vlerësimin nëse ndarjet buxhetore ishin të mjaftueshme. Megjithatë, mungesa e buxhetit për disa aktivitete sugjeron se ndarjet nuk ishin plotësisht të mjaftueshme. PKBGj-ja i përmend shprehimisht kontributet e donatorëve, duke treguar se zbatimi i plotë varej nga mbështetja e jashtme, përtej burimeve shtetërore.

Nga viti 2020 deri në prill 2024, gjithsej 74 milionë euro u shpenzuan për nisma të barazisë gjinore, duke përfshirë 35 milionë euro nga Buxheti i Republikës së Kosovës; në vitet 2020-2021, u raportuan aktivitete në vlerë prej 38 milionë euro, megjithëse ishin planifikuar vetëm 8 milionë euro, ndërsa në vitin 2022 u shpenzuan 14.5 milionë euro krahasuar me 5.7 milionë euro të planifikuara.[73] Meqenëse Plani i Veprimit mbulonte vetëm periudhën 2020-2022, në kuadër të PKBGj-së nuk u ndanë buxhete për vitet 2023-2024; megjithatë, të dhënat në dispozicion tregojnë se gjatë vitit 2023 dhe periudhës janar-prill 2024 u shpenzuan 20.966.314 €, duke përfshirë 11.857.730 € nga buxheti shtetëror.[74] Shumë aktivitete të raportuara për vitin 2023 dhe periudhën janar-prill 2024 nuk përfshinin hollësi buxhetore, prandaj shpenzimet e përgjithshme për këtë periudhë ka të ngjarë të jenë nënvlerësuar.[75]

Tabela 5. BPGj-ja në PKBGj-në 2020-2024

Kriteret	Gjetja
Programi dhe Plani i Veprimit përcaktojnë qartë buxhetin për të gjitha aktivitetet	Pjesërisht
Shumat e buxhetuara janë të mjaftueshme për realizimin e aktiviteteve	Pjesërisht
Institucioni përgjegjës për buxhetin është i përcaktuar qartë	Pjesërisht
Janë ndarë burime të mjaftueshme shtetërore (pa varësi nga donatorët)	Jo
Buxheti është ndarë (siguruar) plotësisht	Pjesërisht
Buxheti i ndarë shpenzohet sipas planifikimit	Jo, është tejkaluar

Në vitin 2025, Qeveria filloi hartimin e PKBGj-së së re, por ky proces nuk kishte përfunduar deri në finalizimin e këtij hulumtimi. PKBGj-ja e re mund të parashohë ndarje dhe shpenzime përkatëse lidhur me adresimin e dhunës me bazë gjinore, të cilat institucionet përgjegjëse do të duhej t'i merrnin parasysh gjatë procesit të planifikimit të buxheteve për shërbimet e specializuara.

Programi i Qeverisë 2021-2025

Qeveria e miratoi këtë Program në vitin 2021, duke shpalosur vizionin e saj për qeverisjen dhe zhvillimin në Kosovë.[76] Një nga objektivat ishte avancimi i barazisë gjinore përmes finalizimit të kornizës ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore, si dhe përmes fuqizimit të mekanizmave institucionalë për të reaguar në mënyrë efektive ndaj rasteve të tilla. Për të përmirësuar shërbimet e strehimit, u planifikua hartimi i një analize të situatës dhe i një modeli të kostos ekonomike. Më tej, Programi thekson se

[73] Zyra e Kryeministrit, Raporti përfundimtar i vlerësimit të Programit të Kosovës për barazi gjinore 2020-2024, 2024.
[74] Ibid.
[75] Ibid.
[76] Republika e Kosovës, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, 2021.

politikat e reja duhet t'u nënshtrohen vlerësimeve të ndikimit gjinor për të mbështetur një vendimmarrje gjithëpërfshirëse e të bazuar në dëshmi, si dhe BPGj-ja të fuqizohet edhe më tej. Po ashtu, Programi planifikonte financimin e nismave që promovojnë pjesëmarrjen e grave në shoqëri përmes mbështetjes financiare për OJQ-të. Për të parandaluar vështirësitë financiare për strehimoret që ofrojnë shërbime akomodimi, do të merreshin masa konkrete: linja e shërbimeve bazë të strehimit do të kthehej në një linjë të përhershme në Ligjin për Buxhetin e Kosovës dhe korniza ligjore për ndihmën juridike falas do të rishikohej për t'i njohur viktimat e dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore si kategori të veçantë. Dokumenti nuk përmban shifra buxhetore, por vetëm përcakton veprimet e synuara.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 dhe Plani për 2024-2026

E publikuar në prill të vitit 2023, Strategjia synon të krijojë një kornizë që e ndërlidh vizionin afatgjatë për vendin me veprimet konkrete për arritjen e rezultateve të dëshiruara.[77] Ajo ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë i paraqet qëllimet zhvillimore dhe strategjike të Kosovës deri në vitin 2030, të njohura si Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030. Pjesa e dytë i paraqet në hollësi masat strategjike, treguesit dhe hapat konkretë të planifikuar për tri vitet e ardhshme. Kjo perspektivë trevjeçare përkon me periudhën e planifikimit buxhetor afatmesëm, me qëllim që aktivitetet e planifikuara të kenë mbështetje të mjaftueshme financiare. Strategjia e identifikon Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASh) si instrument kyç për harmonizimin e buxheteve me qëllimet e politikave dhe përmirësimin e mbikëqyrjes financiare. Strategjia i jep përparësi adresimit të performancës së dobët dhe menaxhimit të dobët financiar në ndërmarrjet publike, si dhe zbatimit të LBGj-së, veçanërisht përfaqësimit të barabartë në institucionet publike dhe BPGj-së. Për këtë qëllim, ajo planifikon vazhdimin e zbatimit të strategjive ekzistuese, siç është SKDhG-ja. Objektivat zhvillimore përfshijnë përmirësimin e qasjes në kujdesin shëndetësor dhe shërbimet sociale, fuqizimin e sistemeve të mbrojtjes sociale dhe sigurimin e banimit të sigurt dhe adekuat. Prandaj, Strategjia zotohet t'i japë përparësi adresimit të dhunës me bazë gjinore dhe qasjes në shërbime të specializuara. Ajo nuk përmban ndarje specifike buxhetore.

Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026 u miratua në dhjetor të vitit 2023. [78] Ai përfshin dy masa strategjike: parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit (8.4.10); dhe fuqizimin institucional për mbrojtjen dhe trajtimin e viktimave (8.4.11), të udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë. Në kuadër të masës strategjike 8.4.10, ishte planifikuar që 39.650 euro të mbuloheshin nga Qeveria dhe 53.000 € nga donatorët.[79] Masa përqendrohet në fuqizimin e mekanizmave të koordinimit, monitorimin e zbatimit të strategjisë kombëtare, përmirësimin e raportimit dhe mbledhjes së të dhënave dhe sigurimin e qasjes në informacion dhe shërbime për viktimat. Për këto aktivitete u ndanë 17.200 € në vitin 2024. Për vitet 2025 dhe 2026 ishte ndarë buxhet në kuadër të Planeve të rishikuara 2025–2027 dhe 2026–2028, të cilat rishikohen çdo vit. Plani parasheh gjithashtu ndërgjegjësimin për qasjen në drejtësi, duke u përqendruar në dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje, dhunën seksuale gjatë luftës dhe të drejta të tjera. Kjo masë përfshin ndarje buxhetore prej 15.000 € nga fondet e Qeverisë për vitin 2024, 10.000 € nga donatorët për vitin 2025 dhe 15.000 € nga fondet e Qeverisë për vitin 2026. Nuk kishte informacion nëse fondet e parashikuara ishin ndarë dhe shpenzuar sipas planifikimit.

[77] Republika e Kosovës, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030, 2023.
[78] Zyra e Kryeministrit, Mbledhja e 180-të e Qeverisë. Qasur më 24 korrik 2026.
[79] Zyra e Kryeministrit, Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026, 2023

Tabela 6. BPGj-ja në Planin Kombëtar për Zhvillim 2024-2026

Kriteret	Gjetja
Plani përcakton qartë buxhetin për të gjitha aktivitetet	Po
Shumat e buxhetuara janë të mjaftueshme për realizimin e aktiviteteve	Pjesërisht
Institucioni përgjegjës për buxhetin është i përcaktuar qartë	Po
Janë ndarë burime të mjaftueshme shtetërore (pa varësi nga donatorët)	Jo
Buxheti është ndarë (siguruar) plotësisht	NA
Buxheti i ndarë shpenzohet sipas planifikimit	NA

Agjenda e Reformave e Kosovës

Në vitin 2024, Kosova e miratoi Agjendën e Reformave të Kosovës në kuadër të Instrumentit të BE-së për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor.[80] Korniza ofron një udhërrëfyes strategjik për adresimin e prioriteteve kyçe, duke përfshirë qeverisjen, zhvillimin ekonomik, reformat në tregun e punës, infrastrukturën, sundimin e ligjit dhe përfshirjen sociale. BPGj-ja përmendet në seksionin e AR-së për integrimin e perspektivës gjinore dhe në disa reforma. AR-ja përcakton se Kosova është zotuar ta avancojë BPGj-në përmes hartimit të një kornize të posaçme rregullatore, zbatimit sistematik të vlerësimeve *ex-ante* të ndikimit gjinor në nismat e reja të politikave dhe ato rregullatore, si dhe përgatitjes së një Programi të ri të Kosovës për Barazi Gjinore si instrument strategjik që përfshin të gjithë sektorët qeveritarë. Më konkretisht, AR-ja vëren se "në fushën e politikave të të drejtave themelore dhe sundimit të ligjit, do t'i përqendrojmë përpjekjet tona në ... hartimin e kornizës rregullative të Kosovës për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor". Megjithatë, përpjekjet në AR për institucionalizimin e BPGj-së nuk janë të ndërlidhura qartë me qëllimet e përcaktuara në kornizat ndërkombëtare të monitorimit, siç janë treguesi 5.c.1 i OZHQ-ve të OKB-së ose Korniza Gjinore e Shpenzimeve Publike dhe Llogaridhënies Financiare (PEFA)[81]. Agjenda e Reformave nuk përmban as hapa specifikë, as ndarje buxhetore të parashikuara lidhur me institucionalizimin e BPGj-së.

AR-ja synon "ta fuqizojë zbatimin e kornizës legjislative dhe strategjike për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore". Së pari, ajo synon ta vërë plotësisht në funksion Divizionin për Qasje në Drejtësi, Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me bazë gjinore (që shërben në cilësinë e Sekretariatit të Koordinatorit Kombëtar), i cili u themelua sipas Rregullores (QRK) nr. 37/2024.[82] Kjo përfshin funksionalizimin e plotë të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar, përfshirë plotësimin e pozitave të burimeve njerëzore. AR-ja synon gjithashtu ta rrisë numrin e urdhrave për mbrojtje të lëshuar nga gjykatat themelore për 20% krahasuar me vitin 2023. Buxheti i përafërt lidhur me këtë reformë është 6.3 milionë euro. Së dyti, ajo synon ta fuqizojë reagimin gjyqësor ndaj dhunës në familje duke siguruar që dënimet ta tejkalojnë pragun minimal ligjor në të paktën 80% të rasteve dhe duke rritur numrin e dënimeve të plotëfuqishme që zbatojnë marrëdhëniet familjare si rrethanë rënduese. Reforma synon ta përmirësojë llogaridhënien, ta fuqizojë efektin parandalues dhe

[80] Republika e Kosovës, Instrumenti i BE-së për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor: Agjenda e Reformave e Kosovës, 2024.

[81] PEFA vlerëson efektivitetin e sistemeve të menaxhimit financiar publik, dhe korniza e saj e përgjegjshme gjinore përdor nëntë tregues për të vlerësuar se sa mirë këto sisteme e mbështesin barazinë gjinore dhe i trajtojnë nevojat e ndryshme të grave, burrave dhe nëngrupeve. Vlerësimi përqendrohet në kapacitetin e institucioneve për të menaxhuar burimet në një mënyrë të përgjegjshme gjinore, duke përfshirë realizimin e vlerësimeve të ndikimit gjinor dhe përdorimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Korniza ligjore e Kosovës i përmbush kërkesat e Kornizës Gjinore të PEFA-s. Megjithatë, institucionet nuk e integrojnë plotësisht perspektivën gjinore në menaxhimin financiar publik.

[82] Republika e Kosovës, Rregullorja (QRK) Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, 2025.

ta rrisë mbrojtjen për viktimat. Buxheti i përafërt për këtë reformë është 12.5 milionë euro. Asnjëra reformë nuk lidhet shprehimisht me shërbimet sociale.[83]

Asnjë masë nuk përfshin tregues të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor për të përcjellë ndikimet e shpenzimeve te gratë dhe vajzat. ABGj-ja ka propozuar tregues për matjen e barazisë gjinore, por Qeveria ende nuk i ka miratuar. Duke pasur parasysh hartimin e AR-ve, ku ndarjet buxhetore ofrohen si mbështetje e drejtpërdrejtë buxhetore pas arritjes së hapave, është e vështirë të vlerësohet nëse shpenzimet e planifikuara mund të shpenzohen për veprime lidhur me adresimin e dhunës me bazë gjinore apo jo. Nga dokumentet buxhetore të disponueshme publikisht, nuk është e qartë se sa ka ndarë Qeveria për t'i arritur këto masa. Prandaj, nuk është e mundur të vlerësohet nëse kjo është e mjaftueshme ose nëse ndonjë ndarje buxhetore është shpenzuar sipas planit.

Programi për Reforma në Ekonomi 2024-2026

Qeveria e publikoi Programin për Reforma në Ekonomi në vitin 2022. Ai synon të krijojë një sistem të qëndrueshëm dhe afatgjatë të mbrojtjes sociale që i plotëson nevojat e qytetarëve dhe e mbështet zhvillimin ekonomik.[84] Objektivat përfshijnë përmirësimin e shërbimeve sociale, zgjerimin e mbulimit për familjet në varfëri, reformimin e sistemit pensional dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në skemat e përfitimeve dhe shërbimet sociale. Prioritetet shtesë janë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, eliminimi i dyfishimit të pagesave dhe fuqizimi i mbikëqyrjes së respektimit të ligjeve përkatëse nga përfituesit. Masa 20 synon të kontribuojë në mirëqenien e popullsisë përmes zgjerimit dhe përmirësimit të skemave të mbrojtjes sociale, skemave pensionale dhe shërbimeve sociale, në përputhje me Programin e Qeverisë 2021-2025 dhe strategjitë kombëtare për shërbimet sociale, aftësinë e kufizuar dhe mbrojtjen e fëmijës.[85]

Në vitin 2022, kjo masë planifikonte aktivitete të përqendruara në krijimin e kornizës legjislative dhe operacionale për ofrimin e shërbimeve sociale. Kjo përfshinte planet për miratimin e Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe legjislacionit sekondar, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal me udhëzime administrative për financimin përmes granteve specifike, si dhe hartimin e legjislacionit për vlerësimin, njohjen dhe ofrimin e përfitimeve dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Nismat shtesë përfshinin udhëzime administrative për lirimin nga pagesa shëndetësore, ndërtimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve, zbatimin e programit të shtesave për fëmijë, mbështetjen për 50 OJQ të licencuara që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, si dhe hartimin e moduleve të trajnimit profesional për 200 punëtorë socialë.

Në vitin 2023, kjo masë planifikonte të përqendrohet në standardizimin dhe digjitalizimin e ofrimit të shërbimeve sociale. Aktivitetet e planifikuara përfshinin hartimin e standardeve minimale për shërbimet sociale dhe familjare, krijimin e Sistemit Informativ të Skemës së Asistencës Sociale (SAS) dhe platformës së integruar të mirëqenies sociale, digjitalizimin e të dhënave të skemave pensionale, ndërtimin e shtëpive në komunitet për personat e moshuar dhe grupet e cenueshme, si dhe mbështetjen e ofrimit të shërbimeve në përputhje me legjislacionin që pritej të miratohej. Në vitin 2024, ishte planifikuar që përpjekjet të përqendroheshin në zgjerimin e shtëpive në komunitet, vazhdimin e mbështetjes së shërbimeve sipas legjislacionit të ri, licencimin dhe trajnimin e punëtorëve socialë në sektorin publik dhe të atyre në OJQ, zhvillimin e mëtejshëm të platformës së regjistrit social dhe trajnimin e stafit në zyrat e shërbimeve pensionale, OShC-të dhe institucionet e tjera të mbrojtjes sociale. Ndonëse masat nuk u referohen shprehimisht shërbimeve të specializuara,

[83] Meqenëse asnjë hap nuk lidhet me shërbimet e specializuara, tabela e BPGj-së nuk është përfshirë; të gjitha të gjetjet do të ishin "nuk zbatohet", për shkak të mungesës së ndarjeve buxhetore specifike për shërbimet e specializuara.
[84] Republika e Kosovës, Programi i Reformave Ekonomike, 2022, Masa 20.
[85] Strategjia për të drejtat e fëmijëve ka skaduar në vitin 2023.

disa masa për përmirësimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me shërbimet për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë fëmijët.

Kostoja e përgjithshme e vlerësuar e Masës 20 për periudhën 2022-2024 ishte 150 milionë euro. Në vitin 2022, kostoja ishte 30 milionë euro, duke përfshirë 28 milionë euro nga buxheti i Kosovës dhe 2 milionë euro nga fondet e donatorëve); në vitin 2023, 50 milionë euro (47 milionë euro nga buxheti, 3 milionë euro nga donatorët); dhe në vitin 2024, 70 milionë euro (68 milionë euro nga buxheti, 2 milionë euro nga donatorët). Këto shpenzime synonin ta mbështesnin zbatimin e legjislacionit të ri lidhur me shtesat për fëmijë, ndihmën sociale, aftësinë e kufizuar, mbrojtjen e fëmijës dhe shërbimet sociale e familjare. Asnjëra prej tyre nuk dukej se lidhej shprehimisht me adresimin e dhunës me bazë gjinore, por ato nuk ishin të ndara sipas kategorive. Asnjë raport i disponueshëm publikisht nuk ofron informacion për shpenzimet reale.

Programi Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028

Në tetor 2024, Kuvendi e miratoi Programin Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024-2028. Ai shërben si korniza kryesore strategjike e Kosovës për avancimin e integrimit në BE, duke u përqendruar në përafrimin e ligjeve kombëtare me *acquis*-në e BE-së dhe sigurimin e zbatimit efektiv të tyre. Ai synonte t'i adresonte rekomandimet e BE-së për vitin 2024, të cilat përfshinin fuqizimin e zbatimit të ligjeve për dhunën me bazë gjinore, miratimin e akteve të nevojshme nënligjore, ofrimin e mbështetjes financiare për strehimoret dhe shërbimet e specializuara, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional për hetime dhe ndjekje penale në kohë, si dhe fuqizimin e grave dhe vajzave përmes ngritjes së kapaciteteve dhe vlerësimeve të ndikimit gjinor për ta parandaluar dhunën me bazë gjinore dhe për ta siguruar mbështetjen gjithëpërfshirëse për viktimat.

Në matricën e masave afatshkurtra, një masë përqendrohet në përmirësimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas për ta bërë sistemin e drejtësisë më efikas, me buxhet prej 10.000 € (5.000 € nga Kosova dhe 5.000 € nga donatorët). Një masë tjetër synon avancimin e barazisë gjinore me 25.000 € të planifikuara (10.000 € nga Kosova dhe 15.000 € nga donatorët). Një masë e tretë synon fuqizimin e kornizës së politikave për luftimin e dhunës në familje, ngacmimit seksual dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë abuzimin seksual, ekonomik dhe psikologjik. Kjo masë ka buxhet prej 20.000 € (10.000 € nga Kosova dhe 10.000 € nga donatorët). Matrica gjithashtu përfshin masa për përmirësimin dhe avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, me gjithsej 6.000 € për secilën masë, të financuara nga Kosova. Nuk është publikuar ndonjë informacion që përcakton qartë se si janë buxhetuar këto shuma në buxhetet vjetore ose se si janë shpenzuar, përfshirë edhe për shërbimet e specializuara, prandaj nuk mund të vlerësohen buxheti dhe shpenzimet reale.

Tabela 7. BPGj-ja në Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028

Kriteret	Gjetja
Programi përcakton qartë buxhetin për të gjitha aktivitetet	Po
Shumat e buxhetuara janë të mjaftueshme për realizimin e aktiviteteve	Po
Institucioni përgjegjës për buxhetin është i përcaktuar qartë	Po
Janë ndarë burime të mjaftueshme shtetërore (pa varësi nga donatorët)	Pjesërisht
Buxheti është ndarë (siguruar) plotësisht	NA
Buxheti i ndarë shpenzohet sipas planifikimit	NA

Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës (2022-2026)

Siç u theksua, GREVIO ka ngritur shqetësime lidhur me qasjen e grave rome, ashkali dhe egjiptiane në shërbimet e specializuara.[86] Kjo Strategji dhe Plani i saj i Veprimit (2022-2024) e riafirmojnë përkushtimin e Kosovës ndaj një shoqërie shumetnike të bazuar në barazi, të drejta qytetare dhe liri për të gjithë.[87] Në përputhje me kornizën e BE-së për integrimin e romëve, Strategjia përcakton pesë qëllime: zgjerimin e qasjes në arsim cilësor; përmirësimin e punësimit dhe zvogëlimin e varfërisë; sigurimin e qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor; sigurimin e banimit dhe infrastrukturës së qëndrueshme; dhe parandalimin e diskriminimit, racizmit, gjuhës së urrejtjes, segregimit dhe paragjykimeve.[88] Plani i Veprimit përqendrohet në fushata ndërgjegjësuese dhe nuk përmban dispozita specifike për shërbimet e specializuara. [89] Dhuna me bazë gjinore përmendet në lidhje me fushatat e planifikuara ndërgjegjësuese për komunitetet rome dhe ashkali për dhunën. Plani parasheh gjithashtu aktivitete të udhëhequra nga ABGj-ja, duke përfshirë ritransmetimin e një videoje për parandalimin e martesave të hershme dhe prodhimin e 150 fletushkave me kosto totale prej 300 €. Plani i Veprimit përfshin nënshkrimin e Memorandumit të dhjetë të Mirëkuptimit ndërmjet OJQ-ve dhe strehimoreve për ta fuqizuar bashkëpunimin dhe për ta mbështetur rehabilitimin e fëmijëve dhe grave nga komunitetet rome dhe ashkali që janë viktima të dhunës në familje, me 50.000 € të planifikuara çdo vit nga viti 2022 deri në vitin 2024.

Raporti i zbatimit për vitin 2024 tregoi progres të përzier në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.[90] Ndonëse Plani i Veprimit përfshinte mbështetje për OJQ-të e licencuara që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për komunitetet rome dhe ashkali, në vitin 2023 nuk kishte organizata të licencuara dhe asnjë pjesë e buxhetit të planifikuar prej 100.000 € nuk u shpenzua. Ndërkohë, bashkëpunimi me strehimoret vazhdoi përmes marrëveshjeve ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe OJQ-ve që ofrojnë shërbime të mbrojtjes dhe rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje, ku në vitin 2023 u akomoduan 81 viktima rome, ashkali dhe egjiptiane. Ndonëse disa aktivitete lidhur me shërbimet e specializuara kishin ndarje të qarta buxhetore dhe institucione përgjegjëse, jo të gjitha aktivitetet kishin buxhete të specifikuara dhe disa masa vareshin nga mbështetja e donatorëve. Burimet e buxhetuara nuk ishin gjithmonë të mjaftueshme për të siguruar zbatimin dhe disa fonde nuk u shpenzuan sipas planifikimit. Ndonëse Plani i Veprimit përfundoi në vitin 2024, nuk duket se ndonjë Plan i ri Veprimi e ka zëvendësuar atë. Strategjia do të skadoi në vitin 2026.

[86] Këshilli i Evropës, Assessment of the alignment of Kosovo*'s laws, policies and other measures with the standards of the Istanbul Convention [Vlerësimi i përputhshmërisë së ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës* me standardet e Konventës së Stambollit], 2022.

[87] Republika e Kosovës, Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Plani i Veprimit 2022-2024, 2022.

[88] European Commission, EU Roma strategic framework for equality, inclusion and participation for 2020-2030, 2020. [Komisioni Evropian, Korniza strategjike e BE-së për romët për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje 2020-2030, 2020.]

[89] Meqenëse asnjë shpenzim nuk lidhet me shërbimet e specializuara, tabela e BPGj-së nuk është përfshirë; të gjitha të gjetjet do të ishin "nuk zbatohet", për shkak të mungesës së shpenzimeve specifike për shërbimet e specializuara.

[90] Zyra e Kryeministrit, Raporti për Zbatimin e Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planit të Veprimit 2022-2024 për vitin 2023, 2024.

Tabela 8. BPGj-ja në Planin e Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali (2022-2024)

Kriteret	Gjetja
Plani i veprimit përcakton qartë buxhetin për të gjitha aktivitetet	Pjesërisht
Shumat e buxhetuara janë të mjaftueshme për realizimin e aktiviteteve	Pjesërisht
Institucioni përgjegjës për buxhetin është i përcaktuar qartë	Po
Janë ndarë burime të mjaftueshme shtetërore (pa varësi nga donatorët)	Pjesërisht
Buxheti është ndarë (siguruar) plotësisht	Pjesërisht
Buxheti i ndarë shpenzohet sipas planifikimit	Jo

Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2025-2030

Strategjia synon t'i avancojë të drejtat dhe mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara, familjeve të tyre, përfaqësuesve ligjorë dhe të gjitha palëve përkatëse të interesit.[91] Ajo përqendrohet në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve sociale, nxitjen e arsimit gjithëpërfshirës dhe zhvillimit profesional, si dhe përmirësimin e qasshmërisë dhe pjesëmarrjes. Ajo i harmonizon reformat kombëtare me KDPAK-në e OKB-së dhe OZHQ-të e Agjendës 2030, veçanërisht OZHQ-në 10, që synon t'i zvogëlojë pabarazitë dhe ta promovojë përfshirjen sociale. Plani shoqërues i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2025-2027 i zbërthen këto objektiva në aktivitete dhe tregues të matshëm, duke theksuar fuqizimin institucional, qasshmërinë dhe ndërgjegjësimin e publikut për çështjet e aftësisë së kufizuar. Kostoja e përgjithshme e zbatimit për periudhën 2025-2027 u vlerësua në 1.398.950 €, nga të cilat ishte planifikuar që 45.000 € të financoheshin nga donatorët dhe 1.353.950 € nga Kosova.

Strategjisë i mungojnë dispozitat specifike për shërbimet e specializuara.[92] GREVIO ka ngritur shqetësime lidhur me qasjen e grave me aftësi të kufizuara në shërbime të specializuara.[93] Kjo mund të ishte adresuar përmes kësaj Strategjie dhe Planit të Veprimit, ose përmes versioneve të tyre të ardhshme.

Krahas miratimit të kësaj Strategjie, Kosova ka ndërmarrë disa reforma legjislative dhe rregullatore. Këto përfshijnë Ligjin për Personat e Verbër, i cili siguron kompensim mujor dhe qasje me përparësi në shërbimet publike; Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, i cili përcakton kompensimet, përfitimet shtesë dhe qasjen me përparësi në banim social; si dhe Rregulloren QRK nr. 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës, e cila i obligon institucionet publike ta sigurojnë interpretimin në gjuhën e shenjave dhe parasheh financimin, trajnimin dhe monitorimin e saj. Megjithatë, këto masa nuk përfshijnë shërbime të specializuara për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore me aftësi të kufizuara dhe as nuk parashohin BPGj-në për t'i adresuar këto nevoja specifike.

Planet Lokale të Veprimit për Barazi Gjinore

Komunat janë përgjegjëse për hartimin e planeve të veprimit për adresimin e dhunës me bazë gjinore në nivel lokal, në përputhje me SKDhG-në. Ato gjithashtu menaxhojnë shërbimet në fusha të tilla si shëndetësia, arsimi, trajnimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, të

[91] Republika e Kosovës, Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2025-2030, 2025.
[92] Meqenëse asnjë shpenzim nuk lidhet me shërbimet e specializuara, nuk është përfshirë tabela që përmbledh vlerësimin e ndarjeve buxhetore; të gjitha të gjetjet do të ishin "nuk zbatohet".
[93] Council of Europe, Assessment of the alignment of Kosovo*'s laws, policies and other measures with the standards of the Istanbul Convention, 2022.
[Këshilli i Evropës, Vlerësimi i harmonizimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës* me standardet e Konventës së Stambollit, 2022.]

cilat financohen kryesisht përmes transfereve nga buxheti i përgjithshëm i Kosovës. Gjithsej 17 komuna kanë hartuar plane për zbatimin e zotimeve për barazi gjinore. [94] Planet synojnë t'i fuqizojnë gratë, vajzat dhe të rejat në gjithë diversitetin e tyre përmes rritjes së transparencës, pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe ndërgjegjësimit për të drejtat e barabarta. Ato gjithashtu synojnë ta përmirësojnë qasjen në mundësitë ekonomike, punën e dinjitetshme, shërbimet sociale cilësore, arsimin, kulturën dhe sportin. Treguesit kyç përfshijnë përqindjen e grave që janë të informuara për të drejtat e tyre, buxhetin e ndarë për masat për barazi gjinore, si dhe pjesëmarrjen në shërbime sociale, në arsim dhe në aktivitete kulturore e sportive. Meqenëse shërbimet sociale ofrohen kryesisht në nivel komunal, planet lokale të veprimit për barazi gjinore dhe për shërbime sociale do të duhej të planifikonin burime financiare për mbështetjen e shërbimeve të specializuara. [95]

Shqyrtimi i planeve të veprimit tregon se programet kryesisht kanë buxhet të përcaktuar, me ndarje të planifikuara për aktivitetet përkatëse. Institucionet përgjegjëse për zbatim janë identifikuar. Megjithatë, disa aktivitete varen nga financimi i jashtëm i donatorëve. Po ashtu, ka mungesë financimi për disa aktivitete të planifikuara. Në vitin 2025, 16 komuna kishin shënuar progres modest, duke zbatuar rreth 60% të aktiviteteve të tyre të planifikuara.[96] Zbatimi varionte nga komuna në komunë, ku disa kishin tejkaluar 70% të aktiviteteve të planifikuara, ndërsa të tjerat kishin zbatuar më pak se 50% të tyre, duke pasqyruar dallimet në kapacitete, burime dhe caktimin e prioriteteve. Shumë aktivitete kanë filluar, por mbeten pjesërisht të zbatuara ose nuk kanë filluar për shkak të pengesave strukturore dhe administrative dhe jo për shkak të mungesës së vullnetit politik, siç janë vonesat në procedura, riprogramimi i fondeve dhe disbursimi i ngadalshëm. Sfidat kyçe përfshinin vonesat në themelimin e komiteteve për barazi gjinore, kapacitetet e kufizuara zbatuese, mekanizmat e dobët të monitorimit dhe, në disa raste, mungesën e shërbimeve thelbësore, të cilat e kufizuan zbatimin e tyre. Po kështu, dokumentimi i dobët dhe mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë e zbehin llogaridhënien dhe e kufizojnë vlerësimin e ndikimit. Kufizimet shtesë përfshijnë mospërputhjet buxhetore, mbingarkesën e stafit, prioritetet konkurruese dhe pengesat shoqërore që ndikojnë në të drejtat dhe përfshirjen e grave, veçanërisht të grupeve të margjinalizuara. Mangësitë në koordinim dhe kufizimet e burimeve vazhdojnë ta pengojnë zbatimin e plotë të tyre. Siç tregon Tabela 9, shkalla në të cilën planet komunale përfshijnë BPGj-në, kanë fonde të ndara dhe i shpenzojnë ato ndryshon nga komuna në komunë.

Tabela 9. BPGj-ja në Planet Lokale të Veprimit për Barazi Gjinore

Kriteret	Gjetja
Planet e veprimit përcaktojnë qartë buxhetin për të gjitha aktivitetet	Po/Pjesërisht
Shumat e buxhetuara janë të mjaftueshme për realizimin e aktiviteteve	Pjesërisht
Institucioni përgjegjës për buxhetin është i përcaktuar qartë	Po/Pjesërisht
Janë ndarë burime të mjaftueshme shtetërore (pa varësi nga donatorët)	Pjesërisht
Buxheti është ndarë (siguruar) plotësisht	Pjesërisht
Buxheti i ndarë shpenzohet sipas planifikimit	Pjesërisht

Rregullorja e Punës së Qeverisë dhe Vlerësimi i Ndikimit Gjinor

Në kuadër të zbatimt të obligimeve për integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha ligjet dhe politikat, të përcaktuara në LBGj, kjo Rregullore kërkon realizimin e Vlerësimeve të

[94] Këto përfshijnë Hanin e Elezit, Gjilanin, Dragashin, Kamenicën, Gjakovën, Obiliqin, Vitinë, Podujevën, Lipjanin, Istogun, Graçanicën, Klinën, Mitrovicën, Prizrenin, Pejën, Ferizajn dhe Prishtinën.
[95] Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, neni 8.
[96] Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Nga politika në praktikë: Monitorimi i zbatimit të planeve lokale të veprimit për barazi gjinore në Kosovë, 2025.

Ndikimit Gjinor (VNGj)[97] Neni 7 përcakton se para se ndonjë koncept dokument, projektligj, akt nënligjor ose strategji t'i dorëzohet Qeverisë, organi propozues duhet të konsultohet me ABGj-në. Që nga viti 2018, Qeveria e Kosovës e ka kërkuar VNGj-në si pjesë të obligueshme të hartimit të legjislacionit dhe politikave, siç përcaktohet në Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021.[98] Kjo Strategji synonte ta përmirësonte cilësinë e politikave publike dhe efikasitetin e administratës publike. VNGj-ja u prezantua si instrument i analizës *ex-ante* të politikave që duhet të përdoret gjatë hartimit të koncept-dokumenteve për të vlerësuar nëse nismat e propozuara mund të përmirësohen për ta promovuar më mirë barazinë gjinore dhe për ta siguruar përputhjen si me parimet e barazisë gjinore, ashtu edhe me agjendën kombëtare të Kosovës për barazi gjinore.[99]

Për ta mbështetur zbatimin e Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, *Udhëzuesi dhe Doracaku për Hartimin e Koncept-Dokumenteve* i përcaktojnë kërkesat për hartimin e koncept-dokumenteve. Shtojcat ilustrojnë mënyrën se si duhet të plotësohen koncept-dokumentet për miratim nga Qeveria, pas analizave dhe konsultimeve me palët e interesit. Kjo përfshin një instrument të VNGj-së për ta udhëzuar vlerësimin e çështjeve që lidhen me gjininë në secilin koncept-dokument. [100] Ky instrument synon ta përmirësojë cilësinë e përkufizimit të problemit përmes analizimit të problemit, shkaqeve dhe efekteve të tij nga perspektiva gjinore. Në vitin 2019, ABGj-ja e hartoi Manualin për VNGj, me qëllim të udhëzimit të VNG-ve të politikave, programeve dhe aktiviteteve. [101]

Prandaj, të gjitha institucionet publike, përfshirë organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, duhet të sigurojnë që elementet thelbësore të barazisë gjinore të integrohen në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe kornizave të tyre ligjore, përfshirë konceptet, proceset, sistemet dhe instrumentet përkatëse. Rrjedhimisht, VNGj-ja, si instrument kyç i analizës gjinore, duhet të jetë pjesë përbërëse e hartimit të politikave dhe përgatitjes së koncept-dokumenteve. Sikurse organet e tjera qeveritare, organizatat buxhetore duhet të kryejnë VNGj *ex-ante* në përputhje me Manualin e ABGj-së. Këto vlerësime duhet të shërbejnë si bazë për hartimin e politikave publike dhe propozimeve buxhetore vjetore apo shumëvjeçare, duke përfshirë analizën gjinore ndërsektoriale aty ku është relevante. VNGj-ja mund të ndihmojë në identifikimin e nevojave specifike gjinore dhe pabarazive të mundshme në fazat e hershme të hartimit të politikave, në mënyrë që ato të adresohen përmes masave buxhetore të synuara nga organizatat buxhetore, siç janë ministritë dhe komunat.

Rregullorja (MPMS) nr. 02/2015 për Kriteret dhe Procedurat e Përkrahjes Financiare për Subvencione dhe Grante

Kjo Rregullore i përcakton kriteret dhe procedurat për mbështetjen e individëve që kanë nevojë për ndihmë financiare, si dhe OJQ-ve dhe ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime dhe zbatojnë projekte lidhur me punësimin dhe mirëqenien sociale.[102] Ministria mund t'u ofrojë mbështetje financiare individëve, OJQ-ve dhe bizneseve që aplikojnë për mbështetje financiare përmes subvencioneve dhe granteve. Në fillim të çdo viti, Ministria përgatit një

[97] Republika e Kosovës, Rregullorja nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, 2011.
[98] Republika e Kosovës, Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021.
[99] Ibid.
[100] Zyra e Kryeministrit, *Manuali për Vlerësimin e Ndikimit Gjinor*, 2019.
[101] Ibid. Për t'i ngritur kapacitetet institucionale për realizimin e VNGj-ve, ABGj-ja gjithashtu organizoi 14 sesione trajnimi dyditore dhe 11 ngjarje orientuese gjatë periudhës 2018-2019, ku morën pjesë 486 shërbyes civilë (Rrjeti Mbikëqyrës i Buxhetimit Gjinor, Monitorimi i zbatimit të treguesit 5.c.1 të OZHQ-ve në Kosovë, 2020).
[102] Republika e Kosovës, Rregullore nr. 02/2015 për Kriteret dhe Procedurat e Përkrahjes Financiare për Subvencione dhe Grante, 2015, neni 1. Vlen të theksohet se në versionin anglisht përdoret termi "Rules" ("Rregulla"), ndërsa në versionin shqip përdoret "Rregullatore", që do të thotë "Rregullore". Për qëllime të konsistencës, përdoret termi "Rregullore".

program mbështetës për subvencione dhe grante.[103] Mbështetja mund të mbulojë nevojat urgjente sociale për individë dhe familje, si dhe shërbimet sociale dhe familjare për viktimat e dhunës në familje, ndër të tjera.[104] Neni 7 mundëson financimin e individëve dhe OJQ-ve në raste të nevojave urgjente për para, strehim ose kushte bazike të jetesës. Procedura e aplikimit për përfitimin e subvencioneve ose granteve fillon pas shpalljes publike zyrtare përmes një thirrjeje për propozime ose konkursi të bazuar në projekte, në të cilin përcaktohet qartë afati i aplikimit. Shuma maksimale e mbështetjes përmes subvencioneve përcaktohet në thirrjen ose konkursin publik.

OJQ-të që aplikojnë për subvencione ose grante duhet të jenë të regjistruara dhe t'i plotësojnë kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë. Aplikimet duhet të përfshijnë një projekt-propozim me objektivat, aktivitetet, përfituesit, afatin kohor, vendndodhjen dhe buxhetin e hollësishëm. OJQ-të duhet gjithashtu ta dëshmojnë kapacitetin menaxhues dhe aftësinë për zbatimin e projektit, si dhe të dorëzojnë dokumente mbështetëse, duke përfshirë CV-të e ekspertëve, certifikatën e regjistrimit, numrin fiskal, të dhënat bankare dhe raportet financiare për dy vitet e fundit. OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare duhet të jenë të licencuara për llojin specifik të shërbimeve që ofrojnë.

Udhëzim Administrativ nr. 01/2026 për procedurën e dhënies, përsëritjes, pezullimit dhe marrjes së licencës për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare

Ky Udhëzim Administrativ përcakton procedurat dhe kushtet për licencimin, ripërtëritjen, pezullimin dhe heqjen e licencave për ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare, si dhe llojet e shërbimeve që i nënshtrohen licencimit dhe tarifat përkatëse të licencimit.[105] Ai përcakton kërkesat minimale që lidhen drejtpërdrejt me funksionimin dhe vlerësimin e kostove të shërbimeve sociale, përfshirë kërkesat për hapësira dhe infrastrukturë adekuate, pajisje të përshtatshme, profesionistë të kualifikuar dhe të licencuar, si dhe dokumentimin e marrëveshjeve të punësimit ose të ofrimit të shërbimeve. Ofruesit që aplikojnë për licencim ose ripërtëritje të licencës duhet të dëshmojnë se kanë hapësirë dhe infrastrukturë të mjaftueshme, pajisje të përshtatshme dhe profesionistë të licencuar sipas llojit të shërbimit që ofrojnë. Udhëzimi gjithashtu përcakton kërkesat për dokumentacionin financiar dhe administrativ dhe parasheh verifikimin përmes shqyrtimit të dokumentacionit dhe inspektimeve në terren. Licencat fillimisht janë të vlefshme për tri vjet dhe ripërtëriten për pesë vjet, ndërsa përmbushja e kushteve i nënshtrohet monitorimit dhe pezullimit të mundshëm kur kushtet e kërkuara nuk përmbushen më. Këto kërkesa kanë ndikim të drejtpërdrejtë në kostot e ofruesve të shërbimeve, përfshirë kostot e hapësirave, pajisjeve, stafit, licencimit profesional, administrimit dhe përmbushjes së kushteve. Prandaj, ato duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të burimeve të nevojshme për ofrimin e shërbimeve sociale që lidhen me dhunën me bazë gjinore, si dhe gjatë vlerësimit të mjaftueshmërisë së mënyrave aktuale të financimit.

[103] Neni 4.
[104] Ibid., Neni 5.
[105] Republika e Kosovës, Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2026 për Procedurën e Dhënies, Përsëritjes, Pezullimit dhe Marrjes së Licencës për Ofruesit e Shërbimeve Sociale dhe Familjare, 2026.

Rregullorja MF - Nr - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve

Kjo Rregullore i përcakton kriteret, standardet dhe procedurat themelore për financimin publik të OJQ-ve. [106] Organizatat buxhetore që financojnë projekte dhe programe të OJQ-ve duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore. Rregullorja kërkon që ofruesit e mbështetjes financiare ta planifikojnë këtë mbështetje brenda buxhetit vjetor të Kosovës "në përputhje me prioritetet dhe objektivat strategjike dhe në konsultim me shoqërinë civile". [107] OJQ-të aplikuese duhet t'i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe specifike të përcaktuara, duke përfshirë dëshminë se kanë përvojë në zbatimin e projekteve të ngjashme dhe licencat përkatëse për realizimin e aktiviteteve të parapara; ndërsa ofruesit e mbështetjes financiare mund të vendosin kërkesa shtesë. [108] Rregullorja sugjeron se kontratat mund të zgjasin më shumë se një vit. [109]

Rregullorja nuk zbatohet veçanërisht kur "shuma e të gjitha përkrahjeve të tilla të drejtpërdrejta nuk tejkalon shumën prej një për qind (1%) të ndarjes totale buxhetore në kuadër të kodit/programit buxhetor për vitin përkatës fiskal, në rastet kur shuma total e në kuadër të atij kodi programi është mbi një milion (1,000,000.00 €) euro" [*sic*]. [110] Sipas raportimeve, ky nen e ka kufizuar financimin për ofruesit e shërbimeve, duke përfshirë strehimoret. Për shembull, linja buxhetore e Ministrisë së Drejtësisë për ofruesit e shërbimeve sociale ishte 2.500.000 € në vitin 2025. Për t'i financuar OJQ-të në bazë të kësaj Rregulloreje, Ministria nuk mund të ndante më shumë se 1%, ose 25.000 €, për një strehimore, gjë që do të ishte e pamjaftueshme për t'i mbuluar shpenzimet e saj.

Rregullorja (QRK) – Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore

Sipas LDhBGj-së, kjo Rregullore përcakton përgjegjësitë e MKL-ve për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore. [111] Ajo përcakton se çdo MKL duhet të përfshijë kryetarin e komunës (kryesuesin), drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ose departamentin përkatës, drejtorin e QPS-së, udhëheqësin e Shërbimeve Sociale në QPS, drejtorin e Arsimit, zyrtarin për barazi gjinore, drejtorin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, përfaqësuesin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, përfaqësuesin e strehimores dhe përfaqësuesin e OJQ-ve lokale aktive në fushën e të drejtave të njeriut ose të grave. Në përputhje me nenin 9 të LDhBGj-së, mbrojtësit/et e viktimave nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave dhe përfaqësuesit/et nga gjykatat, prokuroria, policia, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, zyrat e punësimit dhe qendrat e shëndetit mendor ftohen të bëhen pjesë e MKL-ve. Në mungesë të kryesuesit, nënkryetari i parë i komunës e ushtron rolin e zëvendëskryesuesit. Kryesuesi duhet të emërojë një "Sekretariat" për ta lehtësuar punën e MKL-së. Të gjithë anëtarët e MKL-së duhet të ndjekin trajnimin fillestar dhe të avancuar të detyrueshëm.

Përgjegjësitë e MKL-ve përfshijnë: identifikimin e nevojave të viktimave dhe ofrimin e mbështetjes në bazë të KS-së; koordinimin e politikave për shërbime specifike për

[106] Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Financave, Rregullore MF - Nr - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, 2017.
[107] Neni 5.
[108] Nenet 10 dhe 11.
[109] Neni 24, paragrafi 3.1 i referohet raportimit për projektet më të gjata se një vit. Modelet e bashkëngjitura përfshijnë gjithashtu të dhëna për aktivitetet shumëvjeçare.
[110] Neni 2, paragrafi 5.3. Neni gjithashtu përcakton se Rregullorja nuk zbatohet për financimin nën €500, 5% të kodeve buxhetore deri në €100,000 dhe 2% të kodeve buxhetore që variojnë nga €100,001 deri në €1,000,000.
[111] Republika e Kosovës, Qeveria, Rregullore (QRK) – Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, e miratuar në Mbledhjen e 249-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 01/249, datë 26.02.2025, neni 1.

mbështetjen e viktimave; koordinimin e punës së institucioneve drejt parandalimit, mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimave; hartimin e planeve komunale të veprimit për zbatimin e SKDhG-së; propozimin e buxhetit për shërbimet sociale për miratim nga kuvendet komunale; ngritjen e vetëdijes për zero tolerancë ndaj dhunës; dhe koordinimin e përpjekjeve me OShC-të e grave. Rregullorja kërkon konfidencialitet dhe një qasje të përqendruar te viktima, e cila i merr parasysh nevojat dhe të drejtat e viktimave. MKL-të duhet të mblidhen të paktën çdo tre muaj, por mund të thërrasin edhe mbledhje *ad hoc* për të adresuar raste specifike. Kryesuesi është përgjegjës për raportimin çdo vit në Kuvendin Komunal dhe çdo gjashtë muaj te Koordinatori Kombëtar.

Procedurat standarde të operimit

Në vitin 2013, Kosova i miratoi PSV-të për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, të cilat synonin krijimin e një sistemi të koordinuar kombëtar të reagimit që përfshinte të gjitha institucionet përkatëse, duke përfshirë Policinë e Kosovës, gjyqësorin, shërbimet sociale, ministritë e shëndetësisë dhe arsimit, si dhe OShC-të.[112] PSV-të synojnë t'i qartësojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve kompetente në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje përmes identifikimit, referimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegrimit. PSV-të aktuale përqendrohen vetëm te dhuna në familje dhe nuk i përfshijnë format e tjera të dhunës me bazë gjinore. Deri në vitin 2025, ato ishin në proces të përditësimit në përputhje me LDhBGj-në dhe reformat e tjera të fundit ligjore.

PSV-të për Personat e Trafikuar ofrojnë udhëzime zyrtare për identifikimin, mbrojtjen dhe referimin e personave të trafikuar.[113] PSV-të bazohen në parime kyçe që i udhëheqin akterët kundër trafikimit dhe ofruesit e shërbimeve gjatë proceseve të identifikimit, referimit, ndihmës dhe përfshirjes sociale të personave të supozuar ose të identifikuar si të trafikuar. Dokumenti përfshin identifikimin; ndihmën dhe mbrojtjen e parë; ndihmën e mëtejshme dhe përfshirjen sociale; kthimin vullnetar të asistuar ose rivendosjen; si dhe procedurat penale dhe civile. PSV-të përcaktojnë veprimet që duhet të ndërmerren, kohën kur duhet të kryhen, akterët përgjegjës dhe mënyrën se si duhet të zbatohen.

Udhëzimi Administrativ MD - Nr. 14/2024 për Kriteret dhe Mënyrën për Licencimin e Punonjësit Profesional për Ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare

Ky Udhëzim përcakton procedurat për "aplikimin, mënyrën, kriteret dhe kërkesat për marrjen e licencës për ofrimin e shërbimeve sociale. Ai gjithashtu përfshin procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes për licencim, procedurën e ankesës dhe tarifën e licencimit".[114] Ai është i detyrueshëm për të gjithë profesionistët që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, përfshirë punëtorët socialë në QPS dhe strehimore.

[112] OSBE, Strehimoret për viktimat e dhunës në familje në Kosovë, 2019.
[113] Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Koordinatorit Nacional Kundër Trafikimit, Procedurat Standarde të Veprimit për Personat e Trafikuar në Kosovë.
[114] Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Drejtësisë, Udhëzim Administrativ MD - Nr. 14/2024 për Kriteret dhe Mënyrën për Licencimin e Punonjësit Profesional për Ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare, e miratuar nga Ministri i Ministrisë së Drejtësisë më 26.11.2024, me Vendimin nr. 416/2024.

Udhëzimi Administrativ MD - Nr. 02/2025 për Përcaktimin e Procedurës për Ofrimin e Shërbimeve nga Fondi Emergjent për Nevojat e Viktimave Gjatë Qëndrimit në Polici

Ky Udhëzim përcakton procedurën për "ofrimin e shërbimeve nga Fondi Emergjent për nevojat e viktimave të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore gjatë qëndrimit të tyre në polici, për të siguruar adresimin e nevojave të tyre të menjëhershme", në përputhje me LDhBGj-në. [115] Ai kërkon që QPS-të të planifikojnë, menaxhojnë dhe shfrytëzojnë buxhetet komunale për krijimin e Fondeve Emergjente për të "mbuluar nevojat themelore të menjëhershme të viktimave dhe të personave që varen nga viktima gjatë qëndrimit të tyre në polici". [116] Fondet emergjente mund të mbështesin ushqimin, pijet, veshmbathjen, produktet higjienike, barnat dhe shërbime të tjera emergjente që menaxherët e rasteve në QPS i përcaktojnë si të nevojshme pas vlerësimit të nevojave. QPS-të duhet t'i raportojnë çdo tremujor Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, kryetarit të komunës dhe MKL-së për fondet e ofruara dhe numrin e përfituesve të Fondit Emergjent.

Udhëzimi Administrativ (MD) Nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial

Ky Udhëzim përcakton kushtet strukturore dhe funksionale për strehimin rezidencial për lloje të ndryshme të përfituesve, përfshirë strehimoret për dhunën me bazë gjinore. [117] Ai parasheh se "Strehimoret ofrojnë strehim të sigurt, shërbime për mbrojtjen, rehabilitimin, riintegrimin dhe ofrimin e mbështetjes së specializuar për fëmijët dhe të rriturit viktima të të gjitha formave të dhunës, duke ua përshtatur nevojave të tyre specifike". [118] Ai përcakton numrin maksimal të banorëve në shtëpinë në baza në komunitet: dymbëdhjetë në shtëpinë me bazë në komunitet për të rritur dhe tetë në shtëpinë për fëmijë. Gjithashtu përcakton procedurat e pranimit, të udhëhequra nga QPS-të, dhe mbajtjen e shënimeve. Mbajtja e shënimeve nuk kërkon gjininë, përkatësinë etnike ose aftësitë e kufizuara të përfituesve, apo numrin e ditëve për të cilat është ofruar strehimi. Shtojca 4 përshkruan "Standardet minimale të cilësisë për shërbime sociale në Strehim Rezidencial strehimore viktimë e dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore, viktimë e trafikimit me qenie njerëzore apo forma tjera të dhunës ".

Udhëzimi Administrativ MPFVLÇ-Nr. 02/2026 për Përcaktimin e Kushteve Minimale për Themelimin e Institucioneve të Shërbimeve Sociale

Ky Udhëzim i ri përcakton kushtet minimale për institucionet që ofrojnë shërbime sociale, përfshirë QPS-të dhe shtëpitë e sigurta. [119] Për QPS-të, ai përcakton në hollësi kërkesat lidhur me kushtet fizike, pajisjet dhe stafin e kualifikuar në mënyrë të duhur me trajnime të vazhdueshme. Për strehimoret, ai i referohet kërkesave në Udhëzimin Administrativ nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial.

---

[115] Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Drejtësisë, Udhëzim Administrativ MD - Nr. 02/2025 për Përcaktimin e Procedurës për Ofrimin e Shërbimeve nga Fondi Emergjent për Nevojat e Viktimave Gjatë Qëndrimit në Polici, nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Drejtësisë më 12.02.2025 me Vendimin nr. 40/2025 të datës 12.02.2025, neni 1.

[116] Nenet 3 dhe 4.

[117] Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Drejtësisë, Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial, nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Drejtësisë më 13.02.2025, me Vendimin nr. 51/2025 të datës 13.02.2025, veçanërisht neni 14 dhe Shtojca 4.

[118] Neni 14, paragrafi 2.

[119] Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Udhëzim Administrativ MPFVLÇ-Nr. 02/2026 për Përcaktimin e Kushteve Minimale për Themelimin e Institucioneve të Shërbimeve Sociale, i miratuar nga Ministri me Vendimin nr. 02/2026, 08.07.2026. Neni 15 i referohet strehimoreve.

Zotimet buxhetore për adresimin e dhunës me bazë gjinore

Ky seksion shqyrton shkallën në të cilën financimi i shërbimeve të specializuara për adresimin e dhunës me bazë gjinore pasqyrohet në buxhetet afatmesme dhe vjetore. Ai gjithashtu shqyrton perspektivën financiare afatmesme të Kosovës në kontekstin e disponueshmërisë së financimit për shërbimet e specializuara.

Perspektiva financiare afatmesme e Kosovës

Ekonomia e Kosovës u rrit për 3.6% në TM1 të vitit 2025, më ngadalë se rritja prej 5.6% në TM1 të vitit 2024.[120] Ky ngadalësim ishte pasojë e rritjes më të ulët të konsumit, rënies së eksporteve të mallrave dhe rritjes së importeve. Ndërkohë, rritja e ekonomisë u mbështet kryesisht nga investimet dhe eksportet e shërbimeve. Inflacioni ishte mesatarisht 2.3% në vitin 2025, i nxitur kryesisht nga rritja e çmimeve të ushqimit, ndërsa në këtë trend kontribuan edhe shërbimet dhe energjia. Deficiti aktual u rrit në 9.2% të Bruto Produktit Vendor (BPV), si pasojë e rritjes së importeve të energjisë elektrike, ushqimit dhe automjeteve. Eksportet më të mëdha të shërbimeve, veçanërisht turizmi i diasporës, e kompensuan pjesërisht përkeqësimin. Pozicioni fiskal vazhdoi të mbetet i qëndrueshëm, me deficit buxhetor prej 0.7% të BPV-së, pavarësisht shpenzimeve më të larta sociale. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) parashikon që rritja e BPV-së do të ngadalësohet më tej në 3.3% në vitin 2026, ndërsa inflacioni pritet të rritet në 5.9% për shkak të çmimeve më të larta globale të mallrave bazë.

Sipas Raportit për Vendin të FMN-së, Kosovës i nevojiten reforma gjithëpërfshirëse strukturore dhe institucionale për t'i përmirësuar rezultatet ekonomike dhe sociale, për t'i fuqizuar institucionet publike dhe për ta rritur konkurrueshmërinë; raporti gjithashtu vëren se, për shkak të hendekut të madh gjinor, edhe një rritje e vogël e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore mund ta rriste ndjeshëm ofertën e fuqisë punëtore në vend.[121]

Raporti Vjetor i Auditimit 2024 tregon se 31 nga 38 auditimet komunale (81%) rezultuan me opinione të kualifikuara, krahasuar me 60% në vitin 2023, duke treguar përkeqësim të rezultateve. [122] Çështjet kryesore përfshinin klasifikimin joadekuat të shpenzimeve, duke përfshirë rastet që lidhen me pagesat gjyqësore/përmbarimore për obligimet nga kontratat kolektive, siç janë pagat jubilare, si dhe planifikimin e dobët buxhetor. Kishte gjithashtu probleme në regjistrimin e pasurive, detyrimeve, detyrimeve kontingjente dhe llogarive të arkëtueshme. Në 14 komuna, klasifikimi joadekuat lidhur me kostot e kontratave kolektive ishte një nga arsyet kryesore për opinionet e kualifikuara. Raporti gjithashtu vë në pah kontrollet e dobëta të brendshme dhe gabimet në raportimin financiar, të cilat ndikuan në pasqyrat financiare vjetore.

Nga këndvështrimi makroekonomik, rritja e të hyrave është shoqëruar me rritje të shpenzimeve, duke lënë pak hapësirë fiskale për rritjen e shpenzimeve për financim më të mirë të shërbimeve. Në këtë kontekst, me gjasë do të nevojitet rishpërndarja e burimeve ekzistuese për financimin e duhur të shërbimeve sociale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

[120] Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë, 2025.
[121] IMF, Republic of Kosovo, Fourth Reviews Under the Stand-By Arrangement and the Arrangement Under the Resilience and Sustainability Facility-Press Release; Staff Report; and Statement by the Executive Director for the Republic of Kosovo, 2025. [Fondi Monetar Ndërkombëtar, Republika e Kosovës, Shqyrtimet e katërta në kuadër të Marrëveshjes për Gatishmëri dhe Marrëveshjes në kuadër të Instrumentit për Reziliencë dhe Qëndrueshmëri - Njoftim për shtyp; Raport i stafit; dhe Deklaratë e Drejtorit Ekzekutiv për Republikën e Kosovës, 2025.]
[122] Republika e Kosovës, Raporti Vjetor i Auditimit 2024, 2025.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

Organizatat buxhetore të nivelit qendror e përdorin KASh-in, ndërsa komunat e përdorin Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) për planifikimin buxhetor afatmesëm. KASh-et dhe KAB-et e reja miratohen çdo vit me projeksione të të hyrave dhe shpenzimeve për tri vitet e ardhshme. Ministria përgjegjëse për financat e menaxhon KASh-in, e mbikëqyr përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe nxjerr qarkore buxhetore vjetore.

Meqenëse Kosova përdor buxhetimin sipas zërave dhe jo buxhetimin e bazuar në performancë ose buxhetimin programor, KASh-et dhe KAB-et janë dokumente të rëndësishme për ndërlidhjen e qartë të buxheteve me zotimet strategjike dhe programore të Qeverisë. KASh-et përmbajnë pjesë narrative që mund t'i ndërlidhin shpenzimet me strategjitë qeveritare që kanë objektiva, tregues, vlera bazë dhe caqe të qarta, duke përfshirë adresimin e dhunës me bazë gjinore. Pjesa narrative e KASh-it gjithashtu ofron hapësirë për përfshirjen e analizës gjinore ndërsektoriale dhe informacionit të qartë për përfituesit dhe ndikimet e pritshme.

KASh 2022-2024 e përmendte dhunën me bazë gjinore vetëm një herë, si objektiv kyç strategjik në sektorin e rendit, ligjit dhe sigurisë publike, i cili përfshin parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore.[123] Një objektiv ishte përmirësimi i mirëqenies sociale përmes ristrukturimit, zgjerimit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të mbrojtjes sociale dhe familjare, me fokus të veçantë në grupet e cenueshme dhe barazinë gjinore. KASh 2023-2025 gjithashtu e përmend adresimin e dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, këto nuk mbështeten me masa konkrete ose linja të veçanta buxhetore.[124] Prioritetet e KASh 2024-2026 përfshijnë kompletimin e kornizës ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore, ngritjen e kapaciteteve të mekanizmave institucionalë për adresimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. [125] Një nga objektivat kryesore në kuadër të sektorit të qeverisjes së përgjithshme publike është promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, sigurimi i barazisë gjinore përmes fuqizimit të grave. Ky objektiv përfshin avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Megjithatë, ai nuk përmban veprime të qarta ose linja të dedikuara buxhetore. KASh 2025-2027 i ruan të njëjtat prioritete dhe objektiva strategjike, por sërish nuk ka buxhet të ndarë qartë. [126] KASh-i për vitet 2026-2028 nuk ishte publikuar deri në mesin e vitit 2026 dhe nuk mund të analizohej.

Në përgjithësi, shqyrtimi i KASh-eve të Kosovës për periudhën e shqyrtuar tregon se, ndonëse adresimi i dhunës me bazë gjinore njihet si prioritet strategjik, KASh-eve u kanë munguar veprimet konkrete, treguesit dhe ndarjet buxhetore për ta adresuar qartë dhunën me bazë gjinore.

Në nivel komunal, në vitin 2023, shumica e komunave i dorëzuan shtojcat e BPGj-së së bashku me KAB-in për vitet 2023-2025.[127] Megjithatë, në vitin 2024, vetëm 12 komuna e dorëzuan shtojcën e BPGj-së së bashku me KAB-in. [128] RrGK-ja nuk kishte mundësi t'i analizonte këto dokumente, pasi ato nuk ishin në dispozicion të publikut.

Zotimet buxhetore vjetore për adresimin e dhunës me bazë gjinore

Ky nënseksion shqyrton shkallën në të cilën buxhetet vjetore të shtetit për periudhën 2022-2026 kanë buxhetuar mjete për secilin shërbim të specializuar lidhur me adresimin e

[123] Termi "gjini" përmendet katër herë. MFPT, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2022-2024, 2021.
[124] KASh, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025, 2022.
[125] KASh, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026, 2023.
[126] KASh, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027, 2024.
[127] Vetëm Kllokoti, Fushë Kosova dhe Podujeva nuk i dorëzuan ato.
[128] Analizë e RrGK-së bazuar në kërkesën për të dhëna drejtuar MF-së. Këto përfshinin Fushë Kosovën, Rahovecin, Suharekën, Mamushën, Deçanin, Klinën, Vushtrrinë, Gjilanin, Kamenicën, Shtërpcën, Ferizajn dhe Vitinë.

dhunës me bazë gjinore. Ai shqyrton se cilat linja specifike buxhetore ekzistojnë, nëse ka të tilla, për adresimin e dhunës me bazë gjinore; sa mjete janë buxhetuar në secilën prej tyre; dhe cilat organe janë përgjegjëse për zbatimin e këtyre linjave buxhetore. Sa u përket shërbimeve të specializuara, ai përqendrohet në linjën telefonike SOS, shërbimet për dhunën seksuale, strehimoret dhe menaxhimin holistik të rasteve me qasje të përqendruar te viktima.

Kosova përdor buxhetimin sipas zërave dhe jo buxhetimin programor ose të bazuar në performancë. Prandaj, formulari i buxhetit vjetor nuk përfshin analizën e ndikimit gjinor, objektivat, treguesit, vlerat bazë ose caqet që lidhen me ndonjë shpenzim, duke përfshirë shpenzimet për adresimin e dhunës me bazë gjinore. Kjo e pengon transparencën, monitorimin dhe vlerësimin e ndikimeve të shpenzimeve. Shtojca e BPGj-së, të cilën MFPT-ja e kërkon në qarkoret vjetore buxhetore, mund të ofronte informacion të tillë. Megjithatë, ministritë përgjegjëse nuk kanë publikuar asnjë shtojcë të tillë për asnjërin nga buxhetet vjetore për vitet 2022-2026. Prandaj, shpenzimet e planifikuara lidhur me shërbimet e specializuara nuk mund të shqyrtohen duke përdorur shtojcat e BPGj-së.

Gjithsej 37 komuna e kanë dorëzuar shtojcën së bashku me buxhetin vjetor gjatë periudhës 2023-2025. [129] Në vitin 2025, të gjitha komunat, përveç gjashtë prej tyre, i kishin dorëzuar shtojcat e BPGj-së.[130] Në vitin 2026, vetëm 15 komuna duket se e kanë dorëzuar shtojcën. [131] Shtojcat rrallëherë ishin të qasshme publikisht dhe, për këtë arsye, nuk mund të shqyrtoheshin për të vlerësuar shpenzimet e planifikuara komunale lidhur me shërbimet e specializuara për adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Nënseksionet në vijim i trajtojnë ndarjet e njohura buxhetore vjetore për shërbimet e specializuara të shqyrtuara në këtë raport.

Linja telefonike SOS

Tabela 10. Ndarjet buxhetore për ZMNV

Viti	Buxheti
2022	294.458 €
2023	292.867 €
2024	413.370 €
2025	542.146 €
2026	611.351 €

Kosova nuk ka një linjë të posaçme telefonike SOS, prandaj ndarjet specifike buxhetore nuk mund të vlerësohen. Në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (ZMNV) ofron shërbime të ngjashme përmes linjës së saj telefonike. Megjithatë, ajo u shërben disa profileve të ndryshme të viktimave dhe jo vetëm atyre që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore. Ndonëse nuk ka të dhëna specifike për shërbimet e linjës së saj telefonike që lidhen posaçërisht me dhunën me bazë gjinore, buxheti i përgjithshëm i ZMNV-së është rritur me kalimin e kohës (Tabela 10).

Shërbimet për dhunën seksuale

Buxhetet vjetore nuk përmbajnë linja specifike buxhetore për këto shërbime, kryesisht sepse ato, në të vërtetë, ende nuk ekzistojnë në Kosovë. IML kryen ekzaminime dhe ofron në një masë të caktuar mbështetje emergjente. Ai ka buxhetin e vet në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

[129] E vetmja komunë që nuk e dorëzoi shtojcën e BPGj-së në vitin 2024 ishte Kllokoti
[130] Këto përfshinin Prizrenin, Leposaviqin, Zubin Potokun, Parteshin, Kllokotin dhe Ranillugun.
[131] Të dhënat për vitin 2026 janë të paplota; në kohën e mbledhjes së të dhënave, jo të gjitha komunat kishin raportuar dorëzimin e shtojcave.

Strehimoret

Tabela 11. Buxheti për ofruesit e shërbimeve

Viti	Buxheti
2020	880.000 €
2021	1.000.000 €
2022	1.000.000 €
2023	1.500.000 €
2024	1.500.000 €
2025	2.500.000 €
2026	2.500.000 €

Që nga viti 2019, buxheti i qeverisë qendrore ka përfshirë një linjë buxhetore për funksionimin bazik të strehimoreve.[132] Ajo i financon strehimoret dhe shërbimet ditore për gratë që janë viktima të dhunës në familje dhe fëmijët e tyre, si dhe viktimat e trafikimit me njerëz, fëmijët e keqtrajtuar dhe fëmijët në strehim familjar. Pra, ajo nuk është e destinuar shprehimisht vetëm për strehimoret; strehimoret i ndajnë këto fonde me ofruesit e tjerë të shërbimeve sociale.

Ndarja në këtë linjë buxhetore u rrit nga 880.000 € në vitin 2020 në 1 milion euro në vitin 2021, pas avokimit të RrGK-së dhe anëtareve të saj, veçanërisht strehimoreve, krahas akterëve të tjerë. [133] Ndarja buxhetore mbeti e njëjtë në vitin 2022 dhe u rrit në 1.5 milionë euro në vitet 2023 dhe 2024. Në vitin 2025, ndarja buxhetore u rrit në 2.5 milionë euro dhe mbeti e njëjtë në vitin 2026. Ndonëse kjo shënon rritje të konsiderueshme krahasuar me vitet e kaluara dhe i mbulon shpenzimet thelbësore operative të strehimoreve, ajo mund të ketë mangësi në financimin e gamës së plotë të shërbimeve të rehabilitimit dhe riintegrimit që kërkohen sipas KS-së. Gjithashtu, fakti që linja buxhetore nuk është e destinuar për strehimoret mund t'i detyrojë ato të konkurrojnë për burime me ofruesit e tjerë të shërbimeve, duke rezultuar potencialisht në burime të pamjaftueshme.

Menaxhimi dhe koordinimi i rasteve me qasje të përqendruar te viktima

Komunat kanë kompetencë të plotë dhe ekskluzive për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda juridiksionit të tyre.[134] Komunat duhet t'i vlerësojnë nevojat e banorëve të tyre për shërbime sociale, t'i planifikojnë shërbimet e nevojshme dhe të ndajnë fonde duke u bazuar në këto nevoja.[135] Komunat janë përgjegjëse për menaxhimin e rasteve me qasje të përqendruar te viktima, që ofrohet përmes QPS-ve në kuadër të linjave buxhetore të drejtorive për mirëqenie sociale ose drejtorive me emërtime të ngjashme.

Që nga viti 2022, Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale parashihte që komunat të ndanin fonde për dy punëtorë socialë të specializuar shtesë në secilën komunë dhe katër në Prishtinë. [136] Megjithatë, financimi mbetet i pamjaftueshëm. Që nga viti 2022, vetëm një komunë (Istogu) mund të ketë ndarë fonde për punësimin e dy

[132] Në vitin 2019, kjo linjë buxhetore ishte në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa në vitin 2020 në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. Në vitin 2021, ajo u kthye në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në vitin 2022, u bart në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (tani Ministria e Financave). Që nga viti 2023, ajo është në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. (Shqyrtim i RrGK-së i ligjeve "mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës" për vitet 2019-2026).
[133] RrGK-ja ka avokuar vazhdimisht për burime të mjaftueshme për strehimoret që nga viti 2010. Shih, për shembull, RrGK, "Qeveria të mbështesë strehimoret dhe qendrat ditore për viktimat e dhunës ndaj grave në Buxhetin e Kosovës 2021", letër drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Financave, 2020.
[134] Republika e Kosovës, Ligji nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, 2024.
[135] Ibid.
[136] Republika e Kosovës, Vendimi nr. 11/109, Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, 2022.

punëtorëve socialë shtesë; dhe tetë komuna kanë punësuar së paku një anëtar/e shtesë të stafit, megjithëse këta punonjës mund të mos përqendrohen në dhunën me bazë gjinore.[137] Ndërkohë, nëntë komuna e kanë zvogëluar numrin e stafit gjatë kësaj periudhe.[138] Shumica e komunave nuk ishin në dijeni të këtij obligimi ose deklaruan se përballeshin me kufizime buxhetore.[139]

Përveç kësaj, të gjitha komunat duhet të themelojnë mekanizma koordinues lokalë (MKL) për adresimin e dhunës në familje.[140] Komunat duhet të sigurojnë burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për zbatimin e LDhBGj-së dhe SKDhG-së në nivel lokal. Me sa duket, ky buxhet duhet të ndahet përmes buxheteve të zyrave të kryetarëve, pasi ato janë përgjegjëse për udhëheqjen dhe sigurimin e funksionimit të MKK-ve. Komunat nuk kanë linja specifike buxhetore, gjë që e vështirëson vlerësimin e ndarjeve buxhetore. Prandaj, RrGK-ja u dërgoi një kërkesë zyrtare 38 komunave për të dhëna mbi ndarjet buxhetore lidhur me adresimin e dhunës me bazë gjinore; por vetëm pesë prej tyre u përgjigjën. Vetëm Komuna e Suharekës raportoi se kishte buxhetuar mjete për MKL-të në vitet 2022-2028 (Tabela 12).

Tabela 12. Buxhetet komunale të ndara dhe të planifikuara për MKL-të

Komuna	Të buxhetua-ra 2022	Të buxhetua-ra 2023	Të buxhetua-ra 2024	Të buxhetua-ra 2025	Të planifikua-ra 2026	Të planifikua-ra 2027	Të planifikua-ra 2028
Suhreka	1.520 €	1.520 €	1.520 €	3.800 €	1.500 €	1.500 €	1.500 €

Vetëm pesë komuna kanë raportuar se kanë buxhetuar për strehimore (Tabela 13). Komunat tjera ka të ngjarë të kenë buxhetuar për të mbështetur strehimoret, por nuk iu përgjigjën kërkesës për të dhëna.

Tabela 13. Buxhetet komunale për strehimore

Komuna	Të buxhetua-ra 2022	Të buxhetua-ra 2023	Të buxhetua-ra 2024	Të buxhetua-ra 2025	Të planifikua-ra 2026	Të planifikua-ra 2027	Të planifikua-ra 2028
Suharekë	4.000 €	4.000 €	4.000 €	4.000 €	4.000 €	4.000 €	4.000 €
Dragash	1.700 €	1.700 €	1.230 €				1.700 €
Hani i Elezit	500 €	500 €		500 €	500 €	500 €	500 €
Prishtinë	11.500 €	11.500 €	11.225 €	15.000 €	15.000 €	15.000 €	11.50 €
Obiliq		3.000 €	3.000 €	3.000 €	3-6.000 €		
Kllokot	0 €	0 €	0 €	0 €	0 €	0 €	0 €

Gjithashtu, Komuna e Prishtinës ka ndarë buxhet për të mbështetur të mbijetuarit/at e dhunës me bazë gjinore në riintegrimin e tyre. (Tabela 14)

Tabela 14. Mbështetja financiare e të mbijetuarve (transfere direkte dhe subvencione)

[137] Analizë e RrGK-së e buxheteve 2022-2026. Buxhetet nuk e tregojnë numrin e punëtorëve socialë, por numrin e stafit, i cili mund të përfshijë edhe pozita administrative. Komunat që kanë punësuar anëtarë shtesë të stafit përfshijnë Istogun, Kamenicën, Podujevën, Ferizajn, Vitinë, Zubin Potokun, Junikun dhe Graçanicën.
[138] Këto përfshijnë: Gjakovën, Gjilanin, Obiliqin, Prishtinën, Prizrenin, Skenderajn, Suharekën, Malishevën dhe Mitrovicën e Veriut.
[139] Takimet e RrGK-së me zyrtarët komunalë, 2026.
[140] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, 2022, neni 25. Ndonëse neni i referohet dhunës me bazë gjinore, paragrafi vijues përmend vetëm mbrojtjen nga dhuna në familje. Kjo duhet të rishikohet për ta siguruar mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, në mënyrë që të harmonizohet me nenin.

Komuna	Të buxhetua -ra 2022	Të buxhetua -ra 2023	Të buxhetua -ra 2024	Të buxhetua -ra 2025	Të planifikua -ra 2026	Të planifikua -ra 2027	Të planifikua -ra 2028
Prishtinë	70.000 €	70.000 €	70.000 €	70.000 €	80.000-100.000 €	80.000-100.000 €	80.000-100.000 €

Dy komuna raportuan se i kan përmbushur detyrimet për të ndarë buxhet për mbështetje emergjente, duke përfshirë edhe veshmbathjen dhe barnat. Këto ishin ndarë përmes linjës buxhetore të zyrës së kryetarit.

Tabela 15. Buxheti për mbështetje emergjente (p.sh., veshmabthja, barnat)

Komuna	Të buxhetua -ra 2022	Të buxhetu -ara 2023	Të buxhetua -ra 2024	Të buxhetua -ra 2025	Të planifikua -ra 2026	Të planifikuara 2027	Të planifiku -ara 2028
Suharekë	1.000 €	1.000 €	1.000 €	1.000 €	1.000 €	1.000 €	1.000 €
Obiliq					500 €	500-1.000 €	

Prandaj, komunat kanë pasur praktika të ndryshme në mënyrën se si e buxhetojnë mbështetjen për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore. Mungesa e linjave të qarta buxhetore ose e shtojcave të BPGj-së që i shpjegojnë këto ndarje e ka bërë të vështirë gjurmimin e tyre.

Përfundim

BPGj-ja është e detyrueshme për të gjitha institucionet, por kërkesat dhe metodat e BPGj-së nuk janë institucionalizuar mjaftueshëm në kuadër të sistemit dhe proceseve të menaxhimit të financave publike. LBGj-ja, rregulloret dhe udhëzimet kërkojnë që analiza gjinore të shërbejë si bazë për të gjithë legjislacionin, duke përfshirë buxhetet. LBGj-ja kërkon të dhëna të ndara sipas gjinisë. Analiza e ndikimit gjinor kërkohet gjithashtu me ligj. Megjithatë, të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk janë gjithmonë në dispozicion nga ofruesit e shërbimeve, gjë që e pengon përdorimin e tyre për analizën e ndikimit gjinor që mund të shërbej si informacion për hartimin e buxheteve për shërbimet e specializuara.

Korniza ligjore përfshin parime dhe detyrime të rëndësishme që burojnë nga instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë KS-në. Megjithatë, ende ka mangësi në arritjen e harmonizimit dhe zbatimit të plotë dhe efektiv, përfshirë ato në lidhje me shërbimet e specializuara, format digjitale të dhunës, detyrimet e raportimit dhe detyrimet procedurale, BPGj-në dhe mbrojtjen e grupeve të ndryshme. Nevojiten masa të mëtejshme ligjore dhe institucionale, përfshirë fuqizimin e garancive normative për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me KDPAK-në dhe sigurimin që mbrojtja e kërkuar sipas instrumenteve përkatëse ndërkombëtare të realizohet në mënyrë efektive në praktikë.

Strategjitë dhe planet e veprimit përmbajnë veprime për adresimin e dhunës me bazë gjinore, por jo gjithmonë i përcaktojnë qartë organet përgjegjëse për buxhetimin e këtyre veprimeve ose shumat buxhetore. Disa veprime varen nga kontributet financiare të donatorëve ose shoqërisë civile. Prandaj, buxhetet mund të jenë të pamjaftueshme. Disa buxhete të rëndësishme janë siguruar, ndërsa disa veprime varen nga fondet që pritet të sigurohen nga burimet e ardhshme ose donatorët. Nga buxhetet e ndara në mënyrë të qartë, deri më tani, është shpenzuar vetëm një pjesë e buxhetit të ndarë; shpenzimet reale shpesh janë vonuar ose kanë qenë më të ulëta sesa ishte planifikuar për shkak të mangësive në financim ose varësisë nga kontributet e jashtme.

KASh-të nuk përmbajnë objektiva të qarta për adresimin e dhunës me bazë gjinore në përputhje me strategjitë dhe planet e veprimit të Qeverisë. Kjo mund ta pengojë planifikimin

buxhetor afatmesëm për zbatimin e zotimeve të KS-së, ligjeve dhe politikave që rregullojnë shërbimet e specializuara. Buxhetimi sipas zërave në Kosovë e pengon paraqitjen e qartë të mënyrës se si ndarjet buxhetore vjetore synojnë të kontribuojnë në strategji dhe programe, përfshirë ato që lidhen me dhunën me bazë gjinore. Ndonëse shtojcat e BPGj-së të kërkuara nga MF-ja mund ta ofronin këtë informacion, ato nuk kanë përfshirë gjithmonë hollësi të tilla dhe as nuk janë vënë në dispozicion të publikut. Linja buxhetore e Ministrisë së Drejtësisë që lidhet me shërbimet e specializuara është rritur ndjeshëm me kalimin e kohës, por nuk i mbështet vetëm strehimoret dhe mund të mos jetë e mjaftueshme për mbështetjen e shërbimeve gjithëpërfshirëse të rehabilitimit dhe riintegrimit. Komunat gjithashtu kanë ndarë buxhete për adresimin e dhunës me bazë gjinore, por kjo qasje nuk ka qenë konsistente në të gjitha komunat.

KAPITULLI 2. NË PËRMBLEDHJE: KOSTOT E SHËRBIMEVE TË SPECIALIZUARA PËR ADRESIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE

Ky kapitull shqyrton deri në çfarë mase Qeveria ka ndarë dhe ka shpenzuar fonde të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve të specializuara që lidhen me dhunën me bazë gjinore, në përputhje me KS-në, gjatë periudhës 2022–2025, si dhe deri në çfarë mase ka buxhetuar fonde të mjaftueshme për periudhën 2025–2029. Kjo periudhë është zgjedhur për të analizuar çdo prirje të përsëritur me kalimin e kohës, në përputhje me praktikat më të mira të BPGj-së. Ky kapitull shqyrton financimin përkatësisht për secilin shërbim të specializuar të përcaktuar nga KS-ja. Shërbimet përfshijnë: linjën kombëtare telefonike SOS; qendrat e krizave për rastet e përdhunimit dhe qendrat e referimit për dhunën seksuale; strehimoret; menaxhimin e rasteve, koordinimin dhe shërbimet sociale të specializuara; si dhe banimin social.
Për secilin shërbim, ky kapitull fillimisht paraqet përgjegjësitë institucionale dhe mandatet specifike institucionale të përcaktuara sipas KS-së dhe legjislacionit vendor. Më pas, ofron një pasqyrë të akterëve kyç përgjegjës për ofrimin dhe financimin e secilit shërbim dhe analizon kapacitetet e tyre për BPGj dhe kërkesën e dokumentuar për shërbimin. Në vijim, secili seksion shqyrton buxhetin dhe shpenzimet publike për shërbimet specifike gjatë periudhës 2022–2025, duke u bazuar në ligjet për buxhetin, shtojcat dhe raportet financiare në dispozicion. Nënseksioni i fundit paraqet vlerësimet e kostove për secilin shërbim të specializuar për periudhën 2026–2029. Vlerësimet bazohen në të dhënat financiare dhe buxhetore në dispozicion të publikut, informacionin e ofruar nga ofruesit e shërbimeve, të dhënat e mbledhura përmes intervistave me ofruesit dhe përfaqësuesit e institucioneve, si dhe çmimet e tregut.

Linja telefonike SOS

Sipas nenit 24 të KS-së, shteteve u kërkohet të krijojnë shërbime të përshtatshme mbështetëse për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, përfshirë linjat telefonike të ndihmës, të cilat duhet të jenë në dispozicion 24/7. Linjat telefonike të ndihmës duhet të jenë konfidenciale, pa pagesë dhe të qasshme për të gjitha të mbijetuarat dhe të gjithë të mbijetuarit, duke ofruar ndihmë të menjëhershme dhe informacion për shërbimet në dispozicion dhe mundësitë ligjore.

Përgjegjësitë

Detyrimi për krijimin e një linje kombëtare telefonike plotësisht funksionale filloi zyrtarisht në vitin 2020 me ratifikimin e KS-së nga Kosova. Qeveria është dashur që qysh atëherë të nisë planifikimin dhe buxhetimin për këtë shërbim. Krijimi i një linje telefonike emergjente 24/7 për viktimat e dhunës me bazë gjinore është detyrim në kornizën ligjore dhe të politikave të Kosovës, përfshirë Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës

Seksuale,[141] SKDhG-në 2022–2026,[142] dhe Udhëzimin Administrativ (QRK) – nr. 01/2025 për Linjën Telefonike Emergjente për Viktimat e Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës me Bazë Gjinore.[143]

Protokolli kërkon që linja telefonike SOS të ofrojë ndihmë të menjëhershme, konfidenciale dhe shumëgjuhëshe. Ndihma synon të përfshijë: mbështetjen emocionale, ndërhyrjen në krizë dhe referimin në shërbimet përkatëse, siç janë strehimoret, policia, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe mbështetja psikosociale. Ofruesit e linjës telefonike emergjente kanë për detyrë të vlerësojnë kërcënimet ndaj viktimave, të ruajnë konfidencialitetin e thirrjeve, të bashkëpunojnë me shërbimet përkatëse dhe të ndjekin trajnime të rregullta. Po ashtu, ata duhet të raportojnë çdo tre muaj te Koordinatori Kombëtar, të përgatisin raportet e kërkuara dhe të mbështesin fushatat për ndërgjegjësimin e publikut lidhur me shërbimin.[144] SKDhG-ja synonte që linja telefonike të ishte plotësisht funksionale deri në fund të vitit 2026. Institucionet udhëheqëse dhe mbështetëse përgjegjëse për themelimin e saj janë Ministria e Shëndetësisë, MFPT-ja, Zyra e Koordinatorit Kombëtar në Ministrinë e Drejtësisë dhe ABGj-ja. Ndërkohë, Udhëzimi Administrativ e bëri Ministrinë e Drejtësisë përgjegjëse për themelimin dhe funksionimin e linjës telefonike emergjente. Ministria duhet të sigurojë financimin dhe të përcaktojë procedurat për funksionimin dhe mirëmbajtjen e saj të vazhdueshme.[145]

Historikisht dhe deri më sot, ZMNV-ja ka ofruar disa shërbime të linjës telefonike, duke u dalë në ndihmë personave që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore, si dhe viktimave të tjera të mundshme të krimit. Megjithatë, ky shërbim nuk i përmbush kriteret e KS-së për një linjë telefonike SOS *të dedikuar* për adresimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, e cila drejtohet nga operatorë të përgatitur e të trajnuar në mënyrë profesionale. Mbështetja e specializuar përmes linjës telefonike për format e tjera të dhunës, përveç asaj në familje, mbetet e kufizuar.[146] Po ashtu, raportohet se linjat telefonike të ZMNV-së dhe të ndihmës juridike falas nuk funksionojnë rregullisht dhe, në disa raste, kanë qenë jashtë funksionit.[147]

Kapacitetet për BPGj-në në kuadër të linjës telefonike SOS

Linja telefonike nuk është themeluar, prandaj nuk ishte e mundur të shqyrtoheshin kapacitetet për BPGj të zyrtarëve përgjegjës. Me sa duket, ende nuk është bërë përllogaritja e kostove për këtë shërbim.

Të dhënat për përfituesit/et dhe ndikimet

Meqenëse linja telefonike ende nuk është themeluar, nuk ka pasur ende përfitues/e. Me sa duket, ende nuk ekzistojnë sisteme për mirëmbajtjen konfidenciale të të dhënave të tilla.

[141] Republika e Kosovës, Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, 2022.
[142] Plani i Veprimit i SKDhG-së parasheh krijimin e një "linje kombëtare telefonike të ndihmës për të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në dispozicion 24/7 në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë, në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit".
[143] Republika e Kosovës, Udhëzim Administrativ (QRK) – nr. 01/2025 për Linjën Telefonike Emergjente për Viktimat e Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës me Bazë Gjinore, 2025.
[144] Neni 8.
[145] Neni 4.
[146] Këshilli i Evropës, Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë*, 2017.
[147] Ministria e Drejtësisë deklaroi se linjat telefonike të ndihmës juridike falas funksionojnë rregullisht; megjithatë, hulumtimi i RrGK-së tregoi se ato funksionojnë në mënyrë jokonsistente dhe nganjëherë nuk punojnë (shih RrGK, *Zero Tolerancë? Monitorimi i Reagimit Institucional ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë*, 2025).

Kërkesa për shërbime

Tabela 15. Rastet e dhunës në familje të raportuara në polici

Viti	Rastet	Ndryshimi në %
2021	2.456	
2022	2.764	13%
2023	2.639	-5%
2024	2.959	12%
2025	2.246	-24%
Mesatar	2.613	-1%

Statistikat zyrtare për rastet e raportuara të dhunës me bazë gjinore dëshmojnë për një nevojë urgjente për një linjë telefonike SOS. Shkalla e saktë e nevojës dhe kërkesës për këtë shërbim nuk mund të përcaktohet me saktësi, duke pasur parasysh vetë natyrën e dhunës me bazë gjinore, pasi jo të gjitha viktimat kërkojnë ndihmë ose e raportojnë dhunën. Megjithatë, për të llogaritur kërkesën e mundshme, mund të shërbehemi me tregues të përafërt. Sipas anketës së fundit të botuar mbi ekonomitë familjare, në përgjithësi, 54% e grave në Kosovë deklarojnë se kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga partneri intim që nga mosha 15-vjeçare, ndërsa 29% kanë përjetuar ngacmim seksual gjatë jetës së tyre, sipas anketës së fundit të publikuar të ekonomive familjare.[148] Kjo dëshmon se nevoja e mundshme është jashtëzakonisht e gjerë.

Policia e Kosovës ka raportuar mesatarisht 2.613 raste të raportuara të dhunës në familje në vit (Tabela 15).[149] Ndërkohë, Tabela 16 paraqet viktimat e dyshuara gra (W) dhe burra (M) të veprave penale që potencialisht lidhen me dhunën me bazë gjinore.[150] Jo të gjitha veprat penale të raportuara përfshinin domosdoshmërisht dhunën me bazë gjinore; Policisë së Kosovës i mungon një sistem për klasifikimin dhe gjurmimin e rasteve që përfshijnë dhunën me bazë gjinore. Megjithatë, disa nga këto vepra penale përfshijnë dhunën me bazë gjinore, siç janë dhuna në familje, ngacmimi seksual dhe të gjitha format e dhunës seksuale.

[148] OSBE, *Anketa mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë*, 2019. Të dhëna më të fundit nuk janë në dispozicion.
[149] Policia e Kosovës, Raporti vjetor i punës së Policisë së Kosovës, 2026.
[150] Përgjigjja e Policisë së Kosovës ndaj kërkesës për të dhëna, e publikuar në RrGK, *Zero Tolerancë? Monitorimi i Reagimit Institucional ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë*, 2025. Vlen të theksohet se të dhënat e raportit të Policisë së Kosovës nuk përputhen me të dhënat që i janë ofruar RrGK-së në përgjigje ndaj një kërkese për të dhëna. Të dyja grupet e të dhënave paraqiten këtu, ndonëse është e paqartë se cilat janë më të sakta. Përjashtimisht, shifrat për dhunën në familje për vitin 2025 janë marrë nga Baza e të Dhënave e Ministrisë së Drejtësisë për Identifikimin e Rasteve të Dhunës në Familje.

Tabela 16. Viktimat sipas veprës penale të raportuar dhe gjinisë

Vepra penale	W 2021	W 2022	W 2023	W 2024	W 2025	M 2021	M 2022	M 2023	M 2024	M 2025	Totali	Gjithsej W	% W	Gjithsej M	% M
172 Vrasja	1		1	1		6	3	8	2		22	3	14%	19	86%
s173 Vrasja e rëndë	2	4	5	2		16	10	15	10		64	13	20%	51	80%
183 Ngacmimi seksual	19	51	34	49	32	1	1	1		2	190	185	97%	5	3%
182 Ngacmimi	138	152	134	111	133	56	60	53	54	51	942	668	71%	274	29%
186 Lëndimi i rëndë trupor	23	25	20	18		214	172	158	130		760	86	11%	674	89%
227 Dhunimi	89	74	72	56	62	2	3	5	4	4	371	353	95%	18	5%
229 Sulmi seksual	552	40	40	41	31	1	3	3	24	3	738	704	95%	34	5%
230 Degradimi i integritetit seksual				1	3	1			2		7	4	57%	3	43%
233 Nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës	4	1	1								6	6	100%	0	0%
234 Mundësimi ose detyrimi në prostitucion	4	1		4					1		10	9	90%	1	10%
236 Marrëdhëniet seksuale brenda familjes		2		1							3	3	100%	0	0%
248 Dhuna në familje	1245	1414	1144	1095	2137	328	296	279	269	699	8906	7035	79%	1871	21%
Gjithsej	2077	1764	1451	1379	2398	625	548	522	496	759	12019	9069	75%	2251	19%

Vlen të theksohet se dhuna në familje ka qenë vazhdimisht vepra e dytë penale më e raportuar në Kosovë, pas lëndimit të lehtë trupor.[151] Gratë përbëjnë 79% të viktimave të dyshuara, gjë që dëshmon qartë dimensionin gjinor të kësaj vepre penale. Po ashtu, gratë përbënin 97% të viktimave të dyshuara të ngacmimit seksual, ndërsa ishin të përfaqësuara në mënyrë disproporcionale edhe te veprat e ngacmimit (71%), dhunimit (95%), sulmit seksual (95%) dhe incestit (100%). Në mungesë të të dhënave të linjës telefonike, të dhënat e policisë mund të shërbejnë si tregues i përafërt për nivelin e mundshëm të nevojës për linjën telefonike. Mesatarisht, çdo vit janë raportuar 2.404 raste që lidhen me raste të pretenduara të dhunës me bazë gjinore, ndërsa shkalla e vërtetë e dukurisë ka të ngjarë të jetë më e lartë. Të dhënat e policisë lënë të kuptohet se ekziston nevoja për t'iu përgjigjur mesatarisht shtatë thirrjeve në ditë.

[151] Policia e Kosovës, Disa nga Rezultatet dhe të Arriturat e Policisë së Kosovës gjatë Vitit 2024, 2024. Qasur më 15 gusht 2026.

Tabela 17. Rastet e dhunës në familje të ZMNV-së dhe thirrjet në linjën telefonike që lidhen me dhunën me bazë gjinore

Viti	Rastet	Thirrjet në linjën telefonike					
		Dhuna në familje	Trafikimi me qenie njerëzore	Dhuna seksuale	Keqtrajtimi	Të tjera	Gjithsej
2021	1.822	187	2		2	136	327
2022	2.538	267	6	4	1	281	559
2023	2.636	175	9	5		239	428
2024	2.620	119	14	1		247	381
2025		96		5		147	248
Mesatarja	2.404	169	8	4	2	210	389

Të dhënat e policisë përfshijnë vetëm veprat penale të pretenduara të raportuara, por jo çdo rast raportohet. Prandaj, për të vlerësuar kërkesën e mundshme në të ardhmen, mund të shfrytëzohen edhe thirrjet që lidhen me dhunën me bazë gjinore dhe që pranohen nga ZMNV-ja. Numri i personave që kërkojnë ndihmë lidhur me dhunën në familje është rritur vazhdimisht nga viti 2021 deri në vitin 2024 (Tabela 17).[152] Ndërkohë, numri i thirrjeve në linjën telefonike që lidhen me dhunën në familje është zvogëluar ndjeshëm që nga viti 2023, ndonëse thirrjet që lidhen me trafikimin me njerëz janë rritur. Duke u mbështetur në përvojën e ZMNV-së, parashikohet se një linjë telefonike SOS mund të pranojë mesatarisht 389 thirrje në vit, gjë që i bie rreth një thirrje në ditë.

Ndërkohë, të dhënat e policisë sugjerojnë se një linjë telefonike SOS mund të pranojë mesatarisht rreth shtatë thirrje në ditë. Ky numër mund të rritet në të ardhmen përmes një promovimi më të mirë të shërbimit, duke përfshirë ofrimin e këshillimit për format e tjera të dhunës me bazë gjinore, të cilat aktualisht duket se janë të nënpërfaqësuara.

Buxhetet dhe shpenzimet 2022–2026

Pavarësisht detyrimeve që rrjedhin që nga viti 2020, SKDhG-ja ka paraparë themelimin e linjës telefonike deri në vitin 2026. Si rrjedhojë, në buxhetet e viteve 2022–2025 nuk janë ndarë fare mjete financiare për këtë shërbim, kurse në SKDhG nuk është paraparë asnjë fond buxhetor për vitin 2026. Po kështu, nuk ka asnjë dëshmi për ndonjë planifikim përgatitor ose llogaritje të kostove.

Si një shërbim i ngjashëm, ndonëse jo identik, buxheti dhe shpenzimet e ZMNV-së në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Shtetit mund të shërbejnë si pikë referimi për llogaritjen e kostove (shih Tabelën 10). Buxheti i ZMNV-së për vitin 2025 u rrit për 128.776 € (31%) krahasuar me atë të vitit 2024 (413.370 €). Megjithëse buxheti për vitin 2026 (611.351 €) shënon një rritje prej 13% krahasuar me vitin 2025 (542.146 €), numri i stafit ka mbetur i pandryshuar.[153]

Buxheti i vitit 2026 parasheh ndarje prej 10.000 € në vit për vitet 2026, 2027 dhe 2028 për Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Rasteve në ZMNV.

[152] Të dhënat e ofruara nga ZMNV-ja pas kërkesës për të dhëna për rastet e dhunës me bazë gjinore të raportuara përmes linjës telefonike, 2026. Nuk është e qartë se çfarë nënkupton kategoria "Të tjera", por meqenëse kërkesa për të dhëna kishte të bënte me rastet e dhunës me bazë gjinore, ajo duhet t'u referohet rasteve të tilla.

[153] ZMNV-së i është parashtruar një kërkesë për informacion lidhur me strukturën e personelit të linjës telefonike, numrin e thirrjeve të pranuara, kostot operative, sfidat kryesore, nevojat buxhetore, numrin e nevojshëm të stafit dhe ndarjen buxhetore. Nuk është pranuar përgjigje dhe informacioni i kërkuar nuk është ofruar.

Historikisht, numri i Mbrojtësve të Viktimave ka qenë i pamjaftueshëm për t'i përmbushur detyrimet ligjore dhe për të siguruar mbrojtje adekuate për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore.[154] Megjithatë, numri i stafit është rritur që nga viti 2022, gjë që dëshmon përpjekje për forcimin e kapaciteteve.[155] Sidoqoftë, zyrtarët e ZMNV-së ofrojnë shërbime të ndryshme për përfitues të ndryshëm dhe nuk merren vetëm me funksionimin e linjës telefonike. Prandaj, në mungesë të evidencave të hollësishme, nuk ka qenë e mundur të llogaritet koha e shpenzuar për rastet e dhunës me bazë gjinore dhe kostot përkatëse.[156] Pa informacione shtesë, buxheti dhe shpenzimet e ZMNV-së nuk mund të shërbejnë si tregues i saktë i kostove të mundshme të linjës telefonike.

Kostot

Nevojitet një model shumëvjeçar financimi për linjën telefonike, i bazuar në dëshmi. Udhëzimi Administrativ nuk e përcakton numrin e nevojshëm të stafit ose pozitat e tyre, gjë që mund të ndikojë në kosto. Bazuar në kërkesat shtetërore dhe çmimet e tregut, Tabela 18 vlerëson kostot që lidhen me këtë shërbim, duke parashikuar buxhetin për periudhën 2026–2029.

Tabela 18. Kostot e vlerësuara të linjës telefonike SOS 2026–2029

Kostoja	Mujore	2026	2027	2028	2029
Personeli		130.459 €	135.156 €	138.129 €	140.892 €
Drejtor	981 €	11.778 €	12.202 €	12.470 €	12.720 €
Operatorë/e, ndërrimet e ditës (4)	789 €	37.884 €	39.248 €	40.111 €	40.914 €
Operatorë/e, ndërrimi i natës (2)	1.026 €	24.625 €	25.511 €	26.072 €	26.594 €
Operatorë/e, fundjavat, festat (4) (50%)	592 €	28.413 €	29.436 €	30.083 €	30.685 €
Operatorë/e, ndërrimi i natës gjatë fundjavës (50%) (2)	710 €	17.048 €	17.662 €	18.050 €	18.411 €
Zyrtar/e Financiar/e / Administrator/e	643 €	7.712 €	7.990 €	8.166 €	8.329 €
Mirëmbajtës/e e higjienës (50%)	250 €	3.000 €	3.108 €	3.176 €	3.240 €
Kostot operative		**20.530 €**	**15.571 €**	**15.914 €**	**16.232 €**
Shpenzimet për shërbimet komunale	200 €	2.400 €	2.486 €	2.541 €	2.592 €
Shpenzimet e komunikimit	200 €	2.400 €	2.486 €	2.541 €	2.592 €
TI	400 €	4.800 €	4.973 €	5.082 €	5.184 €
Pajisjet teknike		6.500 €	1.036 €	1.059 €	1.080 €
Mjete zyre	50 €	600 €	622 €	635 €	648 €
Shpenzimet për fushata		630 €	653 €	667 €	680 €
Trajnimi i vazhdueshëm		2.000 €	2.072 €	2.118 €	2.160 €
Shpenzimet bankare	100 €	1.200 €	1.243 €	1.271 €	1.296 €
Gjithsej		**150.989 €**	**150.727 €**	**154.043 €**	**157.124 €**

[154] RrGK, *Zero Tolerancë? Monitorimi i Reagimit Institucional ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë*, 2025.
[155] Republika e Kosovës, Raporti Vjetor i Zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026, 2024.
[156] Ndonëse RrGK-ja kërkoi informacion për stafin, kohën dhe shpenzimet e tjera përkatëse, ky informacion nuk u ofrua.

Vlerësimet e pagave bazohen në nivelet aktuale të pagave në sektorin publik të përcaktuara me Ligjin për pagat në Kosovë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.[157] Në përputhje me këtë ligj, paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës së të punësuarit, përkatësisht nga 0.5% për çdo vit të plotë të përvojës së punës. Ndërkohë, sipas Ligjit të Punës, orari ndërmjet orës 22:00 dhe 06:00 konsiderohet punë nate, andaj punonjësit që angazhohen gjatë kësaj periudhe përfitojnë një shtesë prej 30% për orë për çdo orë të kaluar në punë.[158] Po ashtu, punonjësit që punojnë gjatë fundjavave duhet të paguhen me një shtesë prej 50% për orë.[159] Pagat dhe buxhetet janë përllogaritur duke marrë parasysh këto detyrime ligjore.

Drejtori/ja i/e linjës telefonike do të jetë përgjegjës/e për menaxhimin e veprimtarisë së linjës telefonike. Kjo përfshin mbikëqyrjen e stafit, sigurimin e shërbimeve cilësore në përputhje me kërkesat ligjore, planifikimin strategjik, promovimin e linjës telefonike dhe mirëmbajtjen e partneriteteve të fuqishme me institucionet e tjera për të ofruar mbështetje efektive. Paga vjetore bruto llogaritet bazuar në koeficientin 8.3 të pagës në sektorin publik për pozitën me orar të plotë si "drejtor institucioni", duke e trajtuar si rol ekuivalent në sektorin publik (p.sh., drejtor shkolle ose institucioni shëndetësor). Shumëzimi i koeficientit me pagën bazë (110 €) jep një pagë të përgjithshme bruto prej 913 € në muaj. Duke pasur parasysh se Drejtorit/es do t'i duhen të paktën 15 vjet përvojë pune në trajtimin e rasteve që lidhen me dhunën me bazë gjinore për të plotësuar kriteret për këtë pozitë, një shtesë prej 0,5% për çdo vit të përvojës së punës do ta rrisë pagën bazë me 7.5%, gjë që rezulton në një pagë bruto të vlerësuar prej 981 € në muaj, apo 11.778 € për vitin 2026.[160]

Udhëzimi Administrativ përcakton se stafi i linjës telefonike duhet të ketë arsim të lartë dhe të jetë i licencuar dhe i trajnuar për ofrimin e mbështetjes psikosociale, këshillimit dhe referimit. Për më tepër, organizata që ofron shërbimin duhet të ketë të paktën pesë vjet përvojë në adresimin e dhunës me bazë gjinore, ndërsa stafi i linjës telefonike duhet të ketë të paktën një vit përvojë profesionale përkatëse.[161] Operatorët duhet të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime në gjuhët që fliten nga viktimat, gjë që tregon nevojën për njohjen e gjuhës shqipe dhe asaj serbe, krahas gjuhëve të tjera të mundshme. Operatorët e linjës telefonike duhet të jenë psikologë të kualifikuar dhe të trajnuar, të cilët u përgjigjen thirrjeve, dëgjojnë telefonuesit dhe ofrojnë mbështetje pa paragjykim. Ata verifikojnë nëse dikush është në rrezik të lëndojë veten ose të tjerët, japin këshilla të thjeshta dhe këshilla praktike përballimi për menaxhimin e stresit ose emocioneve të forta, si dhe i referojnë telefonuesit te shërbime apo burime të tjera. Detyra e tyre kryesore është të sigurojnë mbrojtjen e njerëzve dhe t'u ofrojnë mbështetje. Linjës telefonike do t'i duhen operatorë psikologë profesionistë për të siguruar mbulimin e ndërrimeve të ditës dhe të natës. Një anëtar i dytë i stafit duhet të jetë gjithmonë në dispozicion gjatë zhvillimit të një bisede telefonike. Për shembull, nëse një telefonues ndodhet në një situatë emergjente dhe duhet të kontaktohet Policia e Kosovës, operatori duhet të mund ta vazhdojë komunikimin me telefonuesin ndërsa një anëtar tjetër i stafit merret me koordinimin dhe logjistikën e nevojshme. Prandaj, të paktën dy anëtarë të stafit duhet të jenë të pranishëm gjatë secilit ndërrim. Ata do të mbulojnë ndërrimet 6:00–15:00, 15:00–22:00 dhe 22:00–6:00, me një operator shtesë gjithmonë në dispozicion për të ofruar mbështetje

[157] Republika e Kosovës, Ligji nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, 2022.
[158] Republika e Kosovës, Ligji nr. 03/L-212 i Punës, 2010, nenet 27 dhe 56.
[159] Një i punësuar mund të kërkojë të kompensohet me ditë pushimi në vend se t'i marrë këto shtesa.
[160] Duke pasur parasysh se një shërbim i tillë aktualisht nuk ekziston, kërkesa për 15 vjet përvojë pune mund ta kufizojë numrin e aplikuesve/eve pa siguruar domosdoshmërisht cilësi më të lartë. Nëse nuk gjenden kandidatë/e të përshtatshëm/me, përvoja e kërkuar mund të zvogëlohet në 10 ose pesë vjet.
[161] Nenet 6 dhe 7. Profesionistët duhet t'i plotësojnë kriteret në vijim: "1.1. të kenë arsim të lartë në psikologji, sociologji, pedagogji, shkenca juridike ose fusha të ngjashme; 1.2. të jenë të licencuar nga autoriteti përkatës; 1.3. të kenë të paktën dyzet (40) orë trajnim profesional të specializuar në vit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore; 1.4. të kenë të paktën një (1) vit përvojë pune në fushën psikosociale me viktimat e dhunës, dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore".

kur nevojitet, përfshirë periudhat me vëllim të lartë të thirrjeve (p.sh., gjatë festave), kur operatorët e tjerë marrin pushim dhe gjatë fundjavave. Paga bazohet në koeficientin për psikologët (7), duke rezultuar në një shumë prej 770 € në muaj për secilin operator. Duke pasur parasysh se operatorëve u duhen të paktën pesë vjet përvojë pune për të plotësuar kriteret në mënyrë adekuate, paga e tyre do të jetë 789 € për secilin. Në varësi të viteve të përvojës, kostoja për secilin operator mund të jetë pak më e lartë. Për katër operatorë të ndërrimit të ditës, shuma e përgjithshme do të jetë 37.884 € në vitin 2026. Dy operatorët e ndërrimit të natës do të paguhen me një shtesë prej 30% për punën nga ora 22:00 deri në orën 6:00, duke arritur në një total prej 1.026 € në muaj për person dhe 24.625 € për të dy operatorët në vitin 2026. Nevojiten katër operatorë për fundjavat dhe festat, të cilët gjithashtu mund ta mbulojnë stafin që punon gjatë ditëve të javës gjatë festave dhe pushimeve të tjera. Për ta do të aplikohet një shtesë prej 50% për ndërrimin e fundjavës dhe 50% kur zëvendësojnë operatorët e tjerë gjatë festave zyrtare. Ata nuk do të punojnë me orar të plotë, por vetëm gjatë fundjavave, ditëve të pushimit vjetor të paguar të anëtarëve të tjerë të stafit dhe festave, dhe do të paguhen në bazë të orëve të realizuara, duke marrë parasysh shtesat për fundjavë, natë dhe festa. Për pagesën e fundjavës (50%) dhe të festave (50%), paga bazë prej 789 € llogaritur me shtesat përkatëse 50%, arrin gjithsej në 1.184 € për person. Duke supozuar se kjo do të jetë një pozitë me orar të pjesshëm (50%), shuma arrin në 592 € në muaj për person, apo 28.413 € për katër operatorë gjatë vitit 2026. Në fund, do të nevojiten dy operatorë për ndërrimin e natës gjatë fundjavave dhe festave për të mbuluar operatorët e tjerë të natës. Ata do të marrin shtesë për natën (30%) dhe fundjavën (50%), duke arritur gjithsej 1.421 € në muaj për person, përkatësisht 710 € për një pozitë me orar të pjesshëm (50%), ose 17.048 € për të dy operatorët në vitin 2026. Meqenëse këto janë vlerësime të përafërta, të dhënat mbi shpenzimet reale do të jenë thelbësore për një buxhetim më të saktë gjatë planifikimit të ardhshëm buxhetor, mbështetur në orët e realizuara në të vërtetë.

Zyrtari/ja Financiar/e / Administratori/ja është përgjegjës/e për menaxhimin e financave të linjës telefonike, duke përfshirë buxhetimin, mbajtjen e kontabilitetit, kryerjen e pagesave dhe përgatitjen e raporteve financiare. Ky person siguron që të gjitha veprimtaritë financiare të jenë në përputhje me kërkesat ligjore, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie. Po ashtu, kjo pozitë mbulon detyra administrative për të mbështetur funksionimin e përgjithshëm të linjës telefonike. Paga vjetore bruto vlerësohet duke u bazuar në koeficientin 5.7 të një rregulloreje komunale për pozitën me orar të plotë të zyrtarit financiar.[162] Shumëzimi i këtij koeficienti me pagën bazë (110 €) rezulton në pagë të përgjithshme bruto prej 627 € në muaj. Duke supozuar se për këtë pozitë kërkohet të paktën pesë vjet përvojë pune dhe rritje page prej 0.5% në vit, paga bruto e vlerësuar do të jetë 643 € në muaj, apo 7.712 € në vitin 2026.

Mirëmbajtësi/ja e higjienës është përgjegjës/e për ruajtjen e pastërtisë, rendit dhe higjienës në të gjithë objektin. Paga vjetore bruto vlerësohet duke u bazuar në koeficientin shtetëror të pagës 3.9 për një pozitë me orar të plotë të mirëmbajtësit/es së higjienës. Duke marrë parasysh ndryshimet e fundit të pagës minimale (500 €), paga mujore bruto për këtë pozitë me orar të pjesshëm (50%) do të jetë 250 €.[163] Paga vjetore bruto do të jetë 3.000 € në vitin 2026.

Kostot operative sigurojnë funksionimin e linjës telefonike, duke përfshirë një mjedis mbështetës pune për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme dhe cilësore.

[162] Republika e Kosovës, Komuna e Istogut, *Rregullore Komunale 97/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale* [Rregullorja Komunale 97/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale] përdoret sepse Ligji për Pagat nuk përmban koeficient për këtë pozitë. Komunat e tjera kanë rregullore të ngjashme me koeficientë të njëjtë.
[163] Sipas nenit 9 të Ligjit për Pagat, pavarësisht vlerës monetare të koeficientit, kur paga bazë e përllogaritur përmes koeficientit është më e ulët se paga minimale, paga bazë konsiderohet e barabartë me pagën minimale. Paga minimale u ndryshua më 31.10.2026 me vendimin numër 10/273.

Vlerësimet e kostove bazohen në shërbime të tjera të ngjashme të linjave telefonike, siç është *Linja e Jetës* (Lifeline).[164] Shpenzimet komunale përfshijnë ujin, energjinë elektrike, menaxhimin e mbeturinave dhe ngrohjen, të vlerësuara mesatarisht në 200 € në muaj, respektivisht 2.400 € në vitin 2026. Shpenzimet e komunikimit janë thelbësore për funksionimin e linjës telefonike. Këto kosto sigurojnë shërbime të pandërprera komunikimi për përfituesit/et dhe një koordinim të brendshëm të rrjedhshëm brenda ekipit. Buxheti i vlerësuar është 200 € në muaj, respektivisht 2.400 € në vitin 2026.

Mbështetja e TI-së përfshin kontraktimin e një profesionisti ose kompanie të TI-së, përgjegjëse për mirëmbajtjen e sistemeve teknike që lidhen me linjën telefonike, duke siguruar funksionimin e duhur të mjeteve të komunikimit, softuerit dhe stabilitetin e përgjithshëm të sistemit. Kjo mbështetje është thelbësore për parandalimin e ndërprerjeve teknike dhe sigurimin e ofrimit të vazhdueshëm të shërbimeve. Buxheti i ndarë për mbështetjen e TI-së është 400 € në muaj, respektivisht 4.800 € në vitin 2026. Pajisjet teknike që nevojiten për linjën telefonike përfshijnë kompjuterë, kufje me mikrofon, serverë dhe infrastrukturë tjetër. Këta artikuj nuk do të ketë nevojë të blihen çdo vit, por vetëm sipas nevojës për zëvendësim ose përmirësim. Pas investimeve fillestare në laptopë, server dhe pajisje përkatëse, që kapin vlerën prej 6.500 € në vitin 2026, mirëmbajtja mund të planifikohet në 1.000 € në vit, plus inflacionin për periudhën 2027–2029. Materialet e zyrës nevojiten për operimet e përditshme, duke përfshirë pijet në vendin e punës (p.sh., kafe dhe çaj), materialet e shkrimit, materialet e printimit, materialet harxhuese, mjetet e pastrimit, dezinfektuesit dhe furnizime të tjera bazë. Këto vlerësohet të kushtojnë 50 € në muaj, respektivisht 600 € në vitin 2026. Shpenzimet e fushatës lidhen me ndërgjegjësimin për dhunën me bazë gjinore dhe shërbimet mbështetëse në dispozicion, siç parashihet nga KS-ja, dhe vlerësohen në 630 € në vitin 2026.[165] Kjo mund të përfshijë aktivitete informuese, broshura, reklama televizive dhe promovim në rrjetet sociale. Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve përfshin kostot për trajnerët, materialet, transportin, tarifat dhe burimet e tjera që nevojiten për ngritjen e kapaciteteve. Buxheti i vlerësuar për trajnime është 2.000 € në vit.[166] Tarifat bankare mbulojnë shpenzimet standarde bankare që lidhen me transaksionet financiare të projektit, përfshirë transferet dhe mirëmbajtjen e llogarisë. Buxheti është mesatarisht 100 € në muaj, gjithsej 1.200 € në vit.

Bazuar në supozimet dhe zërat e kostos të përfshirë në model, buxheti i vlerësuar për kostot e përsëritshme dhe kostot fillestare të identifikuara është 150.989 € për vitin 2026, pa përfshirë qiranë e zyrës dhe disa kosto fillestare për mobilim, materiale dhe vënien në funksion. Vlen të theksohet se kostot e qirasë së zyrës dhe kostot fillestare që lidhen me orenditë, materialet dhe pajisjet që nuk janë kompjuterike nuk janë marrë parasysh, pasi është e paqartë nëse ato do të jenë siguruar tashmë nga organet qeveritare ose OJQ-ja që ofron shërbimet e linjës telefonike SOS. Nëse jo, edhe këto kosto shtesë do të duhet të buxhetohen dhe mund të bazohen në kostot për produkte të ngjashme të paraqitura në seksionet e mëvonshme të këtij raporti. Duke marrë parasysh kostot më të ulëta fillestare dhe normën vjetore të inflacionit prej 4%, buxheti do të jetë 150.727 € në vitin 2027.[167] Duke zbatuar një normë të mëtejshme vjetore të inflacionit prej 2% për vitet 2028 dhe 2029, buxheti i përgjithshëm do të rritet në 154.043 € në vitin 2028 dhe në 157.124 € në vitin 2029.

[164] "*Linja e Jetës*" (LifeLine) është linja e parë telefonike për parandalimin e vetëvrasjes në Kosovë. Që nga themelimi i saj në nëntor 2019, ajo ka ofruar mbështetje emergjente pa pagesë për këdo që telefonon kur ka nevojë. Ndonëse nuk përqendrohet në rastet e dhunës me bazë gjinore, si linjë telefonike mund të ofrojë një tregues për kostot që lidhen me shërbimet e linjave telefonike në Kosovë.

[165] Për qëllime të konsistencës, është përllogaritur duke u bazuar në buxhetin mesatar të strehimoreve, i cili është më i ulët se buxheti i Linjës së Jetës.

[166] Ibid.

[167] FMN, Norma e inflacionit, çmimet mesatare të konsumit. Uebfaqja, qasur më 22 korrik 2026.

Qendra e Krizave për Rastet e Përdhunimit dhe Qendra e Referimit për Dhunën Seksuale

Sipas nenit 25 të KS-së, shtetet duhet të marrin masa për të siguruar themelimin e qendrave të përshtatshme dhe lehtësisht të qasshme të krizave për rastet e përdhunimit ose të qendrave të referimit për dhunën seksuale. Këto qendra duhet të ofrojnë shërbime gjithëpërfshirëse, duke përfshirë kujdesin mjekësor, ekzaminimet forenzike, këshillimin për tejkalimin e traumës dhe referimin për mbështetje ligjore, shëndetësore dhe psikosociale.

Qendra e krizave për rastet e përdhunimit është shërbim i specializuar që u ofron mbështetje afatgjatë viktimave të dhunës seksuale. Aktivitetet kryesore të një qendre përfshijnë këshillimin dhe ndihmën terapeutike, përfshirë këshillimin ballë për ballë, grupet mbështetëse dhe kontaktin me shërbimet e tjera përkatëse. Qendrat e krizave për rastet e përdhunimit mund t'i mbështesin viktimat edhe gjatë procedurave gjyqësore, duke u ofruar përfaqësim të interesave dhe ndihmë praktike.[168]

Nga ana tjetër, qendra e referimit për dhunën seksuale përqendrohet te kujdesi i menjëhershëm mjekësor, ekzaminimi forenzik dhe ndërhyrja në krizë pas sulmit seksual. Qendrat e tilla mund të funksionojnë në kuadër të spitaleve. Ato kryejnë vlerësime mjekësore dhe ekzaminime forenzike dhe sigurojnë referim të menjëhershëm te organizatat përkatëse të specializuara për mbështetje të mëtejshme. Ato gjithashtu mund të mbledhin dhe ruajnë prova forenzike edhe kur viktima ende nuk ka vendosur nëse do ta raportojë sulmin në polici.[169] Këto qendra duhet të jenë pjesë e një rrjeti më të gjerë mbështetës, i cili është pa pagesë, në dispozicion të të gjitha të mbijetuarave dhe të gjithë të mbijetuarve dhe garanton konfidencialitetin dhe pëlqimin e dhënë me vetëdije të plotë. Përveç ofrimit të të gjitha elementeve që kërkohen zakonisht për strehimoret, qendrat e krizave për rastet e përdhunimit dhe qendrat e referimit për dhunën seksuale duhet të kenë infrastrukturë dhe pajisje të specializuara për shërbime forenzike dhe mjekësore.

Përgjegjësitë

Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale parasheh themelimin e qendrave të specializuara të krizave për rastet e përdhunimit *ose* të qendrave të referimit si shërbime thelbësore të reagimit të parë për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale.[170] Ai kërkon programe SART për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, të cilat sigurojnë koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet policisë, Prokurorisë së Shtetit, QPS-ve, Mbrojtësve të Viktimave, profesionistëve shëndetësorë, mjekëve ligjorë dhe strehimoreve. Aktualisht, korniza ligjore, e politikave dhe institucionale e Kosovës nuk përfshin SART-in, një mekanizëm koordinimi multidisiplinor për rastet e sulmit seksual, ose Infermierët Ekzaminues të Sulmit Seksual (SANE), një funksion i specializuar infermieror forenzik. Modelet SANE-SART janë lidhur me përmirësimin e kujdesit klinik dhe koordinimit në disa mjedise.[171] Zbatueshmëria dhe efektiviteti i tyre i mundshëm duhet të shqyrtohen në kontekstin e sistemeve ligjore, shëndetësore dhe forenzike të Kosovës. Çdo mekanizëm i tipit SART do të duhej të integrohej me MKL-të ekzistuese për të shmangur dyfishimin; dhe çdo funksion SANE do të duhej të lidhej me mjekët ligjorë dhe procedurat forenzike ekzistuese.

[170] Republika e Kosovës, Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, 2022.
[171] Departamenti i Shëndetësisë, Pasqyrë Ndërkombëtare e Shërbimeve për Dhunën Seksuale, 2012.

Korniza aktuale ligjore dhe e politikave nuk përcakton se sa qendra të krizave për rastet e përdhunimit ose qendra të referimit për dhunën seksuale duhet të themelohen. Aktualisht, asnjë institucion në Kosovë nuk është caktuar zyrtarisht ose mandatuar me ligj për të funksionuar si qendër e krizave për rastet e përdhunimit ose si qendër e referimit për dhunën seksuale. Asnjë dokument i politikave nuk përcakton se ku duhet të vendosen këto qendra ose cili institucion duhet t'i menaxhojë ato. Po ashtu, mandati dhe funksionimi i tyre nuk janë përcaktuar qartë në asnjë akt nënligjor. As Protokolli Shtetëror, as SKDhG-ja nuk kanë parashikuar hartimin e legjislacionit sekondar që do të rregullonte funksionimin e tyre.

Në praktikë, Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) kryen disa funksione që lidhen me një qendër të referimit për dhunën seksuale, veçanërisht ekzaminimin forenzik dhe mbledhjen e provave. I vendosur brenda kompleksit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, ai funksionon në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë. Disa nga pjesëmarrësit në hulumtim argumentuan se IML-ja do të ishte lokacioni më i përshtatshëm për një Qendër Referimi për Dhunën Seksuale, pasi është institucioni kryesor përgjegjës për mbledhjen dhe ruajtjen e provave forenzike. [172] Stafi i IML-së gjithashtu ka ndjekur trajnime përkatëse dhe posedon një pjesë të madhe të ekspertizës së nevojshme. Raportohet se institucionet e tjera shpesh nuk e kanë kuptuar plotësisht natyrën dhe brishtësinë e provave biologjike ose mënyrën e trajtimit të duhur të tyre. [173] Pavarësisht mënyrës se si do të organizohet përfundimisht menaxhimi i qendrës, IML-ja duhet ta ruajë përgjegjësinë për standardet forenzike, protokollet e mbledhjes së provave, sigurimin e cilësisë dhe kërkesat për zinxhirin e ruajtjes së provave. Menaxhimi i përgjithshëm, qeverisja dhe financimi i shërbimit multidisiplinor duhet të përcaktohen përmes kornizës së përshtatshme ligjore dhe institucionale.

Një Qendër Referimi për Dhunën Seksuale dhe potencialisht një Qendër e Krizave për Rastet e Përdhunimit mund të ndërtohen në pronën komunale të papërdorur përreth IML-së. [174] Projekti i planifikuar i infrastrukturës do të duhej t'i dorëzohej komunës për leje ndërtimore. Ende do të duhej të kryhej një studim i plotë fizibiliteti lidhur me kostot e infrastrukturës. Institucioni përgjegjës për menaxhimin e qendrave të tilla ende duhet të qartësohet në mënyrë që të ndahet buxheti.

Në mungesë të një objekti të posaçëm, Instituti i ka përshtatur hapësirat e tij aktuale për të ofruar kushte sa më të pranueshme dhe të përshtatshme për viktimat dhe palët e tjera. Megjithatë, kjo nuk e zëvendëson nevojën për një qendër të specializuar, veçanërisht pasi nuk ka shërbime përcjellëse për viktimat. Aktualisht nuk ekzistojnë institucione tek të cilat IML-ja mund t'i referojë viktimat për mbështetje psikosociale apo psikologjike, e po ashtu mungojnë mekanizmat për adresimin e mangësive në koordinim me institucionet dhe me zinxhirin e drejtësisë penale. Këto çështje kërkojnë zgjidhje pikërisht në kuadër të një qendre të posaçme.

Mungesa e një qendre të specializuar të referimit ka shkaktuar sfida të shumta sistemike në të gjithë zinxhirin e drejtësisë penale. Pa një qendër të centralizuar që funksionon me procedura të standardizuara, të mbijetuarat/it detyrohen t'i përsërisin dëshmitë në institucione të shumta, duke rritur rrezikun e ritraumatizimit. Mungesa e një qendre të referimit gjithashtu shkakton vonesa procedurale dhe rreziqe lidhur me provat, pasi hapat kryesorë forenzikë dhe ligjorë nuk janë të bashkërenduar. Dështimet në koordinim ndërmjet policisë, prokurorëve, shërbimeve sociale dhe ofruesve të kujdesit shëndetësor nënkuptojnë se mbrojtja emergjente, trajtimi mjekësor dhe ndihma psikologjike shpesh ofrohen në mënyrë të izoluar dhe jo përmes një shtegu të vetëm të përqendruar te viktima.[175]

[172] Intervistë e RrGK-së me përfaqësuesit e IML-së, gusht 2025.
[173] Ibid. dhe vërejtjet e RRGK-së.
[174] Ibid.
[175] Ibid.

Në mungesë të qendrave zyrtare të referimit, strehimoret kanë ofruar disa shërbime ad hoc. Stafi i strehimoreve ka ndjekur trajnime për ofrimin e shërbimeve për dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje, përfshirë dhunën seksuale, dhe personat e prekur nga trafikimi për qëllime seksuale. [176] Ato tashmë u ofrojnë shërbime mbështetëse të mbijetuarave/ve të dhunës seksuale, veçanërisht kur ajo ndodh brenda rrethit familjar. Shërbimet e strehimoreve përfshijnë lehtësimin e kujdesit urgjent mjekësor, këshillimin psikologjik dhe akomodimin në raste krize. [177] Këto shërbime ofrohen pa njohje formale, financim të posaçëm ose mbështetje institucionale. Në situata emergjente, strehimoret raportuan se u kanë ndihmuar viktimave të dhunës seksuale, pasi "nuk mund t'i refuzonin viktimat". Megjithatë, pa një mandat formal për ofrimin e shërbimeve të tilla, strehimoret nuk kanë mundur t'i raportojnë ato pranë institucioneve nëse dhuna seksuale ka ndodhur jashtë mjedisit familjar. Strehimoret mbështeten në raportet e policisë për t'i verifikuar shërbimet e tyre dhe për të marrë mbështetje shtetërore për to. Strehimoret nuk përfitojnë mbështetje financiare për rastet që përfshijnë dhunë seksuale jashtë marrëdhënieve familjare. Kjo u krijon një barrë shtesë administrative dhe financiare strehimoreve që i ofrojnë këto shërbime.

> "Nuk mund t'i refuzonim rastet e tilla. […] Në raste emergjente, i pranojmë.

> "Përzierja e shërbimeve është shumë problematike. Nuk do të doja t'i përzieja. Është e rrezikshme. [K]jo shkakton shumë probleme.

Ndonëse strehimoreve potencialisht mund t'u jepej mandati për të akomoduar qendra të krizave për rastet e përdhunimit, duke shfrytëzuar objektet dhe ekspertizën e tyre ekzistuese, përfaqësuesit e strehimoreve shprehën shqetësim rreth shtimit të shërbimeve të tilla. Ata ishin të mendimit se duhet të ketë objekte të veçanta, të dedikuara ekskluzivisht për mbështetjen e të mbijetuarave/ve të dhunës seksuale.

Kapacitetet për BPGj për shërbimin e specializuar

Nuk ekziston asnjë institucion i tillë, prandaj kapacitetet për BPGj-në brenda një tij nuk mund të vlerësoheshin. IML-ja ka bërë disa vlerësime buxhetore, por kapacitetet për BPGj-në mund të zhvillohen më tej.

Të dhënat për përfituesit/et dhe ndikimet

Aktualisht, baza e të dhënave nacionale për identifikimin e rasteve të dhunës në familje regjistron vetëm rastet e dhunës në familje. Kjo ua bën të pamundur strehimoreve ose institucioneve të tjera regjistrimin formal të rasteve të dhunës seksuale. Kjo e pengon dokumentimin e saktë të rasteve, planifikimin e shërbimeve dhe përcaktimin e projeksioneve të financimit për to.

Kërkesa për shërbime

Materialet shpjeguese të Këshillit të Evropës sugjerojnë si tregues orientues një qendër të krizave për rastet e përdhunimit për çdo 200.000 banorë dhe të paktën një qendër për rajon. Popullsia rezidente e Kosovës është afërsisht 1.536.137 banorë.[178] Tabela 19 ilustron numrin e qendrave që do të nevojiten bazuar në madhësinë e popullsisë dhe për t'u shërbyer rajoneve të ndryshme.

[176] Intervistë e RrGK-së, 2025.
[177] Për informata të mëtejshme për shërbimet e strehimoreve, shih seksionin për Strehimoret.
[178] ASK, Popullsia e Kosovës sipas regjistrimeve dhe vlerësimeve, 2024.

Tabela 19. Qendrat e nevojshme të krizave për rastet e përdhunimit / të referimit për dhunën seksuale sipas komunave

Komuna (Sipas madhësisë)	Popullsia e përgjithshme	% e popullsisë së Kosovës	Qendrat e nevojshme të krizave për rastet e përdhunimit	Qendrat aktuale të krizave
Prishtinë	227.154	14.1%	1	0
Prizren	148.202	9.2%	1	0
Ferizaj	109.264	6.8%	1	0
Gjilan	83.576	5.2%		0
Gjakovë	79.480	4.9%		0
Podujevë	72.735	4.5%		0
Mitrovicë e Jugut	67.900	4.2%		0
Vushtrri	62.559	3.9%		0
Lipjan	55.021	3.4%		0
Pejë	53.620	3.3%		0
Suharekë	46.228	2.9%		0
Gllogoc	48.361	2.6%		0
Malishevë	43.888	2.9%		0
Rahovec	41.595	2.8%		0
Skenderaj	40.664	2.6%		0
Viti	35.566	2.3%		0
Istog	33.334	2.1%		0
Klinë	30.503	2.0%		0
Kamenicë	36.170	2.2%		0
Deçan	27.979	1.7%		0
Fushë Kosovë	66.070	4.1%		0
Obiliq	25.342	1.6%		0
Shtime	24.460	1.5%		0
Junik	3.900	0.2%		0
Dragash	29.023	1.8%		0
Kaçanik	33.572	2.1%		0
Kamenicë	36.170	2.2%		0
Shtërpcë	10.870	0.7%		0
Zubin Potok	3.158	0.2%		0
Zveçan	2.877	0.2%		0
Graçanicë	17.907	1.1%		0
Mamushë	5.649	0.4%		0
Hani i Elezit	8.712	0.5%		0
Ranillug	2.476	0.2%		0
Partesh	2.296	0.1%		0
Leposaviq	12.087	0.7%		0
Mitrovicë e Veriut	7.976	0.5%		0
Novobërdë	4.493	0.3%		0
Kllokot	3.053	0.2%		0
Gjithsej	**1.536.137**	**100%**	**8**	**0**

Gjithsej, Kosovës do t'i nevojiten tetë qendra për t'i përmbushur standardet e KS-së. Për të siguruar shërbime në dispozicion në mbarë vendin bazuar në madhësinë e popullsisë, qendrat mund të themelohen në secilin prej rajoneve kryesore të Kosovës, duke u shërbyer komunave të afërta, për shembull në Prishtinë (dy), Prizren, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë, Pejë dhe Mitrovicë (Tabela 20).

Tabela 20. Qendrat e nevojshme të krizave për rastet e përdhunimit / të referimit për dhunën seksuale sipas rajoneve

Lokacioni /Rajoni	Komunat shtesë që duhet shërbyer	Popullsia e përgjithshme e shërbyer	Qendrat aktuale të krizave	Qendrat e nevojshme të krizave për rastet e përdhunimit
Prishtinë	Podujevë, Graçanicë, Fushë Kosovë, Drenas (Gllogoc), Obiliq	457.569	0	2
Prizren	Suharekë, Dragash, Mamushë, Malishevë	272.990	0	1
Ferizaj	Kaçanik, Shtime, Hani i Elezit, Shtërpcë, Lipjan	241.897	0	1
Gjilan	Kamenicë, Viti, Partesh, Ranillug, Kllokot, Novobërdë	167.630	0	1
Gjakovë	Rahovec, Junik, Deçan	152.954	0	1
Mitrovicë	Mitrovicë e Veriut, Vushtrri, Skenderaj, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan	197.021	0	1
Pejë	Istog, Klinë	117.457	0	1

Duke pasur parasysh shkallën aktualisht të ulët të raportimit (Tabela 16) dhe burimet e kufizuara në dispozicion, ekspertët kanë propozuar themelimin gradual të shërbimeve të tilla, veçanërisht duke marrë parasysh se Prishtina mund të arrihet brenda pak orësh nga shumica e lokacioneve në Kosovë.[179] Prandaj, dy qendrat e para mund të themelohen në Prishtinë, duke përfshirë Qendrën e Referimit për Dhunën Seksuale brenda ose afër IML-së dhe një Qendër të Krizave për Rastet e Përdhunimit, tek e cila mund t'i referojë klientët për kujdes afatgjatë. Pas kësaj nisme pilot, shërbimet mund të themelohen në shtatë komunat e tjera, duke u dhënë përparësi komunave ku janë raportuar më shumë raste.

Buxhetet dhe shpenzimet 2022–2026

Gjatë periudhës 2022–2026, asnjëri prej ligjeve të Kosovës për buxhetin nuk përmbante linjë të posaçme buxhetore për krijimin, funksionimin ose planifikimin e qendrave të krizave për rastet e përdhunimit ose qendrave të referimit për dhunën seksuale (d.m.th., studimet e fizibilitetit).

Si tregues i përafërt, buxheti i IML-së mund të ofrojë disa të dhëna për kostot e një qendre të referimit për dhunën seksuale (Tabela 21). Duke qenë se Kosova përdor buxhetimin sipas zërave me vetëm pesë kategori shpenzimesh, nga të dhënat zyrtare të publikuara është e vështirë të kuptohet se cilat kosto mbulohen konkretisht nga buxhetet vjetore. Gjithsej, IML-ja ka 65 të punësuar.[180] Megjithatë, IML-ja ofron shërbime për disa lloje rastesh dhe jo vetëm për rastet e dhunës seksuale. Prandaj, kostot ka të ngjarë të jenë dukshëm më të larta sesa kostot e funksionimit të një qendre referimi.

[179] Intervistë e RrGK-së me një ekspert, gusht 2025.
[180] Republika e Kosovës, Rregullore (MD) nr. 01/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institutin për Mjekësinë Ligjore, 2025. Konkretisht, Shtojca nr. 1 – Organogrami i IML-së përcakton 75 pozita, ndonëse aktualisht janë plotësuar 65.

Tabela 21. Buxheti i IML-së 2022–2026

	2022	2023	2024	2025	2026
Numri i punëtorëve	65	65	65	65	65
Pagat dhe mëditjet	760.671 €	764.474 €	605.516 €	814.345 €	874.234 €
Mallrat dhe shërbimet	180.878 €	230.878 €	330.878 €	330.878 €	330.878 €
Shpenzimet komunale	52.000 €	52.000 €	52.000 €	52.000 €	52.000 €
Subvencionet dhe transferet					
Shpenzimet kapitale	60.000 €		170.000 €	410.000 €	288.000 €
Gjithsej	**1,053,549 €**	**1.047.352 €**	**1.158.394 €**	**1.607.223 €**	**1.545.112 €**

Kostot

Duke qenë se qëllimet e tyre ndryshojnë, qendrat e referimit për dhunën seksuale dhe qendrat e krizave për rastet e përdhunimit mund të kenë kosto paksa të ndryshme. Kostot e mundshme të secilës paraqiten veçmas në këtë nënseksion. Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave për shpenzimet e mëparshme, vlerësimet e kostove bazohen në shërbimet ekzistuese të krahasueshme, të mbështetura nga intervistat me një ekspert të IML-së dhe hulumtimi i RrGK-së për çmimet e tregut. Ato bazohen në praktikat më të mira të rekomanduara ndërkombëtarisht dhe në shërbime të ngjashme, megjithëse të ndryshme, në Kosovë. Kostot janë ilustruese dhe do të duhet të rishikohen pas përfundimit të kornizës ligjore për këto qendra.

Kostot e Qendrës së Referimit për Dhunën Seksuale

Qendrat e referimit synohet të jenë shërbime multidisiplinore të vendosura në spitale, që ofrojnë 24/7 mbështetje mjekësore, forenzike dhe psikosociale për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale. Si shërbime të integruara spitalore, qendrat e referimit duhet të kenë ekip multidisiplinor të profesionistëve të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë infermierë forenzikë, mjekë, gjinekologë, pediatër, staf laboratori, radiologë, mjekë dhe profesionistë të tjerë përkatës mjekësorë.[181] Ekipi duhet të përfshijë edhe staf të posaçëm mbështetës, si punonjës socialë dhe këshilltarë. Ky ekip i specializuar duhet të përfshijë profesioniste të kujdesit shëndetësor, të cilat mund t'u përgjigjen rasteve të dhunës seksuale kur të mbijetuarat/it mund të mos dëshirojnë të ekzaminohen dhe/ose mund të përjetojnë ritraumatizim nëse ekzaminohen nga persona të gjinisë tjetër. Përveç kualifikimeve profesionale, stafi duhet të përfundojë trajnim të specializuar për menaxhimin klinik, forenzik dhe psikosocial të rasteve të dhunës seksuale. Trajnimi duhet të përfshijë: mbrojtjen, pëlqimin e dhënë dhe aftësinë për të dhënë pëlqim, kujdesin e bazuar në qasjen e informuar nga trauma, komunikimin me të mbijetuarat/it, vlerësimin e rrezikut, mbledhjen dhe ruajtjen e provave forenzike, ndërgjegjësimin për shëndetin mendor, përfaqësimin e interesave dhe rrugët e referimit, si dhe punën e koordinuar ndërinstitucionale. Ndonëse ky trajnim është veçanërisht i rëndësishëm për mjekët, infermierët dhe punonjësit socialë, i gjithë stafi tjetër i institucionit të kujdesit shëndetësor, si punonjësit e pastrimit dhe administratorët, duhet gjithashtu të

[181] Organizata Botërore e Shëndetësisë, Udhëzime për Kujdesin Mjeko-ligjor për Viktimat e Dhunës Seksuale, 2003.

ndjekë trajnim ndërgjegjësues. Ky trajnim duhet të përfshijë mënyrën e respektimit të konfidencialitetit dhe të komunikimit me dhembshuri dhe pa diskriminim.

Qendrat e referimit duhet të ofrojnë kujdes gjithëpërfshirës, të përqendruar te të mbijetuarat/it, duke përfshirë trajtimin mjekësor emergjent, ekzaminimet forenzike, testimin e shtatzënisë dhe kontracepsionin emergjent, testimin dhe profilaksinë për infeksionet seksualisht të transmetueshme (IST), trajtimin e lëndimeve, këshillimin psikosocial dhe referimin për ndihmë juridike dhe shërbime të mirëqenies sociale. Për ta siguruar cilësinë dhe konfidencialitetin, qendrat duhet të kenë hapësira të posaçme, me dhomë private ekzaminimi të pajisur për ekzaminime forenzike dhe gjinekologjike, dhomë të veçantë këshillimi, hapësira me dush dhe tualet për pacientët, dhe hapësirë të përshtatshme pritjeje dhe recepsioni. Këto standarde synojnë t'i minimizojnë ekzaminimet e përsëritura dhe të sigurojnë që të mbijetuarat/it të marrin kujdes të koordinuar në mjedis të sigurt dhe konfidencial.

Të gjitha kostot e mundshme janë marrë parasysh për një Qendër që mund të funksionojë në mënyrë të pavarur. Nëse IML-ja dhe/ose spitali i afërt tashmë punësojnë staf mjaftueshëm të kualifikuar, disa prej këtyre kostove mund të mos nevojiten. Kostot gjithashtu janë vlerësuar duke supozuar se Qendra mundëson qëndrime deri në maksimum 72 orë, pas të cilave rastet referohen në Qendrat e Krizave për Rastet e Përdhunimit për trajtim të mëtejshëm.

Kostot e stafit përfshijnë pagat bruto për të gjithë personelin që punon në një qendër. Sikurse në seksionin e fundit, vlerësimet e pagave bazohen në nivelet aktuale të pagave në sektorin publik të përcaktuara me Ligjin për Pagat dhe në përputhje me Ligjin e Punës sa i përket punës së natës (pagesë shtesë prej 30%), punës gjatë festave dhe fundjavave (50%).[182]

Drejtori/ja është përgjegjës/e për menaxhimin e të gjitha veprimtarive. Kjo përfshin mbikëqyrjen e stafit, sigurimin e shërbimeve cilësore, planifikimin strategjik, respektimin e kërkesave ligjore, mbikëqyrjen e menaxhimit dhe planifikimit të qëndrueshëm financiar, monitorimin dhe vlerësimin e punës së Qendrës dhe mirëmbajtjen e partneriteteve të fuqishme me institucionet e tjera për të ofruar mbështetje efektive. Paga përllogaritet duke përdorur koeficientin zyrtar për drejtor (8.3), të shumëzuar me pagën bazë (110 €) dhe duke marrë parasysh të paktën 10 vjet përvojë pune. Kjo rezulton në një pagë bruto 1.009 € në muaj, respektivisht 12.106 € në vitin 2026.

Zyrtari/ja Financiar/e është përgjegjës/e për menaxhimin e financave të qendrës. Kjo përfshin buxhetimin e bazuar në dëshmi, mbajtjen e kontabilitetit, përgatitjen e raporteve financiare dhe detyra të tjera administrative. Zyrtari/ja siguron që të gjitha veprimtaritë financiare të jenë në përputhje me kërkesat ligjore, me transparencë dhe llogaridhënie. Duke pasur parasysh madhësinë e Qendrës dhe veprimtaritë e saj, parashihet që kjo të jetë pozitë me orar të pjesshëm (50%). Paga e parashikuar përllogaritet në bazë të koeficientit të pagës publike (5.7), të shumëzuar me pagën bazë (110 €), duke marrë parasysh pesë vjet përvojë pune, gjithsej 321 € në muaj për punë me orar të pjesshëm, respektivisht 3.856 € në vitin 2026.

Punonjësit socialë ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë dhe menaxhim të rasteve për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale. Ata ofrojnë ndihmë psikosociale, mbështetje për tejkalimin e traumës dhe menaxhim të rasteve, si dhe i ndihmojnë të mbijetuarat/it të kenë qasje në shërbimet thelbësore, përfshirë përmes referimit në institucione të tjera. Ata janë gjithashtu përgjegjës për futjen e të dhënave, menaxhimin e dokumentacionit të rasteve dhe përpilimin e të dhënave për raportim. Për të ofruar shërbime 24-orëshe dhe emergjente, duke i respektuar të drejtat e stafit nga marrëdhënia e punës dhe për pushim, Qendrës do t'i nevojiten gjashtë punonjës socialë profesionistë; tre për t'i mbuluar ndërrimet 24-orëshe gjatë ditëve të javës dhe tre punonjës me orar të pjesshëm për fundjavat, festat dhe pushimet e punonjësve të tjerë socialë. Tri ndërrimet 24-orëshe do të jenë 6:00–15:00, 15:00–22:00 dhe

[182] Republika e Kosovës, Ligji nr. 03/L-212 i Punës, 2010, nenet 27 dhe 56.

22:00–6:00 (punë nate). Koeficienti i pagës publike (6.7), i shumëzuar me pagën bazë (110 €), është gjithsej 670 € në muaj. Duke supozuar të paktën pesë vjet përvojë, paga e rregullt mujore është 755 €, gjegjësisht 9.065 € në vit për secilin nga dy punonjësit gjatë ditëve të javës, gjithsej 18.130 €. Në varësi të viteve të përvojës, kostoja mund të jetë pak më e lartë. Për ndërrimin e natës gjatë javës, një punonjës social do të marrë kompensim shtesë prej 30%, gjithsej 982 € në muaj, respektivisht 11.785 € në vitin 2026. Ndërkohë, për dy punonjësit socialë të fundjavave dhe festave, të cilët gjithashtu do t'i zëvendësojnë punonjësit gjatë ditëve të festave dhe pushimeve të tjera, do të kërkohet shtesë prej 50% për ndërrimet e fundjavës dhe 50% kur punojnë për t'i zëvendësuar punonjësit e tjerë socialë gjatë festave kombëtare. Ata nuk do të punojnë me orar të plotë dhe do të paguhen në bazë të orëve të realizuara, duke marrë parasysh pagesën për fundjavë, natë dhe festa. Për pagesën për fundjavë (50%) dhe festa (50%), paga bazë prej 755 € duhet të shumëzohet me 50%, duke arritur mesatarisht gjithsej 567 € në muaj për punën me orar të pjesshëm, 6.799 € në vit për një punonjës, respektivisht 13.598 € për dy punonjës në vitin 2026. Në fund, do të nevojitet një punonjës social i ndërrimit të natës për fundjavat dhe festat e punonjësve të tjerë, i cili do të marrë pagesë për natë (30%) plus pagesë për fundjavë (50%), gjithsej 884 € në muaj për punë me orar të pjesshëm (50%), respektivisht 10.606 € në vitin 2026. Meqenëse këto janë vlerësime të përafërta, të dhënat për shpenzimet reale do të jenë thelbësore për buxhetim më të saktë gjatë planifikimit të ardhshëm buxhetor, bazuar në orët e realizuara në të vërtetë.

Psikologu/ja Klinik/e u ofron mbështetje të specializuar të mbijetuarave/ve, duke i ndihmuar viktimat të përballen me traumën dhe stresin. Psikologu/ja gjithashtu mund të ofrojë këshillim dhe vizita përcjellëse për viktimat pasi të jenë larguar nga Qendra, nëse viktimat zgjedhin t'i marrin shërbimet e tilla. Psikologu/ja gjithashtu mund t'i ofrojë stafit mbështetje psikologjike për ta ndihmuar të menaxhojë ndikimin emocional të punës dhe të parandalojë traumatizimin dytësor. Kjo mbështetje do ta ndihmojë stafin ta ruajë mirëqenien e vet dhe t'u ofrojë shërbime cilësore të mbijetuarave/ve. Paga përllogaritet në bazë të koeficientit (7) për psikologun klinik, të shumëzuar me pagën bazë (110 €), gjithsej 770 €. Psikologu/ja duhet të ketë trajnim dhe ekspertizë të specializuar në trajtimin e dhunës me bazë gjinore, veçanërisht të dhunës seksuale. Prandaj, paga mujore e parashikuar prej 789 € merr parasysh se psikologu/ja do të ketë të paktën pesë vjet përvojë pune, gjithsej 9.471 € për vitin 2026. Nëse Qendra ndodhet brenda ose afër spitalit, një psikolog nga spitali mund t'i ofrojë këto shërbime pa kosto shtesë, ndonëse psikologut do t'i nevojiten trajnim dhe kualifikime të specializuara.

Mjeku/ja Ligjor/e u ofron të mbijetuarave/ve të dhunës seksuale ekspertizë thelbësore mjekësore dhe ligjore. Mjeku/ja kryen ekzaminime të hollësishme mjekësore, dokumenton lëndimet për qëllime ligjore, mbledh prova forenzike dhe dëshmon si ekspert/e në gjykatë. Mjeku/ja koordinohet me organet e zbatimit të ligjit, shërbimet sociale dhe stafin këshillues për të siguruar kujdes gjithëpërfshirës për të mbijetuarat/it. Paga vjetore e parashikuar bazohet në kategorinë Mjek Specialist me koeficient 12 dhe të paktën pesë vjet përvojë pune, gjithsej 1.353 € në muaj, respektivisht 16.236 € në vitin 2026. Ndonëse Qendrës do t'i nevojitet të paktën një mjek ligjor, një mjek i dytë duhet të jetë në kujdestari për raste emergjente dhe gjatë periudhave kur mjeku kryesor është në pushim. Nëse Qendra ndodhet brenda IML-së ose spitalit, kjo pozitë mund të mbulohet nga spitali pa kosto shtesë, pasi mjekët tashmë janë të punësuar dhe paguhen për kujdestari 24-orëshe si në IML ashtu edhe në spital. Megjithatë, mjekëve do t'u nevojitet trajnim i specializuar. Ngjashëm, gjinekologët, pediatrit, radiologët, stafi i laboratorit dhe specialistët e tjerë të specializuar dhe të certifikuar që punojnë në spital mund t'i shërbejnë Qendrës nëse ajo ndodhet afër. Këto shërbime duhet të ofrohen brenda Qendrës, në mënyrë që pacienti të mos ketë nevojë të lëvizë.[183] Ndërkohë, Qendrat e Krizave për Rastet e Përdhunimit mund të shfrytëzojnë të njëjtin mjek ligjor të specializuar në kuadër të Qendrës së Referimit, pasi nevojitet specialist për dokumentimin e duhur të lëndimeve. Këto

[183] Organizata Botërore e Shëndetësisë, Menaxhimi Klinik i të Mbijetuarave/ve të Përdhunimit dhe Dhunës nga Partneri Intim, 2020.

shërbime forenzike ndodhen brenda pak orësh udhëtimi me veturë nga pothuajse të gjitha skajet e Kosovës. Në të ardhmen, ato mund të zhvillohen në zona të tjera, bazuar në nevojën dhe financimin në dispozicion.

Infermierët mjeko-ligjorë ose infermierët ekzaminues të sulmit seksual u ofrojnë të mbijetuarave/ve të dhunës seksuale kujdes dhe mbështetje thelbësore mjekësore. Ata kryejnë vlerësime shëndetësore, trajtojnë lëndime të lehta, ofrojnë ndihmën e parë pas incidenteve të sulmit seksual, monitorojnë mirëqenien fizike dhe mendore dhe japin udhëzime për higjienën dhe shëndetin riprodhues. Qendrës do t'i nevojiten gjashtë infermierë për të siguruar disponueshmëri 24-orëshe, në mënyrë që të mbijetuarat/it të marrin kujdes mjekësor profesional dhe në kohën e duhur, me ndërrime të ngjashme me ato të punonjësve socialë. Paga vjetore e parashikuar për infermier përllogaritet duke përdorur koeficientin 5.6, të shumëzuar me pagën bazë prej 110 €, duke marrë parasysh se do të kërkohen të paktën pesë vjet përvojë pune, gjithsej 631 € në muaj, respektivisht 7.577 € në vit. Për dy infermierë gjatë ditëve të javës, kostoja do të jetë 15.154 €. Infermieri që punon në ndërrimin e natës do të marrë kompensim shtesë prej 30%, përkatësisht 821 €, gjithsej 9.850 €. Ndërkohë, për dy infermierët e fundjavave dhe festave, të cilët gjithashtu do t'i zëvendësojnë punonjësit gjatë ditëve të festave dhe pushimeve të tjera, do të kërkohet shtesë prej 50% për ndërrimet e fundjavës dhe 50% kur punojnë për të zëvendësuar infermierët e tjerë gjatë festave kombëtare. Ata do të paguhen në bazë të orëve të realizuara, duke marrë parasysh pagesën për fundjavë, natë dhe festa. Shumëzimi i pagës bazë prej 631 € me 50% rezulton në gjithsej 474 € në muaj për punën me orar të pjesshëm, 5.683 € në vit për një punonjës, respektivisht 11.365 € për dy infermierë në vitin 2026. Në fund, do të nevojitet një infermier i ndërrimit të natës për fundjavat dhe festat e infermierëve të tjerë të ndërrimit të natës, i cili do të marrë pagesë për natë (30%) dhe fundjavë (50%), gjithsej 568 € në muaj për punë me orar të pjesshëm (50%), respektivisht 6.819 € në vitin 2026. Meqenëse këto janë vlerësime të përafërta, të dhënat për shpenzimet reale do të jenë thelbësore për buxhetim më të saktë gjatë planifikimit të ardhshëm buxhetor, bazuar në orët e realizuara në të vërtetë. Gjithashtu, nëse Qendra ndodhet brenda spitalit, këto linja buxhetore mund të mos nevojiten, pasi infermierët e spitalit mund të jenë në dispozicion për të ofruar këto shërbime. Megjithatë, infermierët duhet të jenë të specializuar dhe në gatishmëri për t'u përgjigjur menjëherë sapo të mbërrijnë klientët. Personi që punon në recepsion pas orarit të rregullt të punës dhe gjatë natës mund të jetë edhe infermier/e, në mënyrë që viktimat të kenë qasje të drejtpërdrejtë në stafin profesional.

Mirëmbajtësi/ja e higjienës është përgjegjës/e për ruajtjen e pastërtisë, rendit dhe higjienës në të gjithë objektin, duke përfshirë dhomat e klientëve, hapësirat e përbashkëta dhe zyrat. Në disa raste, ky person mund të përgatisë edhe ushqim për personat në qendër. Pas rritjes së pagës minimale në 500 € në muaj në vitin 2026,[184] paga bruto për këtë vend pune është 6.000 € në vitin 2026.

Për themelimin e Qendrës nevojiten disa shpenzime fillestare.[185] Këto shpenzime do të bëhen në vitin e parë. Më pas, do të nevojiten vetëm zëvendësime dhe riparime periodike. Nëse Qendra menaxhohet nga Qeveria, këto shpenzime do të përfshiheshin në linjën buxhetore për mallra dhe shërbime. Shtretërit nevojiten si blerje e njëhershme për nevojat e akomodimit të të mbijetuarave/ve dhe fëmijëve që mund t'i shoqërojnë, duke ofruar hapësirë të sigurt dhe të rehatshme për rimëkëmbje. Kostoja e parashikuar për secilin shtrat spitalor është 1.210 €, gjithsej 7.260 € për gjashtë shtretër.[186] Një shtrat ekzaminimi do të kushtojë

[184] Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimet e mbledhjes së 275-të të Qeverisë, 2025. Bazuar në koeficientin shtetëror të pagës 3,9 dhe pagën bazë prej 110 €, paga mujore do të ishte 456 €. Megjithatë, sipas nenit 9 të Ligjit për Pagat, pavarësisht vlerës monetare të koeficientit, kur paga bazë e përllogaritur përmes koeficientit është më e ulët se paga minimale, paga bazë është e barabartë me pagën minimale.

[185] Këto janë identifikuar bazuar në Organizatën Botërore të Shëndetësisë, Udhëzime për Kujdesin Mjeko-ligjor për Viktimat e Dhunës Seksuale, 2003, dhe në një diskutim me një ekspert nga Kosova.

[186] Vlerësimi i kostos bazohet në çmimin e një shtrati spitalor me tri funksione të listuar në Amazon.

600 €. Qendrës do t'i nevojiten gjithashtu pajisje të specializuara. Frigoriferi për ruajtjen e mostrave biologjike do të mundësojë ruajtje të sigurt dhe në përputhje me standardet të mostrave biologjike, duke ruajtur integritetin e tyre për ekzaminime mjekësore, mbledhje të provave dhe procedura ligjore. Bazuar në furnitorët ndërkombëtarë, çmimi për frigorifer do të jetë afërsisht 5.650 €, në varësi të specifikimeve. Për nevojat e ekzaminimit mjekësor të fëmijëve të mbijetuar nevojitet një tavolinë ekzaminimi pediatrik. Bazuar në çmimet ndërkombëtare, një tavolinë do të kushtojë afërsisht 1.209 €, në varësi të modelit dhe specifikimeve të përzgjedhura.[187] Qendrës së re i nevojitet edhe një tavolinë ekzaminimi për të rritur, e cila ka kosto të parashikuar të ngjashme (1.209 €). Për ekzaminimin gjinekologjik të të mbijetuarave nevojitet një kolposkop, i cili kushton afërsisht 2.850 €, në varësi të modelit dhe specifikimeve. Do të nevojiten pajisje profesionale për incizim (1.000 €), audio (1.000 €) dhe kamerë (800 €) për dokumentimin e dëshmive dhe provave për procedurat ligjore.[188] Do të nevojiten pajisje të tjera mjekësore, duke përfshirë mikroskopin (500 €), tharësen për tamponë (150 €), pajisjet matëse, përfshirë vizoren, metrin dhe kalibrat (50 €), pajisjet për sterilizim (1.000 €), spekulumet e madhësive të ndryshme (65 €), proktoskopin/anoskopin (100 €), enën për mjetet e mprehta (10 €), peshoren dhe matësin e gjatësisë (100 €) dhe zhgutën (447 €).

Qendrës do t'i nevojiten kompjuterë dhe laptopë për menaxhimin e rasteve, dokumentimin dhe koordinimin e shërbimeve. Drejtorit/es, Zyrtarit/es Financiar/e, Psikologut/es, Mjekut/es, punonjësve socialë dhe infermierëve do t'u nevojiten gjithsej gjashtë kompjuterë të cilësisë së lartë. Bazuar në çmimet aktuale online, kjo do të kushtojë afërsisht 900 € për njësi, gjithsej 5.400 €. [189] Skaneri dhe printeri do t'i mbështesin nevojat administrative, dokumentuese dhe ligjore të Qendrës, për mbajtjen e saktë të regjistrave dhe përpunimin efikas të formularëve, raporteve dhe dokumentacionit të të mbijetuarave/ve. Kostoja e tyre është afërsisht 300 €.[190] Fotokopjuesi kushton 1.500 €. Qendrës do t'i nevojitet një faqe interneti për të promovuar punën dhe shërbimet e saj, kostoja fillestare e themelimit të së cilës vlerësohet në 1.000 €.

Për argëtimin e klientëve gjatë qëndrimit në Qendër nevojitet televizor. Kostoja e parashikuar, bazuar në modelet në dispozicion në dyqanet online, është afërsisht 599 €. Ndonëse do të nevojitet të paktën një televizor, Qendra mund të buxhetojë një televizor për dhomë për ta lehtësuar privatësinë e klientëve, gjithsej 3.594 €. Qendrës i nevojitet gjithashtu një tabelë e mençur interaktive për vlerësimin mjekësor, shqyrtimin dhe dokumentimin e provave dhe planifikimin organizativ. Kostoja e parashikuar, bazuar në modelet në dyqanet online, është 529 €, në varësi të madhësisë dhe specifikimeve. Për komunikim nevojitet edhe telefoni, me kosto të përgjithshme prej afërsisht 600 € për një telefon celular me mundësi të shumëfishta për komunikim me klientët dhe institucionet e tjera.

Qendrës i nevojiten orendi gjatë themelimit fillestar.[191] Për hapësirat e punës nevojiten katër tavolina, ku stafi do të merret me detyra administrative konfidenciale dhe menaxhimin e rasteve. Kostoja e parashikuar vlerësohet në 350 € për tavolinë (gjithsej 1.400 €), e përllogaritur në bazë të çmimeve standarde të tregut. Katër karrige zyre nevojiten për t'i ofruar stafit një vendqëndrim të rehatshëm dhe ergonomik. Kostoja e parashikuar është 60 € për karrige, gjithsej 240 € për katër karrige. Nevojitet një tavolinë për konsultime private, takime dhe diskutime të rasteve. Kostoja e parashikuar për një tavolinë të qëndrueshme, me madhësi mesatare, të përshtatshme për përdorim të shumëfishtë në hapësirat e zyrës dhe këshillimit, është 900 €. Katër karrige nevojiten si ulëse për të mbijetuarat/it, stafin dhe vizitorët gjatë

[187] Vlerësimi bazohet në dyqanet online, duke përfshirë burime si Smart Medical Technologies dhe Exam Tables Direct.
[188] Kostot e parashikuara bazohen në çmimet në dispozicion në dyqanet online në Kosovë.
[189] Çmimet nga dyqanet online, si Gjirafa50.
[190] Kostot e parashikuara bazohen në modelet në dispozicion në dyqanet online në Kosovë.
[191] Kostot në këtë kategori bazohen në hulumtimin e tregut për çmimet e ofruara nga kompani si Neptun, Gjirafa dhe Foleja.

konsultimeve dhe aktiviteteve. Kostoja e parashikuar është 60 € për karrige, gjithsej 240 € për katër karrige. Divani për hapësirën e pritjes nevojitet për të krijuar mjedis të sigurt, të qetë dhe mikpritës. Kostoja e parashikuar është 1.250 € për një divan të kategorisë së mesme, të qëndrueshëm, që pastrohet lehtë dhe është i përshtatshëm për hapësirën e recepsionit. Nevojitet një dollap i sigurt për ruajtjen e dosjeve fizike, me brava të sigurta, gjithsej 450 €. Nevojiten burime ndriçimi, gjithsej 150 €.

Makina larëse për larjen e rregullt të rrobave, shtrojave dhe artikujve të tjerë thelbësorë ka kosto të vlerësuar prej 800 €. Për pastrimin e duhur të enëve dhe takëmeve nevojitet pjatalarëse. Kostoja e parashikuar është 550 € për një pjatalarëse standarde për shtëpi ose biznes të vogël, që balancon koston dhe efikasitetin. Mikrovala për përgatitjen dhe ringrohjen e shpejtë të ushqimeve për të mbijetuarat/it dhe stafin vlerësohet të kushtojë 500 €. Furra e kategorisë së mesme për përgatitjen e ushqimeve me vlera ushqyese dhe mbështetjen e mirëqenies së të mbijetuarave/ve kushton afërsisht 550 €. Frigoriferi i qëndrueshëm për ruajtjen e sigurt të ushqimeve, barnave dhe artikujve të tjerë që prishen kushton 2.000 €. Një komplet pjatash dhe takëmesh kushton afërsisht 58 €.

Pas këtyre blerjeve fillestare, kostot e vazhdueshme operative përfshijnë të gjitha shpenzimet që lidhen me sigurimin e kushteve të sigurta dhe funksionale për qendrën. Materialet për zyrë, duke përfshirë stilolapsat, lapsat, letrën për formularët e pëlqimit, etiketat, formularët e referimit për patologji/radiologji dhe raportet mjekësore, mjetet e pastrimit dhe dezinfektuesit kushtojnë 50 € në muaj, respektivisht 600 € në vit. Komunikimet, duke përfshirë mirëmbajtjen e faqes së internetit dhe kostot e telefonit dhe internetit, do të kushtojnë afërsisht 200 € në muaj, respektivisht 2.400 € në vitin 2026. Qendrës do t'i nevojitet një sistem elektronik për menaxhimin e rasteve, për të mbështetur menaxhimin e rasteve, dokumentimin dhe koordinimin e shërbimeve. Sistemi mund të ketë kosto fillestare më të lartë, por do të ofronte përfitime të rëndësishme afatgjata, përfshirë zvogëlimin e gabimeve njerëzore, përmirësimin e gjurmimit dhe ruajtjes së sigurt të dosjeve të rasteve, mbështetjen e raportimit statistikor dhe analitik dhe mundësimin e integrimit të mundshëm me sistemet elektronike që përdoren nga institucionet e tjera përkatëse. Kostoja e një sistemi të tillë do të varet nga projektimi, funksionet dhe niveli i integrimit të kërkuar. Abonimet e vazhdueshme në softuer (sistemi operativ Windows, paketa Microsoft Office, antivirusi) kushtojnë afërsisht 656 € për njësi, gjithsej 3.936 € për gjashtë kompjuterë.[192]

Materialet rekreative dhe edukative për fëmijët mund të blihen dhe më pas të zëvendësohen periodikisht, sipas nevojës; fëmijët mund të lidhen emocionalisht me disa lodra dhe t'i marrin me vete, ndërsa të tjerat mund të shkatërrohen gjatë përdorimit. Për këtë buxhetohen afërsisht 2.000 € në vit. Mirëmbajtja e zyrës, duke përfshirë riparimin ose zëvendësimin e pajisjeve, vlerësohet të kushtojë mesatarisht 300 € në muaj, respektivisht 3.600 € në vitin 2026. Ndërkohë, aktivitetet informuese për promovimin e Qendrës dhe shërbimeve të saj, duke përfshirë broshurat për shërbimet, do të kushtojnë afërsisht 630 € në vitin 2026. Trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve të Qendrës, për të garantuar përditësimin e kualifikimeve, certifikimeve dhe njohurive rreth zhvillimeve më të fundit në fushën e trajtimit, do të kushtojë afërsisht 2.000 € në vitin 2026.

Shpenzimet vjetore për furnizime mjekësore, të vlerësuara në bazë të numrit të parashikuar të klientëve, përfshijnë shiringa, gjilpëra dhe tamponë sterilë (2.160 € në vitin 2026), doreza ekzaminimi (60 €), komplete për testimin e shtatzënisë (336 €), komplete për mbledhjen e mostrave për IST (12.000 €), lubrifikant, ujë steril dhe tretësirë fiziologjike (250 €), enë për transportimin e tamponëve (312 €), lama mikroskopi (180 €), tuba të ndryshëm gjaku (235 €), enë për mostra urine (1.500 €), rrotulla letre për mbulesa ekzaminimi (400 €), qese letre (20 €), analgjezikë (1.000 €), kontracepsion emergjent (1.200 €), materiale për qepje (250 €), profilaksi/vaksinim kundër tetanosit dhe hepatitit (5.000 €), profilaksi për IST

[192] Kostot përllogariten në bazë të çmimeve zyrtare të Microsoft-it për sistemet operative Windows dhe paketat Microsoft 365 Office. Çmimet mund të ndryshojnë në varësi të rajonit, tatimeve dhe opsioneve të licencimit.

(5.000 €), çarçafë dhe batanije (180 €), peshqirë (40 €), veshmbathje për pacientët në nevojë (1.200 €), këmisha për pacientë (170 €), artikuj higjienikë si peceta dhe tamponë (600 €), shpenzime për ushqim dhe higjienë (2.880 €) dhe shpenzime mjekësore për barna (3.600 €). Sipas indikacioneve klinike, paketa e profilaksisë për IST duhet të përfshijë profilaksinë pas ekspozimit ndaj HIV-it (PEP), testimin për IST dhe përcjelljen klinike, krahas trajtimit të IST-ve, kontracepsionit emergjent dhe vaksinimit përkatës. PEP-ja duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur pas ekspozimit, mundësisht brenda 24 orëve dhe jo më vonë se 72 orë, dhe të vazhdojë për 28 ditë. Këto shpenzime mund të ndryshojnë në varësi të numrit të të mbijetuarve të ndihmuar. Ato janë vlerësuar sipas kërkesës së parashikuar, duke pasur parasysh se IML-ja kryen afërsisht 120 ekzaminime të rasteve të dyshuara të dhunës seksuale në vit. Megjithatë, ky numër mund të rritet në të ardhmen.

Regjistrimi i automjetit përfshin shpenzimet vjetore të nevojshme për regjistrimin e mjetit që përdoret për transportimin e të mbijetuarave/ve, stafit dhe mallrave, të vlerësuara në 1.200 €. Kostot e transportit përfshijnë shpenzimet e domosdoshme për transportimin e të mbijetuarave/ve dhe nevoja të tjera udhëtimi, si karburanti, mirëmbajtja e automjetit dhe shpenzime të tjera operacionale. Transporti vlerësohet të kushtojë 172 € në muaj, respektivisht 2.067 € në vitin 2026.[193]

Kostot e paparashikuara përfshijnë shpenzimet e papritura që mund të lindin, si zëvendësimi ose riparimi i inventarit të dëmtuar, nevojat e paplanifikuara për mirëmbajtje dhe kontraktimi i shërbimeve të përkthimit për përfituesit/et që flasin gjuhë të ndryshme, sipas nevojës. Kjo linjë buxhetore është e rëndësishme gjatë vitit të parë të veprimtarisë, pasi mund të shfaqen shpenzime që nuk kanë mundur të identifikohen gjatë planifikimit. Kjo vlerësohet të kushtojë 1.785 € në vitin 2026.[194]

Shpenzimet komunale përfshijnë shërbimet komunale (ujin, energjinë elektrike, largimin e mbeturinave dhe ngrohjen), që vlerësohen të kushtojnë 200 € në muaj, respektivisht 2.400 € në vit.

Sa u përket shpenzimeve kapitale, ky vlerësim nuk i përfshin kostot e ndërtimit të një objekti të ri, të cilat duhet të përcaktohen në bazë të një studimi të plotë fizibiliteti. Përveç kësaj, nevojitet një automjet për të mbështetur nevojat operative dhe të aktiviteteve në terren të Qendrës, përfshirë transportimin e sigurt të të mbijetuarave/ve në institucione dhe shërbime të tjera, udhëtimin e stafit për aktivitete informuese dhe koordinimin me institucionet e tjera. Bazuar në kontratat për furnizimin e institucioneve me automjete dhe çmimet e tregut, një automjet i përshtatshëm kushton afërsisht 40.000 €.

Tabela 22. Kostot e vlerësuara të Qendrës SOS të Referimit për Dhunën Seksuale, 2026–2029

Njësia	Kostoja për njësi	2026	2027	2028	2029
Pagat dhe mëditjet		**44.976 €**	**150.195 €**	**153.499 €**	**156.569 €**
Drejtor	1.009 €	12.106 €	12.542 €	12.818 €	13.075 €
Zyrtar i financave (50%)	321 €	3.856 €	3.995 €	4.083 €	4.164 €
Punonjës socialë (ditët e javës) (2)	755 €	18.130 €	18.783 €	19.196 €	19.580 €
Punonjës social (ndërrimi i natës gjatë javës)	982 €	11.785 €	12.209 €	12.477 €	12.727 €
Punonjës social (fundjavë) (2) (50%)	567 €	13.598 €	14.087 €	14.397 €	14.685 €
Punonjës social (ndërrimi i natës gjatë fundjavës) (50%)	884 €	10.606 €	10.988 €	11.230 €	11.454 €

[193] Vlerësimet e kostove bazohen në shpenzimet mesatare të strehimoreve, duke supozuar kosto të ngjashme.
[194] Ibid.

Tabela 22. Kostot e vlerësuara të Qendrës SOS të Referimit për Dhunën Seksuale, 2026–2029

Njësia	Kostoja për njësi	2026	2027	2028	2029
Psikolog klinik	789 €	9.471 €	9.812 €	10.028 €	10.228 €
Mjek ligjor	1.353 €	16.236 €	16.820 €	17.191 €	17.534 €
Infermier forenzik (ditët e javës) (2)	631 €	15.154 €	15.699 €	16.045 €	16.365 €
Infermier forenzik (netët gjatë javës)	821 €	9.850 €	10.204 €	10.429 €	10.638 €
Infermier forenzik (fundjavat) (2) (50%)	474 €	11.365 €	11.774 €	12.033 €	12.274 €
Infermier forenzik (netët gjatë fundjavës) (50%)	568 €	6.819 €	7.065 €	7.220 €	7.364 €
Mirëmbajtës/e	500 €	6.000 €	6.216 €	6.353 €	6.480 €
Mallrat dhe shërbimet		**104.933 €**	**108.710 €**	**62.248 €**	**63.493 €**
Shtretër spitalorë	1.210 €	7.260 €	7.521 €		
Shtrat ekzaminimi	600 €	600 €	622 €		
Frigorifer për ruajtjen e mostrave biologjike	5.650 €	5.650 €	5.853 €		
Tavolinë ekzaminimi pediatrik	1.209 €	1.209 €	1.253 €		
Tavolinë ekzaminimi (për të rritur)	1.209 €	1.209 €	1.253 €		
Kolposkop	2.850 €	2.850 €	2.953 €		
Pajisje incizimi dhe kamerë	2.800 €	2.800 €	2.901 €		
Mikroskop	500 €	500 €	518 €		
Tharëse për tamponë	150 €	150 €	155 €		
Pajisje matëse	50 €	50 €	52 €		
Pajisje për sterilizim	1.000 €	1.000 €	1.036 €		
Spekulume (madhësi të ndryshme)	65 €	195 €	202 €		
Proktoskop/anoskop	100 €	100 €	104 €		
Enë për mjete të mprehta	10 €	10 €	10 €		
Peshore dhe matës i gjatësisë	100 €	100 €	104 €		
Zhgutë	447 €	447 €	463 €		
Kompjuterë	900 €	5.400 €	5.594 €		
Printer/skaner	300 €	300 €	311 €		
Fotokopjues	1.500 €	1.500 €	1.554 €		
Faqja e internetit	1.000 €	1.000 €	1.036 €		
Televizorë	599 €	3.594 €	3.723 €		
Tabelë inteligjente	529 €	529 €	548 €		
Telefon / telefon i mençur	600 €	600 €	622 €		
Tavolina pune	350 €	1.400 €	1.450 €		
Karrige zyre	60 €	240 €	249 €		
Tavolinë	900 €	900 €	932 €		
Tavolinë dhe karrige	60 €	240 €	249 €		
Divan	1.250 €	1.250 €	1.295 €		
Dollap për dosje	450 €	450 €	466 €		
Ndriçimi	150 €	150 €	155 €		
Rrobalarëse	800 €	800 €	829 €		
Enëlarëse	550 €	550 €	570 €		
Mikrovalë	500 €	500 €	518 €		

Tabela 22. Kostot e vlerësuara të Qendrës SOS të Referimit për Dhunën Seksuale, 2026–2029

Njësia	Kostoja për njësi	2026	2027	2028	2029
Furrë	550 €	550 €	570 €		
Frigorifer	2.000 €	2.000 €	2.072 €		
Pjata dhe takëme	58 €	58 €	60 €		
Mjete zyre	50 €	600 €	622 €	635 €	648 €
Komunikimi	200 €	2.400 €	2.486 €	2.541 €	2.592 €
Softuer kompjuterik	656 €	3.936 €	4.078 €	4.167 €	4.251 €
Materiale rekreative/edukative për fëmijë	167 €	2.004 €	2.076 €	2.122 €	2.164 €
Mirëmbajtja	300 €	3.600 €	3.730 €	3.812 €	3.888 €
Aktivitete informuese	630 €	630 €	653 €	667 €	680 €
Trajnimi	2.000 €	2.000 €	2.072 €	2.118 €	2.160 €
Shiringa, gjilpëra, tamponë sterilë	120 €	2.160 €	2.238 €	2.287 €	2.333 €
Doreza ekzaminimi	12 €	60 €	62 €	64 €	65 €
Komplete për testimin e shtatzënisë	14 €	336 €	348 €	356 €	363 €
Komplete për mbledhjen e mostrave për IST	100 €	12.000 €	12.432 €	12.706 €	12.960 €
Lubrifikant, ujë steril, tretësirë fiziologjike	50 €	250 €	259 €	265 €	270 €
Enë për transportimin e tamponëve	10 €	312 €	323 €	330 €	337 €
Lama mikroskopi	15 €	180 €	186 €	191 €	194 €
Tuba gjaku	47 €	235 €	243 €	249 €	254 €
Enë për mostra urine	25 €	1.500 €	1.554 €	1.588 €	1.620 €
Rrotulla letre për mbulesa ekzaminimi	20 €	400 €	414 €	424 €	432 €
Qese letre	20 €	20 €	21 €	21 €	22 €
Analgjezikë	25 €	1.000 €	1.036 €	1.059 €	1.080 €
Kontracepsion emergjent	10 €	1.200 €	1.243 €	1.271 €	1.296 €
Materiale për qepje	50 €	250 €	259 €	265 €	270 €
Profilaksia/vaksinimi kundër tetanosit dhe hepatitit	50 €	5.000 €	5.180 €	5.294 €	5.400 €
Profilaksia për IST	50 €	5.000 €	5.180 €	5.294 €	5.400 €
Çarçafë dhe batanije	30 €	180 €	186 €	191 €	194 €
Peshqirë	20 €	40 €	41 €	42 €	43 €
Veshmbathje	100 €	1.200 €	1.243 €	1.271 €	1.296 €
Këmisha për pacientë	17 €	170 €	176 €	180 €	184 €
Artikuj higjienikë – peceta/tamponë	50 €	600 €	622 €	635 €	648 €
Shpenzimet për ushqim dhe higjienë	8 €	2.880 €	2.984 €	3.049 €	3.110 €
Shpenzimet mjekësore për barna	30 €	3.600 €	3.730 €	3.812 €	3.888 €
Regjistrimi i automjeteve	1.200 €	1.200 €	1.243 €	1.271 €	1.296 €
Kostot e transportit	172 €	2.064 €	2.138 €	2.185 €	2.229 €
Kostot e paparashikuara	1.785 €	1.785 €	1.849 €	1.890 €	1.928 €
Shpenzimet komunale		**2.400 €**	**2.486 €**	**2.541 €**	**2.592 €**
Shërbimet komunale	200 €	2.400 €	2.486 €	2.541 €	2.592 €

Tabela 22. Kostot e vlerësuara të Qendrës SOS të Referimit për Dhunën Seksuale, 2026–2029

Njësia	Kostoja për njësi	2026	2027	2028	2029
Shpenzimet kapitale		**40.000 €**	**41.440 €**	**€ -**	**€ -**
Automjet	40.000 €	40.000 €	41.440 €		
Gjithsej		**292.308 €**	**302.831 €**	**218.289 €**	**222.655 €**

Buxheti i përgjithshëm për themelimin dhe funksionimin e Qendrës në vitin 2026 do të ishte 292.308 €. Meqenëse ka të ngjarë që ajo të mos themelohet deri në vitin 2027, parashikohet që këto kosto të rriten në 302.831 € për shkak të inflacionit prej 4%, nëse ajo hapet në janar 2027. Vlen të theksohet se kostot mund të ulen në varësi të muajit kur ajo do të hapet dhe kur do të fillojnë shpenzimet operative. Meqenëse kostot bazohen në çmimet aktuale të tregut, ato duhet të monitorohen çdo vit për të mbështetur vlerësimet e bazuara në dëshmi. Për projeksionet buxhetore të vitit 2028, mund të hiqen kostot e blerjeve të njëhershme, si orenditë dhe pajisjet. Ndërkohë, duhet të merret parasysh inflacioni prej 2% i parashikuar nga FMN-ja. Prandaj, buxheti i vlerësuar për vitin 2028 është 218.289 €. Duke marrë parasysh inflacionin e parashikuar prej 2% në vitin 2029, duhet të buxhetohen 222.655 €. Duke pasur parasysh trajnimin e posaçëm që nevojitet për funksionimin e kësaj Qendre, propozohet të themelohet vetëm një Qendër në Prishtinë. Më pas, bazuar në nivelin e kërkesës për shërbime gjatë periudhës 2027–2029, Ministria e Drejtësisë mund të vlerësojë nëse do të nevojiten qendra të tjera të referimit për dhunën seksuale për t'u shërbyer zonave të tjera gjeografike.

Kostot e Qendrës së Krizave për Rastet e Përdhunimit

Një Qendër e Krizave për Rastet e Përdhunimit duhet të themelohet gjithashtu në Prishtinë, duke pasur parasysh madhësinë e popullsisë dhe afërsinë me Qendrën e Referimit për Dhunën Seksuale, nga e cila rastet mund të referohen për trajtim dhe kujdes afatgjatë. Duke pasur parasysh shërbimet e saj të specializuara ndërkomunale të mbështetjes sociale, ajo duhet të themelohet nga MPFVLÇ-ja dhe të financohet përmes buxhetit të saj vjetor.

Ngjashëm me kostot e Qendrës së Referimit për Dhunën Seksuale, të paraqitura hollësisht në seksionin e fundit, Qendrës së Krizave për Rastet e Përdhunimit do t'i nevojiten një drejtor/e; një zyrtar/e financiar/e me orar të pjesshëm (50%); gjashtë punonjës socialë për të mbuluar të gjitha ndërrimet; një psikolog/e klinik/e me orar të plotë për të ofruar këshillim individual dhe në grup, përfshirë përcjelljen e rasteve të referuara përmes vizitave në shtëpi;[195] një infermier/e me orar të plotë dhe me orar fleksibil pune në varësi të nevojave, i/e cili/a mund të jetë "në kujdestari" për raste emergjente, përfshirë gjatë fundjavave dhe natës; si dhe një mirëmbajtës/e të higjienës. Qendrës së Krizave për Rastet e Përdhunimit do t'i nevojitet gjithashtu një edukator/e për të mbështetur kujdesin e përditshëm, sigurinë dhe zhvillimin e fëmijëve që marrin shërbime, përfshirë fëmijët e mbijetuar të dhunës, si dhe fëmijët që shoqërojnë të mbijetuarat/it. Edukatori/ja organizon aktivitete edukative dhe rekreative, ndihmon me mësimin dhe detyrat e shtëpisë dhe i mbështet fëmijët në zhvillimin e shkathtësive sociale dhe emocionale në një mjedis të sigurt dhe mbështetës. Edukatori/ja gjithashtu mund të kujdeset për fëmijët që shoqërojnë një viktimë të dhunës seksuale gjatë kohës që ajo merr trajtim, këshillim, ndihmë mjekësore ose shërbime të tjera. Bazuar në nivelet e pagave të sektorit publik për këtë kategori stafi, paga mujore për kujdestarët/stafin edukativ për fëmijë është 681 €.[196] Meqenëse fëmijët mund të mos jenë vazhdimisht në

[195] Kjo është buxhetuar si pozitë me orar të plotë, por mund të paguhet në bazë të kohës së punuar.
[196] Përllogaritja përfshin pesë vjet përvojë pune, me rritje prej 0,5% në vit.

Qendër, kjo buxhetohet si pagë me orar të pjesshëm (50%) prej 340 € në muaj, gjithsej 4.084 € në vit.

Për themelimin e një Qendre të Krizave për Rastet e Përdhunimit nevojiten disa shpenzime të ngjashme të njëhershme, siç përshkruhet hollësisht në seksionin e mëparshëm, duke përfshirë shtretër të zakonshëm,[197] shtrat ekzaminimi, pajisje incizimi, kamerë, pesë kompjuterë/laptopë, printer/skaner, fotokopjues, faqe interneti, gjashtë televizorë, telefon të mençur me cilësi të lartë, tavolina pune, karrige, tavolina, divan, dollap të sigurt për dosje, ndriçim, makinë larëse, pjatalarëse, mikrovalë, furrë, frigorifer, pjata, takëme dhe peshqirë.

Shpenzimet e vazhdueshme operative përfshijnë materialet për zyrë, komunikimet, softuerin kompjuterik, materialet rekreative dhe edukative për fëmijë, shpenzimet e mirëmbajtjes, materialet informuese për promovimin e Qendrës dhe shërbimeve të saj dhe trajnimin e vazhdueshëm për të punësuarit. Qendrës do t'i nevojiten gjithashtu disa furnizime bazë të ndihmës së parë dhe mjekësore (2.400 € në vit), megjithëse kujdesi mjekësor duhet të sigurohet kryesisht përmes Qendrës së Referimit për Dhunën Seksuale. Qendra mund të mbajë gjithashtu teste shtatzënie, kontracepsion emergjent dhe komplete për raste përdhunimi për situata emergjente, ndonëse procedurat përkatëse duhet të kryhen nga Qendra e Referimit për Dhunën Seksuale. Qendra do të ketë shpenzime për regjistrimin e automjetit (1.200 €), transportin (2.067 €) dhe kosto të mundshme të paparashikuara prej 1.785 €.[198]

Qendrës së Krizave për Rastet e Përdhunimit do t'i nevojiten gjithashtu veshmbathje, artikuj sanitarë, ushqim, produkte higjienike dhe fonde për shpenzime mjekësore. Këto kosto mund të ndryshojnë në varësi të numrit të klientëve dhe kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre, gjatë ditës ose natës. Ato janë vlerësuar bazuar në numrin e rasteve të trajtuara nga IML-ja (120) dhe kohëzgjatjen mesatare të qëndrimit në strehimore (29 ditë), duke supozuar se jo më shumë se një e katërta e përfituesve të IML-së do të kërkonin qëndrim gjatë natës. Qendra shërben edhe si qendër ditore, gjë që mund të përfshijë kosto për ushqim dhe furnizime bazë për përfituesit/et. Disa klientëve mund t'u nevojiten veshmbathje emergjente, që vlerësohen në 2.400 €.[199] Ushqimi mund të kushtojë afërsisht 5.933 € në vit.[200] Materialet higjienike vlerësohen në 400 € në muaj, duke përfshirë tamponët, pecetat dhe materiale të tjera. Shpenzimet mjekësore, përfshirë barnat dhe vizitat për trajtim që nuk mbulohen nga kujdesi i rregullt shëndetësor publik, vlerësohet të kushtojnë 300 € në muaj, respektivisht 3.600 € në vitin 2026. Numri i klientëve dhe kostot përkatëse duhet të gjurmohen gjatë vitit të parë të veprimtarisë për t'i vlerësuar më saktë nevojat buxhetore për vitet e ardhshme.

Siç parashihet nga KS-ja dhe korniza ligjore e Kosovës, mbështetja për riintegrim përfshin ndihmën financiare që u ofrohet të mbijetuarave/ve për t'i ndihmuar ata/ato të krijojnë siguri, stabilitet dhe pavarësi. Kjo mbështetje mund të ndihmojë në zhvillimin e bizneseve të vogla, subvencionimin e përkohshëm të qirasë, kujdesin për fëmijët, transportin dhe forma të tjera ndihme që u mundësojnë të mbijetuarve/ve të rindërtojnë jetën e tyre. Kjo mbështetje duhet të miratohet nga Qeveria. Një buxhet mesatar prej 500 € për klient, për rreth 30 të mbijetuar/a, do të arrinte një total prej 15.000 €. Kostot dhe nevojat duhet të monitorohen nga afër për të përmirësuar planifikimin buxhetor për vitet e ardhshme.

---

[197] Kostoja e parashikuar për secilin shtrat, bazuar në Udhëzuesin për Buxhetimin Operacional dhe Projektimin e Strehimoreve në Kosovë (2021), duke përfshirë kornizën e shtratit, dyshekun, batanijet, jastëkët, jorganin dhe shtrojat mbrojtëse, është afërsisht 475 € për shtrat, për gjashtë shtretër.

[198] Vlerësimet e kostove bazohen në shpenzimet mesatare të strehimoreve, duke supozuar kosto të ngjashme.

[199] Janë përdorur shpenzimet e parashikuara nga MPFVLÇ-ja. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shpenzimet vjetore për veshmbathje dhe këpucë ishin afërsisht 2.632 € në vit ose 219 € në muaj për person në vitin 2024 (Indeksi i Çmimeve të Konsumit).

[200] ASK-ja raportoi se shporta minimale ushqimore kushtonte 2.298 € në vit (6,29 € në ditë) në vitin 2024 (Indeksi i Çmimeve të Konsumit). Duke marrë parasysh inflacionin, kostoja aktuale mund të jetë 6,82 € në ditë. Numbeo vlerëson ngjashëm se ushqimi kushton afërsisht 6,01 € për person në ditë në Kosovë. Ky vlerësim supozon se afërsisht një e katërta e 120 personave që raportojnë dhunë (30 klientë) i përdorin shërbimet ditore ose të natës mesatarisht për 29 ditë (kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në strehimore).

Shpenzimet komunale përfshijnë shërbimet komunale (ujin, energjinë elektrike, largimin e mbeturinave dhe ngrohjen), që vlerësohet të kushtojnë 200 € në muaj, respektivisht 2.400 € në vit.

Sa u përket shpenzimeve kapitale, ky vlerësim nuk i përfshin kostot e ndërtimit të një objekti të ri, ndonëse ato mund të nevojiten. Mund të kontraktohet një OJQ me ekspertizë dhe/ose mund të shfrytëzohet një hapësirë komunale. Këtu duhet të llogariten edhe shpenzimet përkatëse për infrastrukturë dhe renovim. Përveç kësaj, nevojitet një automjet për t'i mbështetur nevojat e Qendrës, përfshirë transportimin e sigurt të të mbijetuarave/ve në institucione dhe shërbime të tjera, udhëtimin e stafit për aktivitete informuese dhe koordinimin me institucionet e tjera. Bazuar në kontratat për furnizimin e institucioneve me automjete dhe çmimet e tregut, një automjet i përshtatshëm kushton afërsisht 40.000 €.

Kostot e themelimit dhe funksionimit të një Qendre të Krizave për Rastet e Përdhunimit në vitin 2027 përmblidhen në Tabelën 23, duke zbatuar një normë vjetore inflacioni prej 4%, arrijnë në totalin prej 218.966 €. Duke llogaritur një inflacion të parashikuar prej 2%, buxhetet e parashikuara për funksionimin e saj janë 155.498 € në vitin 2028 dhe 158.539 € në vitin 2029.[201] Pas dy vjetësh, Qendra të tjera të Krizave për Rastet e Përdhunimit mund të hapen edhe në rajone të tjera, në përputhje me në kriteret e KS-së dhe nivelin e kërkesës së identifikuar, sipas rasteve të raportuara të dhunës seksuale. Ky model i llogaritjes së kostove mund të shërbejë për buxhetimin e themelimit të këtyre qendrave të tjera në të ardhmen, duke marrë parasysh edhe inflacionin.

Tabela 23. Kostot e vlerësuara të Qendrës së Referimit për Rastet e Përdhunimit 2026–2029

Njësia	Kostoja për njësi	2026	2027	2028	2029
Pagat dhe mëditjet		**97.213 €**	**93.716 €**	**95.701 €**	**97.546 €**
Drejtor	1,009 €	12.106 €	12.542 €	12.818 €	13.075 €
Zyrtar i financave (50%)	321 €	3.856 €	3.995 €	4.083 €	4.164 €
Punonjës social (ditët e javës) (2)	755 €	18.130 €	18.783 €	19.196 €	19.580 €
Punonjës social (ndërrimi i natës gjatë javës)	982 €	11.785 €	12.209 €	12.477 €	12.727 €
Punonjës social (fundjavë) (2) (50%)	567 €	13.598 €	14.087 €	14.397 €	14.685 €
Punonjës social (ndërrimi i natës gjatë fundjavës) (50%)	884 €	10.606 €	10.988 €	11.230 €	11.454 €
Psikolog klinik	789 €	9.471 €	9.812 €	10.028 €	10.228 €
Infermiere	631 €	7.577 €	7.850 €	8.022 €	8.183 €
Mirëmbajtës/e	500 €	6.000 €	600 €	600 €	600 €
Edukatore (50%)	340 €	4.084 €	2.850 €	2.850 €	2.850 €
Mallrat dhe shërbimet		**78.498 €**	**81.324 €**	**57.256 €**	**58.401 €**
Shtretër	475 €	2.850 €	2.953 €		
Shtrat ekzaminimi	600 €	600 €	622 €		
Pajisje incizimi dhe kamerë	2.800 €	2.800 €	2.901 €		
Kompjuterë/laptopë	500 €	2.500 €	2.590 €		
Printer/skaner	300 €	300 €	311 €		
Fotokopjues	1.500 €	1.500 €	1.554 €		
Faqja e internetit	1.000 €	1.000 €	1.036 €		
Televizorë	599 €	3.594 €	3.723 €		
Telefon i mençur	600 €	600 €	622 €		

[201] FMN, Norma e inflacionit, çmimet mesatare të konsumit. Uebfaqja, qasur më 22 korrik 2026.

Tabela 23. Kostot e vlerësuara të Qendrës së Referimit për Rastet e Përdhunimit 2026–2029

Njësia	Kostoja për njësi	2026	2027	2028	2029
Tavolina pune	350 €	1.050 €	1.088 €		
Karrige zyre	60 €	180 €	186 €		
Tavolinë	900 €	900 €	932 €		
Tavolinë dhe karrige	60 €	240 €	249 €		
Divan	1.250 €	1.250 €	1.295 €		
Dollap për dosje	450 €	450 €	466 €		
Ndriçim	150 €	150 €	155 €		
Rrobalarëse	800 €	800 €	829 €		
Enëlarëse	550 €	550 €	570 €		
Mikrovalë	500 €	500 €	518 €		
Furrë	550 €	550 €	570 €		
Frigorifer	2.000 €	2.000 €	2.072 €		
Pjata dhe takëme	58 €	58 €	60 €		
Peshqirë	20 €	40 €	41 €	42 €	43 €
Mjete zyre	50 €	600 €	622 €	635 €	648 €
Komunikimi	200 €	2.400 €	2.486 €	2.541 €	2.592 €
Softuer kompjuterik	656 €	3.280 €	3.398 €	3.473 €	3.542 €
Materiale rekreative/edukative për fëmijë	167 €	2.004 €	2.076 €	2.122 €	2.164 €
Mirëmbajtja	300 €	3.600 €	3.730 €	3.812 €	3.888 €
Aktivitete informuese	630 €	630 €	653 €	667 €	680 €
Trajnimi	2.000 €	2.000 €	2.072 €	2.118 €	2.160 €
Furnizime mjekësore	200 €	2.400 €	2.486 €	2.541 €	2.592 €
Komplete për testimin e shtatzënisë	14 €	140 €	145 €	148 €	151 €
Kontracepsion emergjent	10 €	100 €	104 €	106 €	108 €
Komplet për rastet e përdhunimit	100 €	100 €	104 €	106 €	108 €
Regjistrim të automjeteve	1.200 €	1.200 €	1.243 €	1.271 €	1.296 €
Kostot e transportit	172 €	2.064 €	2.138 €	2.185 €	2.229 €
Kostot e paparashikuara	1.785 €	1.785 €	1.849 €	1.890 €	1.928 €
Veshmbathje	200 €	2.400 €	2.486 €	2.541 €	2.592 €
Ushqimi	7 €	5.933 €	6.147 €	6.282 €	6.408 €
Materiale higjienike	400 €	4.800 €	4.973 €	5.082 €	5.184 €
Shpenzimet mjekësore për barna	300 €	3.600 €	3.730 €	3.812 €	3.888 €
Mbështetje për riintegrim	500 €	15.000 €	15.540 €	15.882 €	16.200 €
Shpenzimet komunale		**2.400 €**	**2.486 €**	**2.541 €**	**2.592 €**
Shërbime komunale	200 €	2.400 €	2.486 €	2.541 €	2.592 €
Shpenzimet kapitale		**40.000 €**	**41.440 €**		
Automjet	40.000 €	40.000 €	41.440 €		
Gjithsej		**218.111 €**	**218.966 €**	**155.498 €**	**158.539 €**

Strehimoret

Sipas nenit 23 të KS-së, shtetet duhet të sigurojnë themelimin e strehimoreve të përshtatshme dhe lehtësisht të qasshme, në numër të mjaftueshëm për të ofruar akomodim të sigurt dhe për t'u dalë në ndihmë në mënyrë proaktive të mbijetuarave/ve, veçanërisht grave dhe fëmijëve të tyre.

Përgjegjësitë

LDhBGj-ja dhe aktet përkatëse nënligjore rregullojnë licencimin, financimin, monitorimin dhe funksionimin e ofruesve publikë e joqeveritarë të shërbimeve për personat që kanë pësuar dhunë me bazë gjinore. Financimi i strehimoreve ndikohet gjithashtu nga ligjet dhe politikat për shërbimet sociale dhe familjare të paraqitura në kapitullin e mëparshëm. Standardet minimale të punës ndikojnë në kostot e funksionimit të strehimoreve në përputhje me detyrimet ligjore.[202] Ofruesit e licencuar mund të menaxhojnë qendra mbrojtëse me akomodim të përkohshëm dhe qendra ditore për viktimat e dhunës. Financimi dhe mbështetja buxhetore bazohen te kostot e shërbimeve dhe ato operative, të cilat mund të mbështeten përmes alokimeve nga Buxheti i Kosovës. Gjatë viteve të fundit, strehimoret janë financuar përmes Ministrisë së Drejtësisë, por kjo kompetencë i është transferuar MPFVLÇ-së.

Kosova ka një rrjet strehimoresh që drejtohen kryesisht nga OJQ-të. Tetë strehimore ofrojnë mbrojtje dhe shërbime thelbësore për të mbijetuarat/it e dhunës në familje. Ato ofrojnë gjithashtu shërbime lidhur me format e tjera të dhunës me bazë gjinore, sipas nevojës. Këtu përfshihen:

1. Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Prishtinë
2. Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës "Raba Voca" në Mitrovicë të Jugut
3. Qendra për Mirëqenien e Gruas në Pejë
4. Shtëpia e Sigurt në Gjakovë
5. Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve në Prizren
6. Strehimorja "Liria" në Gjilan
7. Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës "Shtëpia Ime" në Ferizaj
8. Qendra Gjithëpërfshirëse e Grave në Novobërdë

Përveç tyre, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (MVPT) në Prishtinë ofron shërbime të specializuara për gratë dhe vajzat e prekura nga trafikimi. Të gjitha strehimoret ofrojnë akomodim të sigurt, mbështetje psikosociale, ndihmë juridike, referim për kujdes shëndetësor, arsimim dhe aftësim profesional, si dhe programe afatgjata të rehabilitimit e riintegrimit që synojnë fuqizimin e të mbijetuarave/ve dhe parandalimin e riviktimizimit.

Përveç këtyre objekteve që menaxhohen nga OJQ-të, Qeveria e Kosovës menaxhon Objektin e Përkohshëm të Sigurisë (OPS), një strehimore me siguri të lartë e destinuar për viktimat e trafikimit me rrezikshmëri të lartë. Qeveria gjithashtu ka njoftuar se do të hapë një strehimore të re për viktimat e dhunës në familje në Mitrovicë të Veriut. Në gusht të vitit 2024, ministri i Punëve të Brendshme nënshkroi një marrëveshje me kryetarin e Mitrovicës së Veriut për ta ripërdorur një ish-objekt në qytet si qendër për kujdesin dhe strehimin e viktimave të

[202] Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Drejtësisë, Udhëzim Administrativ (MD) nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial, i nënshkruar nga Ministri i Drejtësisë më 13.02.2025, me Vendimin nr. 51/2025 të datës 13.02.2025, veçanërisht neni 14 dhe Shtojca 4.

dhunës në familje.[203] Strehimorja u përurua zyrtarisht më 21 maj 2026.[204] Gjatë përurimit, Presidentja në detyrë e Kosovës deklaroi se çelësat e strehimores i ishin dorëzuar Ministrit të MPFVLÇ-së, në mënyrë që objekti të vihej në shërbim të atyre që kanë nevojë për siguri, kujdes dhe dinjitet. Asnjë informacion i mëtejshëm për funksionimin, kapacitetin ose shërbimet e strehimores nuk është bërë publik. Megjithatë, deri në gusht të vitit 2026, strehimorja dukej se nuk kishte staf të punësuar dhe nuk ishte funksionale.

Për personat LGBTQI+ nuk është përcaktuar ndonjë mandat zyrtar dhe specifik i funksionimit. Ndonëse gratë lezbike, biseksuale dhe kuir mund të strehohen në strehimoret ekzistuese, duket se për to nuk ka shërbime specifike. Personat transgjinorë dhe interseks, si dhe burrat gej, nuk kanë në dispozicion asnjë shërbim strehimi. Pas zotimeve të mëparshme që nuk kishin rezultuar në një strehimore funksionale, Komuna e Prishtinës/Priština i njoftoi aktivistët/et për të drejtat e personave LGBTQI+ në vitin 2025 se synonte ta mbështeste hapjen e një strehimoreje për personat LGBTQI+ në Prishtinë, me një buxhet të vlerësuar prej 800.000 deri në 900.000 €.[205] Megjithatë, pavarësisht këtij zotimi, Komuna nuk e përfshiu strehimoren për LGBTQI+ në buxhetet e saj për vitin 2025 ose 2026. Ajo ka mbështetur dy njësi banimi, të trajtuara në kuadër të banimit social.

Të gjitha strehimoret mund dhe kanë strehuar fëmijë që kanë përjetuar forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht ata, nënat e të cilëve kanë përjetuar dhunë në familje. Megjithatë, praktika aktuale paraqet kufizime në akomodimin e nënave me djem mbi 12 vjeç. Strehimoreve u mungojnë infrastruktura dhe politikat për akomodimin e nënave së bashku me djemtë mbi 12 vjeç. KS-ja nuk u referohet shprehimisht strehimoreve për fëmijë, por përcakton se strehimoret në përgjithësi duhet të ofrojnë mbështetje të specializuar dhe hapësira miqësore për fëmijët. Përfaqësuesit/et e intervistuar/a të strehimoreve e theksuan rëndësinë e hapësirave të ndara dhe kujdesit të specializuar për fëmijët, i cili mund të dallojë në mënyrë thelbësore nga kujdesi që u ofrohet të rriturve. Fëmijëve zakonisht u nevojiten mbikëqyrje, trajtim dhe vëmendje shtesë. Kosova dikur kishte dy strehimore të dedikuara për fëmijët në Prishtinë dhe Prizren. Megjithatë, në vitin 2024, ato u mbyllën për shkak të financimit të pamjaftueshëm. Së fundmi, në Gjakovë u hap një strehimore e re për fëmijët pa kujdes prindëror, përfshirë fëmijët e keqtrajtuar, të abuzuar dhe të lënë pas dore, e cila udhëhiqet nga e njëjta OJQ që e menaxhon strehimoren e grave. Në vitin 2025, stafi i strehimores së grave punoi me rotacion ndërmjet dy objekteve.

Ndonëse ekzistojnë strehimore për fëmijët dhe viktimat e trafikimit, kjo llogaritje e kostove është përqendruar në strehimoret që u ofrojnë shërbime të rriturve dhe fëmijëve që i shoqërojnë dhe që kanë përjetuar dhunë në familje. Ajo nuk përfshin llogaritjen e kostove për strehimoret e fëmijëve ose strehimoret për viktimat e trafikimit. Duke pasur parasysh mandatet dhe grupet e tyre të ndryshme të synuara, kostot do të duhej të shqyrtoheshin përmes llogaritjeve të veçanta.

Kapacitetet për BPGj për shërbimin e specializuar

Në përputhje me praktikat më të mira të BPGj-së, Qeveria duhet të vlerësojë çdo vit kostot e ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse të strehimit, rehabilitimit dhe riintegrimit në përputhje me KS-në, duke siguruar ndarje të mjaftueshme buxhetore çdo vit. Intervistat vunë në pah se, deri më tani, Qeveria nuk i ka bazuar ndarjet buxhetore në përllogaritjet e kostove ose në diskutime të hollësishme me strehimoret lidhur me nevojat. Ishte e paqartë nëse zyrtarët/et financiarë/e dhe programorë/e në Ministrinë e Drejtësisë ose në komuna kanë

[203] Xhelal Sveçla, Facebook, 20 gusht 2024, qasur më 23 shkurt 2026.
[204] Presidenca e Republikës së Kosovës, U.D. Presidentja Haxhiu përuroi strehimoren e parë institucionale në veri, uebfaqja, qasur më 7 korrik 2026.
[205] Intervistë e RrGK-së me një aktivist për të drejtat e personave LGBTQI+, shtator 2025.

punuar së bashku gjatë proceseve buxhetore apo nëse ZBGj-të ose ekspertët/et janë angazhuar në planifikimin buxhetor për buxhetim më të saktë të shërbimeve. Strehimoret raportuan se nuk ishin konsultuar në proceset buxhetore komunale ose të ministrisë, gjë që tregon koordinim të kufizuar në buxhetim.[206]

RrGK-ja realizoi një përllogaritje të hollësishme të kostove të nevojave të strehimoreve në vitin 2012.[207] ABGj-ja më pas zhvilloi një model të përllogaritjes së kostove të bazuar në standarde dhe të përgjegjshëm gjinor, për t'i vlerësuar si kostot fillestare, ashtu edhe kostot vjetore operative për strehimoret, duke përfshirë stafin, infrastrukturën, shërbimet dhe analizën sociale kosto-përfitim, për ta udhëzuar buxhetimin e qëndrueshëm shumëvjeçar në përputhje me detyrimet e KS-së.[208] ABGj-ja e përdori këtë model për të realizuar një përllogaritje të kostove në vitin 2019. Ishte e paqartë nëse Qeveria e përdori metodologjinë e ABGj-së për llogaritjet e ardhshme të kostove. Megjithatë, fakti se buxhetet për strehimoret zakonisht përfshinin shuma të përgjithshme të ndara ndërmjet disa ofruesve të shërbimeve, dhe jo vetëm strehimoreve, duket se tregon se buxhetimi nuk bëhej bazuar në dëshmi për kostot. Në vitin 2026, me mbështetjen e UNICEF-it, Ministria e sapoformuar për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ) ishte në proces të hartimit të një modeli për llogaritjen e kostove për të gjitha shërbimet sociale, përfshirë strehimoret, një proces që ky hulumtim synonte ta mbështeste me të dhëna.

Ndërkohë, disa punonjës/e të strehimoreve kanë ndjekur trajnime për BPGj-në dhe kanë njohuri bazë për mënyrën e buxhetimit të shpenzimeve të tyre. Megjithëse kapacitetet ndryshojnë nga njëra strehimore te tjetra, historikisht ato kanë pasur prirje të përdorin buxhetimin e bazuar në projekte: buxhetimin për një projekt të vetëm në një periudhë të caktuar, në vend të hartimit të një buxheti vjetor për nevojat e tyre të përgjithshme. Strehimoret rrallë e kanë zbatuar BPGj-në në punën e tyre, duke përdorur analizë gjithëpërfshirëse të shpenzimeve të kaluara për të siguruar informacion për planifikimin e ndarjeve të ardhshme buxhetore.

Prandaj, kapacitetet e Qeverisë dhe OJQ-ve për një BPGj të bazuar në dëshmi mbeten të kufizuara, gjë që mund të pengojë dhe e ka penguar parashikimin e buxheteve të sakta për të siguruar informacion për buxhetimin shtetëror për shërbimet e specializuara të strehimoreve.

Të dhënat për përfituesit/et dhe ndikimet

Tabela 24. Viktimat e pretenduara të dhunës në familje të raportuara në polici sipas Ministrisë së Drejtësisë

Viti	Burra	Gra	Totali
2019	386	1.592	1.978
2020	465	1.636	2.101
2021	500	1.986	2.486
2022	523	2.294	2.817
2023	597	2.120	2.717
2024	603	2.385	2.988
2025	699	2.137	2.836

LBGj-ja kërkon që të gjitha institucionet të mbledhin të dhëna të ndara sipas gjinisë.[209] Të dhënat e Policisë së Kosovës për rastet e pretenduara të raportuara të dhunës në familje kanë treguar rritje mjaft të qëndrueshme të rasteve të raportuara, të cilat prekin kryesisht gratë. Tabela 24 ilustron numrin e rasteve të dhunës në familje që prekin gratë dhe burrat,

[206] Intervistë e RrGK-së me një përfaqësues/e të strehimores, qershor 2025.
[207] RrGK, *Me çfarë çmimi? Alokimet Buxhetore për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë*, 2012.
[208] ABGj, Udhëzuesi për Buxhetimin Operacional dhe Projektimin e Strehimoreve në Kosovë, 2021.
[209] LBGj, neni 5.

bazuar në të dhënat e Ministrisë së Drejtësisë. Vlen të theksohet se këto të dhëna dallojnë pak nga ato që Policia e Kosovës i ka ofruar RrGK-së, dhe mbetet e paqartë se cilat janë më të sakta.

Në kuadër të rolit të saj koordinues, Ministria e Drejtësisë e mirëmban Bazën e të Dhënave për Identifikimin e Rasteve të Dhunës në Familje. Duke e mbuluar periudhën nga viti 2019 deri në vitin 2025, baza e të dhënave deri më tani përfshin rastet e dhunës në familje, përfshirë sulmet seksuale brenda familjeve, urdhrat e lëshuar për mbrojtje emergjente (Tabela 25), numrin e grave dhe fëmijëve në strehimore (Tabela 26), kryesit dhe viktimat sipas moshës, përkatësisë etnike dhe gjinisë, si dhe rastet e raportuara në polici.[210] Të dhënat e ndara sipas moshës (Tabela 27) dhe përkatësisë etnike (Tabela 28) janë në dispozicion për periudhën 2023–2025. Të dhënat për aftësinë e kufizuar ose vendndodhjen gjeografike nuk janë në dispozicion. Po ashtu, nuk ishin në dispozicion të publikut të dhëna të ndara sipas *gjinisë dhe* moshës ose përkatësisë etnike. Institucionet janë përballur me sfida në mirëmbajtjen e të dhënave kaq të hollësishme.

Tabela 25. Rastet e dhunës në familje, sulmet seksuale dhe urdhrat për mbrojtje emergjente sipas Ministrisë së Drejtësisë

Viti	Dhuna në familje	Sulmet seksuale brenda familjeve	Urdhrat për mbrojtje emergjente nga policia
2019	1.915	2	
2020	2.069	3	
2021	2,456	4	
2022	2,764	4	
2023	2.638		122
2024	2,959		122
2025	2.815	4	93

Tabela 26. Gratë dhe fëmijët e strehuar sipas Ministrisë së Drejtësisë

Viti	Gra	Fëmijë	Totali
2023	286	334	620
2024	223	260	483
2025	160	181	341

Tabela 27. Viktimat e dhunës në familje sipas grupmoshës

Viti	0-18	18-20	20-30	30-40	40-50	50-60	60-70	70-80	80+
2023	178	153	597	688	498	273	209	93	26
2024	220	127	785	737	529	331	181	61	17
2025	216	163	669	630	539	324	190	81	24

Tabela 28. Viktimat e dhunës në familje sipas përkatësisë etnike

Viti	Shqiptare	Serbe	Boshnjake	Turke	Malazez	Goran	Rome	Ashkali
2023	2.305	113	40	15	1	7	57	108
2024	2.577	125	19	12	0	7	75	127
2025	2.440	101	17	18	0	10	54	109

Vlen të theksohet se sistemi shtetëror gjurmon vetëm rastet e dhunës në familje dhe ende nuk është përditësuar në përputhje me LDhBGj-në për të gjurmuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore. Për pasojë, strehimoret nuk mund t'i fusin këto raste në këtë bazë të dhënash, e as rastet që nuk janë referuar zyrtarisht nga shteti. Kjo bën që të dhënat të

[210] Republika e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, Baza e të Dhënave për Identifikimin e Rasteve të Dhunës në Familje, qasur më 3 shtator 2025.

paraqesin një nënvlerësim të numrit të përfituesve të shërbimeve të strehimit, gjë që mund të çojë në llogaritje të pasakta buxhetore përkundrejt nevojave dhe përdorimit real të shërbimeve.

Regjistrat e strehimoreve tregojnë se ato kanë asistuar dukshëm më shumë raste sesa ato të regjistruara zyrtarisht nga Ministria e Drejtësisë (Tabela 29).[211] Strehimoret disponojnë bazat e tyre të brendshme të të dhënave për gjurmimin e përfituesve (Tabela 30).[212] Të dhënat janë të ndara sipas gjinisë, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar dhe moshës. Numri i rasteve ka ndryshuar nga viti në vit dhe ndërmjet strehimoreve, me një mesatare prej 680 rastesh në total për vit gjatë periudhës 2021–2025. Të dhënat nga shërbimet e mëparshme dëshmojnë se strehimoret duhet të jenë të gatshme për një numër mjaft të luhatshëm personash që kërkojnë ndihmë. Përveç akomodimit, strehimoret ofrojnë shërbime edhe për personat që kërkojnë ndihmë gjatë ditës, përfshirë këshillimin, ndihmën juridike, fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve. Edhe këto shërbime kërkojnë kohë dhe burime shtesë.

Tabela 29 paraqet numrin e grave dhe fëmijëve të strehuar, si dhe numrin e atyre që kanë marrë shërbime nga secila strehimore ndër vite. Ajo nuk përfshin të dhëna nga strehimorja për personat e trafikuar ose nga OPS-ja e menaxhuar nga Qeveria, pasi këto entitete nuk ofruan të dhëna. Në disa raste, gratë mund t'i kenë marrë të dyja llojet e shërbimeve. Strehimorja e Prishtinës në përgjithësi ka akomoduar numrin më të madh të rasteve, me gjasë për shkak të popullsisë më të madhe. ndërkohë që strehimorja e Gjilanit ka ofruar shërbime për një numër dukshëm më të madh rastesh krahasuar me strehimoret e tjera.

Tabela 29. Gratë dhe fëmijët e strehuar dhe që kanë marrë shërbime nga strehimoret

Strehim-orja	2021	2021	2022	2022	2023	2023	2024	2024	2025
	Të strehuar/a	Shërbim-e	Të strehuar/a	Shërbim-e	Të strehuar/a	Shërbim-e	Të strehuar/a	Shërbim-e	Të strehuar/a
Ferizaj	55	32	81	43	75	27	45	18	40
Gjakovë	113		172		135		145		85
Gjilan	71	350	66	329	94	332	76	346	73
Mitrovicë	67		150		97		65		72
Novobërdë	20	32	38	51	39	52	23	61	23
Pejë	66	66	117	117	98	98	64	64	67
Prishtinë	132	53	171	46	141	31	149	38	82
Prizren	53	53	55	55	45	45	57	57	70
Gjithsej	**577**	**586**	**850**	**641**	**724**	**585**	**624**	**584**	**624**

Tabela 30. Numri mesatar i personave të strehuar

Strehimorja	2021	2022	2023	2024	2025	Mesatar
Ferizaj	55	81	75	45	40	59
Gjakova	113	172	135	145	85	130
Gjilan	71	66	94	76	73	76
Mitrovicë	67	150	97	65	72	90
Novobërdë	20	38	39	23	23	29
Pejë	66	117	98	64	67	82
Prishtinë	132	171	141	149	82	135
Prizren	53	55	45	57	70	56
Gjithsej	**577**	**850**	**724**	**624**	**624**	**680**

[211] Ibid.

[212] Të dhënat që strehimoret ia kanë ofruar RrGK-së, të publikuara në *Zero Tolerancë? Monitorimi i Reagimit Institucional ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë*, 2024.

Ndonëse numri i rasteve ndryshon në mënyrë të paparashikueshme, të dhënat e mëparshme mund të shërbejnë si bazë për të parashikuar numrin e rasteve në të ardhmen. Siç tregon Tabela 30, strehimoret mund të presin mesatarisht 680 gra dhe fëmijë për t'i strehuar në vitet në vijim, megjithëse ky numër mund të rritet me përmirësimin e raportimit. Vlen të theksohet gjithashtu se ekzistojnë mundësi që strehimoret t'ia referojnë rastet njëra-tjetrës kur arrijnë kapacitetin maksimal, pasi disa prej tyre historikisht kanë pasur më pak përfitues dhe kanë hapësira të lira. Në praktikë, të mbijetuarat/it gjithashtu mund të transferohen ndërmjet strehimoreve pas periudhës standarde gjashtëmujore të qëndrimit të përcaktuar në rregulloret e brendshme, duke siguruar vazhdimësinë e akomodimit dhe menaxhimit të rasteve kur nevojitet strehim i mëtejshëm.

Tabela 31. Kohëzgjatja mesatare e qëndrimit në strehimore në ditë

Strehimorja	2023	2024	2025	Mesatar
Prishtinë	48	30	32	37
Prizren		16	10	13
Mitrovicë	45	31	20	32
Pejë	24	28	25	26
Mesatar	**39**	**26**	**22**	**29**

Kohëzgjatja e qëndrimit varet nga rrethanat specifike të secilit/ës përfitues/e dhe mund të variojë nga një ditë deri në gjashtë muaj. Bazuar në të dhënat e ofruara nga katër strehimore, përfituesit/et kanë qëndruar në strehimore mesatarisht për 29 ditë. Të dhënat nga strehimoret e tjera dhe gjurmimi i vazhdueshëm i kohëzgjatjes së qëndrimit nga ana e tyre mund të shërbejnë për të parashikuar shkallën e shfrytëzimit të kapaciteteve në të ardhmen dhe kostot përkatëse.

Asnjë hulumtim i njohur nuk e ka shqyrtuar ndikimin e shpenzimeve shtetërore te përfituesit/et.

Kërkesa për shërbime

Përveç nevojës për t'i përmbushur standardet minimale të KS-së, ecuria e mëparshme e shfrytëzimit të strehimoreve mund të shërbejë si tregues i kërkesës në të ardhmen, e cila vlerësohet në të paktën 612 raste në vit. Duke marrë parasysh rritjen e përgjithshme të rasteve të raportuara në polici (Tabela 16), kërkesa për shërbimet e strehimoreve mund të rritet në të ardhmen. Përfaqësuesit/et e strehimoreve të intervistuar/a nga RrGK-ja parashikuan një rritje të numrit të përfituesve gjatë tri viteve të ardhshme. Arsyet e tyre ndryshonin. Njëri/a prej tyre theksoi se kërkesa pritet të shtohet çdo vit për shkak të nevojës në rritje dhe ngritjes së kostos së jetesës, gjë që mund ta bëjë të papërballueshme për gratë që jetojnë vetëm që të gjejnë strehim. Një tjetër u shpreh se rritja e vetëdijes së grave për të drejtat e tyre mund të kontribuojë në shtimin e vazhdueshëm të raportimit të dhunës dhe në përdorimin e shërbimeve të strehimit. Duke pasur parasysh synimet e Qeverisë që ngritja e vetëdijes ta rrisë raportimin,[213] ekzekutivi duhet të shqyrtojë mundësinë e buxhetimit për 700 përfitues/e, për të garantuar ndarje të mjaftueshme të burimeve për këtë shërbim të specializuar.

Të 10 strehimoret ekzistuese funksionojnë 24 orë në ditë/7 ditë në javë. Në total, ato mund të akomodojnë në mënyrë të rehatshme 135 të rritur dhe katër fëmijë. Për më tepër, ato theksuan se në situata emergjente mund të strehojnë edhe 12 gra dhe fëmijë të tjerë për periudha të shkurtra kohore, çka do të thotë se kapaciteti total mund të arrijë deri në 151 gra

[213] SKDhG, Objektivi Strategjik I, "Identifikimi dhe Parandalimi i Dhunës përmes Edukimit dhe Ngritjes së Vetëdijes", f. 40.

dhe fëmijë. Ndërkohë, strehimoret disponojnë 26 dhoma familjare, të përkufizuara si hapësira të veçanta për një nënë dhe fëmijët e saj (Tabela 32).[214] Strehimorja e Ferizajt aktualisht nuk ka dhomë familjare, por pritet që kjo strehimore së shpejti të zhvendoset në një lokacion tjetër.

Tabela 32. Kapaciteti aktual i shtretërve dhe dhomave familjare të strehimoreve në Kosovë

Strehimorja	# i shtretërve për të rritur	# i shtretërve për fëmijë	Shtretërit emergjentë	Numri i përgjithshëm i shtretërve	Nr. i dhomave familjare
Ferizaj	15			15	0
Gjakovë	15		5	20	5
Gjilan	15			15	5
Novo Bërdë	12	2 (foshnje)	3	15	3
Pejë	16			16	3
Prishtinë	20	2		22	
Prizren	14		+	14+	4
Mitrovicë e Jugut	20		4	24	4
MVPT	8			8	2
Totali	**135**	**4**	**12**	**141**	**26**

Neni 23 kërkon strehimore të përshtatshme dhe të qasshme në numër të mjaftueshëm për të ofruar akomodim të sigurt dhe për t'iu qasur në mënyrë proaktive viktimave, veçanërisht grave dhe fëmijëve të tyre. Në kuadër të KS-së, Këshilli i Evropës e përdor një vendstrehim familjar për çdo 10.000 banorë si tregues të mjaftueshmërisë dhe jo si kërkesë detyruese. Vendstrehimet familjare synojnë të ofrojnë një mjedis gjithëpërfshirës mbrojtjeje dhe mbështetjeje për të mbijetuarat/it dhe fëmijët e tyre, dhe jo thjesht kapacitete shtesë të shtretërve. Ato duhet të përfshijnë masa për mbrojtjen e fëmijëve, hapësira miqësore për fëmijët, mbështetje psikosociale dhe të përshtatshme për moshën, privatësi dhe mbrojtje nga ritraumatizimi, vazhdimësi të arsimimit kur është e nevojshme, staf të mjaftueshëm dhe koordinim me sistemet për mbrojtjen e fëmijëve.

LDhBGj-ja rithekson se "organizimi i strehimoreve duhet të bëhet në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës (1/10.000 banorë)".[215] Në Kosovë, ky numër mbetet larg nën standardet e KS-së. Kosova duhet të krijojë edhe 134 vendstrehime të reja familjare në komunat në vijim ose në afërsi të tyre, për të siguruar një shtrirje dhe disponueshmëri të përshtatshme gjeografike të shërbimeve.

[214] Të dhënat i janë ofruar RrGK-së nga strehimoret. Pavarësisht disa përpjekjeve, OPS-ja nuk iu përgjigj kërkesës për intervistë ose të dhëna, prandaj nuk ka informacion për kapacitetin e saj.

Tabela 33. Vendstrehimet familjare të nevojshme sipas komunës, bazuar në kërkesat e KS-së

Komuna (Sipas madhësisë)	Popullsia e përgjithsh-me	% e popullsisë së Kosovës	Vendstrehimet e nevojshme familjare	Vendstrehimet aktuale familjare	Vendstreghimet që duhet të krijohen
Prishtinë	227.154	14.1%	23	0	23
Prizren	148.202	9.2%	15	4	11
Ferizaj	109.264	6.8%	11	0	11
Gjilani	83.576	5.2%	8	5	3
Gjakovë	79.480	4.9%	8	5	3
Podujevë	72.735	4.5%	7		7
Mitrovicë	67.900	4.2%	7	4	7
Fushë Kosovë	66.070	4.1%	7		7
Vushtrri	62.559	3.9%	6		6
Lipjan	55.021	3.4%	6		6
Pejë	53.620	3.3%	5	3	2
Suharekë	46.228	2.9%	5		5
Gllogoc (Drenas)	48.361	2.6%	5		5
Malishevë	43.888	2.3%	4		
Rahovec	41.595	2.8%	4		4
Skënderaj	40.664	2.6%	4		
Kamenicë	36.170	2.2%	4		4
Viti	35.566	2.3%	3		
Kaçanik	33.572	2.1%	3		3
Istog	33.334	2.1%	3		3
Klinë	30.503	2.0%	3		
Dragash	29.023	1.8%	3		3
Deçan	27.979	1.7%	3		3
Obiliq	25.342	1.6%	3		3
Shtime	24.460	1.5%	2		2
Graçanicë	17.907	1.1%	2		2
Leposaviq	12.087	0.7%	1		1
Junik	3.900	0.2%	0		0
Shtërpcë	10.870	0.7%	1		1
Hani i Elezit	8.712	0.5%	1		1
Mitrovicë e Veriut	7.976	0.5%	1		1
Mamushë	5.649	0.4%	1		1
Novo Bërdë	4.493	0.3%	0	3	0
Zubin Potok	3.158	0.2%	0		0
Kllokot	3.053	0.2%	0		0
Zveçan	2.877	0.2%	0		0
Ranillug	2.476	0.2%	0		0
Partesh	2.296	0.1%	0		0
Gjithsej	**1.536.137**	**100%**	**159**	**21**	**134**

Bazuar në madhësinë e popullsisë, komunën dhe shpërndarjen gjeografike, Tabela 34 parashikon se ku nevojiten vendstrehime të tjera familjare dhe strehimore shtesë, në përputhje me kërkesat e KS-së. Kolona e popullsisë së mbuluar tregon totalin e banorëve që i

shërben secila strehimore nëpër komuna, ndërsa kapaciteti i nevojshëm përllogaritet në bazë të popullsisë së shërbyer. Vlen të theksohet se rastet mund të referohen edhe ndërmjet strehimoreve për të ofruar mbrojtje dhe siguri për përfituesit.

Tabela 34. Lokacionet e propozuara të strehimoreve dhe kapacitetet e dhomave në përputhje me kërkesat e KS-së

Lokacioni i strehimores	Komunat që do të shërbehen	Popullsia e përgjithshme e shërbyer	Kapaciteti aktual	Vendet shtesë të nevojshme	Kapaciteti i përgjithshëm i nevojshëm
Prishtinë		227.154	0	23	23
Prizren	Mamushë, Dragash	182.874	4	14	18
Ferizaj[216]	Kaçanik, Shtime, Hani i Elezit, Shtërpcë	162.418	0	16	16
Gjilan	Ranillug, Partesh, Kllokot, Viti	126.967	5	8	13
Gjakovë	Rahovec, Junik, Deçan	152.954	5	10	15
Mitrovicë[217]	Vushtrri, Skenderaj	171.123	4	13	17
Pejë	Istog, Klinë	117.457	3	9	12
Mitrovicë e Veriut	Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan	26.098	0	3	3
Novobërdë	Kamenicë, Graçanicë	58.570	3	3	6
Fushë Kosovë	Drenas (Gllogoc), Obiliq	139.773	0	14	14
Suharekë	Malishevë	90.116	0	9	9
Podujevë		72.735	0	7	7
Lipjan		55.021	0	6	6

Kjo tregon se strehimoret duhet të zgjerohen në Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë, Pejë, Mitrovicë të Veriut dhe Novobërdë. Strehimore të reja duhet të themelohen edhe në Fushë Kosovë, Suharekë, Podujevë dhe Lipjan. Në disa vende mund të ketë nevojë edhe për themelimin e më shumë se një strehimoreje, si në Prishtinë. Ndonëse KS-ja nuk përcakton nëse një strehimore e vetme mund të mbështesë një numër maksimal dhomash familjare, kufizimet infrastrukturore dhe të burimeve njerëzore mund ta vështirësojnë mbështetjen e 23 dhomave familjare në një strehimore të vetme. Strehimoret mund të zgjerohen ose ndërtohen përmes një qasjeje graduale që përfshin bashkëpunimin ndërmjet komunave dhe MPFVLÇ-së. Aty ku tashmë ekzistojnë strehimore, mund të shqyrtohet rritja e numrit të vendstrehimeve familjare përmes investimeve infrastrukturore në objektet ekzistuese. Nëse kjo nuk është e mundur, komunat mund të identifikojnë prona të tjera komunale që mund të renovohen dhe të buxhetojnë renovimin e tyre. Në komunat ku nuk ekzistojnë strehimore, komunat mund t'i shqyrtojnë pronat e mundshme komunale që mund të renovohen dhe të buxhetojnë renovimin e tyre. Meqenëse strehimoret do të ofrojnë shërbime ndërkomunale, MPFVLÇ-ja gjithashtu mund të kontribuojë në investimet infrastrukturore. MPFVLÇ-ja gjithashtu mund të mbështesë kostot operative duke pasur parasysh funksionin e tyre ndërkomunal. Të gjitha strehimoret mund të themelohen

[216] Një strehimore e re ishte në ndërtim e sipër në Ferizaj në vitin 2026 dhe nuk është pasqyruar këtu. Informacioni për numrin e vendstrehimeve familjare nuk ishte në dispozicion.

[217] Një strehimore e re është planifikuar të përfundojë dhe të hapet në Mitrovicë në vitin 2026. Zyrtarët deklaruan se ajo është në përputhje me KS-në. Informacioni për numrin e dhomave familjare që ka nuk ishte në dispozicion, prandaj ky informacion nuk është përfshirë.

gradualisht gjatë disa viteve, duke u dhënë përparësi komunave ku ekziston kërkesa më e madhe për shërbime, bazuar në të dhënat e policisë për rastet e raportuara sipas komunës.

Në përputhje me kriteret e KS-së, strehimoret duhet të jenë të qasshme për gra që flasin gjuhë të ndryshme dhe për gra me aftësi të kufizuara. Përdorimi i mëparshëm i shërbimeve nga grupet me nevoja specifike lidhur me gjuhën ose aftësinë e kufizuar mund të ndihmojë në përllogaritjen e kostove. Megjithatë, Kosova aktualisht nuk mban të dhëna që do ta mundësonin këtë. Shqipja, serbishtja dhe anglishtja zakonisht janë gjuhët që përdoren më së shumti nga përfituesit/et. Shumica e strehimoreve mund të ofrojnë shërbime në këto gjuhë.[218] Për gjuhët e tjera, në kuadër të përllogaritjes së kostove është marrë parasysh një buxhet i vogël për kontraktimin e shërbimeve të përkthimit.

Disa përfaqësues/e të strehimoreve theksuan nevojën urgjente për themelimin e një strehimoreje ose objekti të specializuar për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore me probleme të shëndetit mendor.

Strehimoret mendonin se nuk ishin të pajisura siç duhet në aspektin ligjor, profesional, financiar dhe infrastrukturor për t'i akomoduar të mbijetuarat/it me nevoja komplekse psikiatrike. Megjithatë, në mungesë të institucioneve të specializuara, shpesh pritet që ato ta bëjnë këtë. Një drejtor/e strehimoreje shpjegoi:

> Nuk mund të ofrojmë asgjë përveç ushqimit dhe akomodimit. Përpiqemi, por kjo nuk mjafton. Këto raste janë shumë sfiduese për ne, veçanërisht sepse, për shkak të mungesës së alternativave të realizueshme, ato zakonisht qëndrojnë më gjatë në strehimore. Aktualisht i kemi dy raste të tilla. Njëra prej tyre, një grua e re me vështirësi në zhvillim dhe probleme serioze të shëndetit mendor, është me ne që pesë vjet. Para tri vitesh u përpoqëm ta organizonim transferimin e saj në institucionin e shëndetit mendor në Shtime. Kur na thanë ta dërgonim atje, mu thye zemra. Ajo përjeton episode dhe nganjëherë bëhet agresive, gjë që i shqetëson të tjerat. Një grua tjetër, rreth 50-vjeçe, gjithashtu duhej të transferohej në Shtime pas një vendimi të Ministrisë, por në institucion nuk kishte vende të lira. Tani na mbetet vetëm të presim. Nuk e kuptoj se si merren këto vendime kur nuk ka hapësirë. Nuk shoh kurrfarë bashkërendimi.[219]

Një përfaqësues/e tjetër i/e strehimores theksoi se, megjithëse rrallë i refuzojnë të mbijetuarat/it, një herë u ishte dashur ta refuzonin një rast për shkak të gjendjes së rëndë të shëndetit mendor të të mbijetuarës/it, e cila përbënte rrezik për personat e tjerë në strehimore. Pa kujdes të kualifikuar psikologjik, hapësirë të veçantë banimi dhe kushte të përshtatshme, një banor/e i/e strehimores me probleme të shëndetit mendor mund të ndikojë në mirëqenien e grave dhe fëmijëve të tjerë të strehuar.

KS-ja nuk e parasheh themelimin e një strehimoreje të specializuar për të mbijetuarat/it me probleme të shëndetit mendor; përkundrazi, ajo argumenton se strehimoret duhet të sigurojnë se kanë burime të mjaftueshme për trajtimin e rasteve të tilla.[220] Kjo do të ishte në përputhje me KDPAK-në e OKB-së, e cila parasheh ndryshimin e kushteve shoqërore drejt integrimit dhe fuqizimit.[221] Në propozimet e kostove është marrë parasysh nevoja për zgjerimin e hapësirës në dispozicion, në mënyrë që të ketë dhoma të veçanta familjare për asistimin e rasteve të tilla. Në përllogaritjen e kostove janë marrë parasysh kostot e shërbimeve profesionale psikologjike dhe të trajnimit shtesë të stafit të strehimoreve për

[218] Intervista të RrGK-së me përfaqësuesit/et e strehimoreve, 2026. Vetëm strehimorja në Mitrovicë e theksoi nevojën për përkthim në gjuhën angleze.
[219] Intervistë e RRGK-së, 2025.
[220] Këshilli i Evropës, Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2011.
[221] OKB, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, miratuar më 13 dhjetor 2006, hyri në fuqi më 3 maj 2008.

mënyrën e asistimit të personave me sfida të shëndetit mendor dhe fizik, për të siguruar që stafi i strehimoreve të jetë i kualifikuar për të ofruar shërbime në përputhje me kërkesat e KS-së.

Buxhetet dhe shpenzimet 2022–2026

Tabela 35. Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë për ofruesit e licencuar të shërbimeve sociale

Viti	Buxheti total	Strehimoret
2023	1.500.000 €	617.000 €
2024	1.500.000 €	667.000 €
2025	2.500.000 €	906.000 €
2026	2.500.000 €	815.000 €

Që nga viti 2022, Ministria e Drejtësisë e ka rritur buxhetin për ofruesit e shërbimeve sociale (shih Tabelën 35).[222] Këto mjete shpërndahen përmes një thirrjeje publike vjetore për ofrues të ndryshëm të shërbimeve sociale, përfshirë strehimoret, në kuadër të linjës buxhetore "Shpenzimet themelore të strehimoreve", bazuar në kriteret e vendosura dhe vlerësimin e aplikacioneve nga një komision vlerësues. Thirrja publike për mbështetje financiare nga fondet publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare shpallet në bazë të: 1) neneve 12 dhe 20 të Rregullores MF nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve; dhe 2) Vendimit nr. 19/2025 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë. Mjetet në këtë linjë buxhetore nuk u ndahen vetëm strehimoreve, por mbështesin edhe ofruesit e tjerë të licencuar të shërbimeve sociale dhe familjare. Në vitin 2025, gjithsej 49 OJQ përfituan financim përmes kësaj thirrjeje publike. Tabela # paraqet mjetet e ndara për strehimoret. Asnjë raport zyrtar i Qeverisë për shpenzimet e strehimoreve nuk ishte në dispozicion.

OPS-ja financohet përmes buxhetit të Qeverisë. Qeveria ndau 100.000 € në vitin 2022, 75.000 € në vitin 2023 dhe 150.000 € në vitin 2024.[223] Nuk kishte informacion publik në dispozicion lidhur me shpenzimet.

Qeveria gjithashtu ka buxhetuar investime infrastrukturore që lidhen me shërbimet e strehimoreve (Tabela 36). Së pari, për strehimoren e re të grave në Ferizaj u buxhetuan 80.000 € në buxhetin e vitit 2023. Për vitin 2024 u ndanë 30.000 € shtesë dhe për vitin 2025 u ndanë 50.000 €. Të gjitha këto mjete u buxhetuan në kuadër të linjës buxhetore "Financimi i Investimeve Kapitale Komunale" që lidhet me shërbimet e kujdesit primar shëndetësor, të financuara nga granti qeveritar për komunat.[224] Buxheti i së njëjtës strehimore më vonë u zvogëlua në 70.000 € në buxhetin e vitit 2024, prej të cilave 30.000 € janë ndarë për vitin 2025 dhe 40.000 € për vitin 2026. Megjithatë, kjo linjë buxhetore nuk u përfshi fare në buxhetin e vitit 2026.

Së dyti, Qeveria u zotua për ndërtimin e një shtëpie emergjente për mbrojtjen e fëmijëve në Nashec të Komunës së Prizrenit, e cila është buxhetuar në kuadër të linjës buxhetore të Shërbimeve Sociale dhe financohet përmes grantit qeveritar për komunat. Përfundimi pritet deri në vitin 2027. [225] Ky projekt paraqitet në buxhetin e vitit 2025 si investim kapital.

[222] Republika e Kosovës, Ligjet mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitet 2022–2026.
[223] Departamenti i Shtetit i SHBA-së, Raporti i vitit 2025 për Trafikimin me Persona: Kosova. Qasur më 7 gusht 2026.
[224] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023, 2023.
[225] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 08/L-332 mbi Ndarjen Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, 2025.

Së treti, Ministria e Drejtësisë gjithashtu investoi 640.000 € në strehimoren e Mitrovicës së Veriut, e cila u përurua zyrtarisht më 21 maj 2026. Megjithatë, mbetet e paqartë se nga cila linjë buxhetore është mbuluar ky shpenzim, pasi RrGK-ja nuk ka mundur ta gjejë atë në buxhetin e Kosovës.

Së katërti, ndonëse nuk u financua nga Qeveria, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) financoi një strehimore të re në Mitrovicë të Jugut. UNOPS-i i përfundoi punimet strukturore për këtë strehimore në vitin 2023. Ajo është projektuar për të akomoduar deri në 30 të mbijetuar/a, duke ofruar mjedis të sigurt dhe të mbrojtur. Me një sipërfaqe të përgjithshme prej 341 m², objekti do të ofrojë hapësira dhe shërbime thelbësore, si dhe hapësira të jashtme të dedikuara për aktivitete si kopshtaria dhe relaksimi. Megjithatë, deri në vitin 2026, strehimorja në Mitrovicë të Jugut vazhdonte ta përdorte objektin e vjetër me qira për të akomoduar të mbijetuarat/it, ndonëse planifikonte të zhvendosej.

Tabela 36. Përmbledhje e investimeve kapitale të buxhetuara për strehimoret 2022–2027

Organizata buxhetore	Emri i projektit	Linja buxhetore	Datat e zbatimit	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	Gjithsej
Komuna e Ferizajt	Ndërtimi i Strehimores për Gratë Viktima të Dhunës në Ferizaj	656730 Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	02.2024-10.2025				30.000	50.000			80.000
Komuna e Prizrenit	Ndërtimi i një shtëpie emergjente për mbrojtjen e fëmijëve – Nashec	755460 Shërbimet Sociale – 1040	05.2024-11.2027					155.000[226]	215.000	215.000	585.000
Komuna e Prishtinës	Ndërtimi i Strehimores për Personat LGBTI	616755 Shërbimet Sociale dhe Rezidenciale	01.2021-12.2024	300.000	300.000						300.000

Së pesti, Drejtoria e Mirëqenies Sociale e Komunës së Prishtinës planifikoi ndërtimin e një strehimoreje për personat LGBTIQ+ në vitin 2021. Për këtë strehimore u ndanë 300.000 € si në vitin 2021, ashtu edhe në vitin 2022.[227] Nga viti 2023 deri në vitin 2026, ky alokim nuk u pasqyrua më në buxhetin komunal.[228] Strehimorja ende nuk është ndërtuar. Meqenëse Qeveria nuk ka publikuar KASh-in që nga KASh-i 2025–2027, nuk ishte e mundur të shqyrtoheshin shpenzimet e planifikuara për periudhën 2028–2029.

Në përputhje me detyrimet e tyre ligjore,[229] komunat gjithashtu buxhetuan mbështetje për strehimoret duke përdorur buxhetet komunale. Tabela 37 përmban shumat e buxhetuara nga komunat që ofruan të dhëna. Komunat që nuk janë renditur nuk u janë përgjigjur kërkesave të RrGK-së për të dhëna, por kjo nuk e përjashton mundësinë që ato të kenë ndarë po ashtu fonde.

[226] Vazhdon nga buxheti i vitit 2024, megjithëse nuk është në këtë buxhet.
[227] Komuna e Prishtinës, Buxheti i Komunës së Prishtinës për Vitin 2021, 2021.
[228] Komuna e Prishtinës, Buxheti i Komunës së Prishtinës për Vitet 2023–2026.
[229] Republika e Kosovës, Ligji nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, 2024, neni 21.

Tabela 37. Buxhetet komunale për strehimoret, 2022–2025

Komuna (sipas madhësisë)	2022	2023	2024	2025	Gjithsej
Prishtinë	7.272 €	11.500 €	11.500 €	11.225 €	41.497 €
Suharekë	4.000 €	4.000 €	4.000 €	4.000 €	16.000 €
Fushë Kosovë	4.000 €	4.200 €	4.526 €	5.444 €	18.170 €
Obiliq	2.500 €		3.000 €	3.000 €	8.500 €
Dragash	1.230 €	1.700 €	1.700 €	1.230 €	
Hani i Elezit		500 €	500 €		
Totali	**17.772 €**	**20.200 €**	**23.526 €**	**23.669 €**	**84.167 €**

Strehimoret kanë përfituar gjithashtu mbështetje financiare nga donatorët, jashtë buxhetit të Qeverisë. Kjo tregon se kostot operative të strehimoreve ishin më të larta se fondet e alokuara nga Qeveria. Tabela 38 paraqet të ardhurat dhe shpenzimet e dy strehimoreve për vitin 2025[230]. Kjo dëshmon se Qeveria nuk ofron burime të mjaftueshme për të mbështetur të gjitha shërbimet e tyre.

Tabela 38. Të ardhurat dhe shpenzimet e strehimoreve në vitin 2025

Strehimorja	Të ardhurat	Shpenzime	Kontributi i Qeverisë	Kontributi i donatorëve
Gjakovë (2025)	265.819 €	190.402 €	102.000 €	119.549 €[231]
Pejë (2025)	146.604 €	146.604 €	102.000 €	29.399 €
Gjithsej	**412.423 €**	**337.006 €**	**204.000 €**	**148.948 €**

Kostot

Në këtë nënseksion paraqiten vlerësimet e kostove për strehimoret dhe shërbimet që ato ofrojnë për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore për periudhën 2026–2029. Sipas LDhBGj-së, "financimi dhe mbështetja buxhetore e ofruesve publikë dhe joqeveritarë do të bazohen në koston për njësi/klient, koston e standardeve minimale dhe koston e shpenzimeve operative për funksionimin e një qendre për mbrojtjen e viktimave të dhunës."[232] Projeksionet buxhetore bazohen në udhëzimet e ABGj-së për buxhetim,[233] praktikat më të mira të BPGj-së dhe udhëzimet e KS-së. Ato synojnë të shërbejnë si bazë për ndarjet e ardhshme të Qeverisë për shërbime strehimi të qasshme dhe të përqendruara te të mbijetuarat/it. Të dhënat mbështeten në intervistat me drejtorët e strehimoreve dhe zyrtarët financiarë për të kuptuar strukturat e tyre ekzistuese të financimit, nivelet e stafit dhe modelet e ofrimit të shërbimeve; dokumentet e tyre buxhetore, duke përfshirë shpenzimet historike (2022–2025) dhe kostot e projektuara për periudhën 2026–2028; si dhe hulumtimin e kostove të tregut. Në këtë nënseksion përshkruhet secili shpenzim, i përmbledhur në Tabelën 40. Gjithashtu, paraqitet një mostër buxheti për një strehimore, mbi bazën e së cilës llogaritet buxheti i përgjithshëm i nevojshëm për të gjitha strehimoret. Këto të dhëna janë përdorur për projektimin e kostove të ardhshme, duke synuar njëkohësisht harmonizimin e kostove ndërmjet strehimoreve, ndër të tjera në përputhje me kërkesat e KS-së për kualifikimet minimale, parimet e BE-së për pagë të barabartë për punë të barabartë dhe standardet minimale për strehimoret.[234] Projeksionet

[230] Strehimoret e tjera nuk ofruan të dhëna të plota.
[231] Shuma e përgjithshme përfshin 88.000 € të ndara për strehimoren e fëmijëve.
[232] Neni 24.
[233] ABGj, Buxhetimi operacional i strehimoreve në Kosovë dhe udhëzuesi i projektimit, 2021.
[234] Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Drejtësisë, Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial, nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Drejtësisë më 13.02.2025, me Vendimin nr. 51/2025 të datës 13.02.2025, veçanërisht neni 14 dhe Shtojca 4.

e kostove janë ndarë në kosto operative dhe kosto për klient, të cilat mblidhen së bashku për të nxjerrë kostot e përgjithshme.

Kostot operative të strehimoreve

Këto përfshijnë shpenzimet fikse mujore që bëhen pavarësisht numrit të të mbijetuarave/ve të strehuar. Kostot e burimeve njerëzore përfshijnë pagat e të gjithë personelit të përfshirë në ofrimin dhe menaxhimin e shërbimeve. Pagat janë përcaktuar duke përdorur koeficientët e pagave në sektorin publik të përcaktuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik. Gjithashtu janë marrë parasysh buxhetet e strehimoreve për periudhën 2023–2025, strukturat e stafit dhe numri mesatar i viteve të përvojës së punës për secilën pozitë. Në përllogaritje është përfshirë rritja prej 0.5% për çdo vit të përvojës së punës, e paraparë me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik. Orari i punës ndërmjet orës 22:00 dhe 06:00 konsiderohet punë nate dhe është aplikuar një kompensim shtesë prej 30%, siç parashihet me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik dhe Ligjin e Punës.

Drejtorët e strehimoreve mbikëqyrin menaxhimin e përgjithshëm të strehimores, duke përfshirë por pa u kufizuar në: mbikëqyrjen e stafit, ofrimin e shërbimeve, planifikimin strategjik, respektimin e kërkesave ligjore dhe të donatorëve, si dhe mirëmbajtjen e partneriteteve me institucionet e tjera për ofrimin efektiv të shërbimeve. Sipas koeficientëve të sektorit publik, pozita ekuivalente do të ishte "drejtor i institucionit" (p.sh., drejtor shkolle ose institucioni shëndetësor), me koeficient 8.3. Shumëzimi i koeficientit me pagën bazë (110 €) rezulton në pagë të përgjithshme bruto prej 913 €. Duke marrë parasysh numrin mesatar të viteve të përvojës së punës së drejtorëve të strehimoreve (22 vjet), është aplikuar shtesa prej 0.5% për çdo vit të përvojës së punës, duke arritur gjithsej 1.014 € në muaj, respektivisht 12.169 € në vitin 2026.[235] Duke marrë parasysh përvojën, ekspertizën, kualifikimet dhe konceptin e pagës së barabartë për punë të barabartë, për këtë pozitë duhet të buxhetohen më shumë mjete krahasuar me vitet e mëparshme.

Menaxherët mbështesin planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve, projekteve dhe veprimtarive të strehimoreve. Ata ndihmojnë në organizimin e punës, regjistrimin cilësor të të dhënave dhe raportimin për bazat e të dhënave të brendshme dhe ato qeveritare. Koeficienti i sektorit publik për pozitën e menaxherit është 7.3. Shumëzimi i tij me pagën bazë (110 €) rezulton në një pagë të përgjithshme bruto prej 803 € në muaj. Numri mesatar i viteve të përvojës së punës për këtë pozitë (19 vjet) është shumëzuar me 0.5% për çdo vit përvoje, duke arritur gjithsej 878 € në muaj, respektivisht 10.542 € në vitin 2026.

Menaxherët financiarë menaxhojnë veprimtaritë financiare të strehimoreve, duke përfshirë sigurimin e zbatimit të kornizës përkatëse ligjore që lidhet me menaxhimin e qëndrueshëm financiar, buxhetimin, mbajtjen e kontabilitetit, kryerjen e pagesave dhe raportimin financiar. Historikisht, disa zyrtarë financiarë kanë punuar me orar të plotë, ndërsa të tjerë janë angazhuar me orar të pjesshëm.[236] Koeficienti 5.7 i shumëzuar me pagën bazë (110 €) rezulton në pagë të përgjithshme bruto prej 627 € në muaj.[237] Është marrë parasysh numri mesatar i viteve të përvojës së punës (15 vjet), duke arritur gjithsej 673 € në muaj. Si pozitë me orar të pjesshëm (50%), paga bruto është 337 € në muaj, respektivisht 4.039 € në vitin 2026. Kjo është e ngjashme me nivelin ekzistues të pagës mesatare për këtë pozitë në strehimore.

---

[235] Bazuar në buxhetet vjetore të ofruara nga strehimoret, paga mesatare vjetore e drejtorëve të strehimoreve ishte rreth 9.000 €, që është më e ulët se paga e përcaktuar për pozitat ekuivalente sipas Ligjit për Pagat në Sektorin Publik.

[236] Në strehimoren e Novobërdës, kjo pozitë është me orar të plotë, pasi anëtari/ja e stafit kryen gjithashtu detyra administrative dhe operative që lidhen me menaxhimin dhe funksionimin e përgjithshëm të strehimores.

[237] Meqenëse Ligji për Pagat nuk përmban koeficient për këtë pozitë, është përdorur Rregullorja Komunale 97/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale (2025).

Punonjësit socialë të licencuar në strehimore ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë dhe menaxhim të rasteve për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë ndihmën psikosociale, mbështetjen për tejkalimin e traumës, vlerësimin e rrezikut, planifikimin e rasteve, qasjen në shërbimet thelbësore dhe ruajtjen dhe arkivimin e përshtatshëm dhe të sigurt të materialeve të menaxhimit të rasteve. Punonjësit socialë duhet të kenë përvojë profesionale, trajnim dhe licencat e kërkuara për ofrimin e shërbimeve të specializuara. Standardet zyrtare për strehimin rezidencial, veçanërisht Shtojca 4: Standardet minimale të cilësisë për shërbimet e kujdesit rezidencial në strehimore për viktimat e dhunës në familje, të dhunës me bazë gjinore, të trafikimit me qenie njerëzore apo të formave të tjera të dhunës,[238] i konsiderojnë punonjësit socialë pjesë të stafit profesional multidisiplinor që u ofron banorëve asistencë dhe shërbime të specializuara në bazë të nevojave të vlerësuara. Standardet e njohin punonjësin social si menaxher të rastit brenda strehimores. Secili/a kujdestar/e duhet të jetë përgjegjës/e për jo më shumë se gjashtë banorë. Për përllogaritjen e pagës është përdorur koeficienti 6,7, duke arritur gjithsej 737 €.[239] Duke marrë parasysh përvojën mesatare prej 14 vjetësh, paga është gjithsej 789 € në muaj, respektivisht 9.472 € në vitin 2026.[240] Për mbulimin e dy ndërrimeve gjatë ditëve të javës (6:00–15:00; 15:00–22:00) do të nevojiteshin dy punonjës socialë, me kosto të përgjithshme prej 18.944 €. Secilës strehimore i nevojitet një punonjës social për ndërrimin e natës gjatë javës, nga ora 22:00 deri në orën 06:00, i cili paguhet 30% shtesë për punën e natës, duke arritur gjithsej 1.026 € në muaj, respektivisht 12.314 € në vitin 2026. Meqenëse rastet shpesh paraqiten gjatë natës, prania e një punonjësi social me përvojë është e rëndësishme për menaxhimin cilësor të rasteve. Gjithashtu, nevojiten dy punonjës socialë për të punuar gjatë fundjavës në dy ndërrimet e ditës. Ata mund t'i zëvendësojnë edhe punonjësit e tjerë socialë gjatë festave, gjatë pushimit vjetor dhe pushimeve të tjera. Ata nuk do të punojnë me orar të plotë, por vetëm gjatë fundjavave dhe festave. Do të paguhen në bazë të orëve të realizuara, duke marrë parasysh pagesën për fundjavë dhe festa. Me pagesë 50% më të lartë për punën gjatë fundjavave dhe festave, paga për orar të plotë do të ishte 1.184 €, ndërsa për punën me orar të pjesshëm 592 €. Për një punonjës kjo arrin në 7.104 €, ndërsa për dy punonjës shuma e përgjithshme është 14.208 € në vitin 2026. Ngjashëm, strehimores i nevojitet një punonjës social për ndërrimet e natës gjatë fundjavës, si dhe për të mbuluar ndërrimet e natës të punonjësit tjetër social kur ai është në pushim. Kjo do të përfshinte kompensim shtesë prej 80% për punën gjatë fundjavës dhe natës, duke arritur gjithsej 1.421 € për punën me orar të pjesshëm. Kjo strukturë do të mundësonte mbulimin adekuat të ndërrimeve, duke respektuar njëkohësisht të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Deri më tani, strehimoret zakonisht kanë angazhuar psikologë si ekspertë me pagesë, duke përdorur tarifa për orë. Megjithatë, kjo mund të kushtojë shumë dhe ta pengojë qasjen e vazhdueshme të klientëve në trajtim të rregullt psikologjik individual dhe grupor. Për më tepër, punonjësit e tjerë të strehimores mund të përfitojnë nga mbikëqyrja dhe mbështetja psikologjike e psikologut të strehimores për parandalimin e rraskapitjes profesionale. Standardet minimale të cilësisë parashohin që strehimoret të kenë psikologë me pagesë. Prandaj, është buxhetuar një psikolog klinik në bazë të koeficientit (7), të shumëzuar me pagën bazë (110 €), duke arritur gjithsej 770 €. Psikologu/ja duhet të ketë trajnim dhe ekspertizë të specializuar në trajtimin e dhunës me bazë gjinore, prandaj duke pasur parasysh kriterin për së paku pesë vjet përvojë pune, paga mujore e parashikuar është 789 €, duke arritur gjithsej 9.471 € në vitin 2026.

---

[238] Ministria e Drejtësisë, Udhëzim Administrativ (MD) Nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial, 2025. Shtojca parasheh gjithashtu kujdestarë, por ky buxhet është planifikuar në mënyrë që punonjësit socialë të kualifikuar të shërbejnë si kujdestarë.

[239] Ligji për Pagat nuk përmban koeficient për punonjësit socialë.

[240] Strehimoret raportuan pagë mesatare prej 645 € në muaj, me ndryshime që pasqyrojnë dallimet në përvojën e të punësuarve.

Këshilltarët ose zyrtarët ligjorë u ofrojnë mbështetje të specializuar ligjore të mbijetuarave/ve që qëndrojnë në strehimore, përfshirë këshillimin ligjor, informacionin për të drejtat ligjore dhe mjetet juridike në dispozicion, ndihmën gjatë procedurave ligjore dhe referimin te institucionet përkatëse të ndihmës juridike dhe të drejtësisë. Roli i tyre mund të përfshijë mbështetjen e të mbijetuarave/ve për t'i kuptuar mundësitë e tyre ligjore, për të pasur qasje në masat mbrojtëse dhe mjetet e tjera juridike dhe për t'i ndjekur procedurat përkatëse administrative dhe gjyqësore. Ata mund të kontribuojnë me ekspertizë ligjore në menaxhimin individual të rasteve dhe ta mbështesin koordinimin me institucionet përkatëse të drejtësisë dhe ndihmës juridike. Strehimoret raportuan se përgjithësisht nuk e konsiderojnë të nevojshëm një këshilltar të posaçëm ligjor, pasi të mbijetuarat/it mund të kenë qasje në mbështetje ligjore përmes mbrojtësve të viktimave dhe shërbimeve të Ndihmës Juridike Falas. Strehimoret e lehtësojnë qasjen në ndihmë juridike gjatë orarit të rregullt ditor. Megjithatë, neni 22 i KS-së u kërkon shteteve të sigurojnë qasje në shërbime të menjëhershme, afatshkurtra dhe afatgjata të mbështetjes së specializuar për viktimat, ndërsa GREVIO e ka theksuar rëndësinë e qasjes në shërbime të specializuara, përfshirë këshillimin ligjor dhe përfaqësimin e interesave. Prandaj, një këshilltar i posaçëm ligjor mund të ofrojë mbështetje shtesë të specializuar brenda strehimoreve, veçanërisht për rastet që kërkojnë mbështetje ligjore më të përqendruar ose më komplekse. Personat në këtë pozitë duhet t'i plotësojnë kriteret e kërkuara për kualifikim profesional dhe licencim për ofrimin e shërbimeve ligjore. Koeficienti i sektorit publik për zyrtarët ligjorë (8.0), i shumëzuar me pagën bazë (110 €), rezulton në pagë të përgjithshme bruto prej 880 € në muaj. Duke marrë parasysh pesë vjet përvojë pune dhe ngarkesë pune prej 50%, paga e vlerësuar është 451 € në muaj, duke rezultuar në kosto vjetore prej 5.412 € në vitin 2026.

Infermierët e licencuar në strehimore ndihmojnë në mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së të mbijetuarave/ve duke ofruar kujdes themelor mjekësor, duke monitoruar shëndetin fizik dhe mendor dhe duke ofruar udhëzime për higjienën dhe mirëqenien e përgjithshme. Infermierët konsiderohen pjesë e stafit profesional multidisiplinor që u ofron banorëve asistencë dhe shërbime të specializuara bazuar në nevojat e tyre të vlerësuara, në përputhje me Standardet minimale të cilësisë. Koeficienti për infermier është 5.6. Shumëzimi i tij me pagën bazë (110 €) rezulton në pagë bruto prej 616 € në muaj. Duke marrë parasysh numrin mesatar të viteve të përvojës së punës për këtë pozitë (11 vjet), shuma e përgjithshme është 650 € në muaj. Kjo pozitë me orar të pjesshëm buxhetohet në masën 50%, gjithsej 325 € në muaj, respektivisht 3.899 € në vitin 2026. Shtojca 4 parasheh gjithashtu angazhimin e një mjeku të përgjithshëm me kontratë për ofrimin e mbështetjes mjekësore. Strehimoret më parë nuk kanë buxhetuar mjete për këtë shërbim, pasi zakonisht i kanë referuar klientët në institucionet publike shëndetësore ose spitale. Prandaj, ky shërbim nuk është përfshirë si linjë e veçantë buxhetore, por është marrë parasysh në kuadër të kostove mjekësore.

Stafi arsimor dhe kujdestarët janë përgjegjës për mbështetjen e kujdesit të përditshëm, sigurisë dhe zhvillimit të fëmijëve që qëndrojnë në strehimore. Roli i tyre përfshin ofrimin e veprimtarive edukative dhe rekreative, ndihmën me detyrat e shtëpisë dhe mësimin, si dhe mbështetjen e fëmijëve në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale brenda një mjedisi të sigurt dhe mbrojtës. Ata gjithashtu mund të japin këshilla për nevojat zhvillimore, mësimore dhe arsimore të fëmijëve, gjë që mbështet hartimin e dosjeve dhe planeve të menaxhimit të rasteve të fëmijëve. Si pjesë e ekipeve profesionale multidisiplinore të strehimoreve, ata u ofrojnë banorëve mbështetje dhe shërbime të specializuara bazuar në nevojat e tyre të vlerësuara, në përputhje me Standardet minimale të cilësisë. Personat në këtë pozitë duhet të plotësojnë kriteret e kërkuara për licencim profesional për ofrimin e këtyre shërbimeve. Koeficienti i sektorit publik për mësimdhënësit e shkollave fillore (5.6), i shumëzuar me pagën bazë (110 €), rezulton në pagë të përgjithshme bruto prej 616 € në muaj. Duke marrë parasysh numrin mesatar të viteve të përvojës së punës (tre vjet), paga është 625 € në muaj, respektivisht 7.503 € në vitin 2026.

Pozitat e personelit mbështetës, duke përfshirë mirëmbajtësit e higjienës, kuzhinierët, shoferët dhe rojet e sigurisë, luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e funksionimit efektiv, sigurisë dhe veprimtarisë së përditshme të strehimoreve rezidenciale. Mirëmbajtësit e higjienës janë përgjegjës për mbajtjen e pastërtisë, rendit dhe higjienës në tërë objektin, duke përfshirë dhomat e banorëve, hapësirat e përbashkëta dhe hapësirat e zyrave. Kuzhinierët janë përgjegjës për përgatitjen e ushqimeve ditore për banorët sipas nevojave të tyre. Historikisht, këto pozita nuk janë përfshirë në buxhetet e strehimoreve, pasi përfaqësuesit e strehimoreve deklaruan se i angazhojnë banorët në këto veprimtari si pjesë e aktiviteteve të rehabilitimit dhe fuqizimit, me qëllim të mbështetjes së autonomisë së tyre. Megjithatë, Standardet minimale të cilësisë i kërkojnë këto funksione.[242] Prandaj, propozohet një pozitë për Mirëmbajtës/e të Higjienës/Kuzhinier/e, por ajo mund të hiqet. Shoferët janë përgjegjës për transportimin e sigurt të të mbijetuarave/ve, stafit dhe mallrave për në strehimore dhe nga strehimorja, duke përfshirë shoqërimin e banorëve në vizita mjekësore, ligjore, arsimore ose në shërbime sociale. Gjatë periudhave kur nuk nevojiten shërbime të transportit, shoferët gjithashtu mund të ndihmojnë në mirëmbajtjen e strehimores. Rojet e sigurisë janë

Tabela 39. Kostot e pronësisë dhe qirasë së strehimoreve

Strehimorja	Lloji	Kostoja 2025
Prishtinë	Pronë komunale	0 €
Prizren	Pronë komunale	0 €
Ferizaj	Me qira	4.800[241] €
Gjilan	Pronë komunale	0 €
Gjakovë	Pronë vetanake	0 €
Mitrovicë	Me qira	7.735 €
Pejë	Pronë vetanake	0 €
Mitrovicë e Veriut	Pronë komunale	0 €
Novobërdë	Pronë komunale	0 €

përgjegjëse për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes, duke përfshirë mbrojtjen e banorëve, stafit dhe objekteve. Për këto tri pozita do të ishte përkatës koeficienti 3.9 i sektorit publik. Megjithatë, ato duhet të paguhen të paktën me pagën minimale.[243] Prandaj, për këto pozita është përllogaritur paga prej 500 € në muaj, duke rezultuar në pagë vjetore bruto prej 6.000 €.

Shpenzimet e akomodimit lidhen me sigurimin e kushteve të sigurta dhe të përshtatshme të jetesës për banorët e strehimoreve, gjë që është e nevojshme pavarësisht nivelit të shfrytëzimit të kapaciteteve. Kostot e objekteve të strehimoreve ndryshojnë (Tabela 39). Ndonëse disa i shfrytëzojnë pronat komunale pa pagesë, dy prej tyre kanë shpenzime të qirasë. Qiraja do të kërkojë financim derisa të përfundojnë pronat komunale për përdorim të përhershëm, gjë që përfundimisht do t'i ulë kostot.

Kostot e materialeve, mirëmbajtjes dhe pajisjeve përfshijnë shpenzimet që nevojiten për ta ruajtur funksionimin e përditshëm të strehimores dhe për të siguruar mjedis të përshtatshëm për të mbijetuarat/it. Kostot përfshijnë materiale harxhuese, si letra, toneri, stilolapsat, fletoret, mjetet e pastrimit, dezinfektuesit dhe materiale të tjera për zyrë dhe veprimtari, si dhe nevoja të tjera të vogla që lidhen me mirëmbajtjen dhe pajisjet. Mesatarisht, strehimoreve u nevojiteshin 138 € në muaj, që do të arrinin gjithsej në 1.652 € në vitin 2026 për mirëmbajtje dhe pajisje. Sistemet e sigurisë kontribuojnë në sigurinë dhe mbrojtjen e të mbijetuarave/ve, stafit dhe objekteve të strehimoreve. Kostot përfshijnë instalimin, mirëmbajtjen, riparimin dhe zëvendësimin e pajisjeve të sigurisë, si kamerat dhe komponentët

[241] Sipas të dhënave të vitit 2024 të ofruara nga strehimorja; nuk ka të dhëna në dispozicion për vitin 2025.
[242] Në përputhje me Shtojcën 4, personeli mbështetës duhet të përfshijë së paku një kuzhinier/e, një mirëmbajtës/e të higjienës, një punonjës/e të mirëmbajtjes dhe një roje sigurie.
[243] Ligji për Pagat në Sektorin Publik, neni 9.

e tjerë të sistemit të sigurisë, sipas nevojës. Mesatarisht, strehimoret vlerësuan se shpenzimet e sistemit të sigurisë arrijnë në 100 € në vit.[244] Shpenzimet për kompjuterë dhe TI mbulojnë kostot që nevojiten për ta mbështetur funksionimin digjital dhe administrativ të strehimoreve, duke përfshirë pajisjet kompjuterike, materialet që lidhen me TI-në, shërbimet dhe teknologjitë e tjera të domosdoshme për veprimtarinë e përditshme. Bazuar në informacionin e ofruar nga strehimoret, kostoja mesatare vjetore për shpenzimet e kompjuterëve dhe TI-së ishte 810 €.

Shërbimet komunale (energjia elektrike, uji, mbledhja e mbeturinave dhe ngrohja) përfshijnë kostot thelbësore që nevojiten për të ruajtur një mjedis të sigurt, funksional dhe të rehatshëm, të cilat arrijnë në 200 € në muaj, respektivisht 2.400 € në vitin 2026. Kostot e komunikimit janë të nevojshme për veprimtarinë e përditshme të strehimores, duke përfshirë linjat e telefonisë fikse dhe mobile, lidhjen e internetit, mirëmbajtjen e faqes së internetit dhe tarifat përkatëse të shërbimeve. Kjo është e rëndësishme për organizimin e shërbimeve, komunikimin me klientët dhe familjet e tyre dhe koordinimin e shërbimeve me institucionet e tjera. Për komunikim janë buxhetuar 200 € në muaj, përkatësisht 2.400 € në vitin 2026. Abonimet e vazhdueshme në softuer kushtojnë afërsisht 656 € për njësi, gjithsej 3.936 € për gjashtë kompjuterë.[245]

Regjistrimi i automjetit përfshin shpenzimet vjetore që nevojiten për të siguruar regjistrimin dhe funksionimin e automjeteve të strehimores që përdoren për transportimin e të mbijetuarave/ve, stafit dhe mallrave. Bazuar në evidencat e strehimoreve, regjistrimi i automjetit kushton mesatarisht 1.200 € në vit. Kostot e transportit përfshijnë shpenzimet që nevojiten për transportimin e të mbijetuarave/ve në vizita mjekësore, ligjore, arsimore ose në shërbime sociale, si dhe për nevoja të tjera të udhëtimit. Kostot përfshijnë karburantin, mirëmbajtjen e automjetit, biletat e transportit publik, shërbimet e taksive dhe shpenzime të tjera që lidhen me transportin. Sipas evidencave të strehimoreve, transporti kushton mesatarisht 172 € në muaj, respektivisht 2.067 € në vit.

Lodrat e fëmijëve dhe materialet shkollore, duke përfshirë materialet për punime dore dhe materialet për terapi okupacionale, nevojiten për të mbështetur zhvillimin, arsimimin dhe mirëqenien e fëmijëve në strehimore. Kostot përfshijnë lodrat, materialet e punës dhe ato krijuese, librat, materialet shkollore dhe mjetet didaktike. Strehimoret raportuan një kosto mesatare vjetore prej 1.252 € ose 104 € në muaj. ABGj-ja vlerësoi se këto kosto arrijnë në 2.000 € për lodra dhe materiale krijuese, 1.000 € për libra, 500 € për rafte dhe organizues për dhomat e fëmijëve dhe 480 € për tavolina për fëmijë (nga 60 € për njësi, gjithsej për tetë njësi). Kjo është më e lartë se buxhetet mesatare të strehimoreve, ndonëse strehimoret tashmë kanë disa prej orendive të përhershme. Ndërkohë, strehimoret vunë në dukje se fëmijët shpesh i marrin lodrat me vete kur largohen nga strehimorja, pasi shumë prej tyre krijojnë lidhje emocionale me këto sende. Ndonëse shpenzimi mesatar i raportuar nga strehimoret është më i ulët se vlerësimi i ABGj-së, buxhetimi më i lartë për lodra dhe materiale edukative është i arsyeshëm, pasi strehimoret duhet t'i zëvendësojnë rregullisht dhe të blejnë sende të reja për të siguruar që fëmijët e akomoduar në strehimore të kenë qasje në materiale të përshtatshme rekreative dhe terapeutike. Prandaj, për këtë janë buxhetuar 3.000 € në vit, duke u bazuar në vlerësimet e ABGj-së.

Kostot e trajnimit të vazhdueshëm mbulojnë shpenzimet që nevojiten për të siguruar që stafi i strehimoreve të ketë zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe t'i përditësojë njohuritë, kualifikimet, certifikimet dhe aftësitë e nevojshme për t'u ofruar të mbijetuarave/ve të dhunës mbështetje dhe shërbime cilësore. Kjo përfshin kostot për tarifat e regjistrimit, trajnerët,

[244] Të gjitha strehimoret kanë kamera sigurie; prandaj, kostot e vlerësuara mbulojnë mirëmbajtjen, riparimet dhe zëvendësimin ose instalimin e pajisjeve të reja nëse një kamerë ose komponent tjetër i sigurisë dëmtohet ose pushon së funksionuari.

[245] Kostot përllogariten në bazë të çmimeve zyrtare të Microsoft-it për sistemet operative Windows dhe paketat Microsoft 365 Office. Çmimet mund të ndryshojnë në varësi të rajonit, tatimeve dhe opsioneve të licencimit.

hapësirat, akomodimin, mëditjet ose ushqimin dhe pijet gjatë trajnimeve. Mesatarisht, strehimoret kanë buxhetuar 2.000 € në vit për këtë qëllim.[246]

KS-ja u kërkon palëve të organizojnë rregullisht fushata ndërgjegjësuese në koordinim me shoqërinë civile, veçanërisht me OShCG-të. Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026[247] dhe Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Kosovë[248] gjithashtu planifikojnë ndërgjegjësim për dhunën me bazë gjinore. Prandaj, Qeveria duhet të buxhetojë mjete për mbulimin e kostove që lidhen me ndërgjegjësimin. Kostot e promovimit të strehimoreve mbulojnë shpenzimet që lidhen me ndërgjegjësimin dhe promovimin e shërbimeve të strehimores. Kostot përfshijnë prodhimin e banderolave, fletushkave dhe broshurave; organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe informuese; promovimin dhe marketingun në rrjetet sociale; nismat e avokimit për të ndikuar në politika dhe buxhete; si dhe shpenzime të tjera përkatëse. Në mesin e strehimoreve, buxheti mesatar vjetor për kostot e promovimit gjatë periudhës 2024–2025 ishte 630 €. Përfaqësuesit e strehimoreve shprehën shqetësimin se kjo linjë buxhetore shpesh përjashtohet nga alokimet e financimit qeveritar, pavarësisht rëndësisë së saj për ndërgjegjësimin, promovimin e shërbimeve dhe avokimin për parandalimin dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore, në përputhje me zotimet e Qeverisë ndaj KS-së.

Shpenzimet bankare mbulojnë tarifat që lidhen me transaksionet financiare të strehimoreve, duke përfshirë mirëmbajtjen e llogarisë, transferet e fondeve dhe tarifat e tjera të shërbimit që aplikojnë institucionet financiare. Mesatarisht, strehimoret buxhetuan 39 € në muaj për shpenzime bankare dhe 468 € në vit. Kostot e auditimit mbulojnë verifikimin e jashtëm të financave të strehimoreve dhe shqyrtimin e pajtueshmërisë me kërkesat e donatorëve dhe ato ligjore. Auditimet vjetore konsiderohen praktikë e mirë për OJQ-të, me qëllim të sigurimit të menaxhimit të qëndrueshëm financiar, rekomandimit të çdo përmirësimi të nevojshëm dhe ruajtjes së llogaridhënies në përdorimin e burimeve. Bazuar në të dhënat e strehimoreve, kostoja mesatare vjetore e auditimit vlerësohet në 900 €, e barasvlershme me afërsisht 75 € në muaj. Ndonëse strehimoret kanë kërkuar financim qeveritar për këto shpenzime, ato thanë se kosto të tilla u janë hequr nga buxhetet. Për menaxhim të qëndrueshëm financiar, Qeveria duhet ta financojë këtë kosto si pjesë të veprimtarisë së OJQ-ve.

Kostot e paparashikuara përfshijnë shpenzimet e papritura që mund të lindin gjatë veprimtarisë së strehimoreve dhe që nuk mund të planifikohen. Këto kosto mund të përfshijnë zëvendësimin ose riparimin e inventarit dhe pajisjeve të dëmtuara dhe nevoja të tjera të paplanifikuara për mirëmbajtje. Kjo mund ta mbulojë gjithashtu kontraktimin e shërbimeve të përkthimit për përfituesit/et që flasin gjuhë të ndryshme, sipas nevojës. Sipas strehimoreve, kjo kosto ka qenë mesatarisht 1.785 € në vit.

Kostot që lidhen me përfituesit/et

Përveç kostove operative, kostot e tjera ndryshojnë në varësi të numrit të të mbijetuarave/ve të akomoduar dhe të mbështetur, duke përfshirë ushqimin, mjetet higjienike, veshmbathjen, seancat e mbështetjes psikologjike, barnat dhe vizitat mjekësore. Në përputhje me praktikat më të mira të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor,[249] projeksionet u përllogaritën duke marrë parasysh numrin mesatar të të mbijetuarave/ve të cilëve u janë ofruar shërbime

[246] ABGj-ja e vlerësoi këtë kosto në 1.035 € (Udhëzuesi për Buxhetimin Operacional dhe Projektimin e Strehimoreve në Kosovë, 2021). Shuma mesatare e raportuar nga strehimoret është më e lartë, duke pasqyruar nevojat e tyre dhe kostot reale që nevojiten për organizimin dhe pjesëmarrjen në trajnime. Gjithashtu, inflacioni që nga analiza e ABGj-së ka kontribuar në rritjen e kostove, gjë që është marrë parasysh.
[247] Zyra e Kryeministrit, Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026, 2023.
[248] Republika e Kosovës, Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022–2026 dhe Plani i Veprimit 2022–2024, 2022.
[249] RrGK, *Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në nivel lokal*, 2017.

(64) në vit për strehimore dhe numrin mesatar të ditëve të qëndrimit të tyre në strehimore (29).[250]

Ushqimi dhe produktet higjienike nevojiten për plotësimin e nevojave themelore ditore të banorëve, duke përfshirë ushqimet, mjetet e pastrimit dhe produktet e kujdesit personal. Kostoja mesatare ditore për të mbijetuar/e është përllogaritur duke e pjesëtuar shpenzimin vjetor të secilës strehimore për ushqim dhe produkte higjienike me numrin e të mbijetuarave/ve të akomoduar gjatë vitit dhe më pas duke e pjesëtuar këtë shumë me kohëzgjatjen mesatare të qëndrimit. Kjo rezultoi në kosto mesatare ditore prej 7 € për të mbijetuar/e.[251] Ndërkohë, ABGj-ja rekomandoi ndarje ditore prej 8 € për të mbijetuar/e për ushqim dhe produkte higjienike në vitin 2021.[252] Kjo shumë, e shumëzuar me numrin mesatar të klientëve për strehimore në vit (64) dhe kohëzgjatjen mesatare të qëndrimit (29 ditë), arrin gjithsej në 14.848 € në vitin 2026.

Furnizimet mjekësore dhe kujdesi shëndetësor përfshijnë kostot e barnave bazë, materialeve të ndihmës së parë dhe trajtimit mjekësor nga specialistët, sipas nevojave të të mbijetuarave/ve. Historikisht, strehimoret janë mbështetur kryesisht në institucionet publike të kujdesit shëndetësor për ofrimin e këtyre shërbimeve, duke rezultuar në kosto relativisht të ulëta. Kur shërbimet e nevojshme nuk ishin në dispozicion përmes sistemit publik të kujdesit shëndetësor, të mbijetuarat/it referoheshin te ofruesit privatë të kujdesit shëndetësor. Gjatë periudhës 2024–2025, strehimoret raportuan buxhet mesatar prej 80 € në muaj, respektivisht 957 € në vit për qëllime mjekësore. ABGj-ja vlerësoi ngjashëm se furnizimet mjekësore kushtojnë 80 € në muaj. Mesatarisht, për 64 klientë për strehimore në vit, kostoja mesatare e kujdesit shëndetësor vlerësohet në 15 € për të mbijetuar/e, respektivisht 960 € në vitin 2026. Megjithatë, monitorimi i shpenzimeve reale mund të tregojë se nevojiten më shumë fonde.

Kostot e veshmbathjes mbulojnë sigurimin e veshmbathjeve të nevojshme për të mbijetuarat/it, veçanërisht për gratë dhe fëmijët që mbërrijnë në strehimore pa gjëra personale. Strehimoret raportuan se veshmbathjet që u ofrohen të mbijetuarave/ve nuk ripërdoren, pasi të mbijetuarat/it i marrin këto gjëra me vete kur largohen nga strehimorja. Strehimoret raportuan se në të kaluarën kishin buxhet mesatar vjetor prej 1.695 € për veshmbathje. Mesatarisht, kjo do të arrinte në afro 27 € për një të mbijetuar.

Mbështetja për riintegrim, e paraparë gjithashtu me Standardet minimale të cilësisë, përfshin asistencën financiare që u ofrohet të mbijetuarave/ve për t'i adresuar nevojat pas largimit nga strehimorja dhe për të mbështetur aftësinë e tyre për të krijuar siguri, stabilitet dhe pavarësi. Këto kosto mund të përfshijnë mbështetjen për zhvillimin e bizneseve të vogla, asistencën e përkohshme për qira, kujdesin për fëmijët, transportin dhe forma të tjera të asistencës që i ndihmojnë të mbijetuarat/it të krijojnë stabilitet dhe ta rindërtojnë jetën e tyre pas largimit nga strehimorja. Historikisht, strehimoret e kanë përfshirë këtë kategori të kostove në buxhetet e tyre për të ofruar mbështetje si gjatë qëndrimit të të mbijetuarave/ve në strehimore, ashtu edhe pas largimit të tyre nga strehimorja. Shuma mesatare vjetore e ndarë nga strehimoret për mbështetjen e riintegrimit ishte 1.044 €, që arrin mesatarisht në 16 € për klient. Megjithatë, kjo është e pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e rehabilitimit dhe riintegrimit. Përfaqësuesit e strehimoreve theksuan se kjo lloj mbështetjeje është thelbësore për riintegrimin e suksesshëm të të mbijetuarave/ve, por nuk miratohet gjithmonë për financim nga Qeveria. Këto fonde janë thelbësore për mbështetjen gjithëpërfshirëse të riintegrimit dhe rehabilitimit, siç parashihet me KS-në dhe kornizën ligjore të Kosovës, dhe duhet të miratohen nga Qeveria. Prandaj, propozohet të buxhetohen mesatarisht 500 € për

[250] Katër strehimore dorëzuan të dhëna për kohëzgjatjen mesatare të qëndrimit të të mbijetuarave/ve.

[251] Kjo është në përputhje me ASK-në, Indeksi i Çmimeve të Konsumit, 2024, siç është shtjelluar në seksionin e mëparshëm.

[252] ABGj, Udhëzuesi për Buxhetimin Operacional dhe Projektimin e Strehimoreve në Kosovë, 2021. Vlen të theksohet se nuk është përfshirë inflacioni i mundshëm prej 22% që nga viti 2021. Nëse përshtatet sipas inflacionit, norma ditore do të ishte afërsisht 10 € në vitin 2026.

klient, për të përmirësuar shërbimet e riintegrimit. Kostot dhe nevojat duhet të monitorohen me kujdes për të përmirësuar më tej buxhetimin për këtë kosto.

Këto kosto për përfitues/e janë projeksione të bazuara në kostot e mëparshme. Financimi real mund të kërkojë përshtatje sipas strehimores për shkak të dallimeve në nivelin e shfrytëzimit të kapaciteteve, pasi numri i banorëve ndikon drejtpërdrejt në konsum dhe në koston e përgjithshme. Kostot ndikohen gjithashtu nga kohëzgjatja e qëndrimit, numri i fëmijëve dhe nevojat e banorëve me aftësi të kufizuara. Nëse më shumë përfitues/e kanë nevojë për shërbime dhe/ose kanë shpenzime shtesë që lidhen me shërbimet cilësore, kostot mund të jenë më të larta sesa është parashikuar. Për të siguruar shërbime cilësore, ofruesit e shërbimeve të strehimoreve duhet të kenë mundësi të kërkojnë rimbursimin e shpenzimeve shtesë që lidhen me klientët, për sa kohë që ato janë në përputhje me kategoritë e miratuara buxhetore dhe standardet e kujdesit. Ngjashëm, nëse strehimoret kanë më pak klientë sesa është buxhetuar, fondet e tepërta mund të zbriten nga kështet përfundimtare të pagesës, bazuar në numrin e përgjithshëm të klientëve të cilëve u janë ofruar shërbime.

Kostoja e përgjithshme e funksionimit të një strehimoreje për një vit mund të përllogaritet duke i mbledhur kostot në kategoritë e ndryshme të shpenzimeve, që arrijnë gjithsej në 205.746 € në vitin 2026, 212.694 € në vitin 2027, 217.092 € në vitin 2028 dhe 221.179 € në vitin 2029, duke marrë parasysh inflacionin (Tabela 40).[253]

Tabela 40. Kostot e vlerësuara për një strehimore 2026–2029

Shpenzimi	Kostoja për njësi	2026	2027	2028	2029
Pagat dhe mëditjet		**133.550 €**	**138.017 €**	**140.845 €**	**143.472 €**
Drejtor	1.014 €	12.169 €	12.607 €	12.884 €	13.142 €
Menaxher	878 €	10.542 €	10.921 €	11.162 €	11.385 €
Zyrtar/e financiar/e / Asistent/e (50%)	337 €	4.039 €	4.185 €	4.277 €	4.362 €
Punonjës social (ditët e javës) (2)	789 €	18.944 €	19.626 €	20.058 €	20.459 €
Punonjës social (natën gjatë javës)	1.026 €	12.314 €	12.757 €	13.037 €	13.298 €
Punonjës social (fundjavë) (2) (50%)	592 €	14.208 €	14.719 €	15.043 €	15.344 €
Punonjës social (nata e fundjavës) (80%)	1.421 €	17.049 €	17.663 €	18.052 €	18.413 €
Këshilltar/e ligjor/e ose zyrtar/e ligjor/e (50%)	451 €	5.412 €	5.607 €	5.730 €	5.845 €
Psikolog klinik	789 €	9.471 €	9.471 €	9.471 €	9.471 €
Infermier/e (50%)	325 €	3.899 €	4.040 €	4.129 €	4.211 €
Edukator/e / kujdestar/e	625 €	7.503 €	7.773 €	7.944 €	8.103 €
Shofer	500 €	6.000 €	6.216 €	6.353 €	6.480 €
Mirëmbajtës/e i/e higjienës / kuzhinier/e	500 €	6.000 €	6.216 €	6.353 €	6.480 €
Roje sigurie	500 €	6.000 €	6.216 €	6.353 €	6.480 €
Kostot operative		**22.692 €**	**23.391 €**	**23.833 €**	**24.244 €**
Materiale, mirëmbajtje dhe pajisje	138 €	1.652 €	1.711 €	1.749 €	1.784 €
Siguria	100 €	100 €	104 €	106 €	108 €

[253] Për projeksionet buxhetore janë aplikuar normat vjetore të inflacionit prej 4% për vitin 2027 dhe 2% për vitet 2028 dhe 2029, bazuar në projeksionet e FMN-së (FMN, Norma e inflacionit, çmimet mesatare të konsumit, uebfaqja, qasur më 22 korrik 2026).

Tabela 40. Kostot e vlerësuara për një strehimore 2026–2029

Shpenzimi	Kostoja për njësi	2026	2027	2028	2029
Shpenzimet për kompjuterë/TI	810 €	810 €	839 €	858 €	875 €
Shpenzimet komunale	200 €	2.400 €	2.486 €	2.541 €	2.592 €
Komunikimi	200 €	2.400 €	2.486 €	2.541 €	2.592 €
Softuer kompjuterik	656 €	3.280 €	3.280 €	3.280 €	3.280 €
Regjistrimi i automjeteve	1.200 €	1.200 €	1.243 €	1.271 €	1.296 €
Kostot e transportit	172 €	2.067 €	2.142 €	2.189 €	2.233 €
Lodrat e fëmijëve dhe materialet shkollore	250 €	3.000 €	3.108 €	3.176 €	3.240 €
Trajnimi i vazhdueshëm	2.000 €	2.000 €	2.072 €	2.118 €	2.160 €
Promovimi	630 €	630 €	653 €	667 €	680 €
Tarifat bankare	39 €	468 €	485 €	496 €	505 €
Auditimi	900 €	900 €	932 €	953 €	972 €
Kostot e paparashikuara	1.785 €	1.785 €	1.849 €	1.890 €	1.927 €
Kostot bazë për klientët dhe shërbimet cilësore		**49.504 €**	**51.286 €**	**52.414 €**	**53.463 €**
Ushqimi dhe produktet e higjienës personale	8 €	14.848 €	15.383 €	15.721 €	16.035 €
Barnat dhe vizitat mjekësore	15 €	960 €	995 €	1.016 €	1.037 €
Veshmbathja	27 €	1.696 €	1.757 €	1.796 €	1.832 €
Mbështetja për riintegrim	500 €	32.000 €	33.152 €	33.881 €	34.559 €
Gjithsej		**205.746 €**	**212.694 €**	**217.092 €**	**221.179 €**

Vlen të theksohet se kjo nuk i përfshin kostot e qirasë, duke supozuar se objektet e siguruara nga Qeveria për strehimoret në Mitrovicë dhe Ferizaj do të përfundojnë në vitin 2027.

Për ta parashikuar buxhetin e përgjithshëm për vitin 2027, kjo shumë mund të shumëzohet me 11 për ta përfshirë strehimoren në Mitrovicë të Veriut dhe me normën e inflacionit prej 4%, duke arritur gjithsej në 2.339.631 €. Për vitin 2028, ajo mund të shumëzohet me 12 për ta përfshirë strehimoren LGBTQI+, si dhe me 2% për inflacionin, duke arritur gjithsej në 2.605.110 €. Për vitin 2029, duke marrë parasysh inflacionin prej 2%, buxheti do të ishte 2.654.152 €. Me ndërtimin e strehimoreve shtesë, bazuar në Tabelën 34, kostot duhet të shumëzohen për ta siguruar financimin e tyre. Duke pasur parasysh se strehimoret janë ndërkomunale, MPFVLÇ-ja duhet t'i buxhetojë këto fonde, ndonëse komunat mund të buxhetojnë për t'i mbështetur kostot infrastrukturore.[254]

Kostot e ndërtimit

Për të krijuar numër të mjaftueshëm strehimoresh që t'i shërbejnë popullsisë dhe për të siguruar shpërndarje të përshtatshme gjeografike në bazë të kërkesave të KS-së, në të ardhmen Kosova do të duhet të buxhetojë për ndërtimin dhe/ose renovimin e objekteve për strehimore, duke përdorur linjat buxhetore të investimeve kapitale. Meqenëse projektet e ndërtimit mund të ndryshojnë ndjeshëm dhe kërkojnë studime të veçanta të fizibilitetit, ato nuk kanë qenë pjesë e kësaj analize. Për buxhetimin e zgjerimit dhe ndërtimit të strehimoreve përmes një procesi gradual do të kërkohen studime të fizibilitetit. Strehimoret e reja gjithashtu do të kenë nevojë të pajisen me orendi.

[254] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, 2024, neni 74.

Banimi social

Në këtë seksion shqyrtohen kostot e shërbimeve të banimit social për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore. Qasja në banim të sigurt dhe të përballueshëm është një komponent i rëndësishëm i rimëkëmbjes dhe pavarësisë afatgjatë të të mbijetuarave/ve. Ndërsa strehimoret e specializuara ofrojnë mbrojtje të menjëhershme, disa të mbijetuar/a mund të kenë nevojë për akomodim kalimtar, asistencë për qira ose qasje në banim social, varësisht nga rrethanat dhe nevojat e tyre për banim. Këto masa mund ta zvogëlojnë rrezikun e kthimit te kryerësit e dhunës ose të mbetjes pa strehë dhe mund ta mbështesin pavarësinë ekonomike të të mbijetuarave/ve. Prandaj, mbështetja për banim duhet të konsiderohet pjesë e një vazhdimësie më të gjerë të shërbimeve të mbrojtjes, rimëkëmbjes dhe riintegrimit, në vend se si zgjatje e qëndrimit në strehimore.

Përgjegjësitë

Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit u miratua në vitin 2010 për t'u siguruar qasje në banim të përshtatshëm personave në nevojë që nuk kanë mundësi ta përballojnë atë financiarisht. Ai parasheh mbështetje për persona të ndryshëm dhe jo vetëm për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore. Komunat janë përgjegjëse për banimin social. Ato duhet të identifikojnë nevojat për banim të qytetarëve; të përgatisin programe dhe projekte trevjeçare të banimit bazuar në burimet financiare në dispozicion; të sigurojnë tokë për banim dhe ta zhvillojnë infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e programeve të banimit; t'i paraqesin Ministrisë përkatëse kërkesa për financim dhe subvencione të reja; të krijojnë dhe të menaxhojnë një bazë të të dhënave për familjet përfituese të programeve të banimit; si dhe të sigurojnë ndërtimin e njësive të banimit.[255]

Në nivel kombëtar, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) është përgjegjëse për hartimin e strategjive kombëtare trevjeçare të banimit bazuar në programet komunale.[256] Ministria gjithashtu planifikon buxhetin për të mbështetur zbatimin e programeve vjetore të banimit dhe mirëmban bazën kombëtare të të dhënave për banimin.

Sipas Ligjit për Banim Social dhe të Përballueshëm, strehimi sigurohet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qira. Këto programe përfshijnë banesat e ndërtuara nga komunat, Qeveria ose donatorët, të cilat më pas jepen me qira; banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë ose juridikë, të cilat mund t'u jepen me qira familjeve që përfitojnë asistencë për banim; si dhe pronat e tjera komunale që mund të përshtaten për shfrytëzim në kuadër të programeve të veçanta të banimit. Programet e banimit mund të financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës përmes MMPHI-së, nga të hyrat komunale të dedikuara për banim dhe nga kontributet e donatorëve të ndryshëm.

Të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore nuk janë përfshirë shprehimisht në kriteret e pranueshmërisë në Ligjin për Banim Social dhe të Përballueshëm, por viktimat e dhunës në familje përmenden aty.[257] LDhBGj-ja kërkon sigurimin e banimit të përhershëm për të mbijetuarat/it ose mbështetje financiare për mundësimin e banimit.[258] Kjo mund të sigurohet qoftë përmes banimit social, qoftë përmes asistencës financiare që synon sigurimin e një akomodimi të sigurt dhe të qëndrueshëm. Për këtë qëllim, Plani i Veprimit i SKDhG-së përfshin hartimin e një plani trevjeçar të banimit social në komuna, i cili duhet të përfshijë zgjidhje

[255] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, 2010.
[256] UN-Habitat Kosovë, Facebook, 9 korrik 2026, qasur më 17 korrik 2026. Ende nuk ekziston ndonjë plan. Grupi Punues për hartimin e Strategjisë së Banimit 2027–2034 dhe Planit të Veprimit 2027–2029 mbajti takimin e parë në gusht 2026. Strategjia pritet të publikohet në vitin 2027.
[257] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 10/L-022 për Banim Social dhe të Përballueshëm, 2026. Neni 5 i përmend shprehimisht viktimat e dhunës në familje.
[258] Neni 22.

strehimi për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë mbështetjen për qiranë dhe banimin. Buxheti i planifikuar për periudhën 2022–2024 është 120.000 €, i financuar nga Qeveria dhe komunat. Megjithatë, është e paqartë se sa financim duhet të sigurohet nga Qeveria qendrore dhe sa nga komunat.

Organet përgjegjëse për planifikimin dhe buxhetimin e banimit social ndryshojnë nga një komunë te tjetra. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në drejtoritë për buxhet dhe financa; për urbanizim, planifikim hapësinor dhe mjedis; për shërbime publike, infrastrukturë dhe banim; për punë dhe mirëqenie sociale; si dhe për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, varësisht nga komuna.

Në burimet e disponueshme online u gjetën vetëm dy rregullore për banimin social që rregullojnë ndarjen e banimit social në komuna (Prishtinë dhe Prizren). Sipas Misionit të OSBE-së në Kosovë, disa komuna miratuan plane trevjeçare për banimin social.[259] Analiza e RrGK-së e informacionit në dispozicion të publikut në gusht 2026 tregoi se 63% e komunave kishin miratuar plane për banimin social, veçanërisht për periudhat 2022–2025 dhe 2023–2025. Planet në përgjithësi synojnë një gamë të gjerë të grupeve të cenueshme, duke përfshirë familjet me të ardhura të ulëta, familjet me një prind, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet e tjera të cenueshme. Disa komuna pasqyruan konsiderata gjinore në planet e tyre komunale, duke përfshirë si grupe prioritare të mbijetuarat/it e dhunës, familjet e drejtuara nga gratë dhe nënat vetushqyese; 55% e komunave dhe 88% e atyre që kanë një plan i përmendin shprehimisht të mbijetuarat/it e dhunës në familje dhe të dhunës ndaj grave. Komisionet zakonisht i përzgjidhnin përfituesit/et e banimit social bazuar në kriteret e përcaktuara. Në disa komuna konsultohen gjithashtu QPS-të. Komunat ofruan mbështetje përmes modeleve të ndryshme, duke përfshirë njësitë e banimit social, asistencën për qira dhe bonuset e banimit. Për shkak se banimi social nuk ka qenë në dispozicion, disa komuna i kanë mbajtur të mbijetuarat/it e dhunës në strehimore si zgjidhje të përkohshme alternative. Këto dy forma strehimi kanë natyra krejtësisht të ndryshme, pasi vetëm banimi social përbën një zgjidhje afatgjatë. Ndërkohë, informacioni i vënë në dispozicion të publikut mbi numrin dhe madhësinë e njësive të banimit ndryshon nga një komunë te tjetra.[260]

Në korrik 2025, CSGD-ja dhe Qendra për Barazi dhe Liri (CEL) konfirmuan se, pas vitesh avokimi dhe bashkëpunimi me Komunën e Prishtinës, ishin ndarë dy njësi banimi për të shërbyer si hapësira të sigurta për personat LGBTQI+ që përballen me dhunë, diskriminim ose përjashtim, derisa të arrihej themelimi i një strehimoreje të përhershme.[261] Këto akomodime të përkohshme të siguruara nga komuna nuk i përmbushin standardet ose kërkesat infrastrukturore për objekte formale të strehimoreve.[262] Në vend të kësaj, ato janë "shtëpi të sigurta", përkatësisht hapësira të përkohshme ku të mbijetuarat/it LGBTQI+ mund të qëndrojnë derisa të vihet në dispozicion një zgjidhje më e qëndrueshme dhe afatgjatë. Secila njësi përbëhet nga një dhomë gjumi, një dhomë dite, një kuzhinë dhe një banjë, të cilat në rrethana normale, mund të akomodojnë deri në dy persona, ose deri në katër në raste emergjente. Aktualisht, njësitë mbeten të pamobiluara dhe u mungon infrastruktura elementare, si shtretërit dhe pajisjet e kuzhinës.[263] Nevojitet financim për t'i funksionalizuar këto shtëpi të sigurta.

[259] Shih Shtojcën 3. Misioni i OSBE-së në Kosovë, Vlerësimi i banimit social dhe ndërtimit të banesave në Kosovë 2018–2023, 2024. Seksioni 4: Të dhënat në terren sipas rajonit. Ai ofron një pasqyrë të programeve komunale të banimit social gjatë këtyre viteve. Në atë kohë, Prishtina, Malisheva, Dragashi, Mamusha, Juniku, Vitia, Kamenica, Kllokoti, Novobërda dhe Parteshi nuk kishin programe të tilla, prandaj nuk janë përfshirë në tabelë.
[260] Shih Shtojcën 3 për një përmbledhje.
[261] CSGD Kosovo, Facebook, mars 2026.
[262] Intervistë e RrGK-së me një aktivist për të drejtat e personave LGBTQI+, shtator 2025.
[263] Ibid.

Kapacitetet për BPGj për banimin social

Kishte dëshmi shumë të pakta se komunat e përdorin buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe analizën gjinore të nevojave që e shoqëron atë për të përcaktuar ndarjet për banimin social.[264]

Të dhënat për përfituesit/et dhe ndikimet

Tabela 41. Njësitë e banimit social

Komuna	Njësitë	Dhuna me bazë gjinore
Prishtinë	100	0
Drenas	48	0
Obiliq	1[265]	3

Ekzistojnë të dhëna të kufizuara publike, të ndara sipas gjinisë, për përfituesit/et e banimit social, gjë që e vështirëson vlerësimin nëse mbështetja po shkon te gratë e mbijetuara të dhunës me bazë gjinore, krahas përfituesve të tjerë. OSBE-ja ka vënë në dukje gjithashtu mungesën e të dhënave të ndara për aplikuesit/et dhe përfituesit/et e banimit social, duke përfshirë sipas gjinisë, përkatësisë në komunitete pakicë, aftësisë së kufizuar, zhvendosjes, si dhe përvojave të dhunës në familje apo dhunës ndaj grave. Duke pasur parasysh mungesën e theksuar të informacionit publik, RrGK-ja kërkoi nga MMPHI-ja të dhëna për përfituesit/et për periudhën 2022–2026, por nuk mori përgjigje. Gjithashtu, RrGK-ja realizoi një anketë me komunat, por pak prej tyre u përgjigjën. Vetëm nëntë sosh ofruan të dhëna për numrin e njësive të banimit social që kishin në dispozicion në vitin 2025, duke përfshirë numrin e njësive të rezervuara për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore (Tabela 41).[266]

Asnjë analizë e njohur nuk e ka shqyrtuar ndikimin e këtyre shërbimeve te përfituesit/et, veçanërisht te të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore.

Kërkesa për shërbime

Kërkesa maksimale vjetore për banim social pas qëndrimit në strehimore do të shfaqet vetëm nëse të gjithë përfituesit/et do të kishin nevojë për banim. Megjithatë, jo të gjitha gratë dhe fëmijët që largohen nga strehimoret kanë nevojë për banim social, pasi disa kanë mundësi të tjera në dispozicion. Kërkesa e saktë për banim social mund të përcaktohet më së miri nga komunat, në bashkëpunim me QPS-të, strehimoret, [267] drejtoritë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale (DSHMS), drejtoritë e financave dhe drejtoritë e tjera përgjegjëse, përmes diskutimit vjetor të nevojave. Këto mund të përfshihen në planet e banimit social. Bisedat me komunat treguan se atyre u nevojitej banim social shtesë për të përballuar nivelin e kërkesës.

Disa zyrtarë komunalë shprehën shqetësimin se rregulloret për banimin social nuk parashikojnë afate të qëndrimit maksimal, prandaj disa përfitues/e mund të qëndrojnë për kohë të pacaktuar, çka e vështirëson qasjen e përfituesve/eve të rinj në këto hapësira. Ka mundësi që kjo sfidë të adresohet përmes ndryshimit të rregulloreve për të përcaktuar periudha maksimale të qëndrimit. Megjithatë, këto afate duhet të jenë edhe fleksibile në bazë të nevojave, për të mbrojtur mirëqenien e të mbijetuarave/ve të dhunës me bazë gjinore.

[264] Shqyrtimi i dokumenteve online nga RrGK-ja dhe bisedat me komunat, 2026.
[265] Kjo është një ndërtesë e tërë. RrGK-ja dërgoi një kërkesë pasuese për numrin e njësive, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.
[266] RrGK-ja ua shpërndau anketën në mënyrë elektronike të gjitha komunave në Kosovë në vitin 2025, si dhe ua rikujtoi # herë. Vetëm tetë komuna u përgjigjën, siç është përmbledhur në tabelë.
[267] Në komentin për draftin e raportit, OSBE-ja vuri në dukje se disa strehimore kanë lidhur memorandume mirëkuptimi me komunat për ofrimin e banimit social për të mbijetuarat/it. Strehimoret duhet të konsultohen sistematikisht për ta kuptuar dhe planifikuar kërkesën e ardhshme për banim social.

Punonjësit socialë mund të hartojnë plane për menaxhimin e rasteve që parashikojnë kohëzgjatjen gjatë së cilës të mbijetuarave/ve të dhunës do t'u nevojitet akomodimi, duke i vlerësuar nevojat e vazhdueshme gjatë vizitave të rregullta monitoruese. Qëllimi duhet të jetë që këto njësi të shfrytëzohen gjatë një periudhe kalimtare, derisa të mbijetuarat/it të bëhen të pavarur dhe të mund ta përballojnë banimin e tyre. Pastaj, këto njësi do të ishin në dispozicion të të mbijetuarave/ve të tjera/ëve në nevojë.

Buxhetet dhe shpenzimet 2022–2026

Nga shqyrtimi i buxheteve vjetore komunale mund të dalloheshin vetëm disa linja buxhetore që lidheshin me investimet kapitale në banimin social. Nga nëntë komunat që iu përgjigjën anketës së RrGK-së për banimin social, vetëm tri ofruan informacion për buxhetet dhe shpenzimet për banimin social gjatë periudhës 2022–2025 (Tabela 42). Vlen të theksohet se kjo përfshin buxhetet dhe shpenzimet për tërë banimin social dhe jo vetëm për njësitë e destinuara për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore. Në përgjithësi, buxhetet për banimin social përfshinin shpenzime kapitale për ndërtimin dhe pajisjen e njësive shtesë të banimit social. Banorët e banimit social jetojnë në mënyrë të pavarur dhe zakonisht i mbulojnë vetë kostot e tjera që lidhen me këto akomodime. Megjithatë, në disa komuna, pushteti lokal i paguan gjithashtu shërbimet komunale dhe, në raste të caktuara, i pajis banesat me orendi të nevojshme.[268] Në Suharekë, shpenzimet i tejkaluan dukshëm shumat e buxhetuara, ndërsa në Fushë Kosovë fondet nuk u shpenzuan plotësisht. Në Prishtinë, fondet dhe shpenzimet mbetën të njëjta çdo vit.

Tabela 42. Buxhetet komunale për banimin social (të shprehura në mijëra €) 2022–2025

Komuna	Linja buxhetore	2022	2022	2023	2023	2024	2024	2025
		Buxheti	Shpenzim-e	Buxheti	Shpenzime	Buxheti	Shpenzime	Buxheti
Suharekë	DSHMS	12.0 €	59.9 €	12.0 €	69.3 €	12.0 €	11.1 €	12.0 €
Prishtinë		70.0 €	70.0 €	70.0 €	70.0 €	70.0 €	70.0 €	70.0 €
Fushë Kosovë	Subvencionet	30.0 €	27.0 €	32.0 €	21.2 €	30.0 €	18.0 €	26.0 €
Rahovec [269]	Departamenti i Buxhetit dhe Financave 40844	10.0 €		50.0 €		0.0 €		0.0 €
Obiliq[270]		165.0 €		120.0 €				
Gjakovë [271]	DSHMS	200.0 €						

Në Tabelën 43 paraqiten buxhetet e identifikueshme të planifikuara nga komunat për banimin social për periudhën 2026–2028, bazuar në anketën me komunat dhe dokumentet buxhetore në dispozicion të publikut. Deri në gusht të vitit 2026, Qeveria nuk kishte miratuar KASh-in për periudhën 2026–2028 ose 2027–2029, i cili do të duhej t'i përfshinte parashikimet buxhetore për vitet e ardhshme. Ngjashëm me vitet e mëparshme, Suhareka ka planifikuar 12.000 € për vitin 2026. Prishtina ka planifikuar ta rrisë buxhetin e saj për banimin social për 80.000 € deri në 100.000 € në vit.

[268] Bisedat e RrGK-së me komunat. Peja, për shembull, i financoi shërbimet komunale dhe orenditë e nevonshme në njësitë e saj.
[269] Komuna e Rahovecit, Planifikimi i Investimeve Kapitale 2023–2025, 2022.
[270] Komuna e Obiliqit, Programi trevjeçar i banimit 2022–2024, 2021.
[271] Komuna e Gjakovës, Plani vjetor i punës së Ekzekutivit, 2022.

Tabela 43. Buxhetet komunale për banimin social (të shprehura në mijëra €) për periudhën 2026–2028

Komuna	Linja buxhetore	Buxheti i planifikuar		
		2026	2027	2028
Suharekë	DSHMS	12.0 €		
Prishtinë		80-100 €	80-100 €	80-100 €
Prizren[272]	Ndërtimi i njësive të banimit social në Petrovë-Prizren 55122	183.0 €	250.0 €	300.0 €

Kostot

Nevojiten hulumtime të mëtejshme për të vlerësuar në mënyrë adekuate nivelin e kërkesës dhe kostot që lidhen me ofrimin e banimit social për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore gjatë kalimit të tyre drejt jetesës së sigurt dhe të pavarur. Kjo duhet të marrë parasysh kostot e masave adekuate të sigurisë në njësi, si mbrojtëset për dritaret në katet përdhese, bravat e sigurta në dyer dhe, potencialisht, kamerat për rastet në rrezik. Për të lehtësuar këtë tranzicion, komunat mund të shqyrtojnë gjithashtu pajisjen e njësive me orendi për t'i përmbushur nevojat themelore.

Tabela 44. Kostot e vlerësuara për pajisjen e banesave LGBTQI+

Artikulli	Kostoja
Divan (3-vendësh)	200 €
Perde	45 €
Qilima	90 €
Fshesë elektrike	60 €
Llambadar (3)	120 €
Tabelat	120 €
TV	450 €
Kuzhina	500 €
Frigorifer	250 €
Tavolinë ngrënieje, karrige	200 €
Llambadar	40 €
Pjata	30 €
Gota	10 €
Thika, pirunë, lugë	25 €
Tenxhere	40 €
Sobë	250 €
Bojler	180 €
Stola	20 €
Rrobalarëse	300 €
Shtretër njëshe	100 €
Jastëkë	5 €
Komplet shtrojash, këllëfë jastëkësh etj.	20 €
Jorgan	50 €
Batanije	25 €
Dollapë/Sirtarë	150 €
Gjithsej	**3.280** €

[272] Komuna e Prizrenit, Buxheti i Komunës së Prizrenit për periudhën 2026–2028, 2025.

Si shembull, Komuna e Prishtinës ka vënë në dispozicion dy njësi për të mbijetuarat/it LGBTQI+ të dhunës me bazë gjinore, derisa ata të mund të kalojnë në një jetesë të pavarur. Këto njësi janë të pamobiluara. Një OJQ e specializuar në mbështetjen e personave LGBTQI+, CSGD-ja, koordinon shfrytëzimin e këtyre njësive. Shërbimet e saj që lidhen me menaxhimin e veprimtarisë nuk financohen nga shteti. Në Tabelën 44 paraqiten kostot e vlerësuara për mobilimin e dy njësive të banimit të destinuara për personat LGBTQI+ në Prishtinë, në mënyrë që ato të jenë të përshtatshme për akomodim.[273] Kostot nuk përfshijnë funksionimin ose ofrimin e shërbimeve. Meqenëse shuma është relativisht e vogël, Komuna e Prishtinës mund të buxhetojë për t'i mbështetur këto kosto të njëhershme, ngjashëm me shembullin në Pejë.

Një model i ngjashëm ekziston në Banjallukë (Bosnjë dhe Hercegovinë), ku një OShC menaxhon një njësi të banimit social për të mbijetuarat/it e dhunës në familje.[274] Kostot e vlerësuara të menaxhimit përfshijnë stafin dhe mirëmbajtjen teknike, ndërsa shërbimet komunale paguhen nga përfituesit/et si pjesë e masave të fuqizimit. Përvoja e tyre tregon se kur pushtetet lokale bashkëpunojnë me OShC-të për menaxhimin e banimit social, kostot përkatëse të menaxhimit duhet të përfshihen në buxhetet komunale, potencialisht përmes një linje të dedikuar buxhetore për mbështetjen e banimit social për të mbijetuarat/it e dhunës në familje.

Komuna e Prishtinës gjithashtu ka një program mjaft unik, i cili u ofron subvencione të mbijetuarave/ve të dhunës me bazë gjinore për ta mbështetur pavarësinë e tyre.[275] Mbështetja përbëhet nga tre komponentë: subvencioni për banim deri në 250 € në muaj, shtesa mujore prej 150 € për jetesë për të mbijetuarat/it që nuk janë përfitues/e të Skemës së Ndihmës Sociale dhe deri në 100 € shtesë në muaj për të mbijetuarat/it që kanë fëmijë nën kujdesin e tyre. Të mbijetuarat/it nuk përfitojnë domosdoshmërisht nga të tre komponentët dhe mbështetja e kombinuar maksimale është 500 € në muaj. Mbështetja ofrohet deri në gjashtë muaj dhe mund të zgjatet deri në maksimum dy vjet, në varësi të vlerësimit të rrethanave të të mbijetuarit/es. Mbështetja mund të ofrohet edhe për periudhë më të shkurtër ose të ndërpritet më herët nëse ndryshojnë rrethanat, bazuar në vlerësimin e QPS-së dhe Komisionit Komunal për Vlerësim. Kjo mund të përfshijë gjetjen e një vendi pune ose kthimin në punë, ribashkimin me bashkëshortin, zhvendosjen në një vendbanim tjetër, ndryshimin e statusit martesor ose ndryshime të tjera të identifikuara nga ekipi profesional.

Për komunat që kanë njësi të pamjaftueshme të banimit social, Prishtina paraqet një shembull se si mund t'i mbështesin kostot e akomodimit të të mbijetuarave/ve gjatë periudhave të tranzicionit. Ndërkohë, disa komuna vunë në dukje se buxhetet e tyre ishin tepër të vogla për të mundësuar ofrimin e një mbështetjeje të tillë.

Menaxhimi i rasteve, koordinimi dhe shërbimet sociale të specializuara

Sipas nenit 20 të KS-së, shtetet duhet të ndërmarrin masat e nevojshme legjislative ose masat e tjera për të siguruar që të mbijetuarat/it të kenë qasje në shërbime të kujdesit shëndetësor dhe shërbime sociale. Për më tepër, shërbimeve duhet t'u sigurohen burime të mjaftueshme dhe profesionistët duhet të trajnohen për t'u ofruar asistencë të mbijetuarave/ve, përfshirë referimin e tyre në shërbime të tjera të përshtatshme. Në këtë seksion shqyrtohen kostot që lidhen me menaxhimin e specializuar të rasteve dhe koordinimin përkatës.

[273] CSGD-ja ia ofroi këtë informacion RrGK-së, 2026.
[274] Fondacioni Gratë e Bashkuara, Me çfarë çmimi? Përllogaritja e kostove të shërbimeve të specializuara për dhunën ndaj grave në Bosnjë dhe Hercegovinë, në përgatitje, 2026.
[275] Republika e Kosovës, Komuna e Prishtinës, Vendim për mbështetje financiare për viktimat e dhunës në familje, 2022.

Përgjegjësitë

Historikisht, mungesa e një kornize të qartë ligjore që rregullonte funksionimin e MKL-ve ka sjellë paqartësi lidhur me rolet dhe përgjegjësitë institucionale.[276] Që nga shkurti i vitit 2025, Rregullorja (QRK) – Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e MKL-ve për ofrimin e mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore.[277] MKL-të duhet të takohen rregullisht për të koordinuar menaxhimin efektiv dhe të specializuar të rasteve. MKL-të janë përgjegjëse për propozimin e buxhetit për ofrimin e shërbimeve sociale për viktimat e dhunës me bazë gjinore.[278] Kryetarët e komunave janë përgjegjës për koordinimin e MKL-ve. Kështu, çdo buxhet që nevojitet për funksionimin e MKL-ve ka të ngjarë të sigurohet nga granti i përgjithshëm për komunat, përmes buxhetit të zyrave të kryetarëve të komunave. Rregullorja nuk përcakton qartë se kush është përgjegjës për menaxhimin ose mirëmbajtjen e mbledhjes së të dhënave.

ZBGj-të shërbejnë si mekanizma profesionalë institucionalë përgjegjës për koordinimin, zbatimin, integrimin, monitorimin dhe promovimin e barazisë gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe të politikave publike. ZBGj-të duhet të marrin pjesë në planifikimin vjetor të prioriteteve dhe buxheteve komunale, duke e mbështetur përfshirjen e dimensionit gjinor dhe duke siguruar që aktivitetet për barazi gjinore të integrohen në planifikimin vjetor komunal.[279] Sipas Udhëzuesit të OSBE-së për funksionimin efektiv të mekanizmave koordinues lokalë kundër dhunës në familje, ZBGj-të duhet t'i mbështesin MKL-të dhe koordinatorët.[280] Udhëzuesi përcakton se koordinatorët janë përgjegjës për avokimin për një buxhet komunal për MKL-të. Të gjithë anëtarët e MKL-ve janë përgjegjës për ofrimin e të dhënave statistikore për dhunën ndaj grave dhe ndarjen e tyre sipas gjinisë dhe "komuniteteve" (përkatësisë etnike). Anëtarët e MKL-ve duhet të dorëzojnë raporte të rregullta narrative dhe statistikore, të paraqesin gjatë takimeve zhvillimet e fundit dhe sfidat me të cilat ballafaqohen, si dhe të koordinohen me anëtarët e tjerë të MKL-ve për t'i mbështetur viktimat e dhunës në familje.

Disa komuna kanë themeluar Mekanizma Koordinues Lokalë kundër Dhunës në Familje (MKL), me qëllim të forcimit të reagimit ndaj dhunës në familje, përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për viktimat, zbatimit më efektiv të kornizave ligjore dhe nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet faktorëve përkatës lokalë.[281] Deri në dhjetor 2018, në Kosovë ekzistonin 17 MKL, veçanërisht në komunat ku ndodhen strehimoret. Prej tyre, 15 e kishin formalizuar bashkëpunimin përmes memorandumeve të mirëkuptimit me autoritetet komunale, duke përfshirë kryetarët e komunave, policinë, QPS-të, zyrat e ndihmës juridike, prokurorinë dhe drejtorinë komunale të arsimit dhe shëndetësisë.[282]

Pas miratimit të LDhBGj-së dhe Rregullores për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, secila komunë duhet të themelojë një MKL.[283] Deri më tani nuk ka ndonjë analizë të mirëfilltë që tregon se sa prej tyre janë themeluar. Sipas monitorimit në terren nga Misioni i OSBE-së në Kosovë,

[276] RrGK, *Zero Tolerancë? Monitorimi i Reagimit Institucional ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë*, 2025
[277] Republika e Kosovës, Rregullore (QRK) – nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore[277], 2025.
[278] Po aty, neni 5.
[279] Republika e Kosovës, Rregullore (QRK) nr. 12/2016 për detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve përkatës për barazi gjinore në ministri dhe komuna, 2016.
[280] OSBE, Udhëzues për punë efektive të Mekanizmave Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje, 2023.
[281] Ibid.
[282] Këshilli i Evropës, Krijimi i programeve të trajtimit për kryerësit e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, 2021.
[283] Republika e Kosovës, Rregullore (QRK) – Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore, 2025.

mekanizmat lokalë ekzistojnë në 37 komuna në tërë Kosovën.[284] Gjatë viteve 2025 dhe 2026, në 11 komuna këta mekanizma ose janë themeluar rishtazi, ose janë rithemeluar përmes vendimeve të kryetarëve të komunave dhe/ose kuvendeve komunale.[285] Në shumicën e rasteve, kryetarët e komunave shërbejnë si kryesues, me disa dallime. Monitorimi i RrGK-së ka zbuluar se funksionimi i MKL-ve është mjaft jokonsistent ndërmjet komunave të ndryshme, me vetëm disa praktika të mira (p.sh., në Suharekë).

Me pëlqimin e përfituesit/es, QPS-të kanë përgjegjësinë ligjore për t'i menaxhuar rastet nga fillimi deri në mbylljen e tyre, në koordinim me institucionet përkatëse të përfshira në secilin rast. QPS-të duhet të emërojnë menaxherë të rasteve që janë përgjegjës për menaxhimin e tyre. Për efikasitet më të madh, punonjësit socialë duhet të jenë të specializuar në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.[286] QPS-të duhet t'i vlerësojnë nevojat për përmbushjen e detyrimeve të tyre për menaxhimin e duhur të rasteve dhe të kërkojnë mbështetjen përkatëse, duke përfshirë burimet financiare në buxhetet vjetore dhe afatmesme, për t'i përmbushur nevojat. DSHMS-ja duhet të bashkëpunojë me QPS-të për të planifikuar buxhetin në mënyrë adekuate për shërbimet sociale të specializuara.

Kapacitetet për BPGj për shërbimin e specializuar

Zyrtarët komunalë nuk dukej se e përdornin BPGj-në në planifikimin e buxheteve për MKL-të, koordinimin ose menaxhimin e shërbimeve sociale të specializuara.[287] Ndonëse ZBGj-të duhet t'i mbështesin politikat e integrimit gjinor, duke përfshirë buxhetet, shumë prej tyre shërbejnë njëkohësisht si drejtues të njësive për të drejtat e njeriut brenda komunave të tyre dhe kanë përgjegjësi për të drejtat e fëmijëve, personat me aftësi të kufizuara, dygjuhësinë dhe çështje të tjera. Portofolat e tyre të gjera e vështirësojnë përcjelljen dhe zbatimin gjithëpërfshirës të të gjitha detyrave që lidhen me barazinë gjinore dhe, rrjedhimisht, BPGj-në për shërbimet e specializuara për adresimin e dhunës me bazë gjinore.[288]

ZBGj-të zakonisht theksojnë se përfshirja e tyre në proceset e buxhetimit komunal dhe koordinimi me drejtoritë e tjera, duke përfshirë drejtoritë e financave, kanë kryesisht rol këshillëdhënës. Ato ftohen rrallë, për të mos thënë asnjëherë, për të dhënë kontribut gjatë fazave fillestare të planifikimit buxhetor. Një ZBGj tregoi se kontributi i saj zakonisht kërkohet vetëm gjatë hartimit të KAB-it dhe, madje edhe atëherë, ajo kontribuon me nismën e saj dhe jo përmes një procesi të strukturuar. Prandaj, intervistat vunë në pah një koordinim të pamjaftueshëm ndërmjet ZBGj-ve dhe zyrtarëve financiarë gjatë planifikimit të buxheteve komunale për MKL-të. Kjo vlen edhe për kostot e tjera që lidhen me shërbimet e specializuara për adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Të dhënat për përfituesit/et dhe ndikimet

Bazuar në LBGj-në, të gjitha institucionet duhet të mbledhin dhe t'i raportojnë ASK-së të dhëna të ndara sipas gjinisë.[289] ZBGj-të duhet të mbledhin të dhëna sasiore dhe cilësore që lidhen me zbatimin e LBGj-së, PKBGj-së dhe të gjitha strategjive e programeve institucionale

[284] Koment për draftin e raportit.

[285] Komunat e identifikuara përfshijnë Dragash/Dragaš (26 shkurt 2026), Fushë Kosovë/Kosovo Polje (23 shkurt 2026), Gjakovë/Đakovica (4 korrik 2025), Kamenicë/Kamenica (28 gusht 2025), Lipjan/Lipljan (24 mars 2026), Obiliq/Obilić (30 qershor 2025), Prishtinë/Priština (21 gusht 2025), Prizren (21 gusht 2026), Rahovec/Orahovac (23 prill 2026), Skenderaj/Srbica (14 gusht 2026) dhe Suharekë/Suva Reka (19 shkurt 2026).

[286] Republika e Kosovës, Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, 2022.

[287] Bisedat e RrGK-së me ZBGj-të, zyrtarët financiarë dhe drejtorët e mirëqenies sociale.

[288] Intervistat e RrGK-së me ZBGj-të, 2025.

[289] Republika e Kosovës, Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, 2015, neni 5 (1.8).

ose komunale.[290] Kryetari i komunës, si drejtues i MKL-së, duhet t'i paraqesë kuvendit komunal dhe Ministrisë së Drejtësisë raporte të rregullta për punën e MKL-së. Zyra e Koordinatorit Kombëtar ka krijuar një model të standardizuar të raportimit, i cili kërkon që MKL-të të raportojnë çdo gjashtë muaj. Mandatet e kryetarëve të komunave dhe të MKL-ve nuk kërkojnë shprehimisht që MKL-të të mbledhin të dhëna për moshën, përkatësinë etnike, aftësinë e kufizuar ose vendndodhjen.

Deri më tani, vetëm pak MKL janë mbledhur për të diskutuar raste specifike. Ndonëse Ministria e Drejtësisë mirëmban një bazë ndërinstitucionale të të dhënave për rastet e trajtuara të dhunës në familje, ku institucionet përkatëse raportojnë veçmas, numri i rasteve të trajtuara nga MKL-të mbetet i paqartë. Mungesa e përgjithshme e të dhënave për numrin e rasteve të menaxhuara nga MKL-të ose nga secili punonjës social, duke përfshirë rastet e dhunës me bazë gjinore, e vështirëson vlerësimin e kostove. Deri më tani nuk ka ndonjë analizë të mirëfilltë që të ketë shqyrtuar ndikimin e menaxhimit të koordinuar të rasteve te të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore.

Kërkesa për shërbime

Në përgjithësi, sipas të dhënave të Policisë së Kosovës dhe duke marrë parasysh nënraportimin, mund të vlerësohet se afërsisht 2.000 persona pësojnë dhunë me bazë gjinore çdo vit. Atyre mund t'u nevojiten shërbime të koordinuara dhe të specializuara nga QPS-të dhe MKL-të, përfshirë edhe në drejtim të parandalimit të përsëritjes së dhunës. Kjo nuk i merr parasysh fëmijët e prekur drejtpërdrejt ose tërthorazi nga dhuna me bazë gjinore, të cilëve gjithashtu u nevojiten plane të menaxhimit të rasteve.

Buxhetet dhe shpenzimet 2022–2026

Punonjësit socialë ofrojnë shërbime të specializuara dhe e koordinojnë hartimin dhe zbatimin e planeve të trajtimit për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, përmes QPS-ve. QPS-të buxhetohen në kuadër të DSHMS-së, duke u financuar nga granti i përgjithshëm për komunat. Komunat, konkretisht DSHMS-të, duket se nuk kanë kryer përllogaritje të kostove për t'i vlerësuar kostot e punonjësve socialë.

Krahasimi i buxheteve vjetore për periudhën 2023–2026 tregon se numri i stafit në linjat buxhetore të DSHMS-së nuk është rritur.[291] Komunat nuk kanë ndarë fonde shtesë për rekrutimin dhe trajnimin e punonjësve socialë shtesë, duke përfshirë nga dy punonjës socialë të specializuar në trajtimin e dhunës me bazë gjinore në secilën komunë dhe katër në Prishtinë, siç parashihet në Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale. Kjo ndodh pjesërisht për shkak të kufizimeve të përcaktuara nga MF-ja për numrin e lejuar të stafit për komunë, bazuar në formulën e financimit në grantin e përgjithshëm. Në mënyrë hipotetike, komunat mund të ndërpresin pozitat e panevojshme për të pasur mundësi financiare për këto pozita të reja. Kjo nuk është bërë, qoftë për shkak të mungesës së njohurive për Protokollin, qoftë për shkak të pamundësisë ose mungesës së vullnetit për t'u dhënë përparësi pozitave të tilla.

Mesatarisht, raportohet se punonjësit socialë menaxhojnë 58 raste.[292] Punonjësit socialë menaxhojnë disa lloje të ndryshme rastesh, prandaj është e vështirë të vlerësohen

[290] Republika e Kosovës, Rregullore (QRK) nr. 12/2016 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Zyrtarëve Përkatës për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna, 2016, nenet 9 dhe 10.

[291] Shih Shtojcën 3.

[292] Republika e Kosovës, KOMF dhe Terre des Hommes, Analiza e Qendrave për Punë Sociale: Sfidat në Aspektin Ligjor, Institucional dhe Funksional, 2023. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për numrin e rasteve të menaxhuara në një kohë të caktuar, në muaj dhe në vit, duke përfshirë rastet e vazhdueshme aktive dhe joaktive.

buxhetet dhe shpenzimet që lidhen me adresimin e dhunës me bazë gjinore. Sipas Strategjisë, një punonjës social nuk duhet të menaxhojë më shumë se 20 raste të dhunës me bazë gjinore.[293] Koha e shpenzuar për secilin rast gjithashtu mund të ndryshojë, varësisht nga kompleksiteti i rastit. Disa raste kërkojnë një ose dy vizita, ndërsa të tjerat mund të kërkojnë dhjetëra vizita, ose më shumë, gjatë disa viteve. Duket se nuk ekzistojnë të dhëna për kohën e nevojshme për rastet individuale të dhunës me bazë gjinore, të cilat do të mund të ndihmonin në përllogaritjen e nevojave për burime njerëzore. Punonjësit socialë raportuan se punojnë jashtë orarit, gjatë fundjavave dhe natën pa kompensim sipas Ligjit të Punës, në shkelje të të drejtave të tyre.

Duket se pak komuna kanë ndarë burime të dedikuara financiare për mbështetjen e MKL-ve.[294] Nga nëntë komunat që iu përgjigjën anketës së RrGK-së, vetëm një raportoi se kishte buxhetuar për MKL-në e saj.

Tabela 45. Buxhetet dhe shpenzimet komunale për MKL-të

Komuna	2022 Buxheti	2022 Shpenzimet	2023 Buxheti	2023 Shpenzimet	2024 Buxheti	2024 Shpenzimet	2025 Buxheti
Suharekë	1.520 €	1.280 €	1.520 €	1.280 €	1.520 €	1.900 €	3.800 €

Historikisht, disa komuna janë mbështetur në asistencën e jashtme të donatorëve, si financimi dhe mbështetja teknike nga UN Women dhe OSBE-ja. Ato i kanë financuar aktivitetet e MKL-ve, duke përfshirë trajnimet, fushatat ndërgjegjësuese dhe takimet koordinuese.

Kostot

Shuma që nevojitet për punësimin e së paku dy punonjësve socialë të specializuar në trajtimin e dhunës me bazë gjinore në secilën komunë dhe katër në Prishtinë mund të vlerësohet bazuar në pagat ekzistuese të punonjësve socialë. Kostoja shtesë do të arrijë në afërsisht 707.078 € në vit. Konkretisht, ajo do të jetë 18.130 € për secilën prej 37 komunave dhe 36.260 € për Prishtinën.[295] Ndërkohë, kjo nuk i merr parasysh kostot që lidhen me punën jashtë orarit, gjatë natës dhe fundjavave, bazuar në Ligjin e Punës. Gjithashtu, nuk i merr parasysh kostot shtesë që lidhen me menaxhimin e duhur të rasteve, si kostot e transportit dhe fondet emergjente.[296] Një analizë e plotë e kostove të menaxhimit të duhur të rasteve nga institucionet ishte përtej fokusit të këtij hulumtimi dhe kërkon analizë të mëtejshme.

RrGK-ja i ka trajnuar të gjitha MKL-të për menaxhimin e rasteve, referimin dhe Protokollin e ri Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale në Republikën e Kosovës. RrGK-ja vazhdon të ofrojë trajnime të vazhdueshme dhe mentorim. Ministria e Drejtësisë mund ta miratojë këtë kurrikulë dhe ta bëjë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e MKL-ve. Më pas, Ministrisë do t'i duhet të buxhetojë vetëm për trajnimin e MKL-ve të reja dhe trajnimin e vazhdueshëm për t'i ngritur më tej kapacitetet e MKL-ve në të ardhmen.

Kostot e tjera të koordinimit të MKL-ve janë minimale dhe mund të mbulohen përmes linjave ekzistuese buxhetore të kryetarëve të komunave. Për efikasitet, hapësirat e zyrave në komuna ose QPS mund të shfrytëzohen pa pagesë për takimet e MKL-ve. Zyrtarët e angazhuar në MKL tashmë marrin paga përmes linjave ekzistuese të buxhetit të Qeverisë. Ata tashmë

[293] Republika e Kosovës, Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026, 2022. Nuk përcakton gjatë cilës periudhë kohore, por me sa duket njëkohësisht.
[294] Anketa e RrGK-së me komunat dhe intervistat me ZBGj-të, 2025.
[295] Përllogaritja bazohet në pagën e punonjësve socialë duke përdorur koeficientin 6,7 dhe rritjen prej 0,5% për pesë vjet përvojë. Kjo rezulton në pagë mujore të vlerësuar prej afërsisht 755 € për të punësuar. Përllogaritja supozon dy punonjës socialë në secilën prej 37 komunave, duke rezultuar në 74 të punësuar, me kosto vjetore prej 670.817 €. Për Prishtinën, përllogaritja supozon katër punonjës socialë, duke rezultuar në kosto vjetore prej 36.260 €. Kostoja e përgjithshme vjetore e vlerësuar për të gjitha komunat është 707.078 €.
[296] Republika e Kosovës, Udhëzim Administrativ MD - Nr. 02/2025 për Përcaktimin e Procedurës për Ofrimin e Shërbimeve nga Fondi Emergjent për Nevojat e Viktimave Gjatë Qëndrimit në Polici, 2025, neni 3.

kanë kompjuterë, printerë, materiale për zyrë dhe pajisje të tjera të nevojshme për funksionimin e tyre. Pijet, si kosto mjaft e vogël, gjithashtu mund të sigurohen përmes zyrave të kryetarëve të komunave. Mund të ekzistojnë gjithashtu kosto që lidhen me zbatimin e planeve të veprimit të MKL-ve, si ndërgjegjësimi dhe aktivitetet informuese për promovimin e shërbimeve në përputhje me KS-në. Komunat gjithashtu mund të buxhetojnë për trajnimin e institucionalizuar të anëtarëve të MKL-ve.

Në përputhje me SKDhG-në dhe Udhëzimin Administrativ (MD) Nr. 02/2025 për Përcaktimin e Procedurës për Ofrimin të Shërbimeve nga Fondi Emergjent për Nevojat e Viktimave gjatë Qëndrimit në Polici, komunat duhet të ndajnë buxhet për fondet emergjente. Duke pasur parasysh se ky fond ende nuk ekziston në shumicën e komunave,[297] fillimisht ai mund të përllogaritet në shumën modeste prej 100 € në muaj, përkatësisht 12.000 € në vit. Intervistat e RrGK-së sugjerojnë se procedurat e gjata të prokurimit mund ta bëjnë të pamundur ofrimin e mbështetjes emergjente. QPS-të theksuan nevojën për para të imëta, në mënyrë që të mund të reagojnë shpejt për t'i mbështetur rastet me ushqim, barna, rroba, pelena dhe mjete të tjera që nevojiten urgjentisht gjatë qëndrimit të viktimave dhe fëmijëve të tyre në stacionet policore. Ato deklaruan se faturat e shpenzimeve pastaj mund të krahasohen me dosjet e rasteve dhe me paratë e imëta për qëllime verifikimi, transparence dhe llogaridhënieje.

Përfundim: Kostot e përgjithshme

Në Tabelën 46 përmblidhen shumat që duhet të buxhetohen në buxhetet për periudhën 2027–2029 për ofrimin e shërbimeve sociale të specializuara në përputhje me KS-në. Nëse themelohet në vitin 2027 si subvencion nga Ministria e Drejtësisë për një OShC të aftë për ofrimin e shërbimeve, e cila tashmë ka hapësirë zyre, **Linja telefonike SOS** do të kushtojë së paku 150.727 € për funksionimin. Nëse duhet të sigurohet dhe të pajiset një hapësirë e re, kostoja do të jetë më e lartë. Më pas, duhet të buxhetohen rreth 154.043 € për vitin 2028 dhe 157.124 € për vitin 2029.

Qendra e Referimit për Dhunën Seksuale duhet të themelohet urgjentisht pranë IML-së, me gjasë nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë. Themelimi i Qendrës në vitin 2027 do të kushtojë afërsisht 302.831 €, plus kostot e infrastrukturës. Vlera e parashikuar e buxhetit është 218.289 € për vitin 2028 dhe 222.655 € për vitin 2029.

Një **Qendër e Krizave për Rastet e Përdhunimit** duhet të themelohet në Prishtinë në vitin 2028 dhe të bëhet funksionale në vitin 2029. Kjo do të kërkojë vlerësim të fizibilitetit të kostove të infrastrukturës në vitin 2027. Më pas, kostot e funksionimit të saj do të jenë afërsisht 158.539 € në vitin 2029, pa kostot e qirasë. Ndonëse korniza e politikave që rregullon funksionimin e tyre ende nuk është krijuar, për menaxhimin gjithëpërfshirës të këtyre shërbimeve të specializuara, MPFVLÇ-ja duket se është institucioni më i përshtatshëm për t'i buxhetuar këto dhe për ta financuar funksionimin e tyre, duke pasur parasysh se ato ofrojnë shërbime ndërkomunale. Kjo mund të bëhet përmes burimeve të veta ose, nëse kjo nuk është e mundur, përmes kontraktimit të shërbimeve nga një OJQ (subvencione).

Ndonëse korniza ligjore parasheh që komunat mund të kontribuojnë financiarisht në funksionimin e strehimoreve, përgjegjësia kryesore i takon ministrisë përkatëse, aktualisht MPFVLÇ-së. Vlen të theksohet se **strehimoret** nuk i shërbejnë vetëm një komune, por disa komunave, përfshirë edhe përmes referimeve ndërmjet strehimoreve për arsye sigurie, hapësire dhe arsye të tjera. Aplikimi përmes procedurave të shumëfishta të prokurimit dhe raportimi për kontrata të shumëfishta si në Ministri, ashtu edhe në disa komuna, mund të krijojnë barrë shtesë administrative si për strehimoret, ashtu edhe për zyrtarët qeveritarë, e cila shoqërohet me kosto shtesë për burimet njerëzore. Kontratat e shumëfishta gjithashtu

[297] Bisedat e RrGK-së me 12 komuna në vitin 2026.

mund të çojnë në financim të pamjaftueshëm nëse financuesit nuk i ndajnë me kohë burimet e mjaftueshme. Ato mbartin rreziqe që lidhen me koordinimin e dobët të ndarjes së burimeve. Do të ishte më mirë që ministria përkatëse t'i merrte përsipër të gjitha kostot e financimit të strehimoreve, duke ulur kështu barrën administrative si për strehimoret, ashtu edhe për Qeverinë në menaxhimin e kontratave të shumëfishta. Financimi i strehimoreve ekzistuese do të kushtojë 2.339.631 € në vitin 2027, 2.605.110 € në vitin 2028 dhe 2.654.152 € në vitin 2029. Ndërkohë, komunat mund të kontribuojnë duke ndarë hapësira ose tokë për strehimoret dhe për zgjerimin e strehimoreve ekzistuese, në mënyrë që të strehohen të mbijetuarat/it dhe fëmijë shtesë, në përputhje me KS-në. Komunat mund të buxhetojnë për mbështetjen e renovimeve, kostot e të cilave mund të përllogariten në vitin 2027, duke shërbyer si bazë për kostot e ardhshme të ndërtimit.

Komunat gjithashtu mund të ndajnë **banesa sociale**, duke siguruar që rregulloret komunale të rezervojnë hapësira dhe t'i japin përparësi qasjes për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore. Komunat gjithashtu duhet ta përmirësojnë buxhetimin për **shërbimet sociale**, duke përfshirë së paku 18.130 € për dy punonjës socialë shtesë për komunë dhe katër në Prishtinë (36.260 €), gjithsej 707.078 € në vitin 2027, 722.634 € në vitin 2028 dhe 737.086 € në vitin 2029, duke marrë parasysh inflacionin. Nevojiten sisteme të përmirësuara për monitorimin dhe planifikimin e ngarkesës me raste dhe të orarit të punës, për ta vlerësuar më mirë kohën e nevojshme për menaxhimin cilësor të rasteve dhe numrin përkatës të punonjësve socialë që nevojiten në secilën komunë. Komunat duhet të buxhetojnë për MKL-të, banimin social në kuadër të drejtorive përkatëse komunale dhe fondet emergjente, duke ua lehtësuar QPS-ve qasjen në to. Përmirësimi i sistemeve të mbledhjes së të dhënave lidhur me menaxhimin e rasteve mund të mbështetë një buxhetim më të mirë për punonjësit socialë në të ardhmen, në bazë të nevojave reale.

Tabela 46. Parashikimi buxhetor për trajtimin e dhunës me bazë gjinore

Shërbimi sipas KS-së	Institucioni përgjegjës	Linja buxhetore (# emri)	Shuma që duhet të buxhetohet		
			2027	2028	2029
Linja telefonike SOS	Ministria e Drejtësisë (buxhet shtesë)	Subvencionet dhe transferet	150.727 €	154.043 €	157.124 €
Qendra e Referimit për Dhunën Seksuale	Ministria e Drejtësisë, IML (buxhet shtesë)	Pagat dhe mëditjet	150.195 €	153.499 €	156.569 €
		Mallrat dhe shërbimet	108.710 €	62.248 €	63.493 €
		Shpenzimet komunale	2.486 €	2.541 €	2.592 €
		Subvencionet dhe transferet	NA	NA	NA
		Investimet kapitale	41.440 €		
Qendra e Krizave për Rastet e Përdhunimit	MPFVLÇ [Propozuar] (buxhet shtesë)	Subvencionet dhe transferet [të propozuara]	218.966 €	155.498 €	158.539 €
		Investimet kapitale	NA	NA	NA
Strehimoret	MPFVLÇ (buxheti i përgjithshëm)	Subvencionet dhe transferet	2.339.631 €	2.605.110 €	2.654.152 €
	MPFVLÇ/komunat	Investimet kapitale	NA	NA	NA
Banimi social	Komunat	Investimet kapitale	NA	NA	NA

Tabela 46. Parashikimi buxhetor për trajtimin e dhunës me bazë gjinore

Shërbimi sipas KS-së	Institucioni përgjegjës	Linja buxhetore (# emri)	Shuma që duhet të buxhetohet		
			2027	2028	2029
Shërbimet sociale	Të gjitha komunat – drejtoria e mirëqenies sociale (përveç Prishtinës) (buxhet shtesë)	Pagat dhe mëditjet	18.130 €	18.529 €	18.900 €
Shërbimet sociale	Komuna e Prishtinës – drejtoria e mirëqenies sociale (buxhet shtesë)	Pagat dhe mëditjet	36.260 €	37.058 €	37.799 €
Fondi emergjent	Komunat – drejtoria e mirëqenies sociale (buxhet shtesë)	Mallrat dhe shërbimet	1.200 €	€	€

REKOMANDIME

Në bazë të gjetjeve, rekomandimet e RrGK-së i drejtohen secilit akter përgjegjës. Ato synojnë të jenë praktike, me kosto efektive dhe në përputhje me detyrimet e Kosovës sipas KS-së, LDhBGj-së, SKDhG-së dhe ligjeve e strategjive të tjera. Ndonëse Kuvendi i Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe shoqëria civile nuk kanë përgjegjësi dhe detyrime ligjore për zbatimin e ligjeve dhe politikave që lidhen me adresimin e dhunës me bazë gjinore, ky seksion përmban rekomandime brenda kompetencave të tyre.

Për Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës

Për Zyrën për Planifikim Strategjik

- Të shqyrtohen KASh-të dhe kërkesat buxhetore për të siguruar që ndarjet financiare të parapara në strategji dhe plane të veprimit të pasqyrohen në buxhete.

Për Agjencinë për Barazi Gjinore

- Të sigurohet kryerja e analizës adekuate gjinore për orientimin e të gjitha strategjive dhe planeve të veprimit, duke përfshirë BPGj-në për to. Të sigurohet që ato t'i identifikojnë qartë akterët përgjegjës për ndarjet buxhetore.
- Të sigurohet financim publik i parashikueshëm, adekuat dhe i qëndrueshëm për shërbimet e specializuara në përputhje me KS-në. Financimi nga donatorët mund ta plotësojë, por nuk duhet ta zëvendësojë financimin e qëndrueshëm publik.
- Të shqyrtohen KASh-të dhe buxhetet vjetore për të siguruar ndarje të mjaftueshme në përputhje me strategjitë dhe planet e veprimit.
- Të bashkëpunohet ngushtë me ekspertët e shoqërisë civile për t'i ngritur më tej kapacitetet e institucioneve për BPGj, veçanërisht pasi të rishikohet korniza ligjore për BPGj-në.

Zyra për Qeverisje të Mirë

- Të sigurohet që strategjitë dhe planet e ardhshme të veprimit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të përfshijnë veprime specifike për adresimin e shqetësimeve të GREVIO-s lidhur me qasjen në shërbime të specializuara, ose t'u referohen strategjive dhe planeve të tjera të veprimit që përmbajnë veprime të tilla. Të sigurohen ndarje të mjaftueshme buxhetore për to.

Për Ministrinë e Financave

- Të ndryshohet Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë për ta përkufizuar qartë dhe për ta bërë të detyrueshme BPGj-në, në përputhje me zotimet e Kosovës ndaj OZHQ-së 5.c.1 dhe Kornizës Gjinore të Shpenzimeve Publike dhe Llogaridhënies Financiare (PEFA), si pjesë e reformave të vazhdueshme të financave publike.
- Të ndryshohet Ligji për Financat e Pushtetit Lokal për ta përfshirë BPGj-në, në mënyrë që ndarjet të përllogariten duke u bazuar në nevoja dhe jo vetëm në numrin e popullsisë. Të krijohet një grant specifik për shërbimet sociale për të garantuar financimin e këtij sektori. Granti specifik do të siguronte financim të dedikuar për shërbimet sociale brenda sistemit të financimit komunal, duke parandaluar që këto shërbime të konkurrojnë me prioritetet e tjera komunale për burime. Të sigurohet që

formula të bazohet në analizën gjinore të nevojave dhe të marrë parasysh faktorë si popullsia, numri dhe kompleksiteti i rasteve të shërbimeve sociale, dhuna me bazë gjinore, grupet e cenueshme dhe mbulimi gjeografik i komunave, në vend se të mbështetet vetëm në numrin e popullsisë.

- Të krijohet një linjë e përhershme buxhetore në Buxhetin e Kosovës për financimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të strehimoreve, në përputhje me kërkesat e KS-së, LDhBGj-së dhe Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.
- Të rishikohet formulari i KASh-it për të kërkuar objektiva të qarta dhe të matshme, tregues, vlera bazë, caqe, veprime dhe ndarje të qarta buxhetore që i shoqërojnë ato. Të kërkohet përfshirja e BPGj-së në KASh për ta bërë të qartë se si financimi do të kontribuojë në synimet e barazisë gjinore. Të sigurohet që objektivat për adresimin e dhunës me bazë gjinore të jenë në përputhje me strategjitë dhe planet kombëtare të veprimit. Kjo do ta fuqizojë planifikimin buxhetor afatmesëm, do ta lehtësojë ndarjen e burimeve adekuate për përmbushjen e zotimeve sipas KS-së dhe do ta përmirësojë qasjen në shërbimet e specializuara për adresimin e dhunës me bazë gjinore.
- Të institucionalizohet publikimi vjetor i Deklaratës Buxhetore Gjinore (DBGj) si shtojcë, të ngjashme me Shtojcën aktuale të Buxhetit Gjinor, e cila dorëzohet me dokumentacionin vjetor buxhetor. DBGj-ja duhet ta zgjerojë shtojcën ekzistuese të BPGj-së, e cila kërkohet sipas qarkoreve buxhetore, duke përfshirë informacion shtesë në përputhje me OZHQ-në 5.c.1 dhe Kornizën Gjinore të PEFA-s, si analizën gjinore dhe objektivat, treguesit, vlerat bazë, caqet e qarta dhe ndarjet përkatëse buxhetore. Të kërkohet përmes qarkoreve vjetore buxhetore që organizatat buxhetore ta ofrojnë informacionin e nevojshëm për DBGj-në, duke siguruar që ai të përfshihet në shtojcat e tyre të BPGj-së.
- Të përfshihet sigurimi i cilësisë së BPGj-së në detyrat e zyrtarëve/eve të buxhetit dhe ata/o të trajnohen për shqyrtimin e kërkesave buxhetore nga kjo perspektivë, duke kërkuar sqarime dhe të dhëna të mëtejme nga organizatat buxhetore, sipas nevojës.
- Të krijohet bashkëpunim formal me Departamentin e Shërbimeve Sociale në MPFVLÇ për ridrejtimin e mallrave të konfiskuara (p.sh., ushqimit, veshmbathjes, produkteve higjienike) te strehimoret ose QPS-të, në vend që ato të asgjësohen. Kjo nismë do të kërkojë investim minimal buxhetor dhe mund të zbatohet duke përdorur infrastrukturën ekzistuese të logjistikës dhe magazinimit. Mund të krijohet një regjistër digjital (bazë e të dhënave) i nevojave të strehimoreve dhe QPS-ve për të siguruar shpërndarje të barabartë dhe të bazuar në nevoja ndërmjet komunave.
- Të sigurohet që komunat të kenë ndarë buxhete të mjaftueshme për punësimin e së paku dy punonjësve socialë shtesë përgjegjës për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në secilën komunë dhe katër në Prishtinë, sipas Protokollit për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale dhe në përputhje me përgjegjësitë e tyre.
- Të sigurohet publikimi i shtojcave të barazisë gjinore çdo vit krahas dokumenteve buxhetore, për ta rritur transparencën, fuqizuar llogaridhënien dhe monitoruar progresin lidhur me zotimet gjinore.
- Të krijohet një linjë e dedikuar buxhetore për linjën telefonike SOS.

Për Ministrinë e Drejtësisë

- Të ndryshohet dhe plotësohet KPRK-ja për të paraparë rrethana në të cilat profesionistëve të caktuar nuk do t'u kërkohet detyrimisht raportimi i krimeve, si p.sh. kur kjo do të ishte në interesin më të mirë të ofrimit të mbrojtjes dhe kujdesit të menjëhershëm për viktimën. Të sigurohet trajnim i plotë për këtë çështje, në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, për punonjësit shëndetësorë, në mënyrë që ata të mund t'i identifikojnë qartë rastet në të

cilat duhet ta raportojnë dhunën, si për shembull për ta parandaluar një krim të mëtejshëm.

- Të sigurohet që strategjitë dhe planet e veprimit të përmbajnë zotime të qarta buxhetore, duke përfshirë SKDhG-në e re në përgatitje.
- Të ndryshohet LDhBGj-ja për të siguruar mbrojtje të plotë në të gjitha aspektet nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore. Ndonëse neni 25 i referohet dhunës me bazë gjinore, paragrafi vijues përmend vetëm mbrojtjen nga dhuna në familje. Kjo duhet të ndryshohet në mënyrë që MKL-të t'i mbështesin të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, duke siguruar harmonizimin me nenin 25.
- Të sigurohen objektiva, tregues, vlera bazë dhe caqe të qarta, si dhe ndarjet përkatëse buxhetore për shërbimet e specializuara në KASh-in vjetor, duke e bërë të qartë se si shpenzimet e planifikuara pritet të kontribuojnë në barazinë gjinore dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore.
- Të përgatiten dhe të dorëzohen shtojcat e kërkuara të BPGj-së, të cilat i lidhin qartë ndarjet vjetore buxhetore me strategjitë dhe objektivat për adresimin e dhunës me bazë gjinore. Të paraqiten qartë ndarjet që lidhen me shërbimet e specializuara dhe të arsyetohet përllogaritja e tyre.
- Të ndryshohet Udhëzimi Administrativ (MD) Nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial, pasi neni 21 për mbajtjen e evidencës nuk kërkon të raportojë gjininë, përkatësinë etnike ose aftësinë e kufizuar të përfituesve/eve, apo numrin e ditëve gjatë të cilave është ofruar strehimi. Informacioni i tillë mund ta mbështesë përmirësimin e monitorimit të nevojave dhe buxhetimin e bazuar në dëshmi.
- Të hartohet dhe të miratohet legjislacioni sekondar për themelimin e Qendrave të Krizave për Rastet e Përdhunimit dhe të Qendrave të Referimit për Dhunën Seksuale, përkatësisht, në përputhje me KS-në dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës, dhe në konsultim të ngushtë me MPFVLÇ-në, Ministrinë e Shëndetësisë, IML-në dhe ekspertët e OShCG-ve. Të vlerësohen kostot e infrastrukturës dhe të themelimit të këtyre qendrave së bashku me këta akterë dhe Komunën e Prishtinës në vitin 2027, në mënyrë që ato të mund të buxhetohen siç duhet dhe të bëhen funksionale në vitin 2028.
- Të themelohet një Qendër e Referimit për Dhunën Seksuale në Prishtinë në vitin 2027, mundësisht si shërbim social multidisiplinor në kuadër të një spitali pranë IML-së, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë, IML-në, Ministrinë e Drejtësisë dhe ekspertët e OShCG-ve. Ajo duhet të ketë kapacitet për të ofruar mbështetje afatshkurtër, profesionale dhe të integruar mjekësore, forenzike dhe psikosociale. Qendra mund të funksionojë në mënyrë të pavarur, me kusht që të ketë stafin e nevojshëm të specializuar, objektet, pajisjet dhe rrugët e referimit për të siguruar kujdes gjithëpërfshirës të përqendruar te të mbijetuarat/it. Sipas modelit të përllogaritjes së kostove të paraqitur më lart, të ndahen së paku 302.831 € në vitin 2027, 218.289 € në vitin 2028 dhe 222.655 € në vitin 2029 për funksionimin e saj. Kjo kërkon një ndarje të re buxhetore. Të monitorohet kërkesa për shërbime gjatë periudhës 2027–2029 për të vlerësuar nëse nevojiten Qendra të Referimit për Dhunën Seksuale shtesë në zona të tjera gjeografike.
- Të buxhetohet Linja telefonike SOS në buxhetet për periudhën 2027–2029 si linjë e re buxhetore. Nëse Ministria kontrakton një OJQ ekzistuese për të ofruar këto shërbime, Linja telefonike do të kushtojë së paku 150.727 € për themelimin fillestar dhe funksionimin në vitin 2027 nga linja buxhetore e subvencioneve. Nëse duhet të sigurohet dhe të pajiset një hapësirë e re, kostoja do të jetë më e lartë. Duhet të buxhetohen rreth 154.043 € për vitin 2028 dhe 157.124 € për vitin 2029.
- Të buxhetohet trajnimi i zyrtarëve/eve financiarë/e dhe zyrtarëve/eve të programeve për BPGj, ose të bashkëpunohet ngushtë me ABGj-në, RrGK-në ose ekspertë/e të tjerë/a për ofrimin e këtij trajnimi, përfshirë trajnime rifreskuese.

- Të sigurohet zbatimi i BPGj-së për përllogaritjen e kostove të të gjitha shërbimeve të specializuara, duke u mbështetur në të dhënat ekzistuese për përfituesit/et e mëparshëm/me dhe përfituesit/et e parashikuar/a dhe duke përdorur metodologji të ngjashme me atë që paraqitet hollësisht në këtë raport.
- Të përmirësohet baza e të dhënave për identifikimin e rasteve të dhunës në familje, në mënyrë që t'i përfshijë të gjitha rastet e dhunës me bazë gjinore në përputhje me LDhBGj-në. Të kërkohet nga institucionet që t'i fusin rregullisht këto të dhëna, duke mundësuar analizë në kohë reale të trendeve, e cila mund ta orientojë kërkesën e ardhshme për shërbime dhe buxhetimin për përmbushjen e kësaj kërkese. Të sigurohet që rastet penale të identifikohen në mënyrë të vazhdueshme si raste që përfshijnë dhunën me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën në familje, edhe kur veprimi cilësohet juridikisht si një vepër tjetër penale sipas KPRK-së, në mënyrë që dimensioni i dhunës me bazë gjinore të mbetet i dukshëm në evidencat dhe statistikat penale. Kjo mund ta mbështesë buxhetimin për ngarkesën shtesë me punë, duke ndihmuar në përllogaritjen e kostove në të ardhmen.
- Të mblidhen të dhëna për numrin e rasteve të menaxhuara nga MKL-të. Të monitorohen edhe burimet e nevojshme për menaxhimin gjithëpërfshirës të rasteve, duke përfshirë menaxhimin nga punonjësit socialë në QPS.
- Të miratohen kurrikulat e trajnimit të RrGK-së për MKL-të si kurrikula zyrtare për t'u ofruar MKL-ve trajnime përcjellëse sipas nevojës në të ardhmen. Të buxhetohet trajnimi i vazhdueshëm i anëtarëve të MKL-ve.

Për Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare

- Të themelohet një Qendër e Krizave për Rastet e Përdhunimit në Prishtinë në vitin 2027, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Drejtësisë dhe ekspertët e OShCG-ve. Ajo duhet të kryejë funksione të specializuara dhe multidisiplinore mjekësore, psikosociale, ligjore, referimi dhe koordinimi, duke përfshirë kujdesin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për rehabilitim dhe riintegrim. Bazuar në modelin e përllogaritjes së kostove të paraqitur më lart, ajo duhet të ketë buxhet të vlerësuar prej 218.966 € në vitin 2027, pasuar nga 155.498 € në vitin 2028 dhe 158.539 € në vitin 2029 për funksionimin e vazhdueshëm. Kjo kërkon një ndarje të re buxhetore. Pas dy vjetësh funksionimi, të vlerësohet nevoja për Qendra shtesë të Krizave për Rastet e Përdhunimit në zona të tjera gjeografike bazuar në kërkesën, rastet e raportuara të dhunës seksuale dhe kriteret përkatëse të KS-së. Qendrat e ardhshme duhet të buxhetohen duke përdorur të njëjtin model të përllogaritjes së kostove, të përshtatur sipas inflacionit dhe bazuar në analizën e ndikimit gjinor.
- Të planifikohet zgjerimi i shërbimeve të strehimoreve në vitet e ardhshme për t'i përfshirë komunat e tjera, në përputhje me KS-në dhe duke përdorur këtë metodologji të përllogaritjes së kostove. Kostot duhet të përfshijnë burimet njerëzore, si dhe buxhetet për trajnime të vazhdueshme, për të siguruar që stafi të rekrutohet siç duhet, të paguhet në mënyrë të drejtë dhe të trajnohet mirë për të ofruar mbështetje efektive dhe të përqendruar te viktima.
- Të buxhetohen dhe të sigurohen trajnime të vazhdueshme dhe të specializuara, mbikëqyrje dhe mentorim për stafin profesional përgjegjës për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, duke i përditësuar rregullisht njohuritë dhe shkathtësitë e tyre, si dhe duke adresuar dhe eliminuar besimet dhe praktikat tradicionale që mund të ndikojnë në trajtimin e duhur të rasteve, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale.
- Të bashkëpunohet me MF-në për të krijuar një linjë dhe kod të përhershëm buxhetor për mbështetjen shumëvjeçare jo më pak se trevjeçare të strehimoreve ndërkomunale,

në përputhje me LDhBGj-në dhe Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, duke i mbuluar të gjitha kostot e strehimoreve. Duke pasur parasysh se strehimoret u shërbejnë disa komunave, ofrimi i një granti të vetëm për secilën strehimore mund ta zvogëlojë barrën administrative të strehimoreve për dorëzimin e aplikimeve të shumëfishta në procedurat e prokurimit dhe procedurat e tjera, koordinimin e buxheteve të shumëfishta dhe raportimin e shpenzimeve në disa komuna. Kjo përfshin sigurimin e alokimeve adekuate financiare për strehimore të specializuara, të përshtatura për nevojat specifike të fëmijëve (veçanërisht djemve të moshës 12 vjeç e lart), viktimave të trafikimit dhe personave LGBTQI+, duke përfshirë ndërtimin e infrastrukturës shtesë të strehimoreve ose identifikimin e zgjidhjeve të përshtatshme infrastrukturore, si hapësirat anekse në strehimoret ekzistuese.

- Të ndahet financim adekuat për **strehimoret** që ofrojnë shërbime të specializuara për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, bazuar në këtë metodologji të përllogaritjes së kostove, të integruar në modelin zyrtar të përllogaritjes së kostove që aktualisht është duke u finalizuar nga MPFVLÇ-ja. Ky model i përllogaritjes së kostove të përdoret çdo vit për analizimin e kostove të menaxhimit të duhur të rasteve nga institucionet, duke përfshirë kohën e stafit (dhe punën jashtë orarit, gjatë fundjavave dhe festave), transportin dhe kostot emergjente. Projeksionet na tregojnë se financimi i strehimoreve duhet të arrijë në 2.339.631 € në vitin 2027, 2.605.110 € në vitin 2028 dhe 2.654.152 € në vitin 2029 për të gjitha strehimoret ekzistuese. Kjo do të kërkonte financim shtesë përtej burimeve ekzistuese. Ai do të rritet me çdo strehimore shtesë.
- Të hartohet një plan afatgjatë për financimin e 134 vendstrehimeve familjare shtesë dhe për funksionimin e strehimoreve të reja në komunat e Fushë Kosovës, Suharekës, Podujevës dhe Lipjanit, në mënyrë që të sigurohet numri i vendstrehimeve që kërkon KS-ja. Në përputhje me KS-në, të buxhetohen strehimoret shtesë, përfshirë kostot e funksionimit të tyre, duke marrë parasysh se ato u shërbejnë disa komunave. Kjo mund të bëhet në bashkëpunim me komunat, të cilat mund të sigurojnë tokë dhe/ose hapësira ekzistuese për renovim.
- Të kryhen hulumtime të mëtejshme, së bashku me MMPHI-në, për të vlerësuar në mënyrë adekuate nivelin e kërkesës dhe kostot që lidhen me ofrimin e banimit social për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore gjatë kalimit të tyre drejt jetesës së pavarur.
- Të përmirësohen sistemet për monitorimin e ngarkesës me raste të punonjësve socialë, për të vlerësuar më mirë kohën dhe numrin e punonjësve socialë që nevojiten në secilën komunë. Si pjesë e raportimit të rregullt, të kërkohen të dhëna për numrin e rasteve të menaxhuara nga secili punonjës social në muaj, veçanërisht numrin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe kostot që lidhen me fondet emergjente, për buxhetim më të mirë të kostove të ardhshme.
- Të krijohet dhe të miratohet një metodologji për analizën gjinore të ndikimeve të menaxhimit të rasteve te përfituesit/et, së bashku me ABGj-në, RrGK-në dhe ekspertët e tjerë. Kjo metodologji duhet të përdoret si pjesë e monitorimit të rregullt për të orientuar përmirësimet në ofrimin e shërbimeve.

Për Ministrinë e Shëndetësisë

- Të krijohen dhe të financohen në mënyrë adekuate komponentët mjekësorë dhe të sektorit shëndetësor të Qendrës së Referimit për Dhunën Seksuale, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë, duke përfshirë ekzaminimin mjekësor, kujdesin klinik, personelin e trajnuar shëndetësor, infrastrukturën dhe pajisjet e nevojshme, si dhe kostot përkatëse të vazhdueshme.

- Të hartohen dhe të zbatohen protokolle të standardizuara për ekzaminimin mjekësor, trajtimin, dokumentimin dhe referimin e të mbijetuarave/ve të dhunës seksuale, në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet e tjera përkatëse.
- Të sigurohet që personeli i sektorit shëndetësor i angazhuar për reagim në rastet e dhunës seksuale të marrë trajnimin e specializuar të nevojshëm për të ofruar shërbime në përputhje me standardet profesionale në fuqi, dhe kostot përkatëse të trajnimit të përfshihen në planifikimin dhe buxhetin institucional.

Për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

- Të bëhet një dallim më i qartë ndërmjet formave të ndryshme të mbështetjes për banim për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë akomodimin emergjent, strehimoret e specializuara, akomodimin kalimtar, asistencën për qira dhe banimin social afatgjatë. Së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, MPFVLÇ-në dhe OShCG-të, të sigurohet që përkufizimet dhe format e mbështetjes të jenë të qarta. Të përcaktohen kritere të qarta për pranueshmërinë, kohëzgjatjen e mbështetjes dhe kalimin drejt jetesës së pavarur, si pjesë e një vazhdimësie më të gjerë të mbrojtjes, rimëkëmbjes dhe riintegrimit. Në përputhje me sa më sipër, komunave t'u ofrohen udhëzime dhe mbështetje për buxhetimin e llojeve të ndryshme të banimit social.
- Të finalizohet Strategjia e re e Banimit dhe Plani i Veprimit, duke siguruar analizë gjinore ndërsektoriale dhe integrim gjinor. Të përfshihet kërkesa që komunat të mbledhin dhe të raportojnë çdo muaj numrin e njësive dhe numrin e përfituesve/eve, të ndarë sipas gjinisë *dhe* moshës dhe përkatësisë etnike, për t'u përfshirë në bazën e të dhënave të banimit. Kjo të digjitalizohet për ta lehtësuar raportimin dhe për t'i vënë këto të dhëna në dispozicion online në kohë reale.
- Të analizohen ndikimet e banimit social te përfituesit/et e ndryshëm për të identifikuar përmirësimet e nevojshme në politika, financim dhe programim.

Për komunat: kuvendet komunale, kryetarët e komunave, drejtoritë e financave dhe mirëqenies sociale dhe zyrtarët/et për barazi gjinore

- Të përdoret BPGj-ja, përfshirë analizën e ndikimit gjinor, për të analizuar nevojat e ndryshme të grave dhe burrave. Pastaj, këto të dhëna të përdoren për t'i paraqitur Qeverisë qendrore kërkesa të bazuara në dëshmi lidhur me Grantin e Përgjithshëm, përfshirë ato për shërbimet e specializuara.
- Të sigurohen objektiva, tregues, vlera bazë dhe caqe të qarta, si dhe ndarje përkatëse buxhetore në KAB-e për shërbimet e specializuara, duke përdorur BPGj-në.
- Të përgatiten dhe të dorëzohen shtojcat e kërkuara të BPGj-së për buxhetet vjetore, duke i lidhur qartë ndarjet buxhetore me strategjitë dhe objektivat për adresimin e dhunës me bazë gjinore. Të paraqiten qartë ndarjet që lidhen me shërbimet e specializuara dhe të arsyetohet përllogaritja e tyre.
- Të shqyrtohen dhe ndryshohen politikat komunale të banimit social për të përcaktuar afate maksimale për shfrytëzimin e banimit social. Të parashihet vazhdimi i banimit social pas përfundimit të periudhave maksimale në rastet kur të mbijetuarave/ve të dhunës ende u nevojitet një mbështetje e tillë për sigurinë dhe rehabilitimin drejt jetesës së pavarur, bazuar në vlerësimet e menaxherëve të rasteve në QPS.
- Të ndahen burime të mjaftueshme për banimin social komunal për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, në përputhje me Ligjin për Banim Social dhe të Përballueshëm, bazuar në analizën e ndikimit gjinor, shfrytëzimin e strehimoreve dhe dëshmi të tjera për nevojat gjatë viteve të mëparshme.

- Të përdoret BPGj-ja për të fuqizuar arsyetimet për punësimin e më shumë punonjësve socialë, duke përcjellë çdo muaj numrin mesatar të rasteve të menaxhuara, përfshirë rastet e dhunës me bazë gjinore. Të paraqiten të dhëna të tilla në KAB-e dhe në shtojcat e BPGj-së për buxhetin, duke dëshmuar nevojën për ta rritur numrin dhe buxhetin për punonjësit socialë. Të analizohen burimet njerëzore komunale për të identifikuar nëse të gjitha pozitat janë të nevojshme dhe nëse ndonjëra duhet të hiqet për të ndihmuar në financimin e punonjësve socialë shtesë. Të ndahet buxhet i mjaftueshëm për punësimin e së paku dy punonjësve socialë shtesë (katër në Prishtinë), me kualifikime të përcaktuara për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në secilën komunë, në përputhje me Protokollin Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale dhe LDhBGj-në. Kjo duhet të kushtojë afërsisht 707.078 € në vitin 2027, 722.634 € në vitin 2028 dhe 737.086 € në vitin 2029, përveç buxheteve ekzistuese. Konkretisht, në vitin 2027, kostoja do të jetë 18.130 € për komunë për 37 komunat dhe 36.260 € për Prishtinën.
- Të buxhetohet nga fondet e kryetarëve të komunave për planet e MKL-ve, duke përfshirë funksionimin, ndërgjegjësimin dhe ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve.
- Të krijohen fonde të dedikuara për QPS-të për ofrimin e mbështetjes emergjente në kuadër të linjës buxhetore për mallra dhe shërbime të buxhetit të përgjithshëm. Të minimizohet barra administrative për shfrytëzimin e këtyre fondeve. Të përcillen më mirë kostot e mbështetjes emergjente dhe nevojat e përfituesve për këtë mbështetje, duke përdorur BPGj-në, për të siguruar informacion për buxhetet e ardhshme dhe përmbajtjen e një granti të mundshëm të posaçëm në të ardhmen për shërbimet sociale.
- Të ndahet mbështetje financiare për rehabilitimin e të mbijetuarave/ve, duke ofruar subvencione mujore për të mbështetur qasjen në strehim dhe nevoja të tjera, në kuadër të linjës buxhetore të subvencioneve, bazuar në praktikën më të mirë në Prishtinë. Të bëhen të qarta shuma dhe qëllimi i shpenzimeve të tilla në KAB-e dhe në shtojcat e BPGj-së. Të përmirësohet përcjellja e nevojës për një mbështetje të tillë për ta lehtësuar buxhetimin e bazuar në dëshmi, duke përfshirë përdorimin e këtyre të dhënave si bazë për çdo grant të mundshëm në të ardhmen për shërbimet sociale.
- Të sigurohet pjesëmarrja e ZBGj-ve në planifikimin e programeve, planeve dhe buxheteve komunale, sipas Rregullores (QRK) nr. 12/2016.
- Të gjenerohen të hyra vetanake për burime shtesë për mbështetjen e shërbimeve të specializuara, si përmes shqiptimit të gjobave për shkeljet në trafik dhe parkim.298
- Të buxhetohet për zgjerimin e disponueshmërisë së strehimoreve në përputhje me KS-në, duke ndarë dhe rinovuar hapësira komunale për këtë qëllim. Të buxhetohet për kryerjen e studimeve të fizibilitetit për zgjerimin ose rinovimin e hapësirave ekzistuese të strehimoreve në Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë, Pejë, Mitrovicë të Veriut dhe Novobërdë, duke e rritur numrin e vendstrehimeve familjare në dispozicion. Të kryhen studime të fizibilitetit për themelimin e strehimoreve në Fushë Kosovë, Suharekë, Podujevë dhe Lipjan në të ardhmen. Të sigurohet që infrastruktura t'u përshtatet nevojave të grave dhe fëmijëve nga grupe të ndryshme, duke përfshirë konsideratat e qasjes fizike për personat me aftësi të kufizuara. Punimet infrastrukturore të fillojnë në vitin 2027 ose 2028, duke përdorur një qasje me faza. Në vitet e ardhshme, të buxhetohet për shërbimet komunale dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Të ndahet banim social posaçërisht për të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, si pjesë e programeve trevjeçare të banimit social. Të buxhetohet për banim social shtesë, sipas nevojës.
- Të sigurohen mbledhje të rregullta të MKL-ve dhe të buxhetohet për kostot e koordinimit në kuadër të zyrës së kryetarit të komunës.

[298] Republika e Kosovës, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, 2008, neni 18.

Për Komunën e Prishtinës

- Të buxhetohen 3.280 € në vitin 2027 për pajisjen e strehimit për personat LGBTQI+ me orendi të nevojshme. Kjo kërkon një ndarje të re buxhetore.

Për Qendrat për Punë Sociale në komuna

- Të përmirësohet mbajtja e shënimeve në përputhje me praktikat më të mira të BPGj-së, duke monitoruar kostot për të bërë projeksione të bazuara në dëshmi dhe arsyetime më të fuqishme për financimin e nevojshëm.
- Të sigurohet digjitalizimi i të dhënave për numrin e rasteve të menaxhuara për secilin menaxher të rastit, për të lehtësuar monitorimin dhe BPGj-në.
- Të ofrohen mendime të ekspertëve gjatë proceseve të përzgjedhjes së përfituesve të banimit social. Të përcaktohen qëllime të qarta për banimin dhe afate të planifikuara kohore, si pjesë e planeve të menaxhimit të rasteve, duke monitoruar progresin. Të mbështeten të mbijetuarat/it në arritjen e pavarësisë, duke i liruar, pasi të pavarësohen, njësitë e banimit social për të mbijetuarat/it e tjerë.
- Të sigurohet që punonjësit socialë të punësuar në QPS të njihen dhe të klasifikohen si staf profesional i shërbimeve sociale, në vend se si nëpunës civilë të përgjithshëm. Statusi i tyre profesional, klasifikimi i vendit të punës dhe paga duhet t'i pasqyrojnë në mënyrë adekuate kualifikimet e tyre profesionale, përgjegjësitë e specializuara dhe kërkesat e licencimit.

Për Kuvendin e Republikës së Kosovës

- Të përfshihet KDPAK-ja në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke siguruar mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara nga dhuna dhe abuzimi, përfshirë dhunën me bazë gjinore, si dhe duke siguruar qasje në shërbime të asistencës, rimëkëmbjes dhe riintegrimit, përfshirë shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe masat e mbrojtjes sociale për gratë dhe vajzat.
- Të shqyrtohen për sigurimin e cilësisë dhe të miratohen ndryshimet e tjera ligjore të identifikuara në këtë seksion, të hartuara nga institucionet përgjegjëse.
- Të sigurohet që buxhetet për ofrimin e shërbimeve sociale të specializuara në përputhje me KS-në, të përshkruara në hollësi në seksionet në vijim, të pasqyrohen në buxhetet vjetore.

Për Institucionin e Avokatit të Popullit

- Të monitorohen ndarjet buxhetore në bashkëpunim të ngushtë me OShCG-të, duke u dhënë rekomandime institucioneve për përmirësimin e ndarjeve buxhetore për zbatimin e kornizës ligjore për mbrojtjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore, pa diskriminim në bazë të moshës, orientimit seksual ose aftësisë së kufizuar.

Për OShCG-të

- Të bashkëpunohet me Institucionin e Avokatit të Popullit për të ofruar hulumtime që shërbejnë si bazë për rekomandime të bazuara në dëshmi për përmirësimin e ndarjeve buxhetore për shërbimet e specializuara, pa diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Për strehimoret

- Të përmirësohet buxhetimi i bazuar në dëshmi.

- Të përcillen kohëzgjatja mesatare e qëndrimit dhe numri i përfituesve/eve, për të siguruar informacion për kostot e buxheteve të ardhshme.
- Të sigurohet që përllogaritja e kostove për vendstrehimet familjare të pasqyrojë të gjitha nevojat për mbështetje dhe mbrojtje të grave të shoqëruara nga fëmijët, duke përfshirë mbrojtjen e fëmijëve, hapësirat e përshtatshme për fëmijë, mbështetjen psikosociale, menaxhimin e rasteve, qasshmërinë, privatësinë, vazhdimësinë e shkollimit kur është e zbatueshme dhe rregullimet për referim.
- Të buxhetohet dhe të ofrohet trajnim shtesë për stafin e strehimoreve lidhur me mënyrën e mbështetjes së personave me probleme të shëndetit mendor dhe fizik, duke përfshirë trajnime të specializuara.

PUNIMET E CITUARA

Kuvendi i Republikës së Kosovës. *Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë*. 2008.

———. *Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore*. 2015.

———. *Ligji nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore*. 2023.

———. *Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092*. 2016.

———. *Ligji nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit*. 2013.

———. Ligji Nr. 08/L-002 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-091.

———. Ligji Nr. 08/L-188 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës. 2023.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. *Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë*. 2025.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF). *Analizë e Qendrave për Punë Sociale: Sfidat në Aspektin Ligjor, Institucional dhe Funksional*. 2023.

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave. *Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 për Dhunën me Bazë Gjinore ndaj Grave, që përditëson Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 19*. 2017.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. *Aktgjykimi KO207/22*. 2023.

Këshilli i Evropës. *Vlerësimi i harmonizimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës* me standardet e Konventës së Stambollit*. 2022.

———. *Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje*. 2011.

———. "Kuvendi Kombëtar i Kosovës* vendos ta zbatojë Konventën e Stambollit". 2020. https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/-/the-national-assembly-of-kosovo-decides-to-apply-the-istanbul-convention

———. Raporti Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje. 2011.

———. Hartëzimi i Shërbimeve Mbështetëse për Viktimat e Dhunës ndaj Grave në Kosovë. 2017.

———. Krijimi i Programeve të Trajtimit për Kryerësit e Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave. 2021.

Departamenti i Shëndetësisë. Shërbimet për Dhunën Seksuale: Pasqyrë Ndërkombëtare. 2012.

Komisioni Evropian. *Korniza Strategjike e BE-së për Romët për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje për 2020–2030*. 2020.

Komiteti Evropian i Rajoneve. "Kosova*-Kompetencat Fiskale". 2020.

Fondacioni Gratë e Bashkuara. Me çfarë çmimi? Përllogaritja e kostove të shërbimeve të specializuara për dhunën ndaj grave në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në përgatitje, 2026.

Instituti GAP. *Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor në Komuna*. 2023.

Rrjeti Mbikëqyrës i Buxhetimit Gjinor. *Monitorimi i Zbatimit të Trequesit 5.c.1 të OZHQ-ve në Kosovë*. 2020.

Qeveria e Kosovës. *Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024*. 2020.

Fondi Monetar Ndërkombëtar. *Republika e Kosovës: Shqyrtimet e Katërta në kuadër të Marrëveshjes për Gatishmëri dhe Marrëveshjes në kuadër të Instrumentit për Reziliencë dhe Qëndrueshmëri – Njoftim për Shtyp; Raport i Stafit; dhe Deklaratë e Drejtorit Ekzekutiv për Republikën e Kosovës*. 2025.

———. "Norma e Inflacionit, Çmimet Mesatare të Konsumit". Qasur më 22 korrik 2026. https://www.imf.org/external/datamapper/PCPIPCH@WEO/CIS.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore. *Nga Politika në Praktikë: Monitorimi i Zbatimit të Planeve Lokale të Veprimit për Barazi Gjinore në Kosovë*. 2025.

Rrjeti i Grave të Kosovës. *Udhërrëfyes Praktik: Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor në Nivel Lokal*. 2014.

———. *Me çfarë çmimi? Alokimet Buxhetore për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë*. 2012.

———. *Diskriminimi me Bazë Gjinore dhe Punësimi në Kosovë*. 2019.

———. *Zero Tolerancë? Monitorimi i Reagimit Institucional ndaj Dhunës me Bazë Gjinore në Kosovë*. 2025.

Agjencia e Statistikave të Kosovës. "Indeksi i Çmimeve të Konsumit". 2025. https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/

———. "Popullsia e Vlerësuar e Kosovës sipas Vitit dhe Popullsisë". 2024. https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__Population__Estimate,%20projection%20and%20structure%20of%20population__Population%20estimate/estimationCensus1921_2024.px/

Policia e Kosovës. Raporti Vjetor i Punës së Policisë së Kosovës. 2026. https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2026/02/Raporti-vjetor-i-pun%C3%ABs-s%C3%AB-Policis%C3%AB-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2025.pdf

———. Disa nga Rezultatet dhe të Arriturat e Policisë së Kosovës gjatë Vitit 2024. 2024. Qasur më 15 gusht 2026. https://www.kosovopolice.com/disa-nga-rezultatet-dhe-te-arriturat-e-policise-se-kosoves-gjate-periudhes-kohore-te-vitit-2024/?
Komuna e Gjakovës. Plani Vjetor i Punës së Ekzekutivit. 2022.
Komuna e Obiliqit. Programi Trevjeçar i Banimit, 2022–2024. 2021.
Komuna e Prishtinës. Buxheti i Komunës së Prishtinës për Vitin 2021. 2021.
———. Buxheti i Komunës së Prishtinës për Vitet 2023–2026. 2023.
———. Vendim për Mbështetje Financiare për Viktimat e Dhunës në Familje. 2022.
Komuna e Prizrenit. Buxheti i Komunës së Prizrenit për Vitet 2026–2028. 2025.
Komuna e Rahovecit. Planifikimi i Investimeve Kapitale 2023–2025. 2022.
Zyra e Kryeministrit. *Manuali për Vlerësimin e Ndikimit Gjinor.* 2019.
———. *Plani Kombëtar për Zhvillim 2024–2026.* 2023.
———. *Raporti për Zbatimin e Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022–2026 dhe Planit të Veprimit 2022–2024 për vitin 2023.* 2024.
———. *Raporti Përfundimtar i Vlerësimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024.* 2024.
———. "Mbledhja e 180-të e Qeverisë." https://kryeministri.rks-gov.net/en/news/the-180th-government-meeting/. Qasur më 24 korrik 2026.
Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). *Strehimoret për Viktimat e Dhunës në Familje.* 2019.
———. Vlerësimi i Banimit Social dhe Ndërtimit të Banesave në Kosovë 2018–2023. 2024.
———. Udhëzues për Punë Efektive të Mekanizmave Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje. 2023.
———. Anketa mbi Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë. 2019.
Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënia Financiare (PEFA). *GRPFM e Kosovës 2022, Aneksi Gjinor.* 2022.
Presidenca e Republikës së Kosovës. "U.D. Presidentja Haxhiu Përuroi Strehimoren e Parë Institucionale në Veri." Qasur më 7 korrik 2026. https://president-ksgov.net/u-d-presidentja-haxhiu-peruroi-strehimoren-e-pare-institucionale-ne-veri/
Republika e Kosovës. *Raporti Vjetor i Auditimit 2024.* 2025.
———. Udhëzim Administrativ (QRK) nr. 01/2025 për Linjën Telefonike Emergjente për Viktimat e Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës me Bazë Gjinore. 2025.
———. Udhëzim Administrativ (MD) nr. 03/2025 për Strehimin Rezidencial. 2025.
———. Raporti Vjetor për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026. 2024
———. Udhëzim Administrativ MD - nr. 14/2024 për Kriteret dhe Mënyrën për Licencimin e Punonjësit Profesional për Ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare. 2024
———. Udhëzim Administrativ MD - nr. 02/2025 për Përcaktimin e Procedurës për Ofrimin e Shërbimeve nga Fondi Emergjent për Nevojat e Viktimave Gjatë Qëndrimit në Polici. 2025.
———. *Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017–2021.*
———. *Qarkoret Buxhetore 2015/01.* 2014.
———. *Qarkoret Buxhetore 2025.* 2025.
———. *Koncept-Dokumenti për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor.* 2022.
———. *Kushtetuta e Republikës së Kosovës.*
———. *Ligji për Financat e Pushtetit Lokal.* 2008.
———. Ligji i Punës. 2010.
———. Ligji për Pagat në Sektorin Publik. 2022.
———. Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare. 2024.
———. *Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë 2022–2026.* 2022.
———. *Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026.* 2022.
———. *Programi i Projektligjeve të Qeverisë për Vitet 2026–2028.* 2025.
———. *Instrumenti i BE-së për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor: Agjenda e Reformave e Kosovës.* 2024.
———. Rregullorja (QRK) nr. 12/2016 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Zyrtarëve Përkatës për Barazi Gjinore në Ministri dhe Komuna. 2016
———. Rregullorja (QRK) – nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore. 2025.
———. Rregullore MD - nr. 01/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institutin për Mjekësinë Ligjore. 2025.
———. *Rregullorja nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.* 2011.
———. *Rezoluta për Miratimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.* 2018.
———. *Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022–2026 dhe Plani i Veprimit 2022–2024.* 2022.
———. *Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2025–2030.* 2025.
———. Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale. 2022
———. *Programi për Reforma në Ekonomi.* 2022.
———. *Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021–2025.* 2021.

———. *Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030*. 2023.
———. Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2026 për Procedurën e Dhënies, Përsëritjes, Pezullimit dhe Marrjes së Licencës për Ofruesit e Shërbimeve Sociale dhe Familjare. 2026.
SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë. "Rreth nesh." Qasur më 23 janar 2026. https://soskosova.org/about-us/
Sveçla, Xhelal. Postim në Facebook, 20 gusht 2024. Qasur më 23 shkurt 2026.
Kombet e Bashkuara. *Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave*. Rezoluta 34/180. Miratuar më 18 dhjetor 1979; hyrë në fuqi më 3 shtator 1981.
———. *Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*. Miratuar më 13 dhjetor 2006; hyrë në fuqi më 3 maj 2008.
———. *Konventa për të Drejtat e Fëmijës*. Rezoluta 44/25. Miratuar më 20 nëntor 1989; hyrë në fuqi më 2 shtator 1990.
UN-Habitat Kosovë. Postim në Facebook, 9 korrik 2026. Qasur më 17 korrik 2026.
Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara. Raporti i Vitit 2025 për Trafikimin me Njerëz: Kosova. 2025. Qasur më 7 gusht 2026. https://www.state.gov/reports/2025-trafficking-in-persons-report/kosovo/
UN Women. Treguesi 5.c.1 i OZHQ-ve.
Organizata Botërore e Shëndetësisë. Menaxhimi Klinik i të Mbijetuarave/ve të Përdhunimit dhe Dhunës nga Partneri Intim: Hartimi i Protokolleve për Përdorim në Institucionet Shëndetësore. 2020.
———. Udhëzues për Kujdesin Mjeko-Ligjor për Viktimat e Dhunës Seksuale. 2003.

SHTOJCAT

Shtojca 1. Proceset buxhetore dhe mundësitë për të ndikuar në buxhete

Për ta lehtësuar dhënien e kontributit të bazuar në dëshmi në proceset buxhetore, në këtë shtojcë përmblidhen afatet e proceseve buxhetore, duke përfshirë kohën kur secili institucion i përgatit projektbuxhetet afatmesme dhe vjetore, i konsulton ato me publikun dhe i miraton.

Në përgjithësi, Departamenti për Buxhet dhe Financa i MF-së është përgjegjës për planifikimin dhe zbatimin efektiv të buxhetit.[299] Afatet kyçe të përgatitjes së buxhetit përfshijnë 30 prillin për dorëzimin e KASh-it në Kuvendin e Republikës së Kosovës për miratim; 30 shtatorin për dorëzimin e propozimeve buxhetore nga komunat; dhe 31 tetorin për dorëzimin e Projektbuxhetit të Konsoliduar dhe Projektligjit për Ndarjet Buxhetore në Kuvend (shih Tabelën 47). Ministrive nuk u kërkohet shprehimisht të organizojnë konsultime publike për buxhet. Megjithatë, *të gjitha* ligjet dhe politikat duhet t'u nënshtrohen konsultimeve publike sipas procedurave të përcaktuara, gjë që vlen edhe për ligjin e buxhetit.[300]

Tabela 47. Datat kyçe në procesin vjetor buxhetor në nivel qendror

Data	Ngjarja / Aktiviteti	Përshkrimi
30 prill	Miratimi i KASh-it	Qeveria miraton KASh-in dhe ia dorëzon Kuvendit.
15 maj	Nxjerrja e Qarkores së Parë Buxhetore	Qarkorja përfshin udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetorë dhe kalendarin buxhetor.
28 qershor	Dorëzimi i kërkesave buxhetore	Organizatat buxhetore ia dorëzojnë kërkesat MF-së përmes Sistemit për Zhvillimin dhe Menaxhimin e Buxhetit dhe sistemit të Programit të Investimeve Publike, me arsyetime të plota të shpenzimeve.
28 qershor	Paraqitja e Kornizës Makrofiskale	Departamenti i Politikave Makroekonomike dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar Financiar e paraqet kornizën e re makrofiskale.
19 korrik	Nxjerrja e Qarkores së Dytë Buxhetore (nëse nevojitet)	I adreson çështjet e reja që lindin pas qarkores së parë.
26 korrik	Afati për informata shtesë	Organizatat buxhetore dorëzojnë informatat plotësuese të kërkuara në Departamentin e Buxhetit të MF-së.
19 gusht	Fillimi i dëgjimeve buxhetore	Dëgjimet fillojnë me zyrtarët/et e organizatave buxhetore, stafin e MF-së, Zyrën e Kryeministrit dhe përfaqësuesit/et e Komisionit Parlamentar.

[299] Republika e Kosovës, Departamenti për Buxhet dhe Financa, uebfaqja.

[300] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-025 për Nisma Legjislative dhe Rregullorja (QRK) nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik. Kjo Rregullore përcakton standardet dhe procedurat minimale për zhvillimin e konsultimeve publike gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit. Ajo përcakton mënyrën se si autoritetet publike duhet t'i angazhojnë palët e interesuara dhe publikun për të siguruar transparencën dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje. Ajo kërkon që, gjatë organizimit të takimeve publike, organi propozues të njoftojë së paku shtatë ditë kalendarike më herët, për të mundësuar kohë të mjaftueshme për përgatitje. Ftesat duhet ta përfshijnë projektpropozimin (nëse është në dispozicion), informatat përkatëse kontekstuale, hollësitë e takimit dhe informatat e kontaktit. Brenda shtatë ditëve duhet të përgatitet një përmbledhje e pikave dhe përfundimeve kryesore të takimit dhe t'u shpërndahet pjesëmarrësve/eve. Për konsultimet me shkrim, Rregullorja përcakton se publikut dhe palëve të interesuara duhet t'u jepen jo më pak se 15 ditë pune për dorëzimin e komenteve, nga data e shpalljes së konsultimit. Për aktet legjislative më komplekse ose më të rëndësishme, kjo periudhë mund të zgjatet deri në 60 ditë kalendarike.

Tabela 47. Datat kyçe në procesin vjetor buxhetor në nivel qendror

Data	Ngjarja / Aktiviteti	Përshkrimi
30 gusht	Përfundimi i dëgjimeve buxhetore	Përfundojnë përpjekjet për t'u pajtuar për shumat e përgjithshme buxhetore për secilën organizatë në buxhetin vjetor.
13 shtator	Vlerësimi përfundimtar makroekonomik	Departamenti i Politikave Makroekonomike dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar Financiar paraqet treguesit përfundimtarë makroekonomikë që lidhen me procesin buxhetor.
16 shtator	Fillimi i konsultimeve qeveritare	Fillojnë konsultimet për përcaktimin e kufijve përfundimtarë buxhetorë.
20 shtator	Përfundimi i konsultimeve qeveritare	Përcaktohen kufijtë përfundimtarë buxhetorë.
23 shtator	Nxjerrja e Qarkores së Tretë Buxhetore	Përfshin kufijtë përfundimtarë buxhetorë, të cilët mund të ndryshojnë nga kufijtë në qarkoret e mëparshme.
30 shtator	Fillimi i dorëzimit të ankesave	Organizatat buxhetore dorëzojnë ankesat lidhur me kufijtë buxhetorë.
3 tetor	Përfundimi i dorëzimit të ankesave	Afati për dorëzimin e ankesave në Qeveri.
7 tetor	Fillimi i shqyrtimit të ankesave	Fillojnë mbledhjet e Qeverisë për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve lidhur me ankesat.
10 tetor	Përfundimi i shqyrtimit të ankesave	Qeveria përfundon shqyrtimin e ankesave buxhetore.
18 tetor	Dorëzimi i projektbuxhetit të parë	MF-ja ia dorëzon Qeverisë projektin e parë të buxhetit vjetor.
21 tetor	Fillimi i miratimit përfundimtar nga Qeveria	Qeveria fillon shqyrtimin për miratimin përfundimtar të projektbuxhetit vjetor.
24 tetor	Përmbyllja e miratimit përfundimtar nga Qeveria	Qeveria përfundon miratimin e projektbuxhetit vjetor.
31 tetor	Dorëzimi i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës	Qeveria ia dorëzon Kuvendit të Kosovës propozimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe Propozimin për Ndarjet Buxhetore.
31 dhjetor	Miratimi i buxhetit kombëtar	Kuvendi i Kosovës e miraton buxhetin për vitin e ardhshëm fiskal.

Në Tabelën 48 paraqiten afati kohor dhe procesi i planifikimit të buxhetit komunal. Deri më 30 shtator, kuvendet komunale duhet t'i miratojnë propozimet e buxheteve komunale.[301] Pas miratimit nga kuvendi komunal, komunat duhet t'ia dorëzojnë MF-së propozimet e miratuara buxhetore, së bashku me dokumentet mbështetëse, deri më 30 shtator. Këto përfshijnë një letër përcjellëse të nënshkruar nga kryetari/ja i/e komunës, vendimin e Kuvendit Komunal për miratim dhe tabela të ndryshme të buxhetit komunal. Në mesin e këtyre tabelave është edhe Shtojca e BPGj-së.

Në secilën komunë, gjatë gjashtë muajve të parë të vitit duhet të mbahet një takim publik.[302] Gjithashtu, komunat duhet të mbajnë periodikisht takime publike, së paku dy herë në vit, në të cilat mund të marrë pjesë çdo person ose organizatë që ka interes në komunë.[303] Data dhe vendi i takimit duhet të bëhen publike së paku dy javë më herët. Për më tepër, komunat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët për çdo plan ose program të rëndësishëm me interes publik.

[301] Republika e Kosovës, *Qarkorja Buxhetore 2025*, 2024.
[302] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, neni 68.
[303] Ibid.

Tabela 48. Datat Kyçe në Procesin Vjetor Buxhetor në Nivel Komunal

Data	Ngjarja / Aktiviteti	Përshkrimi
30-prill	Dorëzimi i KASh-it	Qeveria i dorëzon KASh-in Kuvendit të Kosovës, duke paraqitur prioritetet fiskale dhe kufijtë e shpenzimeve.
15 maj	Nxjerrja e Qarkores së Parë Buxhetore	MF-ja nxjerr Qarkoren e Parë Buxhetore, e cila përfshin udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetorë dhe kalendarin buxhetor.
30 qershor	Dorëzimi i KAB-eve komunale	Secila komunë i dorëzon MF-së KAB-in e vet të miratuar nga Kuvendi Komunal.
Qershor–korrik	Planifikimi i brendshëm i buxhetit komunal	Zyrtari Kryesor Financiar nxjerr Qarkoren e Parë të Brendshme Buxhetore Komunale, me të cilën u kërkon drejtorive t'i përgatisin propozimet buxhetore. Më pas, zyrtari nxjerr Qarkoren e Dytë të Brendshme me kufijtë e shpenzimeve dhe Qarkoren e Tretë të Brendshme me orarin e dëgjimeve buxhetore.
15 gusht	Nxjerrja e Qarkores së Dytë Buxhetore	MF-ja nxjerr Qarkoren e Dytë Buxhetore, duke ofruar udhëzimet përfundimtare buxhetore dhe ndarjet përfundimtare të granteve.
1 shtator	Dorëzimi i projektbuxhetit komunal	Kryetari/ja i/e komunës i dorëzon Kuvendit Komunal propozimin e projektbuxhetit komunal për vitin vijues.
30 shtator	Miratimi dhe dorëzimi i buxhetit komunal	Kuvendi Komunal miraton buxhetin komunal për vitin e ardhshëm dhe ia dorëzon MF-së.
31 tetor	Dorëzimi i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës	Qeveria i dorëzon Kuvendit të Kosovës propozimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe Propozimin për Ndarjet Buxhetore.
31 dhjetor	Miratimi i buxhetit kombëtar	Kuvendi i Kosovës miraton buxhetin për vitin e ardhshëm fiskal.

Shtojca 2. Buxhetet komunale për stafin që ofron shërbime sociale

Në Tabelën 49 paraqitet numri i përgjithshëm i stafit në departamentet e mirëqenies sociale që ofrojnë shërbime sociale dhe shërbime rezidenciale për periudhën 2022–2026, bazuar në buxhetet komunale. Po ashtu, paraqiten pagat dhe shtesat e buxhetuara për secilin vit.

Tabela 49. Buxhetet komunale për stafin që ofron shërbime sociale

Komuna	Linja buxhetore	Stafi 2022	Pagat 2022	Stafi 2023	Pagat 2023	Stafi 2024	Pagat 2024	Stafi 2025	Pagat 2025	Stafi 2026	Pagat 2026
Deçan	Shërbimet sociale	10	64.002	10	63.600	10	77.377	10	85.217	10	95.652
	Shërbimet rezidenciale	8	89.250	8	90.000	8	88.318	8	100.000	8	100.000
Gllogoc	Shërbimet sociale	14	91.503	14	91.961	14	109.530	14	166.422	14	139.122
	Shërbimet rezidenciale										
Gjakova	Shërbimet sociale	18	109.000	18	120.000	16	115.000	18	111.339	18	186.261
	Shërbimet rezidenciale					13	50.000	6	50.000	5	50.000
Gjilani	Shërbimet sociale	17	100.530	17	105.100	16	111.451	16	111.451	16	143.220
	Shërbimet rezidenciale					10	56.105	10	56.105	10	102.500
Dragash	Shërbimet sociale	10	54.000	10	54.000	10	69.000	10	70.000	10	87.925
	Shërbimet rezidenciale										
Istog	Shërbimet sociale	12	73.000	12	80.000	12	90.191	12	92.893	12	108.923
	Shërbimet rezidenciale	12	94.500	13	94.500	13	96.539	13	101.000	14	131.361
Kaçanik	Shërbimet sociale	9	50.348	9	50.972	8	52.545	8	61.120	8	74.658
	Shërbimet rezidenciale										
Klinë	Shërbimet sociale	11	75.200	11	77.700	11	91.162	11	90.104	11	103.409
	Shërbimet rezidenciale	0		0		13	50.000	13	71.000	13	127.510
Fushë Kosovë	Shërbimet sociale	10	65.378	10	64.473	10	76.123	10	75.746	10	89.724
	Shërbimet rezidenciale										
Kamenicë	Shërbimet sociale	12	74.500	12	78.228	13	79.000	13	97.354	12	114.952
	Shërbimet rezidenciale	10	89.250	11	90.000	11	77.272	11	100.000	11	109.579
Leposaviq	Shërbimet sociale	10	54.423	10	59.352	10	77.851	10	46.670	10	56.235
	Shërbimet rezidenciale										
Lipjan	Shërbimet sociale	13	73.510	13	81.764	13	102.268	13	105.874	13	112.793
	Shërbimet rezidenciale	10	89.250	10	90.000	10	77.066	10	100.000	10	100.000
Obiliq	Shërbimet sociale	11	70.978	11	83.000	11	75.692	11	84.465	10	95.027

Tabela 49. Buxhetet komunale për stafin që ofron shërbime sociale

Komuna	Linja buxhetore	Stafi 2022	Pagat 2022	Stafi 2023	Pagat 2023	Stafi 2024	Pagat 2024	Stafi 2025	Pagat 2025	Stafi 2026	Pagat 2026
	Shërbimet rezidenciale										
Rahovec	Shërbimet sociale	15	100.780	15	101.284	15	102.625	15	108.000	15	136.000
	Shërbimet rezidenciale										
Pejë	Shërbimet sociale	21	134.760	21	135.434	20	160.209	20	154.801	21	187.901
	Shërbimet rezidenciale					10	52.505	10	52.500	10	52.500
Podujevë	Shërbimet sociale	13	80.285	13	81.229	13	101.207	13	106.267	14	138.724
	Shërbimet rezidenciale					13	91.390	13	104.648	13	110.198
Prishtinë	Shërbimet sociale	49	265.000	47	280.000	47	360.000	47	360.000	47	413.627
	Shërbimet rezidenciale			60	465.000	70	490.000	70	490.000	66	577.581
Prizren	Shërbimet sociale	28	173.559	28	191.135	28	221.051	26	199.323	26	261.469
	Shërbimet rezidenciale	13	175.000	24	184.500	24	177.483	24	183.243	24	199.829
Skenderaj	Shërbimet sociale	17	100.130	17	87.000	17	101.954	17	118.300	17	170.000
	Shërbimet rezidenciale	14	94.500	13	94.500	13	95.981	13	100.000	13	159.526
Shtime	Shërbimet sociale	10	55.218	10	55.300	10	75.744	10	74.000	10	86.000
	Shërbimet rezidenciale	10	89.250	10	90.000	10	78.712	10	100.000	10	100.000
Shtërpcë	Shërbimet sociale	8	49.387	8	48.579	8	59.166	8	64.977	8	78.112
	Shërbimet rezidenciale										
Suharekë	Shërbimet sociale	13	77.000	13	76.000	13	97.000	13	101.000	12	113.000
	Shërbimet rezidenciale										
Ferizaj	Shërbimet sociale	16	94.839	16	97.940	16	119.900	17	125.821	17	132.051
	Shërbimet rezidenciale	10	89.250	10	90.000	10	79.096	10	100.001	10	94.568
Viti	Shërbimet sociale	10	57.160	10	57.150	19	130.000	15	120.000	15	133.055
	Shërbimet rezidenciale										
Vushtrri	Shërbimet sociale	13	80.345	13	80.900	13	92.965	13	92.300	13	111.228
	Shërbimet rezidenciale	11	89.250	11	90.000	11	86.434	11	100.000	11	100.000
Zubin Potok	Shërbimet sociale	12	70.000	12	65.000	13	76.006	13	76.006	13	76.006
	Shërbimet rezidenciale										
Zveçan	Shërbimet sociale	12	63.727	12	64.000	12	81.305	12	65.377	12	86.400
	Shërbimet rezidenciale										
Malishevë	Shërbimet sociale	11	65.283	9	66.265	9	119.835	9	81.591	9	92.407

Tabela 49. Buxhetet komunale për stafin që ofron shërbime sociale

Komuna	Linja buxhetore	Stafi 2022	Pagat 2022	Stafi 2023	Pagat 2023	Stafi 2024	Pagat 2024	Stafi 2025	Pagat 2025	Stafi 2026	Pagat 2026
	Shërbimet rezidenciale					11	50.000	11	59.590	11	71.496
Novobërdë	Shërbimet sociale	4	34.000	4	27.000	4	33.000	4	31.330	4	38.452
	Shërbimet rezidenciale	11	89.250	10	89.250	11	73.297	11	100.000	11	100.000
Mitrovica e Veriut	Shërbimet sociale	14	80.988	14	81.500	12	78.030	12	85.000	12	101.000
	Shërbimet rezidenciale										
Mitrovica e Jugut	Shërbimet sociale	25	153.508	32	167.500	28	188.480	28	191.000	24	232.378
	Shërbimet rezidenciale					10	52.500	10	52.500	66[304]	52.500
Junik	Shërbimet sociale	2	10.538	2	11.426	2	12.519	2	13.089	3	20.194
	Shërbimet rezidenciale										
Hani i Elezit	Shërbimet sociale	3	19.540	3	19.728	3	24.059	3	24.585	3	28.200
	Shërbimet rezidenciale										
Mamushë	Shërbimet sociale	2	12.820	2	12.851	2	13.904	2	16.203	2	18.184
	Shërbimet rezidenciale										
Graçanicë	Shërbimet sociale	4	24.526	4	24.633	4	27.725	4	28.989	5	43.425
	Shërbimet rezidenciale	19	25.757	19	179.250	19	128.311	19	200.000	19	200.000
Ranillug	Shërbimet sociale	4	25.757	4	26.000	4	27.207	4	30.838	4	37.105
	Shërbimet rezidenciale										
Partesh	Shërbimet sociale		NA								
	Shërbimet rezidenciale		NA								
Kllokot	Shërbimet sociale		NA								
	Shërbimet rezidenciale		NA								

[304] Megjithëse ky numër duket i lartë, ai ishte numri zyrtar i publikuar në dokumentet buxhetore.

International Partnerships Austria

Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

ME ÇFARË ÇMIMI?

Vlerësimi i kostove të shërbimeve të specializuara për adresimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë